



PLANI I ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

PLANI I PERGJITHSHEM VENDOR
BASHKIA SHKODER

2015-2030

Univesiteti Polis
Arizona State University
Metropolis sh.p.k
Bashkia Shkodër





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË SHKODËR

MIRATOHET

KRYETARI I KKT-së

Z. EDI RAMA

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Z. XHEMAL BUSHATI

Miratuar me vendim të këshillit të bashkisë _____nr._____

datë_____

Hartuar nga: Bashkia SHKODËR

Subjekti i kontraktuar: Universiteti POLIS, Arizona State University, Metropolis Sh.p.k

Subjekti mbështetës:_____

Me financim të: MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

| 1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë | | |
|--|-------------------------|---|
| Emërtimi | Vlera dhe njësia | Specifikime |
| Sipërfaqja e njësisë vendore | 802.702 ha | S. Totale Urbane= 138168147.6 S. Territori Bujqësor= 1112177682 |
| Numri i popullsisë ekzistuese | 137 760 | |
| Zona të rëndësisë kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore | 258182098 m2 | |
| Sipërfaqe e miratuar zonash informale | | |
| Problematika mjedisore | | Erozioni; Mbetjet; ndotja e ujërave; përmbytjet; ish-vendepozitime mbetjesh |

| 2. Propozime të PPV -së | | |
|--|--|------------------------------|
| Emërtimi | Vlera dhe njësia | Specifikime |
| Lloji i zhvillimit të pritshëm në 15 vitet e ardhshme | Rigjenerim, rikualifikim, densifikim, konservim | Strategjike |
| Përdorimet kryesore të propozuara të tokës | A. Banim, B. Bujqësi. S. Shërbime, Industri dhe Ekonomi IE, Infrastrukturë IN, Institucione INS, Aktivitete social rekreative (ASR), Natyrë N, Ujore U | Mix |
| Numri i popullsisë së pritshme shtesë në 15 vitet e ardhshme | 244572 | (kapaciteti mbajtes) |
| Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar për banim | | |
| Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar jo për banim | 0.73 ha | Hapsire publike |
| Sipërfaqe e përgjithshme e zonave në mbrojtje | 851 ha | Rrjeti i Zonave të mbrojtura |
| Sipërfaqe e përgjithshme e banesave për strehim social | 6000 apartamente të propozuara | |
| Sipërfaqe të gjelbra shtesë | + 20% | |

| | | |
|-----------------------------|-----|--|
| Numri i njësive strukturore | 814 | |
|-----------------------------|-----|--|

| 3. Të dhëna financiare | | |
|--|------------------------------------|--|
| Emërtimi | Vlera dhe njësia | Specifikime |
| Vlera e përgjithshme e planit e investimeve kapitale | _____ lekë | Në përputhje me PBA |
| Fazat e zbatimit të zhvillimit | Çdo 3 vite ose periudhat përkatëse | 2016-2018 2018-2021 2021-2025 2025-2030 |
| Studimin teknik të parafizibilitetit | | |

| 4. Dokumenti i PPV - së për dorëzim | | | | |
|--|------------------------------------|--|--------------------------|-------------------|
| Nr. | Kapitulli/ Dokumenti | Hartohet/ Miratohet | Referenca Ligjore | Check List |
| 1. | Strategjia territoriale | Hartohet dhe miratohet | Neni 51, 52 | |
| 2. | Analiza dhe vlerësimi i territorit | Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit | Neni 51,53 | |
| 3. | Parashikimet e planit | Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit | Neni 51, 54 | |
| 4. | Vlerësimi strategjik mjedisor | Hartohet dhe miratohet | Neni 51 | |
| 5. | Materiali hartografik | Hartohen dhe miratohen | Neni 51, 57 | |
| 6. | Rregullorja e PPV - së | Hartohet dhe miratohet | Nenet 51, 56 | |

| 5. Hartat bashkëlidhur dokumentit të shkruar të PPV - së sipas rregullores së planifikimit | | | | | |
|---|--------------------------|--|----------------|----------------------|-------------------|
| Nr. | Tematika e hartës | Lloji i hartës | Shkalla | Kodi i hartës | Check list |
| 1. | Harta bazë | Harta bazë vektoriale e njësisë vendore dhe topografia | 1:100 000 | | |

| | | | | | |
|----|---|--|------------|--|--|
| 2. | Vizioni strategjik i zhvillimit të territorit | Drejtimet kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit; objektivat; fazat kohore të zbatimit të programeve | 1: 100 000 | | |
| 3. | Elementet ekzistuese të territorit | Topografik; gjeologo -inxhinierik; hidrogjeologjik dhe hidrografik; e makrozonimit dhe, sipas rastit, mikrozonimit sizmik; boniteti i tokave; burimet natyrore, si: mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, miniera dhe të tjera të kësaj natyre; zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike. | 1: 100 000 | | |
| 4. | Pozicionimi strategjik në raport me rajonin | Kufijtë territorialë në rajon; Identiteti historik, urban, ekonomik | 1:100 000 | | |
| 5. | Vlerësimi ekonomik | Pozicionimi dhe përqendrimi i burimeve dhe poleve ekonomike lokale; elementet e konkurrueshmërisë; shpërndarja e sektorëve dhe e fuqisë punëtore. | 1: 100 000 | | |
| 6. | Vlerësimi social | Shërbimet sociale; shkollat; shëndetësia | 1: 100 000 | | |
| 7 | Vlerësim demografik | Përqendrimi i popullsisë në territor; lëvizjet e popullsisë në vite; shpërndarja e popullsisë në nivel banese dhe për tipologji banesash; sipërfaqen e banimit për person sipas tipologjive të banesave; numri i banesave në një strukturë banimi sipas tipologjive në territor. | 1: 100 000 | | |
| | Analiza e planeve të mëparshme | Përdorimi i tokës; infrastrukturat; intensiteti i ndërtimit | 1: 100 000 | | |
| | Pronat | Përdorimi i pronave publike; problemet në marrëdhëniet e pronësisë në territor; zonat informale sipas llojeve dhe ecurisë së integrimi | 1:50 000 | | |

| | | | | |
|----------------------------------|---|------------|--|--|
| Rëndësia kombëtare | Zonat dhe strukturat | 1: 100 000 | | |
| Problemet mjedisore | Vendndodhja e elementeve ndotëse dhe me ndikim negativ; Shkalla e ndikimit negativ të burimeve ndotëse në territor | 1:100 000 | | |
| Përdorimi ekzistues i tokës | Kategori bazë; nënkategoritë; funksionet dhe aktivitetet | 1: 20 000 | | |
| Infrastrukturat | Furnizimi me ujë; ujërat e zeza; mbetjet urbane; rrugët; ndriçimi ; transporti; lidhja me infrastrukturat kombëtare | 1: 100 000 | | |
| Cilësia fizike e strukturave | Nivelet e cilësisë; rekomandime për riparim, rigjenerim, rihvillim. | 1: 20 000 | | |
| Tipologjitë hapësinore | Zona sipas njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes në parcelë dhe në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave | 1: 100 000 | | |
| Periferaliteti | Zona sipas: largësisë nga qendra e zonës së banuar; largësisë nga qendrat e punësimit; lidhjes me sistemin rrugor; furnizimin me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; nivelit të përafërt të të ardhurave të shtresave shoqërore; plotësimit me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës; nivelit të kriminalitetit dhe sigurisë së jetës; problemeve të ndryshme sociale përfshirë përjashtimin social | 1: 100 000 | | |
| Elemente të veçanta territoriale | Objekte dhe struktura, natyrore apo artificiale, me ndikim në qytet dhe hapësirëformim | 1:100 000 | | |
| Nevojat për strehim | Zona sipas nevojës dhe cilësisë | 1:100 000 | | |
| VSM | Hartat përshkruese, analizuese dhe vlerësuese | | | |
| Parashikimi i | 5 sistemet; | 1:20 000 | | |

| | | | | | |
|--|--|--|-----------------------|--|--|
| | përdorimit të tokës | kategoritë bazë dhe nënkategoritë; funksione dhe aktivitete; qendrat, polet, korridoret kryesore të zhvillimit ekonomik; tipologjitë e parashikuara hapësinore; zonat e rëndësisë kombëtare; njësitë strukturore; zonat me prioritet zhvillimi; zonat për PDV; shpërndarja e popullsisë; plani i strehimit; të tjera | | | |
| | Shërbimet dhe infrastrukturat e propozuara | Rrjetet e infrastrukturave; Objektet e shërbimeve sociale dhe rrezet e mbulimit | 1:20 000 1:100 000 | | |
| | Instrumentet e drejtimit të zhvillimit | Zonat për transferim të së drejtës për Zhvillim; Zona për intensitet me kushte; Zona për zhvillim të detyrueshëm të tokës; Zonat e preferimit; Zonat e pezullimit të zhvillimit; Zonat për servitut publik | 1: 20 000 | | |

Tabela e Përmbajtjes

| | |
|--|----|
| KAPITULLI 1- HYRJE | 5 |
| 1.1 Dispozita ligjore..... | 5 |
| 1.2 Dispozita ligjore sektoriale..... | 6 |
| 1.3 Planet Vendore të Bashkisë Shkodër | 9 |
| - Plani Rajonal Shkodër- Lezhë | 9 |
| - Plani Rregullues i qytetit të Shkodres 1994 | 13 |
| - Studim urbanistik pjesor - Qendra e qytetit të Shkodrës | 14 |
| - Projekti për zhvillimin e zonës liqenore të qytetit të Shkodrës | 15 |
| - Plan rregullues i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës | 16 |
| - Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër (2010)..... | 17 |
| - Plani i Përgjithshëm Vendor Komuna Rrethinat (2013)..... | 20 |
| - Plani i Përgjithshëm Vendor Velipojë (2015) | 21 |
| - Konkluzione..... | 23 |
| Kapitulli 2- Përmbledhje e strategjisë së zhvillimit të territorit..... | 24 |
| 2.1 Skenari III: Shkodra Policentrike | 24 |
| 2.2 Vizioni..... | 25 |
| 2.3 Objektivat Strategjike | 27 |
| - Programi Strategjik OS5PS1: Mbrojtja e Mjedisit | 32 |
| - Programi Strategjik OS5PS2: Mbrojtja nga përmbytjet | 32 |
| - Programi Strategjik OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane | 32 |
| - Programi Strategjik OS5PS4: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja | 32 |
| - Programi Strategjik OS5PS5: Qendra e menaxhimit nga risku i përmbytjeve | 32 |
| - Programi Strategjik OS5PS6: Menaxhimi i Rreziqeve Natyrore | 32 |
| - Programi Strategjik OS5 PS7: Menaxhim i pyjeve dhe Kullotave | 32 |
| - Programi Strategjik OS5 PS8: Ndryshimet Klimatike | 32 |
| Kapitulli 3- Plani i Zhvillimit..... | 33 |
| 3.1 Ndarja e territorit në njësi strukturore | 34 |
| 3.2 Përdorimi i Tokës sipas Sistemeve Territoriale..... | 36 |
| 3.3 Plani i ndërhyrjeve në peizazh dhe hapësira publike..... | 42 |
| 3.3.1 Ndërhyrjet në Hapësira publike | 42 |
| 3.4 Ndërhyrjet në peizazh..... | 57 |
| 3.5 Shërbimet Publike | 68 |
| 3.5.1 Kopshtet, shkollat 9-vjecare, shkollat e mesme. | 68 |
| 3.5.2 Qëndrat Shëndetësore..... | 69 |
| 3.5.3 Shërbimi me një ndalesë..... | 71 |

| | |
|---|-----|
| 3.5.4 Qëndrat Multifunkionale..... | 72 |
| 3.5.5 Tregjet | 73 |
| 3.6 Plani i masave për ndërhyrjet në mjedis..... | 74 |
| 3.6.1 Zonat e mbrojtura të rëndësishme kombëtare mjedisore | 75 |
| 3.6.2 Masat për menaxhimin e mbetjeve | 84 |
| 3.6.3 Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota..... | 84 |
| 3.7 Plani i masave për infrastrukturën | 86 |
| 3.7.1 Uji i Pishëm..... | 86 |
| 3.7.2 Kanalizimet e Ujërave të Zeza | 87 |
| 3.7.3 Masat për energjinë elektrike | 88 |
| 3.7.4 Masat për vaditjen dhe kullimin | 88 |
| 3.8 Masat në lidhje me përmbytjet | 89 |
| 3.9 Plani i Masave në Infrastrukturë dhe Transport | 94 |
| 3.9.1 Akset Rrugore..... | 94 |
| 3.9.2 Bypass-i jug-lindor i qytetit Shkodres | 98 |
| 3.9.3 Kryqëzimet | 100 |
| 3.9.5 Rrjeti i Lëvizjes me bicikleta dhe transporti publik | 101 |
| 3.9 Zhvillimi Urban | 105 |
| 3.9.1 Përcaktimi i zonave kryesore të zhvillimit ekonomik dhe atyre me prioritet zhvillimi urban | 105 |
| 3.9.2 Plani i strehimit | 109 |
| 3.9.3 Tipologjitë e propozuara hapësinore, bazuar në përcaktimet e zonave/njësive për dendësim, rigjenerim, rihvillim, konsolidim, konservim, urbanizim. | 111 |
| 3.9.4 Përcaktimi i Planeve të detajuara vendore dhe Termat e Referencës për Planet e Detajuara Vendore..... | 120 |
| 3.10 Masat për Trashëgiminë Kulturore dhe Historike | 123 |
| Kapitulli 4- Plani i Investimeve Kapitale | 125 |
| 4.2 Metodologjia dhe politikat për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale..... | 127 |
| 4.3 Analiza Financiare e Bashkisë | 128 |
| 4.4 Plani i Investimeve sipas prioriteteve | 132 |
| 4.5 Burimet e Financimit..... | 163 |
| 4.6 Miratimi dhe Monitorimi i PIK | 164 |
| Kapitulli 5- Monitorimi i Planit të Zhvillimit..... | 165 |
| 5.2 Faktorë që mund të shkaktojnë një rishikim të pjesshëm të PPV-së..... | 172 |
| Kapitulli 6- Raporti për Kapacitetet Institucionale..... | 174 |
| 6.1 Nevoja për ngritjen e kapaciteteve institucionale | 174 |

| | |
|---|-----|
| 6.2 Marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe strukturën e stafit të nevojshëm për zbatim. | 176 |
| 6.3 Vlerësimi i nevojave të personelit dhe burimeve për hapësirën e departamentit..... | 180 |
| Shtojca 1 – Raport mbi degjesta dhe konsultimet..... | 182 |
| Takime Nderkufitare..... | 182 |
| Raporti mbi komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetareve ne procesin e hartimit te PPV Bashkia Shkoder | 183 |
| Dëgjesat Publike..... | 183 |
| Dëgjesë Publike për Procesin e Planit dhe gjetjet e analizave..... | 183 |
| Dëgjesë Publike për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit për Bashkinë Shkodër | 186 |
| Fokus Grupe | 193 |
| Drejtoria e Pergjithshme e Mjedisit (MM)..... | 199 |
| "Pergjegjesite Bashkiake dhe pjesemarrja qytetare" - Keshill Bashkiak..... | 199 |
| "Financat Vendore" - Keshill Bashkiak Shkoder | 199 |
| Mbi Menaxhimin e Emergjencave Natyrore. - Bashkia Shkoder | 200 |
| Drejtoria e Bujqesise Shkoder..... | 201 |
| Drejtoria Rajonale e Mjedisit | 201 |
| Autoriteti Rrugor Shqiptar | 202 |
| Takime ndërkuftare..... | 202 |
| Komunikimi në internet dhe me media | 203 |
| Televizioni | 203 |
| Komunikimi në Internet..... | 203 |
| SHTOJCA 2- STUDIM MBI PASURITË UJORE DHE PËRMBYTJET | 211 |
| SHTOJCA 3- LISTA E MONUMENTEVE TË KULTURËS BASHKIA SHKODËR | |
| SHTOJCA 4_ZONIFIKIMI I QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR | |

Autorësia dhe kontributet

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Shkodër me mbështetjen teknike të Universitetit POLIS, MetroPOLIS Sh.p.k, Arizona State University, nën drejtimin e kryetares të bashkisë Shkodër, Znj. Voltana Ademi dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Grupi i punës:

Prof. Dr. Besnik Aliaj, Dr. Sotir Dharmo, Prof. Dr. Sherfi Lushaj, Dr. Godiva Rembeci, Dr. Ledian Bregasi, Dr. Braden Kay, Prof. Dr. David Pijawka, Michael Underhill, Prof. Dr. David Swindell, Akheil Singa, Elona Karafili, Mikail Chester, Rob Pahle, Ledio Allkja, Artan Kacani, Amanda Terpo, Iva Tavanxhiu, Sindi Haxhija, Besjana Qaja, Ina Brata, Alda Subashi, Sadmira Malaj, Prof. Dr. Molnar Kolaneci, Michiel Van Driessche, Deborah Lambert

Bashkia Shkodër: Znj. Voltana Ademi, Z. Dritan Meta, Z. Arben Gjuraj, Taulant Dibra, Aljon Koçkiçi, Kreshnik Kopluku, Aida Shllaku.

Falenderojmë Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër për ofrimin e hapësirave për zhvillimin e dëgjesave publike, Z. Sulejman Vekshari për kontributin me anë të studimit të tij, qytetarët e Shkodrës për pjesëmarrjen aktive dhe konstruktive në procesin e hartimit të PPV, të gjitha OJF/OJQ lokale të cilat kanë ndihmuar në këtë process me anë të ideve dhe vënies në dispozicion të studimeve.

KAPITULLI 1- HYRJE

1.1 Dispozita ligjore

Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Shkodër hartohet në bazë të dispozitave ligjore të ligjit 107/2014, dt 01.10.2014 “Mbi Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Bazuar në nenin 20:

- Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë:
 - o balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;
 - o krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor;
 - o drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;
 - o rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
 - o planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
 - o rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitutet publike, sipas këtij ligji;
 - o rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit

Bazuar në vkm 671, dt 29.07.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 51, dokumenti i PPV-së përmban:

- Bazën e të dhënave të integruara të territorit në platformën GIS, sipas standarteve të Regjistrit të integruar të territorit
- Strategjinë Territoriale të Njësisë Vendore
 - o Dokumentin e Analizës metabolike të territorit që i paraprin Strategjisë TerritorialeVizionin strategjik dhe objektivat e zhvillimit
 - o Planin e veprimeve strategjike/ prioritare, investimeve kapitale dhe projektet pilot të zhvillimit
 - o Hartat që ilustrojnë strategjinë e zhvillimit të territorit në shkallën që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000
- Planin e Zhvillimit të Territorit të Njësisë Vendore
 - o Dokumentin e analizës së thelluar të territorit që i paraprin Planit të Zhvillimit
 - o Propozimin me përcaktime territoriale në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor
 - o Hartat që shoqërojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e secilit prej sistemeve më sipër, në shkallën që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000
 - o Relacionin e propozimeve
 - o Vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin e PPV-së
 - o Planin e veprimeve, investimeve dhe projekteve për zbatimin e PPV-së
 - o Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së 4
- Rregulloren e zbatimit të PPV-së
- Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe të ndikimit në mjedis

Bazuar në nenin 54, Plani i Zhvillimit të Territorit të njësisë vendore përmban:

- o ndarjen e territorit sipas pesë sistemeve;

- zonimin sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës, c) ndarjen e territorit në njësi;
- pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave, përfshirë hapësirat publike, dhe përcaktimin e kushteve teknike kryesore për realizimin e infrastrukturave;
- zonat e mbrojtura, të rëndësishme kombëtare, të trashëgimisë kulturore dhe monumentet,
- përcaktimin e zonave kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban;
- tipologjitë e propozuara hapësinore;
- përcaktimin e njësive të cilat do të nënshtrohen hartimit të PDV-së;
- shpërndarjen e popullsisë në territor sipas treguesve të parashikimit demografik dhe ekonomik, të specifikuar në nivel territori urban;
- planin e strehimit, bazuar në nevojat e konstatuara, e tashmë dhe ato të projektuara, duke përcaktuar zonat/ njësitë për dendësim, rigjenerim, rihvillimin, konservim, urbanizim nëse janë zona të reja, dhe territoret për programe sociale të strehimit;
- përcaktimin e zonave/ njësive, ku do të zbatohen instrumentet për drejtimin e zhvillimit sipas Ligjit, në rast se parashikohen të tilla.

Ndërkohë, bazuar në nenin 54, pika 3 plani i mbrojtjes së mjedisit përmban:

- parashikimet për mbrojtjen e pejsazhit;
- parashikimet për mbrojtjen e elementëve ujore;
- parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra;
- parashtrimin e dy varianteve për zgjidhje të problematikës së evidentuar përsa i përket hot-spotëve;
- parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Neni 54, pika 4, parashikon që plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike përmban:

- infrastrukturë publike të propozuar;
- konsiderata nga planet e niveleve të tjera, sipas ndikimit në territorin vendor;
- tipologjinë, cilësinë, shpërndarjen në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve sociale (edukim, shëndetësi, etj.) që propozohen.

Planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së, bazuar në nenin 54 pika 5, përmban:

- fazat e zbatimit të zhvillimit, të ndara në periudha kohore brenda vlefshmërisë së planit, për zonat me prioritet zhvillimi, PDV-të, rrjetet kryesore të infrastrukturave publike dhe projektet pilot;
- koston e përgjithshme për zbatimin dhe aktivitetet kryesore të financuara të shoqëruara me planin e investimeve kapitale;
- ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ në nivel vendor.

Gjithashtu bazuar në nenin 54, pikat 6 dhe 7, Plani i Zhvillimit të Territorit gjithashtu përmban:

- Indikatorët për monitorimin e zbatimit të PPV-së.
- Shtojcat e PPV-së, të cilat përmbajnë të gjitha dokumentet e përmendura për këtë qëllim, studimet ndihmëse që merren nga institucionet përgjegjëse për sektorë të caktuar, si dhe studime për qëllime të veçanta që ndërmerren nga vetë autoriteti vendor.

1.2 Dispozita ligjore sektoriale

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër, përtej ligjit 107/2014, dt 01.10.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillim e Territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, bazohet edhe në ligje të tjera sektoriale të cilat kanë impakt në territor:

Sektori i Zhvillimit Urban

- Ligji 50/2014 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar;
- Ligji nr 80/2014 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9220, dt 15.04.2014 "Për shërbimin publik të varrimit"
- Ligji nr 9220, dt 15.04.2014 "Për shërbimin publik të varrimit"
- VKM nr. 626, datë 15.7.2015, "Për miratimin e normativave të projektimit të banesave"
- VKM nr 711, dt 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"
- VKM nr 712, dt 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores "për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"
- Udhëzim nr 1, dt 30.03.2016 " Për përcaktimin e rregullave për realizimin e projekteve në fushën e efijencës energjisë në ndërtesa ekzistuese në bashkëpronësi"
- Udhëzim nr 3, dt 8/10/2015, "Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët për komunitetin rom dhe Egjyptian"
- Udhëzim, dt 12.03.2015 "Mbi Kriteret për studim-projektimin për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane si dhe ndërtimin e landfilleve, apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane

Sektori i Mjedisit:

- Projekt - Ligji për "Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.10 431, datë 09/06/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji Nr. 7/2014 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 8905. datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi"
- Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji për mbrojtjen e faunës së egër
- Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
- Ligji Nr.10 431 , datë 09.06.2013 "Për mbrojtjen e mjedisit "
- Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Vendim Nr.123, datë 17.02.2011 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis"
- Vendim Nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezkshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
- Vendim Nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
- Vendim Nr.682, datë 02.11.2005 për shpalljen e lumit Buna dhe territoreve ligatinore përreth tij "Peisazh ujor/tokësor i mbrojtur"
- Vendim Nr.683, datë 02.11.2005 "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të liqenit të Shkodrës e të zonës së lumit Buna, zonë natyrore vecanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, vecanërisht si habitate të shpendëve ujorë"
- Vendim Nr. 435 datë 08.06.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe te

procedurave qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"

Sektori Bujqësi

- LIGJ Nr.9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"
- VKM nr. 410, datë 2.7.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës".
- Ligji nr. 131/2014 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" të ndryshuar"
- Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".
- Ligji nr. 10263, datë 8.4.2010, "Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara"
- Ligji nr. 9426, datë 06. 10. 2005 "Për mbarështimin e Blegtorisë" i ndryshuar me Ligjin Nr. 9864, datë 28. 01. 2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9426, datë 06. 10. 2005 "Për Mbarështimin e Blegtorisë", dhe me ligjin nr. 10137, datë 11. 05. 2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
- Projektligj "Për Administrimin E Ujitjes Dhe Kullimit"
- Projekt Ligj "Për prodhimin biologjik"

Sektori i Transportit dhe Infrastrukturës

- Ligji Nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" Ndryshuar nga: Ligji nr. 8908, datë 06. 06. 2002; Ligji nr. 9096, datë 03. 07. 2003; Ligji nr. 9373, datë 14. 04. 2005; Ligji nr. 9760, datë 21. 06. 2007; Ligji nr. 10137, datë 11. 05. 2009 "Për disa ndryshime ne legjislacionin ne fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 8094 datë 21.03.1996,"Për Largimin Publik Të Mbeturinave"
- Ligji Nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore" me ndryshime.
- VKM Nr. 236, datë 10.05.1993 "Për administrimin dhe furnizimin me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë" ndryshuar me VKM Nr.96, datë 21.02.2007
- VKM Nr.643, date 14.9.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve".
- VKM Nr.1304, date 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve, sh.a"

Sektori i Industrisë dhe Energjistikës

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"
- Ligj Nr.124/2015 "Për Efiçencën e Energjisë"
- Ligj Nr. 26/2014 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 138/2013, "Për burimet e energjisë së rinovueshme"
- Ligj nr.138, datë 2.5.2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme"
- Ligj nr.138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme", i konsoliduar
- VKM Nr.27, datë 20.01.2016 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet Energjisë së Rinovueshme 2015-2020"
- VKM Nr.619, datë 7.9.2011 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për efiçencën e energjisë, 2011-2018"

- VKM Nr. 38, datë 16.1.2003 "Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa"

Të tjera

- Ligj nr.115/2015 "Per ndarjen administrativo-territoriale ne Republiken e Shqiperise"
- Ligj nr. 93/2015 Për Turizmin
- VKM nr.369 date 18.05.2016_Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"

1.3 Planet Vendore të Bashkisë Shkodër

Gjatw hartimit tw PPV Shkodwr, janw marrw nw konsideratw tw gjitha planet e mwpارشme tw bashkisw Shkodwr dhe tw ish-komunave, tashmw njwsi administrative tw bashkisw Shkodwr pas reformws territoriale. Nw analizwn e thelluar pwr PPV wshtw njw pwrshkrim mw i gjerw i tw gjithw planeve, ndwrkohw, kwtu pwrmeden elementwt kryesore tw disa prej planeve:

- Plani Rajonal Shkodër- Lezhë

Ky plan është një dokument planifikimi rajonal, hartuar në vitin 2005, bazuar në konceptin e Vizionit të Zhvillimit Rajonal brenda nje zonë territoriale (rajonale) specifike dhe të identifikuar qartë, duke grupuar të gjithë qendrat urbane dhe venbanimet e tjera brenda rajonit Shkodër- Lezhë (rajoni verior), me një qëllim të përbashket, zhvillimin me facilitete dhe shërbime të përbashkëta të infrastrukturës dhe me potenciale të zhvillimit ekonomik.


Ky koncept është i bazuar në idetë e Zhvillimit Rajonal European (INTERREG) për të bërë eficientë përdorimin maksimal të burimeve lokale, aseteve dhe kapaciteteve që ndihmojnë në zhvillimin e ekonomisë lokale dhe vepron kundër eksodit rural të popullsisë. Disa koncepte bazë të ketij plani janë si më poshtë:

- Zhvillimi i Shqipërisë se Veriut, si nje rajon i fortë e kohesiv. Një vizion ky që parandalon mbi-përqëndrimin në zonën Tiranë - Durrës të potencialeve ekonomike të Shqipërise.
- Krijon një "Rajon Urban Policentrik", përgjatë kufirit me Malin e Zi, duke lidhur ekonomitë urbane të Shkodrës, Lezhës, Podgoricës, Tivarit dhe Ulqinit në nje kornizë për zhvillimin ekonomik rajonal dhe shpërndarjen e popullsisë.
- Krijon një korridor të transportit rajonal nga Kosova tek porti i Tivarit përgjatë rajonit Shkodër-Lezhë, e deri në Malin e Zi, duke krijuar një shkallë të lartë të mundësive të zhvillimit përmes rajonit verior.
- Zgjeron zonën e rivierës së Malit të Zi, drejt jugut, në afersi të bregut Shqiptar duke ndërtuar një urë Ulqin - Velipojë përgjatë lumit Buna, duke krijuar kështu një qëndër të madhe për zhvillimin e turizmit.
- Racionon strukturën fizike dhe ekonomike të "Zones së Largët Malore". Menaxhohet rritja e popullsisë ndërsa rritet cilësia e jetës.
- Stabilizon popullsinë e qyteteve të Pukës, Kurbinit dhe rrethit të Mirdites, kështu që një produkt rajonal në rritje është në gjendje të shpërndajë të mirat maksimale.
- Mbron tokën bujqësore, dhe kufizon ndërtimin e fshatrave të "rajonit urban", karshi familjeve që janë pjesë autentike e ekonomisë rurale.
- Harta e mëposhtme tregon disa projekte të rekomanduara dhe interesante për fuqizimin rajonal dhe zhvillimin e ndërkufitar me vendet fqinje, si Mali i Zi dhe Kosova, ashtu si korridori kombëtar Shqiptar dhe i transportit ndërkombëtar. Më poshtë në trajte skematike janë paraqitur ndërhyrjet kryesore strategjike që propozon Plani Rajona Shkodër-Lezhë:

- Akset kryesore rrugore,
- Projektet e zhvillimit ekonomik dhe
- Zonat e rritjes urbane

Studimet e mëposhtme i janë dedikuar qytetit të Shkodrës, rrugës by-pass të qytetit dhe korridori i Koplikut. I pari është studimi që lidhet me infrastrukturen e qytetit ku evidentohet qartë prezencën e by-pass që lehtëson shumë trafikun e qytetit duke shmangur të gjitha automjetet që vijnë nga pjesë të ndryshme të vendit të drejtuar për në Malin e Zi, përmes pikës kufitare të Hanit të Hotit. Ky by-pass tashmë është në fazën e zbatimit por që nga fillimi i tij punimet janë pezulluar. Ka qënë e propozuar gjithashtu një brez i gjelbër ndërmjet Liqenit të Shkodrës dhe rrugës së Unazës perëndimore të qytetit, gjë e cila nuk përputhet me konceptin e planifikimit të sotëm të zhvillimit urban të Shqipërisë.


Harta 1: PLani Rajonal Shkodër-Lezhë



Rruga nga Shkodra në kufi me Malin e Zi, në Han të Hotit ka qenë një tjetër ndër propozimet kryesore infrastrukturore të këtij plani. Evidentohet fakti që në atë kohë rruga ishte në nje cilesi të keqe krahasuar me aspiratat zhvillimore. Propozimet kryesore të këtij plani janë:

- Rruga ekzistuese Shkodër-Koplik që është 15 km e gjatë duhet të zgjerohet dhe të përmirësohet. Ndërprerjet me rrugët lokale duhet të bëhen në një interval 1 km, së paku, dhe të sigurojnë hyrje tek ndërtesat.
- Zonat kryesore të tokave të pazhvilluara duhet të ruhen për ferma të vogla
- Duhet të identifikohen vendet për shkolla, përdorime publike dhe tregtare. Duhet të identifikohet një zonë biznesi në Koplik (në fundin verior të korridorit).
- Rrugët anësore duhet të përmbajne kanalizime ujërash, me një kolektor të radhitur paralel me bregun e liqenit.
- Hekurudha nga Lezha në Podgorice duhet të vihet në funksionim me stacione të reja (me parking makinash) në intervale prej 2 kilometrash.


Harta 2: Plani rajonal Shkodër Lezhë 2



- **Plani Rregullues i qytetit të Shkodrës 1994**

Plani rregullues i qytetit Shkodër, miratuar nga KRRTSRH në vitin 1994, përbën një nga instrumentat kryesorë të zhvillimit të qytetit gjatë viteve së tranzicionit. Baza ligjore mbi të cilën u hartua ky plan ishte ligji nr. 7693, dt. 6.04.1993, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Pavarsisht se ky plan nuk parashikonte hopin e madh të industrisë së ndërtimit në vitet në vijim, gjithsesi shërbej si një bazë shumë e vlefshme për ruajtjen e zonave të mbrojtura historike dhe me vlera mjedisore të qytetit.

Harta 3: Plani i Shkodrës 1994



Studimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Shkodrës është mbështetur në detyrën e projektimit të miratuar me VKM Nr.30, datë 8 Shkurt 1984, si dhe kërkesat e kohës si pasojë e ndryshimeve sociale dhe ekonomike të viteve 1990-1993. Kryesisht ky plan zgjidh 3 probleme kryesore:

- Zonimin funksional
- Sistemin (rrjetin) rrugor
- Vijën kufizuese të ndërtimeve

Plani parashikohet të funksionojë për një periudhë 20 vjeçare dhe sugjeron që zhvillimi të ndodhi brenda territoreve ekzistuese të qytetit, kryesisht duke dendësuar zonat me shtëpi private. Sipas

zonimit funksional të bërë, projektuesit e ISPU që janë dhe autorët e planit, pretendojnë që dendësia bruto nga 136 banorë / ha aktualisht (në vitin 1994) të arrijë deri në 250 banorë/ha. Përsa i përket zgjerimeve të mundshme afatshkurtër të qytetit janë dhënë 4 propozime:

- Zona buzë kodrave të Tepes (18ha);
- Zona tek artistikja (6.7ha);
- Zona tek antifilokseriku (6.7ha);
- Zona mbi unazë në pjesën jug-përendimore.

Ndërsa ato të perspektivës afatgjatë janë:

- Sipërfaqet buzë liqenit
- Sipërfaqet në pjesën veriore (pranë Dobraçit);
- Zona e Institutit Zooteknik deri në afërsi të fshatit Golem.

Vija kufizuese e ndërtimeve, në bazë të rregullores së këtij plani, shpreh kufijtë e lejuar të shtrirjes së qytetit në prespektivën e afërt. Sipërfaqja brenda kësaj vije është 1700ha dhe përbën një rritje prej 900ha në krahasim me sipërfaqen e kufizuar nga vija e verdhë e vjetër.

Brenda kësaj vija janë përfshirë sipërfaqe të reja të planifikuara në zonimin funksional, si hapësirat në veri, ato buzë liqenit kodrat e Tepes dhe Bahçalleku, i cili bëhet përfundimisht pjesë përbërëse e qytetit të Shkodrës.

Përsa i përket sistemit rrugor të propozuar, ai është kryesisht aplikim i projektit të zbatimit të bërë në vitin 1979 (sipas të cilit janë realizuar gati 90% e rrejtit të kanalizimeve të ujrave të zeza). Autostrada e re (by-passi veri -lindor) propozohet të kalojë në shtratin e lumit Kir, pa ndërprerë zhvillimin e zonës industriale. Një tjetër propozim që theksohet në plan është edhe aksi i ri rrugor, që lidh Universitetin "Luigj Gurakuqi" me stacionin e trenit.

Përsa i përket Zonës Industriale, ajo parashikohet të zhvillohet duke sistemuar shtratin e lumit Kir dhe duke vënë në dispozicion të qytetit një sipërfaqe shtesë 300 ha. Kjo zonë ishte parashikuar që do ndahej nga zona e banimit me një brez sanitar mbrojtës 50m.


Zonimi funksional i planit rregullues të Shkodrës përmban 16 kategori përdorimi toke për të cilat, as në plan as në rregulloren që shoqëron planin, nuk jepen detaje apo tregues zhvillimor konkret.

- Studim urbanistik pjesor - Qendra e qytetit të Shkodrës

Studimit urbanistik të qendrës së qytetit i paraprin detyra e projektimit dhe zgjerimi i vijës kufizuese të kësaj qendre, miratuar me vendim të KRRTRSH-së nr .4, dt. 19.02.2003. Sipas vijës kufizuese të përcaktuar me këtë vendim, zona e qendrës ka një sipërfaqe 18 ha.

Ndryshimi nga qendra e parashikuar sipas Planit Rregullues të vitit 1994, konsiston në zgjerimin e saj me disa zona dhe sheshe dhe jo në trajtimin e qendrës si një aks rrugor. Pas 2 vitesh nga hartimi dhe miratimi i detyrës së projektimit miratohet studimi urbanistik pjesor i Qendrës së qytetit me vendimin e KRRTRSH nr.3, dt. 7.05.2005. Propozimi konsiston në një program gradual të rinovimit urban të ndërtesave ekzistuese gjate rrugeve të vjetra të qendrës së qytetit. Me vendimin e KRRTRSH nr.3, dt. 15.06.2005 miratohet rregullorja në zbatim të këtij studimi. Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe një hartë e përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës për objektet monument kulture dhe ato arkeologjike brenda vijës kufizuese të qendrës.

Harta 4: Studim Pjesor qendra e qytetit



- **Projekti për zhvillimin e zonës liqenore të qytetit të Shkodrës**

Ky projekt u hartua nga Bashkia e Shkodër, me konsulencën e Universitetit të Firencës. Nisma për zhvillimin e kësaj zonë u morr duke konsideruar veçoritë dhe karakteristikat peisazhiste dhe mundësitë e zhvillimit në drejtimin jugor të qytetit. Duhet patur parasysh këtu që mjaft ndërtues treguan interes të veçantë për këtë pjesë të qytetit dhe mund të themi që zona e hyrje në qytet është ajo ku është përqendruar një zhvillim i madh në vitet 2005-2010. Ndërtimi i by-pass-it përendimor të qytetit, që shërben edhe si një digë mbrojtëse për gjithë trojet që mbyteshin me fillimin e rreshjeve, e bën edhe më real implementimin e këtij projekti.

Imazh 1: Projekti për zhvillimin e zonës liqenore



- **Plan rregullues i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës**

Në kushtet e rritjes së atraksionit turistik në zonën Shirokë-Zogaj, Bashkia e Shkodrës, ka kërkuar hartimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues për këtë zonë, në mënyrë që jo vetëm të kontrollojë zhvillimin nganjëherë spontan e të pakontrolluar të këtyre zonave, por njëkohësisht të mbrojë e të promovojë vlerat e veçanta të tyre. Ky plan është hartuar nga Bashkia Shkodër dhe GTZ në kuadër të projektit “Planifikimi Hapësinor i Rajonit Ndërkufitar të Liqenit të Shkodrës, Shqipëri dhe Mal i Zi”. Kuadri ligjor mbi të cilin është bazuar ky plan është, ligji 8405, dt.17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar dhe VKM nr.722, dt.19.11.1998 “Për miratimin e rregullores se urbanistikes”, i ndryshuar. Bazuar në përcaktimet ligjore të cituara më sipër, studimi përmban:

- Të dhënat, analizat e të dhënave dhe prognozot
- Objektivat dhe Strategjinë që Bashkia kërkon të arrijë, të ndara sipas zonave.
- Mendimet, sugjerimet dhe propozimet e përfituara nga procesi i përfshirjes qytetare.
- Përcaktimet që influencojnë mbi pronësinë mbi tokën dhe vlerësimin e saj, sipas funksioneve, mënyrës së zbatimit nëpërmjet studimit urbanistik pjesor, intensitetit dhe tipologjisë së ndërtimeve.
- Klasifikimin në zona funksionale të territorit që përfshihet nga plani, duke u mbështetur në gjendjen ekzistuese, në përdorimet e mundshme, në dendësitë e banimit, në infrastrukturat inxhinierike e sociale, si edhe rregullat që duhen ndjekur brenda secilës prej tyre për të ndryshuar destinacionin e përdorimit.
- Shqyrtimin e zonave që do t’i nënshtrohen rikonstruksionit urbanistik, si edhe zonave për shtrirjen e qytetit.

- Strukturën e përgjithshme organike të territorit nëpërmjet elementëve përcaktues të zhvillimit urban, veçanërisht nëpërmjet sistemit të përgjithshëm të komunikacionit rrugor, etj.
- Përcaktimin e ndërhyrjeve për vlerësimin dhe ruajtjen e burimeve mjedisore, bujqësore, peizazhistike e historike, duke vendosur kushtëzime për përdorimin e tyre.
- Parashikimet dhe drejtimet kryesore të vendosura prej studimit urbanistik rajonal.
- Kufizime në lidhje me ndërtimet për:
 - territore apo zona me ndërtime që paraqesin interes mjedisor, peizazhistik, historik e kulturor;
 - mbrojtjen e funksionit të infrastrukturave dhe impianteve me interes publik.

Territoret e zonës Shirokë-Zogaj, me sipërfaqe respektive 66 ha dhe 80 ha, janë përfshirë brenda kufirit administrativ të qytetit të Shkodrës, që nga Janari i vitit 1997. Zona turistike e marrë në studim është rreth 600 ha, dhe me një gjatësi vije ujore rreth 14.5 km, nga e cila rreth 10 km kanë breg shkëmbor dhe 4.5 km fushor. Studimi është mbështetur në Detyrën e Projektimit, e cila është hartuar nga Bashkia e Shkodrës, në bashkëpunim dhe asistencë nga GTZ dhe është miratuar në KRRT të Bashkisë Shkodër me Vendim nr. 3, date 02.11.2007.

- Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër (2010)

Nga vlerësimi i "Pikave të Forta", "Dobesive", "Mundësive" dhe "Rreziqeve" të paraqitura në kapitullin e mësipërm - "Gjetjet Kryesore nga Matricat SWOT", dhe nga konkluzionet e nxjerra në mbledhjet me grupet e interesit si dhe në konsultimet me Bashkinë, Konsulenti ka nxjerre Vizionet e mëposhteme për qytetin e Shkodrës deri në vitin 2020.

Vizioni 1

Shkodra do të vazhdojë të luajë rolin e qendres kryesore urbane e ekonomike të veriut të Shqipërisë siç ka qenë në të kaluarën, dhe mund të bëhet një qytet i qendrueshëm me një cilësi jetese të krahasueshme me nivelet evropiane:

- Qyteti tashmë udhëheq zhvillimin e rrethinave që mbulojnë të gjithë Provincën Veriore dhe me tej dhe përqendron brenda rajonit të tij urban pothuajse të gjitha aktivitetet e punësimit dhe facilitetet e tregut të mbështëtura nga një rrjet infrastrukturor për mobilitetin e mallrave dhe njerezve. Master Plani I ri për Shkodrën do të propozojë forcimin e metejshëm të tyre duke shfrytëzuar në maksimum projektet e tanishme, forcat potenciale, dhe oportunitetet dhe duke adresuar dobësitë e rëndësishme (sidomos në sektorin e rrugëve, mjedisit dhe komunikacionit).
- Afërsia e saj me Kosovën dhe Malin e Zi dhe një numër rrugesh inter-rajonale do ta vendosë atë në qendren e rrjetit rrugor Evropian të rajonit.

Vizioni 2

Shkodra mund të jetë një qendër e rëndësishme e dijes për promovimin e shërbimeve të edukimit modern dhe kërkimeve, një vend studimi për kulturën, historinë, dhe trashëgiminë antike dhe bashkëkohore.

- Qyteti posedon tashmë një Universitet të njohur ndërkombëtarisht me një numër të mirë fakultetesh me një standart të lartë edukimi.
- Plani i Përgjithshëm Vendor duhet të propozojë krijimin e një qendre shkencore universale studimi për migrimin Euro Afrikan të zogjve dhe levizjet e tyre (në lidhje me kontaminimin e gripit të shpendeve), një qendër për mbrojtjen e disa specieve të rralla të peshkut në Liqenin e Shkodrës dhe Lumenjte. Të propozojë gjithashtu krijimin e një qendër studimi për kulturën antike dhe parahistorike dhe arkitekturën.

Vizioni 3

Shkodra mund të jetë një qendër e rëndësishme eko-turizmi e dimensioneve kombëtare dhe ndërkombëtare:

- Fale pranisë së aseteve të bollshme të një varieteti të pejsazheve natyrore, lumenjve e Liqenit, grykave e kanioneve, ndërtesave historike dhe kulturore, varieteteve të rralla të

flores dhe faunes, Shkodra mund të jete nje qender për zhvillimin e eko-turizmit – nje sektor qe po lulezon tashme pavaresisht nga kriza e tanishme ekonomike.

- Plani i Përgjithshëm Vendor për Shkodren do të propozoje aksione të pershtatshme për të arritur kete vizion.

Vizioni 4

Shkodra mund të jete nje qender e rendesishme për promovimin e prodhimeve të artizanatit:

- Fale perqendrimit të rendesishem të artizaneve të kualifikuar qe praktikojne aktivitete tradicionale të punimeve me dore, Shkodra mund të manaxhoje kerkesen e larte për keto produkte nga turistet. Kjo do të krijonte jo vetem nje punesim në shkalle të ulet për grate por edhe do të ulte varferine për grupet e dobeta.
- Plani i Përgjithshëm Vendor do të lokalizojte zona me facilietete për ti grupuar keto aktivitete dhe për ti zhvilluar ato në menyren e duhur.

Vizioni 5


Shkodra do të jete nje qytet i standardit europian, do të zhvillohet në shkalle njerezore dhe do të jete porta e veriut për Shqipërine në Evrope

- Shkodra është nje qytet i mirë-strukturuar i gjelbër dhe i qetë me dendesi mesatare dhe me arkitekture tradicionale, e parqe të gjelbra dhe siperfaqe të hapura dhe ka nje vlere të moderuar të tokes – qe perben në atraksion të fuqishem për kompartitë e ndërtimit që operojnë më vend dhe në rajon.
- Plani i Përgjithshëm Vendor i Shkodres do të perforcoje kete vision me ekzekutimin e planeve të pershtatshme për perdorimin e tokes.

Vizioni 6

Bashkia e Shkodres është fuqimisht e angazhuar për ta kthyer qytetin e vet në nje qytet të gjelber të qendrueshem me dimensione njerezore:

- Bashkia e Shkodrës është fuqimisht e angazhuar për zhvillimin e një qendre të madhe në veri të Shqipërise, si Porte e Gjelbër me të gjitha karakteristikat e veta kulturore e tradicionale me facilietete të pershtatshme zhvillimi.



Synimet e qytetit janë përcaktuar nga rezultatet e analizave SWOT dhe konsultimeve publike:

1. Shkodra - Porta e gjelbër e Shqipërisë.

Liqenet, lumenjte dhe malet Shkodra mund të jete një qendër e rëndësishme eko-turizmi fale prezencës se aseteve të bollshme natyrore. Shkodra është e rrethuar nga uji, tre lumenj, liqenet, dhe mocaloret. Liqeni i Shkodres është me i madhi në rajonin e Ballkanit.

2. Shkodra - Qytet European

Nje qytet i qendrueshem i standarteve evropiane Shkodra mund të jete qendra me e rendesishme e rritjes urbane dhe ekonomike dhe qyteti kryesor I veriut të Shqipërisë me në cilesi jetese të standartit evropian.

3. Shkodra - Qytet i qëndrueshëm dhe dinamik.

Nje qytet qe kombinon tegjitha facilitetet urbane për nje punesim me të mire, banese dhe mjedis të jetueshem. (qytet i zgjuar) Sebashku me oportunitetet qe derivojne nga ekonomia e dijes perfaqesuar nga sistemi universitar dhe sektori i turizmit, edhe ekonomia locale si sektori bujqesor dhe ai tekstil mund të perfitojne nga rinovimi i zonave industriale dhe fuqia punetore ekzistuese e specializuar. Shkodra mund të jete gjithashtu nje qender e rendesishme për promovimin e artizanatit tradicioal dhe produkteve artistike.

4. Shkodra - Qytet i dijes

Universiteti, kerkimi, mjedisi. Ne fakt Shkodra është historikisht qyteti i madh verior i Shqipërisë dhe kryeqytet i rajonit PODShkod dhe nje nga 4 qendrat unversitare kombetare. Tani ajo është nje qender për studentet e veriut me nje influence të madhe në ekonomine (9.000 student). Aktualisht universiteti ka shume lidhje me organizata rajonale dhe nderkombetare kerkimi Shkodra mund të jete nje qender e rendesishme e dijes për sherbime edukimi dhe kerkimi, nje porte hyrse për studimin e cultures antike dhe bashkekohore, historise dhe trashegimise, nje qender universal specifike studimi për migrimin e zogjve nga Afrika në Evrope dhe nje qender për mbrojtjen dhe studimin e specieve të rralla të Liqenit dhe lumenjve.

5. Shkodra - Qytet i aksesueshëm

Nje qytet i aksesibilitetit të larte dhe mobilitetit urban. Infrastruktura me të mire dhe me të sigurte të rrugëve, shpërndarje mallrash dhe shërbimesh – nje qytet i mencur (SMART). Shkodra është nje qytet i mire-strukturuar i gjelber dhe paqesor me dendesi mesatare dhe me arkitekture tradicionale, me parqe të gjelbra dhe sipërfaqe të hapura dhe ka nje vlere të moderuar të tokës – qe perben nje atraksionm të fuqishem. Zhvillimi i ardhshem i Shkodres do të jete i lidhur strategjikisht me qytetin e Dijes, qytetin e qendrueshmerise, i lidhur me bukurite dhe burimet e veta natyrore, trashëgimime historike dhe kulturore. Per me teper vizioni merr gjithashtu në konsiderate nje qytet të jetueshem bazuar në punë me të mire për të gjithë SME siç janë sektori i modes, tekstilet, veshjet, si dhe nje cilesi e larte e prodhimeve agroindustriale. Infrastrukturë rrugore me të mire dhe më të sigurtë me standarte evropiane dhe shërbimi mund të permiresojë imazhin e pergjithshem dhe zhvillimin e krejt qytetit. Nje qytet qe është porta e Ballkanit.

- **Plani i Përgjithshëm Vendor Komuna Rrethinat (2013)**

Hartimi i këtij materiali u realizua duke u mbështetur ne konsultimet me perfaqesues te komunes Rrethina, Shkodër, keshilltarë, specialistë, banorë dhe grupe të tjera interesi. Nga konsultimet u azhornuan të dhëna informuese të Komunës që kanë të bejnë me zhvillimin demografik, ekonomik, social kulturor, mjedisore dhe fenomeneve problematike natyrore. Qëllimi i studimit është t'i paraprijë zhvillimeve ekonomiko-sociale dhe turistike të Komunës Rrethina. Do të hartohet një plan, cili do të marrë në konsideratë ndërtimet dhe infrastrukturën duke u kujdesur edhe për mbrojtjen e mjedisit. Qëllimi i këtij plani është, të percaktojë tokën, që është e papërshtatshme për zhvillim, të identifikojë zonat e zhvillimit urban, dhe të percaktojë zonat e mbrojtura, që janë të përjashtuara nga procesi i zhvillimit për një periudhë prej 15 vjet deri në një rivlerësim. Autoritetet vendore janë të ftuar për parashikimin dhe përgatitjen e Planeve të Detajuara Vendore (PDV) si vazhde e këtyre dokumenteve.

Komuna Rrethina, Shkodër ne keto vite eshte perballur me probleme te shumta qe kane ndodhur keto 20 vitet e fundit te ndodhura per shkak te ndryshimeve te shpejta dhe te papritura qe ndodhen ne te gjithë vendin tone per shkak te ndryshimit te sistemit të qeverisjes. Kjo solli nje nevojë te madhe per ndertime te reja dhe kjo siuate e gjeti Komunën të papregatitur dhe kryesisht ndertimet qe u ngitën, nuk u paraprinë nga studime urbanistike, duke shkaktuar demtimin e tokës bujqësore, infrastruktures rrugore, territore te gjelberuara, etj. Por edhe ndertimet e ndertuara ne menyre te ligjshme dhe me kushtet ligjore kane sjelle jo pak probleme per komunën per shkak te kushteve dhe normave qe kishte ligji paraardhës ne fuqi. Ndërhyrjet në komunën Rrethina janë menduar në mënyrë të detajuar, duke marrë parasysh çdo aspekt të mundshëm i cili mund të ndikojë në arsyetimet për zhvillimin e ardhshëm urban apo ekonomiko-social. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje do të arrihet që, investimi në infrastrukturat kryesore dhe shërbimet publike në të ardhmen, të jetë efikas dhe lehtësisht i zbatueshëm.

Objektivat Strategjikë

- **Përmirësimi i infrastrukturës**

Zhvillimi i infrastrukturës publike

Përmirësimi i aksesit midis vendbanimeve dhe mirëmbajtja e rrugëve komunale duhet kthyer në prioritet strategjik për komunën Rrethina. Prioritar duhet të jetë ndërtimi i rrugëve që lidhin fshatrat në jug të lumit Kir, të cilët kanë infrastrukturë rrugore mjaft të amortizuar dhe kanë nevojë emergjente ndërtimin e një ure të re për automjetet, me të paktën 2 kors.

Arsimi

Shtimi i ambienteve arsimore dhe përmirësimi i cilësisë së tyre është pikë e rëndësishme e trajtuar në PPV. PPV parashikon nje zonë të re të dedikuar për objekte arsimore dhe sportive në pjesën perëndimore të komunës.

Shëndetësia

Nevojitet që krahas përmirësimit të kushteve, cilësisë së shërbimit dhe zgjerimit të stafit, të ngrihen dhe struktura të reja, duke mbuluar kështu në mënyrë korrekte të gjitha zonat e komunës me këtë

shërbim. PPV parashikon gjithashtu dhe një zonë të re të dedikuar për objekte dhe hapësira për shërbimin shëndetësor në perëndim të komunës Rrethina

Mbetjet urbane dhe ujërat e zeza

PPV parashikon zgjidhjen përfundimtare të problemeve ambientale që po ndodhin me mbetjet urbane, të cilat shfaqen dendur në peisazhet e secilit fshat, ose derdhen në sasi akoma më të mëdha në shtratin e lumit Kir. Propozimi është që të krijohen kushtet për një zonë të përshtatshme (në Bardhaj-Bleran), ku mbetjet urbane të depozitohen, përpara se të nisen për në landfill (Bushat). Në këtë vendgrumbullim mund të bëhet dhe përzgjedhja e materialeve për riciklim.

Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore

Plani i Përgjithshëm Vendor parashikon ndërhyrje të fuqishme në strukturën e amortizuar të kanaleve vaditëse dhe kulluese. Pika më e fortë e këtyre zonave janë pjelloria e lartë e tokës fushore dhe klima mesdhetare, të cilat të japin mundësi për larmi produktesh bujqësore, drurë frutorë, arrorë, etj

Përmirësimi i infrastrukturës turistike

Plani i Përgjithshëm Vendor parashikon përmirësimin e aksesit dhe infrastrukturave kryesore në zonat me potencial agroturizmi dhe ekoturizmi. PPV propozon ripyllëzimin e zonave kodrinore në Bardhaj e Bleran për të shmangur rrishten e erozionit që ekziston në këto kodra, duke u hapur rrugën kështu, krijimit të zonave të reja rezidenciale elitare (p.sh. në fshatin Zues).

- Rritja e efikasitetit të përdorimit të tokës dhe burimeve natyrore

Mbrojtja e tokës bujqësore dhe pyjeve

Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe kullotave është çështje e rëndësishme e vendit në përgjithësi dhe e komunës Rrethina në veçanti. PPV parashikon vendosjen e tyre në një status të privilegjuar si zona, duke garantuar mbrojtjen e tyre nga dëmtimi i mëtejshëm dhe duke garantuar kështu zhvillimin bujqësor, agroturistik dhe ekoturistik në të ardhmen.

Menaxhimi i burimeve natyrore

Menaxhimi i burimeve natyrore mund të jetë më i efektshëm kur komunitetet janë të përfshira në të. Gjithashtu duhen realizuar aktivitete për mbrojtjen e ambientit nga degradimi, rivitalizimi ekologjik i tij dhe vënia e turizmit natyror në prioritetet e komunës

Planifikimi i zonave të reja

Krijimi i një qendre me karakter ekonomik dhe tregtar apo industrial lind si nevojë dhe domosdoshmëri për komunën duke marrë parasysh dhe konfiguracionin e shpërndarë të njësive ekzistuese të shërbimit.

- Përmirësimi i mjedisit rural duke rritur potencialet e zhvillimit të turizmit natyror

Kategoritë e turizmit, ekzistues dhe me potencial real zhvillimi në komunën rrethina, janë:

- Agroturizmi
- Ekoturizmi
- Turizmi i kulinarisë
- Turizmi i vizitorëve tranzit

- Plani i Përgjithshëm Vendor Velipojë (2015)

Si rezultat i vlerësimit të situatës ekzistuese, takimeve me grupet e interesit dhe takimeve me zyrtarë të ndryshëm të Komunës Velipojë, konsulenti ka hartuar dokumentin e politikës dhe të strategjive të zhvillimit. Zhvillimi i ardhshëm i Komunës Velipojë bazohet në vizionin e mëposhtëm:

Velipoja synon rritjen e mirëqënies së banorëve të saj, duke u zhvilluar si një zonë agroturistike e standarteve europiane, në harmoni me mjedisin, bazuar në pozitën e favorshme bregdetare, si dhe burimet njerëzore.

Për të arritur realizimin e vizionit janë identifikuar qëllimet/synimet kryesore që duhet të arrihen, këto qëllime janë zëbërthyer në objektiva e në programe.


Qëllimi 1: Velipoja do të promovojë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të ekoturizmit, bujqësisë e blegtorisë dhe peshkimit.

Qëllimi 2: Velipoja do të ofrojë një zhvillim urban, shoqëror e social në respekt të mjedisit duke përmirësuar infrastrukturën inxhinierike, sistemin arsimor, shëndetësor, kulturor dhe sportiv të zonës me parametra e standarte europiane.

Qëllimi 3: Velipoja do të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore dhe promovimin e tyre. Elementet natyrorë të zonës do të bëhen pjesë e jetës aktive të komunitetit dhe të turistëve.

Politika dhe Strategjitë e zhvillimit përmbledhen në skenarin e zhvillimit që zërthehet më tej në Planin e Përgjithshëm të Komunës Velipojë. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik (me bazë eko-turizmin, bujqësinë e blegtorinë dhe peshkimin), zhvillimi urban shoqëror e social dhe ruajtja e burimeve natyrore të komunës Velipojë, përbëjnë planet afatgjata të komunës drejt rrugës së përmirësimit të ekonomisë e jetesës së banorëve.

Harta 6: Vizioni per Zhvillimin e Velipojes 2015



Në vijim janë përmbledhur elementët kryesorë të strategjisë.

- Zhvillimi i ekoturizmit duke përmirësuar dhe krijuar struktura për akomodimin e turistëve si hoteleri, bare, restorante druri etj sipas standarteve bashkëkohore të projektimit.
- Ruajtja e parkut të Baks Rrjollit duke përcaktura zonat për të ngritur infrastrukturën e nevojshme për krijimin e zonave për kamping.
- Zhvillimi i zonës së Lagunës duke mundësuar shëtitjet me varka dhe ngritjen e strukturave të shërbimit.
- Krijimi i shëtitoreve për këmbësorët dhe korsive të biçikletave (në zonën e Bunës).
- Promovimi dhe mbështetja për krijimin e stallave dhe baxhove në fshatra. Ndërtimi i strukturave të shërbimeve pranë staneve në kodra. Krijimi i pikave turistike dhe të vrojtimit në zonat kodrinore.
- Promovimi dhe ndërtimi i serave për kultivimin e produkteve vendase
- Rikualifikimi i strukturave turistike ekzistuese për të mundësuar klasifikimin si hotele dhe B&B

- Promovimi i turizmit dhe krijimit të një imazhi pozitiv të komunës si destinacion turistik. Zhvillimi i turizmit bregdetar dhe i formave të tjera të turizmit si: peshkimi sportiv, vrojtimi i zogjve (birdëatching), agroturizmi etj.

- **Konkluzione**

Planet e analizuara janë hartuar në kohëra të ndryshme dhe të bazuar në kuadre ligjore të ndryshme. Gjithashtu, vlen të përmended se edhe vetë territori i Bashkisë Shkodër, si rrjedhojë e reformës territoriale ka ndryshuar. Për këtë arsye, është e pamundur që të ketë vetëm një bashkim të planeve të mëparshme, përkundrazi është e nevojshme harmonizimi i tyre duke e konceptuar tashmë territorin në bazë të nevojave të të gjithë njësive administrative. Miratimi i Planit të përgjithshëm Kombëtar dhe i Planit të Integruar Ndërsektorial kërkojnë gjithashtu një tjetër qasje përse i përket trajtimit të territorit të bashkisë Shkodër. Ndryshimi i situatës në terren nga koha e miratimit të planeve të mëparshme, ndryshimi i kuadrit ligjor dhe planifikues, çojnë në konkluzionin se këto plane tashmë nuk mund të zbatohen më si një instrument më vete. Për këtë arsye është e nevojshme harmonizimi dhe shmangia e efekteve negative, ose më saktë, koordinimi i politikave dhe përdorimeve të tokës. Gjithashtu, vlen të përmended se shumë prej parashikimeve të këtyre planeve, të cilat nuk bien ndesh me ndryshimet ligjore, planet kombëtare apo dhe me situatën e re të territorit të bashkisë Shkodër pas reformës Territoriale janë ruajtur.

Kapitulli 2- Përmbledhje e strategjisë së zhvillimit të territorit

2.1 Skenari III: Shkodra Policentrike

Zona urbane

Skenari policentrik kërkon një qasje të kombinuar në zonat urbane dhe rurale. Sistemi policentrik paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qendërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qendër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor. Skenari policentrik nuk është domosdoshmërisht i lidhur me ndërtimin, por më shumë me kohezionin dhe shpërndarjen e disa shërbimeve bazë për komunitetin. Zona urbane e Shkodrës do të kishte nevojë të krijonte qendërsi të reja urbane rreth qendrës historike. Këto qendërsi të reja urbane do të konsolidonin strukturën ekzistuese, pa ndikuar në tipologjitë historike të ndërtimit. Ndërkohë zonat rurale do të kishin nevojë për të përmirësuar qendat ekzistuese. Kjo qasje do të ruante tokën bujqësore dhe burimet natyrore. Rreziqet e përmytjeve në këtë rast do të ishin më të ulëta për shkak se zonat e ndërtuar rurale është do të ishte e përqendruar dhe në këtë mënyrë, masat që duhen marrë për parandalimin e përmytjeve mund të përdoret në zona më të kufizuara. Pra nga njëra anë skenari i policentrizmit promovon shpërndarjen në territor të centraliteteve (sipas një hierarkie të caktuar) dhe një vëmendje më të madhe në përmirësimin e cilësisë urbane edhe në zonat rurale, ndërkohë që nga ana tjetër promovon kompaktësimin dhe konsolidimin e tyre për të mos u shpërpatur në territor.

Shërbimet dhe Aktivitetet:

Shërbimet publike janë të shpërndara në të gjithë shtrirjen e bashkisë së re duke u përqendruar në qendrat e reja të njërive (ish komunat) duke patur në Shkodër dhe një përqendrim të madh dhe duke u përpjekur për të specializuar çdo njësi në bazë të prirjeve të tyre historike. Shërbimet orientohen sipas hierarkisë së qendrave ku sa më e vogël hierarkia aq dhe më bazë është kombinimi i shërbimeve, ndërkohë që për qytetin Shkodër i cili konsiderohet si qendër primare edhe në PPK shërbimet që ofrohen janë të një cilësie dhe madhësie më të lartë. Aktiviteti ekonomik do të ketë mundësi që të zhvillohet në mënyrë më të diversifikuar si rrjedhojë e politikave incentivuese të cilat mbajnë popullsinë në zonat rurale. Gjithashtu, ky skenar, në dallim me dy të tjerët lejon kohezionin territorial.

Infrastruktura:


Prania e një infrastrukture lidhëse veri-jug është jetike për zbatimin e këtij skenari. Kjo strukturë do të lejonte një akses të përshtatshëm në shërbime për zonat e thella të Bashkisë Shkodër. Do të kërkonte një investim më serioz edhe në infrastrukturën rrugore në zonat rurale e malore duke garantuar aksesin. Infrastruktura duhet përmirësuar edhe nga fshatrat drejt qendrave lokale të cilat janë lokuset e shërbimit.

Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qëndër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit.

Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjetor do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor, malor e ujqor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.

Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujin dhe përballet me sukses me rrezikun e përmbytjeve”

Harta 8- Vizioni



2.3 Objektivat Strategjike

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Objektivi Strategjik 1- Përmirësimi Aksesit dhe Marrëdhëniet Rajonale

Bazuar në **(draft) PPK dhe PINS Bregdeti** Shkodra shihet si “qytet portë”. Në këtë kontekst është e rëndësishme ndërlidhja më e mirë e bashkisë në nivel rajonal duke shfrytëzuar transportin rrugor, hekurudhor dhe ujor. Për të mbështetur ndërlidhjen dhe lehtësuar lëvizshmërinë, kujdes i veçantë do të tregohet tek zgjidhja e “pikave të zeza” të trafikut (MTI) si dhe tek hapja e terminaleve multimodale.

Objektivi është që Shkodra të ketë 1 Terminal të rëndësishëm multimodal ndërkombëtar i cili ndërthur transportin automobilistik me atë hekurudhor tek ish-Stacioni i Trenit. Gjithashtu do të zhvillohet dhe një terminal i integruar ndërkombëtar (sezonal) në Velipojë i cili do të shërbejë për rregullimin e trafikut gjatë verës me Malin e Zi, Kosovën dhe me qendra të tjera në Shqipëri. Ky terminal do të jetë i kombinuar me transportin publik rrethqytetas. Ndërkohë do të zhvillohet dhe një terminal i vogël ujor në Liqenin e Shkodrës, pranë Bexhistenit, i cili do të garantojë lëvizjen për qëllime turistike në liqen.

Përsa i përket përmirësimit të aksesit, ky objektiv synon përmirësimin e lidhjeve të Bashkisë Shkodër me akse të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare.

Bazuar në (draft) Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe PINS Bregdeti janë tre korridore të rëndësishme të cilat kalojnë në Shkodër:

- **Korridori/Autostrada Veri Jug** - [Podgoricë - Hani i Hotit - Shkodër - Gjirokastër] siguron përshkueshmërinë e shpejtë të territorit dhe lidhjen me vendet e Ballkanit perëndimor dhe të Europës Jug - Lindore. Ky korridor do të forcohet nga rivitalizimi i linjes hekurudhore ekzistuese dhe përmirësimi i saj.
- **Korridori/Autostrada Adriatiko-Joniane** – [Ulqin - Muriqan – Shkodër – Lezhë – Milot – Thumanë – Durrës - Levan – Kakavijë]
- **Rruga Peisazhiste Bregdetare** – [Ulqin - Velipojë – Shëngjin - Patok - Durrës - Divjakë - Seman - Vlorë -Dhërmi - Sarandë - Butrint] një nga lidhjet me strategjike për sa i përket forcimit të ekonomisë së turizmit bregdetar të vendit dhe agro turizmit. Rruga do të jetë e tipit peisazhistik, me impakt të ulët në mjedis dhe do të shtrihet përgjatë segmenteve ekzistuese me qëllim që të minimizojë ndikimin në zonat e mbrojtura. Kjo rrugë do të pajiset me sinjalistikën e nevojshme në lidhje me sigurinë dhe informacionin turistik. Duke respektuar direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti gjurma e kësaj rruge ndjek gjurmët ekzistuese duke shmangur ndërhyrjet e forta në terrenet me morfologji të vështirë ku ndërhyrja do të kishte impakt të madh mjedisor.

Në kuadër të përmirësimit të aksesit, do të rregullohen dhe riasfaltohen edhe akset kryesore lidhëse me qendra të tjera në rajon të tilla si:

- Zogaj- Pika e kalimit kufitar, doganë
- Theth- Valbonë (shteg pejsazhistik për ecje, i pajisur me masat e duhura të sigurisë dhe sinjalistikës)
- Shkodër- Vau Dejës
- Shkodër- Prekal

- Shkodër- Theth
- Shkodër- Pukë
- Shkodër- Koman
- Vau Dejës- Velipojë
- Shkodër-Lezhë

Gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të aksesit synimi është që të ofrohen zgjidhje përfundimtare për disa nga nyjet më të rëndësishme të trafikut si:

- Bahçallët-Ura Bunës
- Harku i Bërdicës
- Shtoj
- Mes
- Ura e Kirit

Bazuar në PPK dhe PINS Bregdeti, Shkodra është pjesë e rajonit ndërkufitar ku promovohen marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Në kuadër të Programit për Bashkëpunimin Ndërkufitar Mal i Zi-Shqipëri IPA 2 (2014-2020) do të bashkëpunojë me aktorët e tjerë kombëtare si Ministri të linjës dhe Qarkun Shkodër si dhe me aktorë të palës malazeze për hartimin e strategjive rajonale dhe projekteve specifike. Fusha e veprimit në këtë bashkëpunim do të bazohet në hartimin dhe harmonizimin e strategjive sektoriale për mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit dhe të paketave turistike të harmonizuara, zhvillimin rural dhe transport. Bashkia Shkodër kërkon të luajë një rol të rëndësishëm edhe në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe krijimin e marrëdhënieve me aktorë të ndryshëm si OJQ për aplikimin me projekte në fushat e përcaktuara nga programi i Bashkimit Europian për bashkëpunimin ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi.

Për arritjen e Objektivit Strategjik 1 janë përcaktuar Programet Strategjike si më poshtë:

- **Programi Strategjik OS1PS1:** Terminalet Multimodale
- **Programi Strategjik OS1PS2:** Rregullimi i Portave hyrëse në Shkodër
- **Programi Strategjik OS1PS3:** Lidhjet Strategjike Rajonale e Kombëtare
- **Programi Strategjik OS1PS4:** Bashkëpunimi Ndërkufitar

Objektivi Strategjik 2- Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses

Objektivi i integrit territorial dhe barazisë në shërbime e akses lidhet fillimisht me kapërcimin e disa prej sfidave me të cilat Bashkia Shkodër përballlet si rrjedhojë e reformës territoriale administrative. Synohet ngritja e kapaciteteve lokale në ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë Bashkinë dhe përshtatja e tyre me popullsinë dhe me kushtet lokale. Disa nga fushat në të cilat do të ngrihen kapacitetet lokale lidhen me:

- Planifikimin/menaxhimin dhe zhvillimin e territorit
- Zhvillimin rural
- Menaxhimin e pyjeve dhe kullotave
- Trajtimin e çështjeve sociale të tilla si pabarazitë gjinore, dhuna në familje, dhuna ndaj gruas e fëmijëve etj

Shërbimet sociale do të përmirësohen në mënyrë që të arrihet një efiçientim i burimeve dhe resurseve për të ofruar një cilësi sa më të mirë jetese tek qytetarët. Në funksion të policentrizmit shërbimet sociale do të ofrohen të përqëndruara duke përshtatur strukturat. Qendra multifunkionale të specializuara do të ngrihen në qendrat njësi administrative. Prioritet janë:

- Përmirësimi i shërbimit të arsimit
- Përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore

Do të përmirësohet aksesin në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe mbështetjen e efiçientimit të ofrimit të shërbimeve. Gjithashtu, akset rrugore do të përmirësohen edhe nga pikëpamja e sigurisë dhe mbështetjes me sinjalistikën e përshtatshme.

Në funksion të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, Bashkia shkodër synon të rrisë aksesin e publikut ndaj tyre me anë të ofrimit të disa shërbimeve elektronike dhe me anë të krijimit të qëndrave me një ndalesë. Do të ngrihet një databazë e integruar e informacionit e cila do të lejojë në mirëmenaxhimin e burimeve lokale. Për realizmin e objektivit strategjik janë përcaktuar një sërë programesh strategjike:

- **Programi Strategjik OS2PS1:** Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)
- **Programi Strategjik OS2PS2:** Konsolidimi i lidhjeve të qëndrave kryesore urbane
- **Programi Strategjik OS2PS3:** Qëndrat me një Ndalesë dhe Ngritja e Kapaciteteve Lokale
- **Programi Strategjik OS2PS4:** Qeverisja Elektronike
- **Programi Strategjik OS2PS5:** Qëndrat Multifunkionale dhe shërbimet Sociale

Objektivi Strategjik 3- Konkureshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik

Për të rritur rolin e Shkodrës në rajon, e rëndësishme është që edhe sektorët ekonomikë të cilët kontribuojnë në Bashki të rrisin konkurrencën e tyre në tregjet rajonale e kombëtare. Sektorët ekonomikë do të jenë një vlerë e shtuar për njëri tjetrin në mënyrë që të mos shkaktojnë dëme. Kjo gjë do të garantojë dhe zgjatjen e zinxhirit të vlerave të ekonomisë sipas direktivave të paracaktuara edhe në Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe Planin e Integruar Ndërsektorial të Bregdetit. Zhvillimi ekonomik do të ketë një **përqsje ndaj mejdisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore të Shkodrës** duke u përputhur me vizionin e **PPK dhe PINS Bregdeti** si pjesë e rajonit natyror.

Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoaria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit, ekonomia blu dhe ajo e gjelbër. Kujdes i veçantë do të tregohet për integrimin e brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Punësimi do të mbështetet me mundësitë për shkollim dhe trajnim profesional. Një tjetër sektor i rëndësishëm i cili do të promovohet dhe mbështetet si një ndër sektorët prioritarë është edhe artizanati.

Zona industriale do të kthehet në një zonë të rëndësishme ekonomike ku do të aplikohen politika të cilat promovojnë rigjenerimin e ish-zonave industriale si dhe do të ndërlidhin më mirë këtë zonë me dy akse prioritarë ekonomike **Shkodër-Lezhë dhe Shkodër-Koplik, duke krijuar një vazhdimësi dhe forcuar rolin e zonës ekonomike si pjesë e rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë dhe rajonit ndërkufitar Podgoricë-Shkodër nga direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti.**

Do të rritet **aksesueshmëria e produkteve vendase në tregjet rajonale** si dhe do të sigurohet që ato të arrijnë të promovohen. Shkodra shihet si një pol i rëndësishëm bujqësor ku produktet vendase dhe veçanërisht produktet bio do të stimulohen.

Turizmi shihet si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik dhe si një vlerë e shtuar e sektorëve të tjerë. Pra koncepti i turizmit nuk duhet të jetë sektorial, por i integruar dhe bashkërenduar me sektorët e tjerë ekonomik **bazuar edhe në direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti.** Në këtë mënyrë, futja e konceptit të turizmit edhe në sektorë të tjerë si shërbimet, zhvillimi rural, shërbimet etj bën që edhe zinxhiri ekonomik i tyre të zgjatet duke garantuar komplementaritetin dhe të ardhurat shtesë. Akset prioritarë të turizmit në Bashkinë Shkodër do të jenë **Ekoturizmi, agroturizmi, turizmi kulturor dhe historik, turizmi malor, turizmi det dhe rërë.** Secili prej sektorëve do të mbështetet me anë të politikave të ndryshme dhe projekteve.

Së fundmi, suksesi për tek rritja e rolit të Shkodrës në Rajon do të plotësohet me anë të përmirësimit të imazhit dhe promovimit të Shkodrës. Bashkia do të krijojë një strategji të sajën për “brandimin” (vendosjen e një marke) për Shkodrën. Në kuadër të realizimit të Objektivit Strategjik janë përcaktuar një sërë programesh strategjike si më poshtë:

- **Programi Strategjik OS3PS1:** Zhvillimi Rural
- **Programi Strategjik OS3PS2:** Zhvillimi Akuakulturës

- **Programi Strategjik OS3PS3:** Zhvillimi Turizmit
- **Programi Strategjik OS3PS4:** Mbështetja e Sipërmarrjeve të reja
- **Programi Strategjik OS3PS5:** Zhvillimi i Zonave Ekonomike
- **Programi Strategjik OS3PS6:** Branding i Bashkisë Shkodër

Objektivi Strategjik 4- Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban

Ky objektivi lidhet drejtpërdrejtë me zonat e urbanizuara dhe me impaktin që këto zona kanë në cilësinë e jetesës së banorëve. Ky objektivi, synon konsolidimin dhe mos lejimin e konceptit të shpërhapjes urbane duke përmirësuar cilësinë e ndërtuar dhe zhvillimin në zonat urbane ekzistuese (**direktiva të PPK dhe PINS Bregdeti**). Qëllimi është që zhvillimi urban të orientohet me anë të politikave e projekteve drejt ofrimit të një mjedisi të ndërtuar i cili ofron kushte të mirë për qytetarët dhe zhvillimin e aktiviteteve të tyre social kulturore.

Në këtë kuadër, bazuar edhe në **PINS Bregdeti** do të rikualifikohen ballinat ujore të Bashkisë Shkodër sipas konceptit:

- Buzë Liqeni (Park rekreativ për Shkodrën)
- Breg Liqeni (Nga ura e Bunës deri në Zogaj si hapësirë për zhvillimin e turizmit liqenor)
- Velipoja (Ballina ujore e një qyteze bregdetare duke përfshirë aktivitete e hapësira sociale)
- Rehabilitimi i Ballinës Ujore të Lumit Kir
- Rehabilitimi i Ballinës Ujore të Lumit Drin
- Rehabilitimi i Ballinës Ujore Lumi Bunë (Park Kombëtar/ ekologjik)

Bazuar në PINS Bregdeti, duhet valorizuar dhe mbrojtur arkitektura tradicionale e zonave urbane e rurale. Në këtë sens do të konservohen zonat historike dhe do të zgjerohen rrugët pedonale në këto zona në mënyrë që të mbrohet trashëgimia kulturore, historike, urbanistike e arkitektonike e qytetit të Shkodrës dhe qendrave të tjera të urbanizuara. Do të ndihmohen pronarët për restaurimin e ndërtesave historike. Për të mbrojtur këto zona do të aplikohet instrumenti i transferimit të të drejtave për zhvillim.

Do të integrohen zonat informale përreth Shkodrës duke i dhënë jo vetëm infrastrukturën e posaçme por edhe shërbimet socio-kulturore. **Bazuar në direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti**, në varësi të pozicionimit të tyre në territor dhe afërsisë me elementë të fortë territorial zonat informale do të integrohen sipas koncepteve:

- Lagjia Kiras (buzë liqeni) me konceptin e qytetit kopësht (duke qënë se ndodhet pranë hapësirës rekreative/parkut rekreacional)
- Rrethinat me konceptin “urban agriculture/agricultural garden duke qënë se ndodhen pranë tregut rajonal të bujqësisë
- Lagjia Mark Lula (integrim duke përdorur rikualifikimin e stacionit të trenit apo dhe prania me zonën industriale/ekonomike e cila do të gjenerojë punësim)
- Do të përmirësohet cilësia e jetesës dhe do të integrohen lagjet e komuniteteve rrome

Do të rigjenerohen/rikualifikohen lagjet e tjera duke përmirësuar cilësinë e ndërtesave, cilësinë infrastrukturore të rrugëve dhe cilësinë e hapësirave publike e të gjelbra. Gjithashtu qendrat e fshtrave do të rikualifikohen në mënyrë që të mbështetet rivitalizimi i tyre bazuar edhe në **politikat e PINS Bregdeti**.

Deri në vitin 2030 do të rritet koeficienti i gjelbërimit për banorë. Do të përmirësohen hapësirat publike dhe do të kthehen në ambjente të këndshme e funksionale për qytetarët e Shkodrës. Do të shtohen parqet e lodrave dhe hapësirat sportive e rekreacionale për të garantuar një stil jetese sa më aktiv. Gjithashtu, do të promovohen funksione të reja në zonat pranë liqenit si hapësira për sportet e ujit, hapësira për festivale e koncerte, hapësira për jetën e natës. Cilësia e mjedisit do të vazhdojë të përmirësohet duke rritur aksesin në hapësira të gjelbëra dhe gjelbërim brenda venbanimeve.

Do të përcaktohet kufiri i brezit të gjelbër, si politikë për të parandaluar shpërhapjen urbane e cila është direktivë **nga PPK dhe PINS Bregdeti**. Ky brez do të mbrohet dhe pasurohet me bimësi të ndryshme për të rritur cilësinë e mjedisit dhe frymëmarrjen e vendbanimeve. Zonat të rëndësishme së

veçantë natyrore do të mbrohen në mënyrë që të mos çenohet integriteti i tyre dhe të jenë një vlerë e shtuar në Bashki. Një rrjet i qënësishëm i gjelbër do të krijohet në mënyrë që të ofrohen alternativa për rekreacion dhe shlodhje.

Deri në vitin 2030 zonat urbane të Bashkisë Shkodër do të jenë të mbuluara me shërbimin e ujit të pishëm dhe me kanalizime të ujërave të zeza bazuar **edhe në objektivat e PPK dhe PINS Bregdeti**. Do të zhvillohet impianti i trajtimit të ujërave. Do të përmirësohet menaxhimi i ujërave të rreshjeve të shiut në mënyrë që të riciklohet dhe ripërdoret për qëllime të ndryshme urbane. Menaxhimi i ujërave të rreshjeve do të kryhet duke aplikuar konceptin e “infrastrukturës së gjelbër”.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Strehimit Social do të rritet numri i banesave sociale dhe atyre me kosto të pranueshme. Kjo gjë do të arrihet me anë të instrumentave të ndryshëm si zhvillimi me kushte apo transferimi i të drejtave për zhvillim. Banesat sociale gjithashtu do të ofrohen edhe me anë të projekteve të drejtpërdrejta nga bashkia. Ndërkohë do të përdoren edhe instrumenta financiare dhe mbështetje financiare për të garantuar rritjen e numrit të banesave me kosto të përballueshme në zonat urbane për familjet në nevojë dhe për çiftet e reja.

Bazuar në politikat e **PPK dhe PINS Bregdeti** do të përmirësohet efizienzja energjitike e ndërtesave ekzistuese duke krijuar partneritete me banorët dhe me operatorët privatë. Do të aplikohen standarte të larta për të garantuar efizienzë energjitike tek banesat e reja. Ndërkohë, do të promovohet edhe përdorimi i energjisë diellore veçanërisht për qëllime turizmi dhe bujqësore bazuar edhe në politikat e **PPK dhe PINS Bregdeti për energjinë e rinovueshme**.

Infrastruktura do të përshtatet në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse. Hapësirat publike dhe institucionet do të jenë të parat të cilat do të përshtaten për të garantuar akses nga të gjithë. Mobiliteti në Shkodër synon që deri në vitin 2030 Shkodra të ketë një ndarje të ambicioze midis modaliteteve të ndryshme të transportit 30% biçikleta, 25% transport publik, 25% këmbësorë dhe 20 % makina individuale duke u përputhur edhe me **direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti**. Për këtë do të zgjatohet rrjeti i rrugëve pedonale.

Gjithashtu do të zgjerohet rrjeti i transportit publik në mënyrë që të përfshijë jo vetëm qytetin por edhe njësitë administrative. Do të zgjatohen më tej rrugëkalimet për biçikletat në zonat urbane me parimin e hapësirës së përbashkët (për të mbrojtur dhe kulturën e pedalimit në Shkodër) dhe me korsi të ndara në zonat ku shpejtësia e makinave është me e madhe. Gjithashtu, do të shtohen hapësirat e parkimeve publike. Do të zhvillohen tre parkingje të mëdha me konceptin “park & ride”, në të cilat do të ofrohet edhe transporti publik dhe marrja me qera e biçikletave.

Për realizimin e objektivit strategjik janë përcaktuar një sërë programesh strategjike të cilat më pas do të detajohen në projekte dhe politika:

- **Programi Strategjik OS4PS1:** Rikualifikimi i Ballinave Ujore
- **Programi Strategjik OS4PS2:** Restaurimi i Ndertesave Historike dhe mbrojtja e trashëgimisë historike e kulturore
- **Programi Strategjik OS4PS3:** Rikualifikimi i Hapësirave Industriale dhe Përdorimi i ‘Broënfield’
- **Programi Strategjik OS4PS4:** Urbanizimi i Zonave Informale
- **Programi Strategjik OS4PS5:** Rigjenerimi Urban
- **Programi Strategjik OS4PS6:** Përmirësimi dhe Integrimi i Komuniteteve Rome dhe Egjyptiane
- **Program Strategjik OS4PS7:** Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban
- **Programi Strategjik OS4PS8:** Hapësirat Publike; Hapësirat Rekreative dhe Sportive
- **Program Strategjik OS4PS9:** Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ
- **Programi Strategjik OS4PS10:** Strehimi Social dhe i Përballueshëm
- **Programi Strategjik OS4PS11:** Efizienzja Energjitike dhe Energjia e Rinovueshme
- **Programi Strategjik OS4PS12:** Transporti Publik
- **Programi Strategjik OS4PS13:** Biçikletat

- Programi Strategjik OS4PS14: Gjallëria Urbane
- Programi Strategjik OS4PS15: Parkimet

Objektivi Strategjik 5- Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore

Bazuar në PPK dhe në PINS Bregdeti ka dy implikime kryesore përsa i përket Bashkisë Shkodër në lidhje me mjedisin:

- Zgjerimi i Parkut të Thethit
- Shpallja e Lumit Buna në Park Kombëtar.

Bashkia Shkodër, me territorin e saj të zgjeruar tashmë, është e kërcënuar nga disa rreziqe natyrore si përmytjet, erozione dhe rrëshqitjet e tokës. Me anë të krijimit të programeve të veçanta do të synohet mirëmbajtja e përmirësimi i metodave ekzistuese të mbrojtjes ndaj rreziqeve natyrore. **Bazuar edhe në PPK** zhvillimi në zonat me rreziqe natyrore është kategorikisht i ndaluar dhe ato zona të cilat janë subjekt kërcënimi do të menaxhohe dhe mbrohen me projekte të veçanta, si fortifikimi i digave mbrojtëse dhe argjinaturave, pyllëzime apo dhe masave inxhinierike për mbrojtjen nga erozioni dhe rrëshqitjet e tokës.

Ndryshimet Klimatike janë sfida më e madhe afat-gjatë me të cilën përballlet bota në ditët e sotme. Marrja e masave për adaptimin ndaj ndryshimeve klimaterike duhet të kthehet në një prioritet për planifikimin e territorit dhe qeverisjet vendore. Ato mund të ndihmojnë duke vepruar për përmirësimin e kushteve të komuniteteve në mënyrë të tillë që të jenë sa më të qëndrueshme dhe të adaptueshme ndaj ndryshimeve klimaterike. Gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor, do të parashikohet një rregullore e veçantë, për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike në territorin e bashkisë Shkodër. Ky dokument synohet të kthehet më pas në një rregullore.

Bazuar në direktivat e PPK, duhet të rritet sasia e mbetjeve të cilat shkojnë në lëndfillin e Bushatit si dhe të aplikohet riciklimi dhe kompostimi. Bashkia synon menaxhimin sa më të mirë të mbetjeve dhe për këtë do të hartohet edhe strategjia vendore e menaxhimit të tyre bazuar në strategjitë dhe politikat kombëtare. Bashkia Shkodër do të promovojë riciklimin e mbetjeve urbane ku si fillim do të trajtohen letra dhe metalet. Bashkia do të krijojë mundësinë për ndarjen e mbetjeve që në burim, duke krijuar kosha të diferencuar. Programe të veçanta do të aplikohen për riciklimin, jo vetëm në aspektin e menaxhimit të mbetjeve por edhe në edukimin e qytetarëve dhe ndërgjegjësimin e tyre. Për realizimin e këtij objekti janë përcaktuar një sërë programesh strategjike:

- Programi Strategjik OS5PS1: Mbrojtja e Mjedisit
- Programi Strategjik OS5PS2: Mbrojtja nga përmytjet
- Programi Strategjik OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane
- Programi Strategjik OS5PS4: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja
- Programi Strategjik OS5PS5: Qendra e menaxhimit nga risku i përmytjeve
- Programi Strategjik OS5PS6: Menaxhimi i Rreziqeve Natyrore
- Programi Strategjik OS5 PS7: Menaxhim i pyjeve dhe Kullotave
- Programi Strategjik OS5 PS8: Ndryshimet Klimatike

Kapitulli 3- Plani i Zhvillimit

Bazuar në vkm 671, dt 29.07.2016 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 73, territorit i Bashkisë Shkodër është ndarë në 5 sistemet bazë të përkufizuara dhe kodifikuara si më poshtë:

- Sistemi urban (UB) formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër.
- Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekuara të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë” (N) dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm.
- Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë” (B). Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njerëzore, për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor. Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitete e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
- Sistemi ujqor është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujqorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujqor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë” (U).
- Sistemi infrastrukturor përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë” (IN).

Bazuar në vkm 671, dt 29.07.2016, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 77, përdorimet e tokës kodifikohen si më poshtë vijon:

- **Përdorimi “banim”**, me kod “A”, i cili përfshin zona dhe objekte ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit, edhe në rast se janë të klasifikuara nga legjislacioni për monumentet e kulturës ose të tilla që janë në funksion të banimit;
- **Përdorimi “industri dhe ekonomi”**, me kod “IE”, ku përfshihen të gjitha llojet e industrive sipas legjislacionit të posaçëm, nxjerrje dhe përpunim mineralesh e materialesh ndërtimi, parqe industriale dhe logjistike, inkubatorë biznesi dhe të përziera industriale dhe ekonomike për sa kohë që qëllimi kryesor i funksionit të tyre nuk janë shërbimet dhe aktivitete ekonomike bujqësore sipas kësaj rregulloreje;
- **Përdorimi “bujqësi”**, me kod “B”, për qëllim bujqësor sipas legjislacionit të posaçëm, përfshirë aktivitetet ndihmëse dhe në funksion të drejtpërdrejtë të bujqësisë, përveç banesave dhe rrugëve;
- **Përdorimi “shërbime”**, me kod “S”, territore dhe struktura për shërbime tregtare, zyra dhe qendra biznesi;
- **Përdorimi i veçantë**, me kod “V”, varrezat dhe çdo territor apo strukturë që nuk përfshihet në kategoritë e tjera bazë;
- **Përdorimi “ujëra”**, me kod “U”, të gjithë trupat ujqorë, përfshirë brigjet, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ujërat;
- **Përdorimi “toka natyrore”**, me kod “N”, sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin, biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme;

- **Përdorimi “trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike”,** me kod “M”, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm, përveç atyre që banohen;
- **Përdorimi “zona ushtarake”,** me kod “ZU”, territore dhe objekte të klasifikuara si të tilla në territor apo në legjislacionin e posaçëm;
- **Përdorimi “institucione”,** me kod “IS”, administrata dhe struktura shtetërore, pavarësisht nivelit, të sistemit gjyqësor, bankat, mediet, institucione të mbrojtjes civile dhe kombëtare veç atyre që përfshihen në kategoritë e tjera, të shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit social, të shoqërisë civile, sistemi i burgjeve dhe institucione fetare;
- **Përdorimi “aktivitete sociale dhe rekreative”,** me kod “AR”, aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, përfshirë ato sportive, sipas legjislacionit të posaçëm;
- **Përdorimi “arsim”,** me kod “AS”, sipas legjislacionit të posaçëm;
- **Përdorimi “shëndetësi”,** me kod “SH”, sipas legjislacionit të posaçëm;
- **Përdorimi “infrastruktura”,** me kod “IN”, të gjitha pjesët e infrastrukturave për transportin, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimin me ujë, naftën dhe gazin, biokarburantet, komunikimin


3.1 Ndarja e territorit në njësi strukturore

Ndarja e territorit në njësi strukturore është kryer në bazë të përcaktimeve ligjore për ndarjen e territorit në njësi strukturore të përcakturara si “ndarja më e vogël e territorit për qëllime zhvillimi, e cila përcaktohet gjatë procesit të planifikimit” (vkm 671, 29.07.2016 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 75, pika 1):

Ndarja e njësive ka marrë në konsideratë përputhshmërinë midis përdorimeve të ndryshme dhe shmangien e përdorimeve me ndikime negative mes tyre në të njëjtën njësi, veç rasteve kur parashikohen kushte shtesë për realizimin e një zhvillimi. Gjithashtu faktori kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë përsa i përket tipologjisë hapësinore është një tjetër kriter i përdorur për ndarjen e tyre. Për ndarjen e njësive janë respektuar kriteret për treguesit dhe kushte të njëtrajtshme të zhvillimit si dhe për kufizimin e tyre është përdorur rrjeti rrugor, linja hekurudhore, breza mbrojtës dhe sanitarë, brigje ujore, përrenj, lumenj apo elemente të tjera lineare dhe të dukshme në territor në mënyrë që të ketë qartësi përsa i përket kufinjve.

Në fund, përsa i përket kriterëve të ndarjes së njësive janë përdorur dhe disa elemente të tjera si marrëdhënia me zonat historike, natyrore, bujqësore e ujore. Në këtë kontekst, edhe parashikimet për të ardhmen janë të implementueshme më thjeshtë dhe garantojnë një zhvillim të harmonizuar të këtyre elementëve.

Përsa i përket kodifikimit të njësive strukturore është përdorur metoda e mëposhtme në mënyrë që të lejohet një kërkim sa më lehtë për qytetarët dhe përdoruesit e tjerë të planit në lidhje me njësitë strukturore në GIS.



Kodifikimi përbëhet nga një kombinim gërma dhe numra ku me tre vlera ku:

- Vlera e parë= inicialen e njësisë administrative

(**AM**= Ana e Malit, **BE**= Bërdicë, **VL**= Velipojë, **DA**= Dajç, **GZ**= Gur i Zi, **RrE**= Rrethina, **POS**= Postribë, **SH**= Shkodër; **SHO**=Shosh, **SHA**= Shalë, **PU**= Pult)

- Vlera e dytë

Numri rendor i njësisë strukturore. Numri rendor i njësive strukturore fillon nga 001 për secilën njësi administrative në Bashkinë Shkodër.

- Vlera e tretë

Përfaqëson sistemin në të cilin bën pjesë njësia strukturore të cilat mund të jenë:

(Urban= **UB**; Ujor=**UJ**; Infrastrukturor= **IN**; Natyror= **N**; Bujqësor= **B**)

Më poshtë jepen tre shembuj për kodifikimin e njësive strukturore:

- SH.001.UB= Njësia strukturore 001 në njësinë administrative Shkodër pjesë e sistemit urban.
- VL.035.N= Njësia strukturore 035 në njësinë administrative Velipojë pjesë e sistemit natyror
- AM.007.B= Njësia Strukturore 007 në njësinë administrative Ana e Malit pjesë e sistemit bujqësor

3.2 Përdorimi i Tokës sipas Sistemeve Territoriale

Një nga ndikimet kryesore që, plani dhe projektet strategjike sjellin në territor, është ndryshimi i mundshëm i sistemeve të territorit. Nëse në nivel planesh territoriale përgjithësisht sigurohemi që të krijojmë përdorime toke të përputhshme me njëra-tjerën, në nivel strategjik duhet të kuptohet edhe mundësia e ndryshimit të sistemeve territoriale (bujqësore, natyrore, ujërat, urbane dhe infrastrukturore), për dy arsye: 1) për të kuptuar efektet afatgjata të strategjisë dhe planit në çdo aspekt (territorial, mjedisor, social dhe ekonomik); 2) për të kuptuar, parashikuar dhe rregulluar efektet e sektorëve të ndryshëm mbi njëri-tjetrin dhe si rezultat për të marrë masa ligjore e procedurale për zbutjen e efekteve, ose për realizimin e tyre.

Si rezultat i zbatimit të vizionit dhe planit të zhvillimit dhe projekteve strategjike në territor, pritet që të ndodhin edhe ndryshime të mundshme të sistemeve territoriale, pra konvertime të tokës nga një sistem në tjetrin. Këto konvertime/transformime mund të ndodhin mbi bazën e propozimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të infrastrukturave si dhe përmes disa procedurave ligjore të vendosura në legjislacionin sektorial në fuqi (për bujqësinë, tokat natyrore, ujërat, etj.).

Transformimet e sistemeve në Shkodër bazohen tek objektivat të propozuara në strategjinë. Bazuar në VKM nr. 671/2015, sistemet në thelb do të ngelin po ato pra: sistemi natyror, urban, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor, por disa territore të bashkisë së madhe Shkodër mund të pësojnë ndryshime bazuar në tendencat e zhvillimit që propozohen në këtë strategji e më pas në plan.

Ekziston mundësia e konvertimit të tokave bujqësore përgjatë rrugës së Shkodër Hani Hotit në zonën e njësisë administrative Rrethinat, përgjatë propozimit për by-pass të ri në Shkodër dhe në zonën e Velipojës përgjatë aksit kryesor rrugor. Ky transformim ndodhë për t'i dhënë hov zhvillimit ekonomik lokal dhe për të akomoduar shërbime të tilla tregtare dhe agazinimi/përpunimi, të cilat do të jenë në shërbim të zhvillimit të bujqësisë dhe të turizmit. Në fakt, transformime të tilla kanë ndodhur disi aktualisht për shkak të zhvillimit në mënyrë të shpërhapur dhe informal, që ka ndodhur në këto territore. Kjo do të thotë se konvertimet e mundshme që diktohen në këtë zonë nga strategjia e territorit, do të funksionojnë mbi parimin e kompaktësisë në zona me karakter ndërtimor të shpërhapur dhe të ruajtjes së zonave të tjera bujqësore nga urbanizimi i mëtejshëm.


Gjithashtu, referuar propozimeve që vijnë nga projekti i linjës së 'Korridorit Adriatik Jonian' edhe pse nuk ka ende një gjurmë të qartë, mendohet që të ndodhë një transformim i mundshëm i tokës bujqësore në tokë urbane/infrastrukturore. Ky transformim është i justifikuar përmes Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të ndodhë.

Nisur nga programet strategjike, transformimi i sistemit urban/ infrastrukturor që ndodhet në aksin e bypass ekzistues në qytetin e Shkodrës. Kjo sipërfaqe e cila shtrihet në mënyrë gjatësore përgjatë gjithë shtrijës së bregut të liqenit, ka tendencën të transformohet në zonë natyrore me qëllim rehabilitimin e by-pass (argjinaturës) dhe pyllëzimin e zhvillimin e zonës në një park dhe hapësirë rekreative përgjatë liqenit.

Përsa i përket njësive strukturore ato janë ndarë duke patur në konsideratë edhe sistemet territoriale. Në këtë sens janë identifikuar katër tipologji njësish strukturore, duke qënë se sistemi infrastrukturor është vështirë të përcaktohet si një njësi e vetme. Pra është pjesë integrale e njësive të tjera, dhe për secilën njësi specifike janë përcaktuar dhe kushtet përkatëse të distancave të cilat duhen respektuar bazuar në parashikimet e Kodit Rrugor.

Sistemi Bujqësor

Për të garantuar mbrojtjen e tokës bujqësore, në territorin e bashkisë Shkodër janë përcaktuar një numër i konsiderueshëm njësisish të cilat kanë si përdorim parësor bujqësinë. Vlen të përmendet se këto njësi nuk janë të vetmet njësi në të cilat ka prezencë të tokës bujqësore. Toka bujqësore është pjesë edhe e njësive të tjera si ato urbane dhe natyrore, por në këto njësi janë përcaktuar kritere të forta për të ruajtur tokën bujqësore.



Sistemi Natyror

Ashtu si në rastin e njësive strukturore pjesë e sistemit bujqësor, e njëjta praktikë është ndjekur edhe me sistemin natyror. Janë përcaktuar fillimisht njësitë të cilat kanë përdorim dominues natyrë në mënyrë që të garantohet mbrojtja e tyre. Ndërkohë në njësi të tjera të cilat kanë përdorime urbane apo dhe bujqësore por që ka dhe prezencë të sistemit natyror janë përcaktuar kushte të forta në bazë njësie për mbrojtjen e këtij sistemi.

Sistemi Urban

Për përcaktimin e sistemit urban janë përdorur kufinj të e zonave të urbanizuara bazuar në Vendimin e KKT mbi zonat e urbanizuara në Shqipëri. Duke ndjekur direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti qëllimi ka qënë që të mbrohet toka bujqësore dhe natyrore duke konsoliduar qendrat ekzistuese.


Përdorimi i tokës për zonat ekzistuese është bazuar në një kombim me tre kategori bazë kryesore në mënyrë që të gjenerohen zona dhe njësi urbane me përdorime miks midis banimit, shërbimeve dhe hapësirave tregtare. Për secilën njësi gjithashtu janë përcaktuar edhe koeficientët përkatës për hapësirat publike dhe rrjetin infrastrukturor (për këtë gjë mund të shikohet më në detaj rregullorja me parashikimet përkatëse)

Përtej tre kategorive kryesore, për secilën njësi janë parashikuar dhe përdorimet e tjera të lejuara si dhe ato të ndaluara për të shmangur ndikimet negative. Vlen të përmendet se për ndërhyrje për qëllime të infrastrukturës së rëndësishme kombëtare dhe/ose në interes publik parashikimet në planin e përgjithshëm vendor mund të rishihen rast pas rasti për aq kohë sa respektojnë ligjet dhe dokumentat e planifikimit të niveleve më të larta.

Për të mbështetur turizmin në Velipojë, është parashikuar që brezi midis rrugës kryesore hyrëse në Velipojë dhe shëtitorës të jetë i destinuar për shërbime hotelerie dhe jo për banim. Kjo gjë do të garantonte një unifikim të zonës dhe të ardhura ekonomike për zonën si dhe për bashkinë si rrjedhojë e taksave mbi bizneset.

Përsa i përket Rrjollit, duke qënë se ka pasur kërkesa të shumta për zhvillimin e zonës në rezorte janë përcaktuar tre njësi të cilat nuk preken nga kufizimet sektoriale për mjedisin dhe ujërat. Qëllime është që zhvillimi në këto njësi të jetë i harmonizuar dhe miqësor ndaj mjedisit duke promovuar struktura në funksion të eko-turizmit. Bazuar në skemën e mësipërme zhvillimi lejohet vetëm pranë infrastrukturës kryesore duke konsoliduar vendbanimet ekzistuese. Ndërkohë në afërsi të detit do të aplikohet skema parkim+ shërbim me strukturë të përkohshme + stacion plazhi.

Më poshtë tregohet në mënyrë të përmbledhur treguesit përkatës për secilin prej sistemeve territoriale.



| TABELA E TREGUESVE TE SISTEMEVE | | |
|--|--|---|
| Sistemi | Treguesi | Vlera |
| Urban | S. Territori Urban | 26878658.73 |
| | S. Territori pjesërisht urban | 111289488.9 |
| | S. Totale Urbane | 138168147.6 |
| | Popullsia Ekzistuese | 137760 |
| | Popullsia Propozuar (kapaciteti mbajtes) | 244572 |
| | Strehimi Social | 0 Ekzistues/ 6000 propozuar |
| | Shërbime Administrative | 141561.37 |
| | Transport publik dhe privat | 6 linja transporti publik |
| | Makina | 21000 |
| | Ndarja në zona | 16 |
| | Njësi strukturore urbane | 392 |
| | Gjelbërimi I menaxhuar Z. Urbane | 0.72m2 banor |
| | Gjelbërim I pamenaxhuar | 677.5ha +136.5 ha |
| | Mbetje | 40310 Ton/vit |
| | Prona Publike | 156005 |
| Bujqësor | S. Territori | 1112177682 |
| | S. Primare | 93043307 |
| | S. Dytësore | 52551993 |
| | S. Bujqësore me sistem ujitje | 104682078 |
| | S. Bujqësore pa ujitje | 1007495604 |
| | S. Tokë pa fryt | 5063 ha |
| | Njësi strukturore bujqësore | 199 |
| Ujor | S. Totale | 31106156 m2 |
| | Gjatësia e vijës bregdetare | 12341 m |
| Infrastruktur a | S. Rrugë Kombëtare | 1.06% |
| | S. Rrugë interurbane | 9.67% |
| | S. Rrugë urbane parësore | 3.51% |
| | Hekurudha | 914413 |
| | Porte | 3 porte liqenor= 36314m2 |
| | Aeroporte | - |
| | Ujësllës-Kanalizime | Nga stacioni i pompimit Dobrac merret sasia e ujit Q=800-1100 l/sek |
| | | S |
| | | S |
| | | S |
| | | S |
| | S | |
| | S | |

| | | |
|---------|----------------------------|--|
| | | S |
| | | Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytezohehet nga akuiferi i Nënshkodrës Q=500-800l/sek. |
| Natyror | S. përgjithshme | 6 |
| | S. Pyjore | 30353 ha |
| | Kullota | 6665 ha |
| | S. të gjelbra jo urbane | 851 ha |
| | Z. të mbrojtura | 258182098 |
| | Njësi strukturore natyrore | 1 |

3.3 Plani i ndërhyrjeve në peizazh dhe hapësira publike

3.3.1 Ndërhyrjet në Hapësira publike

Plani i ndërhyrjeve ne hapësirat publike paraqitet si nje rezultat i një kërkimi fotografik të qytetit të Shkodrës dhe lidhjes se këtij qyteti me lumin Kir. Pas konfirmimeve të ndryshme eshte arritur te percaktohet në përafërsi gjurma e këtij lumi dhe rruga me degëzimet e saj ndiqte dikur.

Ashtu si shohim edhe më poshtë dy degëzimet e lumit Kir, të cilat fillonin mbi zonën industriale, i kanë dhënë qytetit të Shkodrës formen urbane të cilen gëzon sot - mbi të gjitha formën e qendres dhe kontekstit urban dhe rrugore përgjatë fushes perëndimore te qytetit ne breg të Liqenit. Hulumtimi i nje te kaluare me karakter natyror do te sherbejë gjithashtu për të udhehequr edhe planin mbi hapësirat publike dhe sheshet qe keto rrugë pershkruajnë.




Imazh 2 Kiri ne fillim te shekullit te '20 – nga foto në hartë

Për të risjellë në jetë një memorie më te fortë qe lidhte lumin Kir me Liqenin e Shkodrës do të propozohen tre Korridore ky fokusi kryesore i nderhyrjes do të nxisë vlerat kulturore, turistike dhe ato ekonomike. Duke u nisur edhe nga eksperiencia e mirë e rruges Gjuhadol dhe Kol Idromeno do te dizonjohen edhe instrumentat e ndërhyrjeve mbi këto korridore.


Konkretisht, ashti si edhe në fig. no.2 tre do të jenë fushat e ndërhyrjeve:

- në rrjetin infrastrukturor,
- në godinat që këto korridore përshkruajnë dhe
- në sheshet përgjatë këtyre korridoreve.

Më poshtë thellimi i tre korridoreve për menyrat e ndërhyrjes, dhe funksionet mbi arsyet e hartimit te ketij plani mbi hapësirat publike.



Imazh 3- Tre korridoret



Imazh 4- Tre format e nderhyrjeve

KORRIDORI I PARË (Korridori Qëndror)


Korridori i Parë, ose ai më qëndrori, synon lidhjen e stacionit të trenit me parkun e Liqenit të Shkodrës duke kaluar nëpërmjet qendrës kulturore / turistike dhe administrative të qytetit të Shkodrës.




Imazh 5- Korridori Qëndror – Nga Kiri ne Parkun e Liqenit duke kaluar per ne qendren historike

Për një detajim më të hollësishëm është zgjedhur që ky korridor të ndahet në tre prerje të cilat do të jenë edhe udhëzuesit e këtij korridori kaq kompleks. Ashtu si edhe ne fig. nr. 5 këto prerje shtrihen si më poshtë:

- Prerja Pare: Nga stacioni trenit ne rrugen Kol Idromeno.
- Prerja Dytë: perqark qendrës duke llogaritur edhe zgjatimet për ne jug të qendrës.
- Prerja e Tretë: nga stadiumi ne parkun e Liqenit të Shkodrës.



Imazh 6- Stacioni i Trenit Kol-Idromeno



PRERJA E PARË:

Prerja parë synon lidhjen e stacionit të trenit me qëndrën e qytetit. Rr. Revolucionit Antikomunist Hungarez, Rr. Justin Godard, Rr. Gjuhadol

Arsyet e nderhyrjeve infrastrukturore:


- Lidhja e e stacionit te trenit me qendren historike dhe turistike te qytetit te shkodres.
- (ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, e turistik).
- Krijimi I nje aksesit te lehte (ne kembe) e te vecante qe te lidhe stacionin e trenit me qendren. (ceshtje te aksesibilitetit te lehte dhe te diferenciuar)

Arsyet e nderhyrjeve ne godina:

- Nderhyrje ne riveshjen e banesave historike per te nxitur bashkepunimin me privation / institucionet jo qeveritare / kulturore dhe rivleresimin historik. (ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, turistik dhe te banesave).
- Nderhyrje ne riveshjen e godinave buze rruges per te nxitur hapjen e aktiviteteve private. (çështje të ekonomisë lokale)

Arsyet e nderhyrjeve ne sheshet pergjate prerjes se pare:

- Rritjen e nje mireqenie fizike e te njetratjeshme Qender - Periferi. (rikraction, kohe e lire per banoret, nxenesit e shkolles dhe ne te ardhmen edhe per pasagjeret hekurudhore).





Imazh 7 Ndëryhjet në Prerjen e Pare

Llojet e ndërhyrjes në infrastrukture: Rikonstrukcion i rrugës, sistemit te kanalizimeve te ujerave të bardha e të zeza dhe ate elektrik dhe internet.

Llojet e ndërhyrjes në godina: Rikonstrukcion në fasadat e banesave buze dhe mbi muret rrethues te ketyre shtepiave.

Llojet e ndërhyrjes në sheshet publike: Rikonstrukcion ne mobilimin urban dhe trajtimin e hapësirave të gjelbërta përreth shesheve.



Imazh 8 Elemente te nderhyrjes ne rruge dhe hapësira publike

PRERJA E DYTË:

Prerja e dytë synon lidhjen e disa objekteve me rëndësi publike në një lakore historike dhe turistike. Rr. 13 Dhjetori, Rr. Kol Iromeno, Rr. Kardinal Koliqi, Rr. Vladimir Jani, Rr. Bashkimi, Rr. Nazmi Kçryeziu, Rr. Elvija Celebiu, Rr. Hamz Kazazi.

Arsyet e nderhyrjeve infrastrukturore:


- Perkufizimi i nje qendre arkitektonisht te identifikueshme. (ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, e turistik).

Arsyet e nderhyrjeve ne godina:

- Nderhyrje ne riveshjen e banesave historike per te nxitur bashkepunimin me privation / institucionet jo qeveritare / kulturore dhe rivleresimin historik. (ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, turistik dhe te banesave).
- Nderhyrje ne riveshjen e godinave buze rruges per te nxitur hapjen e aktiviteteve private. (çështje të ekonomisë lokale)

Arsyet e nderhyrjeve ne sheshet pergjate prerjes se dyte:

- Rritjen e nje mireqenie fizike ne qender te qytetit. (rikracion, kohe e lire per banoret, nxenesit e shkollave dhe turistet)




Imazh 9 Ndërhjetet në Prerjen e Dytë

Llojet e ndërhjetjes në infrastrukture: Rikonstruksion i rrugës, sistemit te kanalizimeve te ujerave të bardha e të zeza dhe ate elektrik dhe internet.

Llojet e ndërhjetjes në godina: Rikonstruksion në fasadat e banesave buze dhe mbi muret rrethues te ketyre shtepiave.

Llojet e ndërhjetjes në sheshet publike: Rikonstruksion ne mobilimin urban dhe trajtimin e hapësirave të gjelbërta përreth shesheve.



stacion për ndalesa të shkurtra

stacion për ndalesa të gjata

Imazh 10 Elemente te nderhyrjes ne rruge / hapesira publike / sheshe urbane

PRERJA E DYTË (zgjatimet përçark qendrës):

Zgjatimet përçark qendrës synojnë zgjerimin e zonës historike duke nxjerrë ne pah atë cka gjëndet ne krah te aksit kryesore Kol Idromeno - konkretisht ne jug te 'Kafes së Madhe' dhe Bashkisë Shkodër. Rr. Edith Durham, Rr. Hafiz Sabri Bushati, Rr. Don Bosko, Rr. Rruga Jezuiteve, Rr. Franc Nopca, Rr. Besnik Syka, Rr. Oso Kuka, Rr. Gjylbegaj, Rr. Vilson.

Arsyet e nderhyrjeve infrastrukture:


- Krijimi i nje aksesit te lehte (ne kembe) e te vecante qe te depertoje per ne qender te qytetit.(ceshtje te aksesibilitetit te lehte dhe te diferenciuar)

Arsyet e nderhyrjeve ne godina:

- Nderhyrje ne riveshjen e banesave historike per te nxitur bashkepunimin me privation / institucionet jo qeveritare / kulturore dhe rivleresimin historik. (ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, turistik dhe te banesave).
- Nderhyrje ne riveshjen e godinave buze rruges per te nxitur hapjen e aktiviteteve private. (çështje të ekonomisë lokale)

Arsyet e ndërhyrjeve ne sheshet pergjate prerjes se dyte:

- Rritjen e nje mireqenie fizike ne qender te qytetit. (rikracion, kohe e lire per banoret, nxenesit e shkolles dhe turistet)




Imazh 11 Nderhyjet në Prerjen e Dytë (zgjatimet perqark qendres).

Llojet e ndërhyrjes në infrastrukture: Rikonstrukcion i rrugës, sistemit te kanalizimeve te ujerave të bardha e të zeza dhe ate elektrik dhe internet.

Llojet e ndërhyrjes në godina: Rikonstrukcion në fasadat e banesave buze dhe mbi muret rrethues te ketyre shtepiave.

Llojet e ndërhyrjes në sheshet publike: Rikonstrukcion ne mobilimin urban dhe trajtimin e hapësirave të gjelbërta përreth shesheve.



Imazh 12 Elemente te nderhyrjes ne rruge dhe hapësira publike

PRERJA E TRETË:

Prerja e tretë synon lidhjen e stadiumit dhe te prerjes se dytë me parkun e Liqenit të Shkodrës. Rr. Djepaxhij, Rr. Muhamet Dibra, Rr. Fetih Dizdari, Rr. Kasem Taipi, Rr. Hoxhë Kadria, Rr. Jul Variboba

Arsyet e nderhyrjeve infrastrukturore:


- Lidhja e qendres historike dhe turistike te qytetit te Shkodres me bregun natyror te Liqenit.(ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, e turistik).
- Krijimi i nje aksesit te lehte (ne kembe) e te vecante qe te lidhe qendreme Liqenin. (ceshtje te aksesibilitetit te lehte dhe te diferenciuar)

Arsyet e nderhyrjeve ne godina:

- Nderhyrje ne riveshjen e banesave historike per te nxitur bashkepunimin me privation / institucionet jo qeveritare / kulturore dhe rivleresimin historik. (ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, turistik dhe te banesave).
- Nderhyrje ne riveshjen e godinave buze rruges per te nxitur hapjen e aktiviteteve private. (çështje të ekonomisë lokale)

Arsyet e nderhyrjeve ne sheshet pergjate prerjes se dyte:

- Rritjen e nje mireqenie fizike ne qender te qytetit. (rikracion, kohe e lire per banoret, nxenesit e shkolles dhe turistet)




Imazh 13- Ndërrhyjet në Prerjen e Tretë

Llojet e ndërrhyjes në infrastrukture: Rikonstruksimin e rrugës, sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha e të zeza dhe atë elektrik dhe internet.

Llojet e ndërrhyjes në godina: Rikonstruksimin në fasadat e banesave buze dhe mbi muret rrethues të katër shtëpiave.

Llojet e ndërrhyjes në sheshet publike: Rikonstruksimin në mobilimin urban dhe trajtimin e hapësirave të gjelbërta përreth shesheve.



Imazh 14 Elemente të ndërrhyjes në rrugë dhe hapësira publike

KORRIDORI I DYTË (Korridorin Jugor)

Korridori I Dytë vjen si propozim I zgjatimin te zones tregtare ne sheshin Zdrale drejte zons se liqenit dhe ate te kalase. Nga ky propozim ky corridor do te marre edhe emrin ndryshe si korridori I tregtise.



Imazh 15 Ndëryhjet në Prerjen e Tretë. _Lek Dukagjini, Rr. Kongresi Manastirit, Rr. Myzafer Pipa, Rr. Eqerem Çabej, Rr. Vellezerit Frasherit, Rr. Isuf Sokoli


Arsyet e nderhyrjeve infrastrukture dhe në godina:

- Lidhja e qendres historike dhe turistike te qytetit te Shkodres me bregun natyrore te Liqenit. (ceshtje te vleresimit kulturore, artistik, e turistik).
- Zgjatimi i interesit tregtar nga sheshi Zdrale ne Tophane. (çështje të ekonomise lokale)


Llojet e ndërhyrjes në infrastrukture: Rikonstrukcion i rrugës, sistemit te kanalizimeve te ujerave të bardha e të zeza dhe ate elektrik dhe internet.

Llojet e ndërhyrjes në godina: Rikonstrukcion në fasadat e banesave buze dhe mbi muret rrethues te ketyre shtepiave.

(Rikonstruktimi I godinave do te behet mbas nje vleresimi historik dhe arkitektonik te vlerave qe keto korridore mbartin – per te perzgjedhur me pas vetem ato godina te cilat rezultojne historike)




Imazh 16 Ndëryhjet në Korridorin e Dyte



Imazh 17 Elemente te nderhyrjes ne rruge dhe hapësira publike

Korridori i Tretë (Korridori Verior)

Ky Korridor vjen si nje zgjatim i dy korridoreve te mepareshem dhe synon lidhjen e qendres se qytetit me pjesen veriore te parkut te Liqenit. Nga lloji i nderhyrjeve mund te themi se ky korridor do te kete karakter te nderhyrjeve ne sistemin e gjelberimit qe ndodhet ne rruge per tu bashkuar me pas me parkun.




Imazh 18 Ndëryhjet në Prerjen e Tretë. Rr. Bujar Bishanaku, Rr. Hoxha Tasim, Rr. Mëndafshit

Arsyet e nderhyrjeve infrastrukturore dhe në godina:


- Lidhja e qendres historike dhe turstike te qytetit te Shkodres me bgerun natyror te Liqenit. (ceshtje e vleresimit kulturore, artistik, e turistik).
- Zgjatimi I sistemit te gjelber ne rruge deri ne parkun e liqenit. (çështje të mireqenies lokale)

Llojet e ndërhyrjes në infrastrukture: Rikonstrukcion i rrugës, sistemit te kanalizimeve te ujerave të bardha e të zeza dhe ate elektrik dhe internet.


Llojet e ndërhyrjes në godina: Rikonstrukcion në fasadat e banesave buze dhe mbi muret rrethues te ketyre shtepiave. (Rikonstruktimi i godinave do te behet mbas nje vleresimi historik dhe arkitektonik te vlerave qe keto korridore mbartin – per te perzgjedhur me pas vetem ato godina te cilat rezultojne historike)



Imazh 19 Ndëryhjet në Korridorin e Trete



situata aktuale



mbas rikualifikimit




adoptimi i Konceptit Woonerf në disa lagje
 Karakteristikat: Shpejtësi e ulët e makinave, Rrugë gjarpëruarë (me xhepa parkimi),
 Rrugë të gjelbëruara, Rrugë gjysëm kembësore.

Imazh 20 Elemente të ndërhyrjes në rrugë dhe hapësira publike


3.4 Ndërhyrjet në peizazh

Rizhvillimi i qendrës së qytetit të Shkodrës ka një bazë të mirë mbi të cilën të vazhdojë përmirësimin. Gjithashtu, përtej ndërhyrjeve në qendër dhe në hapësira publike e rëndësishme është që vëmëndja të kthehet edhe përsa i përket kufinjve të qytetit, duke kapitalizuar në marrëdhënien e tij me lumenjtë dhe liqenin, dhe duke përdorur cilësitë e larta të ekzistuese. Ndërlidhje strategjike duhet të forcohen midis qendrës dhe kufinjve.



Imazh 21- Ndërhyrje në peizazh 1


Marrëdhënia me zonën mund të përforcohet më shumë duke krijuar zona dhe struktura të cilat mbrojnë Shkodrën nga përmytjet, si dhe përmirësojnë cilësinë e jetesës së qytetarëve të qytetit. Katër zona specifike mund të përfitojnë nga kjo përjasje për tu kthyer në peizazhe ujore multifunktionale.



Imazh 22- ndërhyrje në peizazh 2

Këto katër zona kanë karakteristika të ndryshme peizazhistike, si rezultat i marrëdhënieve të ndryshme me ujin:


- Diga (zona e bypass perëndimor)
- Peizazh Lumor
- Breg Liqeni
- Zona e përmbytjeve



Imazh 23- katër ndërhyrjet në peizazh


Diga tek Liqeni

Diga e ngritur si rrjedhojë e bypass perëndimor krijon mundësinë për struktura dhe funksione dhe njëkohësisht mbron zonën nga përmbytjet. Kjo lejon për zhvillime të reja spektakolare dhe të veçanta . Zhvillimet e reja vendosen pas digës ose mbi të. Ndërtimi në këtë zonë është i mundur por duke marrë masa përkatëse për mbrojtjen nga përmbytja.





Imazh 24- skema e ndërhyrjeve

Gjithashtu, vija ujore të tjera mund të gërmohen dhe të përdoren për rritjen e kapacitetit të ujëmbajtës të kësaj zone si dhe për të përforcuar karakterin e zonës. Dherat mund të përdoren për të zbutur teksturën e profilit që ndërlihd qytetin me digën.



Imazh 25- skema e ndërhyrjeve 2

Në këtë zonë gjithashtu propozohet që të zhvillohen disa aktivitete institucionale dhe facilitate publike të tilla si qendra kërkimore, zyra të bashkisë, institute, stacione monitorimi.



EXCLUSIVE PUBLIC FACILITIES
ON THE DIKE



NEW URBAN QUARTER
AND PUBLIC PLAZA
BEHIND THE DIKE



Imazh 26- skema e ndërhyrjeve 3

Ndërkohë në pjesën jugore të digës, propozohet që zona të rihvillohet duke u kthyer në një nga kuarteret e rinj të Shkodrës.



Imazh 27- Porti në Liqenin e Shkodrës

Zhvillime miks, propozimi i një porti të vogël për lundrim në liqen. Ky mol/port i vogël do të shërbejë edhe për lëvizjen e turistëve nëpërmjet liqenit nga Shqipëria në Mal të Zi dhe anasjelltas. Ndërkohë mund të zhvillohen më pas dhe sporte ujore të lidhura me lundrimin, kanotazhin etj.




Imazh 28- Rikualifikimi i By-Pass Perëndimor

Kjo zonë do të shërbejë si një park i vazhduar dhe një hapësirë e re e rekreative për qytetin e Shkodrës. Do të shërbejë për të afruar qytetin me liqenin si dhe për të rritur përdorimin e tij. Është një nga masat që rekomandohet për të zbutur impaktet negative që për momentin kanë shkaktuar punimet për bypass perëndimor. Gjithashtu, kthehet edhe në një funksion mbrojtës në kuadër të situatës së përmbytjeve.

Lumi i Kir

Qëllimi është që Lumi Kir të kthehet në një ballinë ujore për qytetin e Shkodrës.




Imazh 29- ndërhyrjet në peizazh 4

Kjo është një zonë e neglizhuar, për këtë arsye marrëdhënia midis lumit dhe qytetit është e nevojshme që të forcohet. Duke qënë se lumi Kir është mjaft i rëmbyeshëm fillimisht duhet që të ketë një sistem për drejtimin e ujërave në mënyrë që të mos rrezikojë përmbytjen apo dhe erozionin.


LOW WATER



HIGH WATER



PEAK WATER



Si rrjedhojë fillimisht duhet rregulluar fasha ripariane e lumit Kir, e cila mund të kryhet me masa të cilat janë të buta si mbjellje bimësie apo edhe në disa raste duke përdorur masa më të forta me anë të strukturave fikse të cilat mund të përdoren për qëllime të ndryshme rekreative.

Imazh 30- Skema e ndërhyrjeve KIR



Imazh 31- Imazh Kir



Breg Liqeni



Imazh 32- Skema për ndërhyrje në breg liqeni

Marrëdhënia midis Shirokës dhe Zogajt me bregun e liqenit fuqizohet duke shtuar aktivitete ujore dhe rekreative. Këto aktivitete zhvillohen mbi nivelin e rrugës dhe duke respektuar përkatësisht kodin rrugor dhe legjislacionin mjedisor në fuqi.

CONNECTION BETWEEN VILLAGES AND WATER




Imazh 33- Skema e Ndërhyrjeve në për plazhet në liqen

Kjo gjë mund të organizohet me anë të një programesh hapësinore të cilat ndërlidhin tre komponentë si parkimi, shërbimi dhe plazhi.


Zona e përmbytjes

Kjo është një zonë e rëndësishme nga pikëmjësia mjedisore në Bashkinë Shkodër. Është kryqëzimi i dy prej lumenjve më të mëdhenj dhe shpesh herë është në impaktin e përmbytjes.




Imazh 34- Ndërhyrjet në Peizazh


Nuk lejohet operimi me struktura të përhershme por vetëm me struktura të lehta të çmontueshme duke qënë një zonë me rrezik të lartë përmbajtjeje. Në këtë kontekst propozohen edhe hapësira për kamping apo shëtitje, lëvizje me biçikletë dhe aktivitete të tjera rekreative.



NETWORK FOR BIKES/PEDESTRIANS



INACCESSIBLE, FLOODED DURING HIGH AND PEAK WATER



Imazh 35- Ndërhyrjet në Peizazh 2

3.5 Shërbimet Publike


3.5.1 Kopshtet, shkollat 9-vjecare, shkollat e mesme.

Bashkia Shkodër ka një mbulim të mirë me kopshte, shkolla 9-vjecare dhe shkolla të mesme. Propozohet ndërtimi i kopshteve vetëm një në Shirokë dhe një Dajç duke qenë se aty mungojnë si dhe përmirësimi i kushteve në kopshtet ekzistuese. Në njësitë administrative Dajç dhe Mes propozohet ndërtimi i një nga shkollat të mesme si dhe përmirësimi i kushteve në shkollat e tjera ekzistuese. Ndërsa përsa i përket rrezes së mbulimit me shkolla të mesme ato nuk shihet e arsyeshme të ndërtohen të reja, por vetëm të përmirësohen kushtet e atyre ekzistuese.

Sipas ligjit për planifikimin e territorit në nenin 83 të tij, për strukturat publike për arsim rrezet e mbulimit janë vendosur duke marr pasasysh numrin e banorëve.

Për kopshtet

1. Llogaritet një kopshtë për çdo 1,500 banorë
2. Rrezja e mbulimit të kopshtit në vijë ajrore është 250-350 metra për zonat urbane dhe 500-600 metra për zonat rurale.



Për shkollat fillore dhe 9-vjeçare


1. Llogaritet një shkollë për çdo 6,000 banorë
2. Rrezja e shërbimit të shkollës në vijë ajërore është 500-600 metra në zonat rurale dhe 1,000-1,500 metra në zonat rurale.

Për shkollat e mesme

1. Llogaritet një shkollë për cdo 9,000 banorë
2. Rrezja e mbulimit të shkollës në vijë ajërore është 1,000-1,500 metra në zonat urbane dhe 2,000-4,500 metra në zonat rurale.

3.5.2 Qëndrat Shëndetësore

Bashkia Shkodër ka një rrjet të mirë të shpërndarjes së qendrave shëndetësore në territorin e saj si rrjedhojë edhe e trashëgimisë institucionale nga bashkimi me komunat e tjera përreth saj. Në këtë kuadër, si pjesë e PPV Shkodër propozohet rregullimi dhe përmirësimi i cilësisë së ndërtesave të këtyre qendrave shëndetësore në të gjithë territorin e bashkisë.




Gjithashtu parashikohet përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit duke shtuar edhe aparatura shtesë për shërbime të tjera si në rastin e konsultoreve të grave të cilat propozohen edhe si pjesë e qendrave të njëjësive administrative. Në zonën e velipojës duke parë një fluks më të madh të turistëve gjatë verës, propozohet hapja e dy qendrave shëndetësore sezonale të cilat do të vijnë në ndihmë qytetarëve gjatë sezonit turistik. Këto qendra duhet të jenë të lidhura me sistemin e rojeve të bregdetit në mënyrë që të ofrojnë një shërbim të koordinuar ndaj qytetarit.

3.5.3 Shërbimi me një ndalesë

Ky shërbim mund të ofrohet më vete, pra në zyrat e njësisë administrative, dhe/ose në bashkëpunim me zyra të tjera si posta/policia/shkolla etj në varësi të kapaciteteve dhe institucioneve ekzistuese lokale. Në këtë kontekst zyrat me një ndalesë mund të luajnë edhe role këshillimore ndaj qytetarëve të tilla si:

- Informacion/Guida turistike
- ‘Arkitekti Im’

Ofron këshillim për restaurimi/rikonstrukcionin dhe ndërtimin e objekteve në mënyrë që të bëhen konform rregullave ligjore dhe në mbrojtje të trashëgimisë arkitektonike apo karakteristikave lokale. Programi “Arkitekti Im” synon gjithashtu lidhjen me procesin e legalizimit të zonave informale. Ai synon zbutjen dhe informimin e këtij procesi por gjithashtu u vjen në ndihmë atyre të cileve nuk e kanë një planimetri dixhitale të shtëpisë së tyre - hap parësor për procesin e legalizimeve. “Arkitekti Im” ndryshe nga shërbimet e tjera të cilat ofron Bashkia dhe zyra rajonale e Legalizimeve (aluizni, Shkodër) synon të shtrihet sa më afër ketyre konteksteve territoriale në periferinë e Shkodrës.



3.5.4 Qëndrat Multifunksionale.

Krijimi i shkollave me bazë komunitare si një element integral i përmirësimit të cilësisë së jetesës në zonat informale ku ndihet dhe mungesa e shërbimeve. Zhvillimi i Burimeve Njerezore duke u bazuar

tek Arsimi dhe Trajnimet profesionale në përgjigje të nevojave të ndryshme të banorëve të Shkodrës.

- Shkolla të integruara si qendra për komunitetin.
- Eficiencë e shkollimit në distancë (shkollim part-time, online, etj.)
- Kualifikime profesionale për të gjithë komunitetin.
- Qendra Multifunkionale dhe Qendra Sociale në funksion për komunitetin


Propozohen:

- “Shkolla si Qëndër Multifunkionale” Postrisë
- “Shkolla si qëndër komunitare” (lagjia mark lula)
- “Qëndër Multi funksionale”- rikualifikim i ish-shkollës së veterinarisë
- “Qëndër Multifunkionale Dajç”
- “Shkolla si qëndër komunitare” Bërdicë
- “Shkolla si qëndër komunitare” Gur i Zi
- “Shkolla si qëndër komunitare” Ana e Malit


Për sa më sipër, Bashkia Shkodër duhet të hartojë një rregullore të funksionimit të qendrave multifunkionale dhe qendrave komunitare.

3.5.5 Tregjet

Në bashkinë Shkodër është shumë e nevojshme të krijohet një rrjet i konsoliduar tregjesh. Ato nuk duhet të shihen thjesht si hapësira tregtimi por edhe si hapësira publike e argëtimi.



Në hartën e mësipërme janë përcaktuar njësitë strukturore në të cilat mund të ndërkohen/ hapen tregje. Gjithashtu, përveç qytetit të Shkodrës, edhe në velipojë është e rëndësishme që të krijohen hapësirat përkatëse për tregjet:



Në të dyja rastet, tregjet mund të ndërtohen në disa mënyra. Me investime të drejtpërdrejta nga bashkia në toka publike. Me anë të partneriteteve publike private në toka publike ose duke marrë me qera toka private. Gjithashtu, për krijimin e tregjeve apo hapësirave publike mund të përdoren dhe instrumentet e drejtimit të zhvillimit të përcaktuara në rregulloren e planit të tilla si zhvillim me kushte dhe transferim i të drejtës për zhvillim.

3.6 Plani i masave për ndërhyrjet në mjedis

Në lidhje me masat e mbrojtjes së mjedisit, kujdes i veçantë është treguar edhe për zonat e mbrojtura natyrore si **Parku i Alpeve, Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna (Park Kombëtar sipas PPK), Lumi Buna- Velipoja (Peizazh i Mbrojtur)** në mënyrë që propozimet e përdorimit të tokës të mos kenë ndikime negative në to.

Gjithashtu, do të ndalohet derdhja e mbetjeve në mjediset ujore. Do të ofrohen infrastrukturat e nevojshme nëntokësore për të ndaluar derdhjen e ujërave të zeza në ujëra. Gjithashtu do të rikualifikohen hotspotet mjedisore dhe mbyllen pikat ilegale të depozitimit të mbetjeve. Në fund, ishvendepozitimet e mbetjeve në Bardhaj dhe Pulaj do të rigjenerohen. Rikualifikimi i ish-vendepozitimit të mbetjeve Shkodër pranë varreza të Dëshmorëve.

Shfrytëzim i kontrolluar dhe i planifikuar i ujërave nëntokësorë. Kontroll i burimeve të ndotjeve në pellgjet ujembledhës, uëjrat sipërfaqësore dhe luginat përkatëse. Zbatim i legjislacionit për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore. Përpunim dhe rishfrytëzim i ujërave të ndotur

Ruajtja e fashës së lumit sipas specifikimeve ligjore. Trasferimi i ndërtimeve që ndodhen Brënda fashës së mbrojtur të lumit në zona zhvillimi nëpërmjet instrumentave të zhvillimit. Krijimi i një rripi/brezi të gjelbër, me pyllëzim të dendur në të gjithë gjatësinë e fashës së mbrojtur. Pyllëzimi i zonave ku ka erodion në shtratin e lumit për të administruar riskun. Rivitalizimi i rrjetit duke aktivizuar: Kënetën e Shlirës, Kënetën e Pentarit, Kënetën e Casit, Kënetën Nerliz, Kënetën e Gjeneralit dhe Liqenin e Muriemës

Në çdo njësi administrative do të instalohen sistemet e alarmit dhe paralajmërimit. Një herë në vit do të kryhet testimi i sistemit të alarmit dhe paralajmërimit dhe një trajnim/provë për evakuimin e popullsisë drejt zonave të sigurisë.

Pyjet dhe kullotar përbëjnë një aset të rëndësishëm ekonomik për zonat rurale dhe gjenerimin e të ardhurave në Shkodër. Në këtë kontekst do të hartohen planet e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që ato të mbrohen dhe njëkohësisht të shfrytëzohen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetet lokale.

Forcimin e kapaciteteve në Bashkinë Shkodër për hartimin e politikave për klimën, me prioritet ngritjen e sistemit të monitorimit dhe të raportimit vjetor të GHG-ve në përputhje me kërkesat e BE-së. Mbështetjen e krijimit të partneriteteve rajonal e lokal për përmirësimin e teknologjisë, politikave dhe strategjive për mitigim në të gjitha sektorët e ekonomisë. Integrimi i masave të përshtatjes (adaptimit) dhe reduktimit të GHG në hartimin e planeve vendore të detajuara, menaxhimin e ujrave dhe tokës duke përfshirë bujqësinë, pyjet dhe ruajtjen e natyrës. Masa specifike për mbrojtjen e mjedisit janë parashikuar dhe në vlerësimin strategjik mjedisor të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër.

3.6.1 Zonat e mbrojtura të rëndësishme kombëtare mjedisore

Park Kombëtar “Thethi”

Me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 96, datë 21.11.1966, zona malore e Thethit, me sipërfaqe 2630 ha, nga e cila 1680 ha pyje dhe pjesa tjetër kullota dhe sipërfaqe shkëmbore, shpallet “Park Kombëtar” dhe administrohet nga D.SH.P, Shkodër. Parku Kombëtar i Thethit ndodhet në pjesën qendrore të Alpeve të Shqipërisë, ndërmjet bllokut të Bjeshkëve të Nëmuna në perëndim dhe bllokut të Jezercës në lindje. Thethi është një qendër turistike-alpinistike më e rëndësishme e zonës veriore, 70 km larg nga qyteti i Shkodrës. Ai bën pjesë në njësinë administrative të Shalës, të zonës së Dukagjinit. Parku kufizohet nga të gjitha anët me maja të larta shkëmbore të dy blloqeve më të sipërme, të cilat bien thikë në luginë dhe formojnë pamje të papërsëritshme të tilla si: maja e Radohimës, (2570 m), Arapit (2217 m), Paplukës (2569 m), Alisë (2471 m), etj. Në lartësitë 750-800 metër, poshtë në luginë shtrihet fshati piktoresk i Thethit.

Në park dallohen dy sektorë ai i sipërm dhe sektori i poshtëm. Sektori i sipërm është shumë më tepër i thepisur, gjë që lidhet me përbërjen e tij prej gëlqerorësh masiv të dolomitizuar. Pikërisht ky dolomitizim kushtëzon zhvillimin intensiv të tjetërsimit fizik të tyre, në kushtet e veprimit të fuqishëm procesiv, ngricave dhe dëborës, të cilat janë të pranishme në pjesën më të madhe të vitit dhe të ndryshimeve të shpeshta të temperaturës. Në këto kushte litologjike dhe klimatike, aty zhvillohet copëtimi i shkëmbit rrënjësor dhe rrëzime gravitacionale të materialeve copëzore. E gjithë kjo ka për pasojë formimin e majave dhe të kreshtave të thepisura dhe natyrisht, mungesën e plotë të bimësisë dhe të mbulesës së tokave.

Sektori i poshtëm ka pjerrësi më të vogël, duke shënuar kështu një thyerje të dukshme të profilit të shpatit, një shkallë në këtë profil. Formimi i kësaj shkalle lidhet me ndryshimin e karakterit të gëlqerorëve, nga masiv në shtresorë, me shtresa shumë më të holla. Këta lloj gëlqerorësh janë më pak të dolomitizuar dhe më të tretshëm. Për pasojë, në krahasim me sektorin e sipërm, zvogëlohet pjerrësia e shpatit, por përsëri ajo mbetet më e madhe se e pjesës fundore, e përbërë nga terrigjen rreshpor, me pjerrësi shumë më të vogël. Është kjo arsyeja që në sektorin e poshtëm të kreshtave

rrethuese, proçeset e rrëzimeve gravitacionale zhvillohen me intensitet shumë më të vogël. Ndërkohë, në këtë sektor edhe proçeset e tjera erozivo-denuduese kanë zhvillim më të vogël. Kjo ka bërë që në këtë sektor të shtohet gradualisht bimësia deri sa merr formën e pyjeve masive të ahut, halorëve dhe dushkut.

Parku shtrihet në toka të murme pyjore, mbi të cilat janë të vendosura pyjet e parkut, dhe pjesërisht në tokat livadhore malore, mbi të cilat janë të vendosura kullotat alpine. Në pjesën jugore të parkut është i formuar kanioni i Grunasit rreth 2 km i gjatë, 60 metra i thellë, dhe varion nga 2-3 metra deri në 30-40 m i gjerë. Në Theth ka edhe shumë shpella të famshme si ajo e Harapit dhe Bira e Rrathëve, ku ka liqene nëntokësore dhe galeri e sifone gjigante. Thethi ka edhe 12 mullinj të vegjël dhe një hidrocentral funksional. Në periudhën maj – shtator Thethi vizitohet nga 5000–10.000 turistë të huaj dhe pothuajse të gjithë vizitojnë kanionin e famshëm të Grunasit.

Parku i Thethit është kompleks, me larmi habitatesh dhe tipe vegjetacioni, ku pjesën më të madhe e zënë ato të pyjeve të ahut (*Fagus silvatica*), por ka dhe formacione shkurre me mbizotërim të boronicës (*Vaccinium myrtillus*) apo kullota alpine (*Poion alpinae*), të cilat bashkëshoqërohen dhe me shkurre xhuxhe dhe të zonave alpine si: (*Juniperus communis nana*; *Juniperus sibirica*.), driada tetëpetalshe (*Drias octopetala*), etj. Në park rriten rreth 1500 lloje bimësh, të cilat përfaqësojnë gati gjysmën e florës së vendit tonë. Nga bimët, rreth 100 lloje janë bimë mjekësore dhe tanifere shumë të dobishme ndërsa rreth 70 lloje bimësh janë të rrezikuara për zhdukje. Nga shoqërimet më të zakonshme të Fagion illyricum janë: Fagetum oxalidosum, Fagetum vaccinosum, Tremuleto-Fageto asperulosum, Fageto-allietosum ursinum, etj. Për t'u vlerësuar janë prania e drurit relik të tisetit (*Taxus baccata*), brenda katit drunor të pyllit të ahut, megjithëse në ekzemplarë të rrallë, si dhe bimët endemike (*Ēulfenia baldacci*; *Viola dukagjinica*; *Lilium albanicum*.), dhe bimët subendemike (*Aquilegia dinarica* dhe *Teucrium arduin*). Në Theth gjendet edhe *Gentiana*, lulja që përdorte mbreti Ilir Genti në mjekësi.

Në parkun e Thethit dallohen 3 kate bimore. Kati i dushkut, shtrihet në lartësi 600-800 m dhe takohet në fundet e shpateve malore si në Fushë të Thethit, Gjellaj, etj. Ndër bimët më të rëndësishme të këtij kati janë: qarri (*Quercus ceris*), mëlleza (*Ostria carpenifolia*), shkoza (*Crapinus orientalis*), frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus*), thana (*Cornus mas*), etj.

Kati i ahut shtrihet në lartësinë 700-1900 m. Si pasojë e kushteve të përshtatshme klimatiko-tokësore të favorshme, pyjet e ahut zënë pjesën më të madhe të parkut. Ndër bimët më të rëndësishme të këtij kati janë: ahu (*Fagus silvatica*), bredhi i bardhë (*Abies alba*), panja e malit (*Acer pseudoplatanus*), etj. Kati i kullotave alpine shtrihet në lartësitë 1900-2300 m mbi nivelin e detit. Ky kat përbëhet nga bimë barishtore dhe pak shkurreza siç janë : dëllinjat (*Juniperus*), shëlgjet (*salix*), etj. Ndër bimët më të rëndësishme të këtij kati janë: flokëzi (*Poa alpina*), pirrgjaksja (*Sesleria nitida*), bishtpelza (*Festuk sulkata*), asteri (*Aster alpinus*), tërfili i alpeve (*Trifolium alpestre*), thuepule (*Lotus cornicultus*) etj. Për shkak të largësisë nga zonat e mëdha të banuara, gjendja e pyllit të ahut është përgjithësisht e mirë. Por ka pasur dhe raste të dëmtimit nga zjarri, prerja, etj.

Në vende të sheshta me një farë shtrese toke e me lagështi mesatare me PH acid takohet xhufka, vlera ushqyese e së cilës është e dobët dhe kafshët nuk e hanë. Mbulesa bimore e kësaj pjese është e hapur, e ulët dhe relativisht e rrallë, prandaj dhe vlera ekonomike e këtyre kullotave është e pakët. Karakteristike për thepat e Thethit në lartësi mbi 2300 m, mbi nivelin e detit, është dhe prania e kërlekës ose centinaku (*Pinus mughus*), një lloj pise në formë shkurreje me gjatësi deri në 3 m.

Fauna e parkut është e pasur dhe e larmishme. Ka rreth 20 lloje gjitarësh, 50 lloje shpendësh folenizues, afro 10 lloje zvarranikësh dhe rreth 8 lloje amfibësh. Rëndësi paraqesin gjitarët dhe

shpendët e lidhur me pyjet e larta dhe ekosistemet malore e alpine. Ndër gjitarët më të mëdhej të parkut janë: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), dhia e egër (*Rubicapra rubicapra*), dhe kaprolli (*Capreolus capreolus*), etj. Në pyllin e lartë nga shpendët mbizotërojnë kryesisht pjestarët e familjes së Fragillidae (4 lloje), dhe Paridae (4 lloje). Përbërës të tjerë më të rrallë janë elementë tipik të pyllit të lartë si: kukapikët (3 lloje), zvarritësi i drurëve (*Sitta europea*), etj. Në katin e shkurreve hasim lloje të tjera si: gushkuqi (*Erithacus rubecula*), mëllënja (*Turdus merula*), larashi kurrikzkuq (*Lanus collurio*), etj. Gjendja e përgjithshme e habitateve është relativisht e mirë.

Rekomandime dhe Masa për mjedisin:

- Bazuar në PPK parku Kombëtar i Thethit parashikohet të zgjerohet dhe të formojë Parkun Kombëtar të Alpeve
- Mbështetja me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësitë administrative Postribë, Pult, Shosh dhe Shalë. Gjithashtu, ngritja e kapaciteteve vendore për hapjen e bujtinave. Krijimi i guidave dhe manualeve për bujtinat.
- Mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të biodiversitetit, shtimit të sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura dhe zonave pyjore
- Do të mbrohen burimet ujore nga ndotjet.
- *Kompostimi në bazë ferme/familje/bujtine* do të aplikohet kryesisht në njësitë administrative Postribë, Pult, Shosh dhe Shalë. Fermerët/familjet/bujtinat do të ofrohen "kutiza" kompostimi të madhësisë 1m³ të cilat do të shërbejnë për depozitimin e mbetjeve organike. Lënda e përfutur më pas mund të përdoret për qëllime bujqësore.
- Pyjet dhe kullotat përbëjnë një aset të rëndësishëm ekonomik për zonat rurale dhe gjenerimin e të ardhurave në Shkodër. Në këtë kontekst do të hartohen planet e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që ato të mbrohen dhe njëkohësisht të shfrytëzohen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetet lokale.
- Do të respektohen zonimi përkatës i Parkut Kombëtar në të cilin përcaktohen edhe zonat për zhvillim
- Turizmi duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë dëme në mjedis dhe në habitatet përkatës
- Do të krijohen habitate specifike për mbrojtjen e specieve në zhdukje të florës dhe të faunës
- Do të hartohen planet e menaxhimit të pyjeve dhe kujdes i veçantë do të tregohet për monitorimin e tyre dhe mbrojtjen nga prerja pa kriter.
- Zhvillimi urban dhe infrastrukturor do të ndodhë brenda kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni sektorial në fuqi për të shmangur ndikime negative në mjedis.

Peizazh i Mbrojtur "Lumi Buna-Velipojë"

Lumi Buna dhe territoret ligatinore përreth tij, delta e Bunës, kënetat e Domnit si dhe Laguna e Vilunit. Janë shpallur - Peizazh ujor, tokësor i mbrojtur. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura". Ky peizazh ujor/tokësor i mbrojtur kufizohet nga Veriu: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri në kufirin verior me Republikën Serbi-Mali i Zi (koordinatat 420 03'08" 190 29'30", 420 01'31" 190 29', 420 00'36" 190 25'7", 420 00' 190 23'45"); nga perëndimi Me vijën e kufirit shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën e Malit të Zi; nga Lindja me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rëra e Hedhur dhe që kalon nga zona malore (koordinatat: 410 50'30" 190 35'30", 420 53'15" 190 30', 410 59'30" 190 31'30", 420 00' 190 31'33" , 420 02'15" 190 30', 420 03'08" 190 29'); nga Jugu: me vijën bregdetare nga Rëra e Hedhur deri te grykëderdhja e lumit Buna (koordinatat: 410 50'57" 190 23', 410 51'28" 190 27'30", 410 50'58" 190 30'.

Peizazhi ujqor/tokësor i mbrojtur i lumit Buna ka një sipërfaqe të përgjithshme 23 027 ha, të përbërë nga:

- sipërfaqe pyjore dhe shkurre - 7 799 ha;
- sipërfaqe lagunore - 346 ha; c) duna ranore, bregdetare, - 496 ha;
- toka të kripura - 252 ha;
- Sipërfaqe të tjera (toka bujqësore, zona të banuara) - 14 134 ha.

Peizazhi ujqor/tokësor i lumit Buna ka zonimin e mëposhtëm

- Zona qendrore :
 - pjesa e lumit Buna dhe brigjet e tij nga bashkimi me lumin Drin deri në fshatin Obot;
 - brigjet e lumit Buna në pjesën perëndimore të rezervatit të Velipojës, nga grykëderdhja e lumit deri përballë skajit verior të ishullit Ada dhe 200 m në brendësi të rezervatit në Lindje;
 - ishulli i Franc Jozefit dhe bregdeti në Lindje të grykëderdhjes, në gjatësi deri 2 km dhe gjerësi 300 m në det, drejt Jugut;
 - pjesa qendrore dhe veriore e lagunës së Vilunit;
 - gadishulli në plazhin e Baks-Rrjollit dhe një gjerësi 300 m në Jug të vijës bregdetare deri te Rëra e Hedhur;
 - pjesa qendrore e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

- Zonë e përbërë nga:
 - pjesa e lumit Buna në një gjatësi brigjesh 3 km në anën e djathtë të lumit, në Veri të fshatit Oblikë;
 - pjesa e lumit nga fshati Obot deri në pikën përballë skajit verior të ishullit Ada me një gjerësi 200 m drejt Lindjes;
 - gjithë sipërfaqja e rezervatit të Velipojës,
 - pjesa jugore e lagunës së Vilunit dhe gjithë sipërfaqja kënetore, që rrethon brigjet e lagunës;
 - zona e Baks-Rrjollit deri në lartësinë 335 m në shpatin e malit Kolaj, në Veri;
 - pjesa e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës që e rrethon atë.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

Zonë e përbërë nga:

- pjesa e lumit Buna, me gjatësi brigjesh 2 km, midis fshatrave Shirq dhe Obot, në anën e djathtë të lumit;
- në gjatësi brigjesh 2 km të lumit Buna, në Veri të fshatit Dajç, në anën e majtë të lumit.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

Zonë e zhvillimit tradicional Zonë e zhvillimit tradicional dhe e përbërë nga:

- fushat e Velipojës, me sipërfaqe 2 500 ha;

- fushat e Pentarit, me sipërfaqe 850 ha;
- pellgjet (ish-vaskat e peshkut) e fshatit Reç, me sipërfaqe 114 ha;
- kullotat e Urës së Gjo Lulit dhe Domnit, me sipërfaqe 2200 ha.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, ku mund të ushtrohen veprimtari me karakter rikrijues, edukativ, ekoturistik, si dhe përdorimi tradicional i tokës, në harmoni të plotë me ruajtjen e natyrës dhe të vlerave shoqërore e kulturore të komunitetit vendas.

Zonë e zhvillimit tradicional e përbërë nga: territori që fillon nga fshati Pentar, në kufirin me Malin e Zi, vazhdon përmes kënetave të lumit Buna e kodrave të Rrencit dhe zbret në bregdet te Rëra e Hedhur, e cilësuar si korridor migrimi. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, por për karakteristikat që ofron, kërkohen plane të veçanta menaxhimi.

Zonë e tranzicionit e përbërë nga: plazhi i Velipojës, i kufizuar në Perëndim nga rezervati i Velipojës, në Veri nga rruga automobilistike dhe me shtrirje, në Lindje, deri në 500 m përpara kanalit të komunikimit të lagunës së Vilunit me detin. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”. Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari bujqësore, si dhe mund të përdoret toka për qëllime të ndryshme turistike, sportive, edukative, rikrijuese etj., që nuk çenojnë natyrën dhe biodiversitetin, mbështetur në zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore të zonës.

Ishulli i Franc_ Jozefit është rezervat strikt natyror së bashku me zonën e rezervatit të Velipojës. Ky rezervat është shpallur i tillë dhe është një brez natyror me shumë vlera por që fatkeqësisht është në zhdukje.

Zonat e lagëta si Delta e Bunës dhe grykëderdhja e saj si dhe pjesa veriore dhe verilindore e Lagunës e Vilunit janë shpallur në 2005 Zonë Ramsar. Rezervati natyror i menaxhuar i Velipojës. Për vlerat e tij, ky rezervat është një pasuri e rallë. Nuk ka pasur shumë dëmtime në të, pasi ai ka qenë me kohë rezervat, megjithatë duhet të punohet për tu frekuentuar më shumë nga turistët vendas dhe të huaj që mund të jenë edhe një burim i konsiderueshëm të ardhurash për komunën. Rezervati kufizohet nga veriu me toka bujqësore. Nga jugu me detin Adriatik, nga lindja me një rrugë që të çon në plazhin e Velipojës dhe nga perëndimi me Lumin Buna.

Përgjatë brigjeve të lumit Buna ka një biodiversitet me vlera të larta natyrore. Bimësia pyjore dikur ka qenë shumë më e pasur sesa sot. Një prej faktorëve kryesorë degradues ka qenë prerja e paligjshme e drurëve deri në kufijtë e një shpyllëzimi të plotë. Rreziqet që kanosen sot prej erozionit kanë detyruar banorët që të mbjellin përsëri drurë pyjorë ose të kujdesen për lastarët e rinj të dalë nga trungjet e prera. Sot mund të llogaritet një sipërfaqe pyjore prej rreth 20 ha me moshë relativisht të re, e cila gjendet përgjatë brigjeve. Kjo bimësi përbëhet kryesisht nga shelgje, plepa, akacie e më pak marine, konopice, etj. Bimësi pyjore në kuptimin e mirëfilltë, gjejmë në brigjet e lumit në Rezervatin e Velipojës, Ishullin Ada dhe Franc Jozef, në fshatrat Reç, Sutjel, Shënkoll dhe në ishullin e Bahçallekut.

Bimësia e këtyre sipërfaqeve pyjore përbëhet kryesisht nga disa lloje plepash (*Populus*), shelgjesh (*Salix*), frashëri (*Fraxinus*), dushqesh (*Quercus*) e gjithashtu nga rrushkulli (*Ruscus aculeatus*), akacia (*Robinia pseudoacacia*), thana (*Cornus mas*), shkoza (*Carpinus betulus*), marina (*Tamarix parviflora*), etj. Në lumin Buna gjenden mbi 30 lloje peshqish të ujërave të ëmbël që jetojnë gjithashtu në Liqenin e Shkodrës. Ndër to përmendim krapin (*Cyprinus carpio*), karasin (*Carassius auratus gibelio*), gjucën (*Alburnus alburnus alborella*), njilën (*Chondrostoma nasus ohridanus*), skortën e zezë

(*Pachychilon pictum*), lloshkën (*Scardinius erythrophthalmus scardafa*), mëlyshin (*Leuciscus cephalus albus*), sharmakun (*Perca fluviatilis*), barburiaqin (*Blenius fluviatilis*), etj.

Buna është rrugë kalimi për 13 lloje e nënloje peshqish që migrojnë nga liqeni për në det dhe anasjelltas. Ndër to përmendim blinin (*Acipenser sturio*) që është lloj globalisht i rrezikuar, kublën (*Alosa fallax nilotica*), ngjalën (*Anguilla anguilla*), levrekun (*Dicentrarchus labrax*), qefullin e verës (*Mugil cephalus*), qefullin e vjeshtës (*Liza ramada*), shojzën (*Platichthys flesus luscus*), etj. Në estuarin e grykëderdhjes së Bunës ka mbi 50 lloje të tjerë peshqish, ku ndër më të njohurit janë açuga (*Engraulis encrasicolus*), çeliku (*Aphanius fasciatus*), gjilpërëza turigjatë (*Syngnathus tenuirostris*), korbi i zi (*Sciaena umbra*), korbi i bardhë (*Umbrina cirrosa*), sargu (*Diplodus sargus sargus*), murra (*Lithognathus mormyrus*), aterina (*Atherina hepsetus*), gjuhëza e Adriatikut (*Solea vulgaris*), etj.

Buna, së bashku me ujërat pranë saj, përfaqëson një nga sipërfaqet më të pasura me shpend në rajon. Grykëderdhja e Bunës, Rezervati i Velipojës, Këneta e Domnit, Laguna e Vilunit, Liqeni i Shasit, kriporja e Ulqinit, sipërfaqja kënetore e Shtojt të Poshtëm të Ulqinit janë plot me shpendë, veçanërisht në dimër. Avifaunat e këtyre sipërfaqeve komunikojnë me njëra tjetrën, por edhe me Liqenin e Shkodrës, Lagunën e Kunes e më gjërë. Këto sipërfaqe përfshihen në një rreth prej tre rrugëve të migrimit të shpendëve të Evropës. Këto fakte tregojnë për rolin e rëndësishëm të Bunës në shkallë rajonale. Aq më tepër ky rol vlerësohet me faktin se një përqindje e konsiderueshme e llojeve janë migrues dhe folezues në këtë zonë.

Në Bunë janë numëruar rreth 50 lloje shpendësh ujore. Ndër to, me numër më të madh individësh rezultojnë kredharaku i vogël (*Tachybaptus ruficollis*), karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmeus*), kryekuqja e madhe (*Anas penelope*), rosa e vendit (*Anas platyrhynchos*), rosa sqeplugë (*Anas clypeata*), rosa kërre (*Anas crecca*), kryekuqja e mjeme (*Aythya ferina*), rosa me katër sy (*Bucephala clangula*), bajza (*Fulica atra*), cinja (*Vanellus vanellus*), pulëbardha e zakonshme (*Larus ridibundus*), etj. Rëndësi të veçantë ka pulëbardha e vogël (*Larus minutus*) dhe dallëndyshja e detit (*Sterna sandvicensis*), numri i të cilave konsiderohet i rëndësishëm ndaj numrit të përgjithshëm për Shqipërinë dhe Mesdheun. Veçohet gjithashtu kriporja e Ulqinit e cila aktualisht është një nga mjediset më të përshtatshëm për folezimin e shumë llojeve si laraska e detit (*Haematopus ostralegus*), gjelaci symadh (*Burhinus oedicephalus*), kalorësi (*Himantopus himantopus*), sqepbiza (*Recurvirostra avosetta*), bisht-dallëndyshja (*Glareola pratincola*), vrapuesi gushëbardhë (*Charadrius alexandrinus*), dallëndyshja e vogël e detit (*Sterna hirundo*), etj.

Rekomandime për mbrojtjen e mjedisit:

- Lumi Buna bazuar në PPK është përcaktuar si Park Kombëtar, pra është rritur niveli i mbrojtjes. Si rrjedhojë përdorimet përgjatë fashës së lumit janë përcaktuar të tilla që të mos shkaktojnë dëme në mjedis
- Do të respektohen masat mbrojtëse përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për të ruajtur burimet ujore
- Duhet të aplikohen masa specifike për mbrojtjen e shpendëve migratorë të rikthyer në kënetat e zonës. Gjithashtu, në funksion të mbrojtjes së shpendëve propozohet edhe ofrimi i infrastrukturave të lehta për vëzhgimin e shpendëve
- Projektet infrastrukturore dhe urbane të cilat mund të zhvillohen në zonë duhet të marrin masa zbutëse për mosdëmtimin e habitateve mjedisore
- Do të respektohen distancat mbrojtëse prej 200m sipas legjislacionit sektorial në fuqi
- Nuk lejohen përdorime, aktivitete dhe funksione të cilat kanë ndikime negative në mjedis dhe habitate

Monument Natyre dhe Zonë Ramsar “Liqeni i Shkodrës”

Liqeni i Shkodrës bën pjesë në kompleksin ujqor “Liqeni i Shkodrës-Drini-Buna” dhe përfaqëson një nga sistemet hidrografike më të komplikuar dhe më interesante në Ballkan. Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Gadishullin Ballkanik, për sa i përket sipërfaqes ujore. Liqeni i Shkodrës përfshihet në pellgun ujëmbledhës të detit Adriatik. Pasqyra ujore e tij ka një sipërfaqe prej 368 km², nga të cilat 149 km² përfshihen brenda territorit shtetëror të Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër ndodhet në Malin e Zi. Ai shtrihet në kufirin midis vendit tonë dhe Malit të Zi, në pjesën jugore të Alpeve Dinarike, ndërmjet 42°21'54" dhe 19°09'52" në veri, 42°03'15" dhe 19°30'00" në jug (hyrja e Bunës), 42°03'15" dhe 19°30'00" në lindje (ana e qytetit të Shkodrës), 42°21'19" dhe 19°01'28" (pranë Rijeka Crnojevicës) në perëndim. Baseni i liqenit shtrihet në një sipërfaqe prej 5500 km² (4470 km² në Malin e Zi dhe 1030 km² në Shqipëri). Zonat kryesore të pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës janë: fushat e Nikshiqit dhe Cetinjës, ultësira e Zetës, Shkodër, Lumi Moraça, Përroi i Thatë, si dhe sipërfaqe të tjera më të vogla, si: lugina e Crnojevicës dhe lugina e Rrjollit. Pellgu ujëmbledhës ka sipërfaqe prej 5500 km² dhe lartësia mesatare e bazenit mbi nivelin e detit është rreth 770m, që tregon se liqeni në fjalë mbledh ujërat e një zone malore. Liqeni i Shkodrës lidhet me Detin Adriatik nëpërmjet emisarit të vetëm të tij, Lumit Buna. Sipërfaqja e liqenit luhatet nga 368 km² në periudhë të thatë në 500 km² në periudhë të lagësht.

Liqeni i Shkodrës është më i madhi në gadishullin e Ballkanit për sa i përket sipërfaqes ujore. Pjesa Malazeze e liqenit dhe zona përreth saj janë shpallur si park kombëtar në vitin 1983. Ky park është një nga rezervatet më të mëdha të zogjve në Europë, duke pasur 270 specie të zogjve ndërmjet të cilëve janë disa nga pelikanët e fundit në Europë. Në 1996, është përfshirë në listën Ramsar të ligatinave me rëndësi ndërkombëtare nga Konventa Ramsar për ligatinat. Qeveria Shqiptare e ka shpallur pjesën shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervë Natyrore e Menaxhuar”, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave, No. 684 datë 02.11.2005. Kompleksi ujqor i pjesës Shqiptare të liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna është aprovuar gjithashtu si zonë Ramsar në 2005 (duke u përfshirë në listën ndërkombëtare të ligatinave të rëndësishme, veçanërisht si habitat i shpendëve ujqorë). Mbrojtja dhe zhvillimi i liqenit të Shkodrës ka qenë fokus i një dialogu të vazhdueshëm dhe afatgjatë midis dy shteteve kufitare që e ndajnë atë. Për vlerat e mëdha kulturore, natyrore, biologjike, dhe peisazhin, pjesa malazeze e liqenit të Shkodrës është shpallur Park Kombëtar që në 1983 (Kategoria II sipas IUCN). Në vitin 1995 Parku Kombëtar i liqenit të Shkodrës u regjistrua në listën Ramsar (si zonë e lagët me rëndësi ndërkombëtare). Pjesa shqiptare e liqenit nuk kishte status të mbrojtur, deri në vitin 2005, kur u shpall nga qeveria shqiptare Rezervat Natyror i Menaxhuar (kategoria IV sipas IUCN), sipas vendimit No. 684, datë 02. 11. 2005. Në shkurt 2006, zona u shpall zonë Ramsar.

Lumenjtë kryesorë që derdhen në liqen: nga veriu janë Moraça, Crnojevica, Orahovshtica, Karatuna, Baragurska nga Mali i Zi dhe Përroi i Thatë, Rjollit dhe Përroi i Vrakës në Shqipëri. Në liqen përfundojnë edhe shumë përrenj të vegjël, sidomos në pjesën perëndimore të tij. Reshjet dhe ujërat nëntokësorë kontribuojnë gjithashtu në prurjet në liqen. Dy lloj burimesh kryesore nëntokësore mund të dallohen në pellg: akuiferet në rrafshinën e Zetas dhe burimet karstike, kryesisht në pjesën jug-perëndimore të liqenit. Një pjesë e ujit të liqenit, rreth 34% e zenë ujërat nëntokësore që përbëhen nga një numër burimesh karstike përreth bregut të liqenit. Rreth 9% e ujërave të Liqenit të Shkodrës vjen prej burimeve karstike ose „syreve”. Në pjesën shqiptare deri tani njihen mbi 20 syre, të cilat gjenden në anën lindore dhe juglindore të Liqenit. Disa nga syret më të mëdhenj për pjesën shqiptare të Liqenit janë: Syret e Hotit, Syri i Zi, Syri i Sheganit, Syri i Virit, Syri i Gjonit, Syri i Sumajve, Syri i Vrakës etj. Ujërat e syreve mund të klasifikohen me shkallë të lartë pastërtie dhe si ujëra tipike

karstike. Emisari i vetëm i Liqenit të Shkodrës është Lumi Buna, rrjedhja e të cilit drejt detit, në rastet e reshjeve të mëdha, pengohet nga prurjet e Lumit Drin, i cili derdhet në Bunë, jo më larg se 1 km larg nga liqeni. Lumi Buna është një hallkë ndërmjetëse midis dy hallkave shumë të rëndësishme, Liqenit dhe Detit.

Liqeni i Shkodrës dhe pellgu i tij ujëmbledhës përfaqëson një kompleksitet habitatesh, të përshtatshme për praninë e një larmie organizmash të gjallë. Ky diversitet i lartë biologjik i dedikohet veprimit të faktorëve favorizues kryesisht të karakterit ekologo-gjeografik. Këtu përfshihen disa tipe, nëntipe dhe shumë njësi klasifikimi më të vogla, si: lakustrine, palustrine, riverine, limnetike, litorale, emergjente, submergjente, notuese, pyll, shkurre, kaçube, bar etj. Për liqenin e Shkodrës njihen 850 specie bimore dhe 600 specie shtazore. Në pellgun e liqenit të Shkodrës njihen 1900 specie bimore dhe 3500-4000 specie shtazore. Ky diversitet habitatesh u jep strehë një numri të madh bimësh dhe kafshësh. Tabela më poshtë tregon numrin e specieve për grupet kryesore të habitateve të liqenit të Shkodrës.


Mikroorganizmat janë pjesëtarët më të rëndësishëm të ekosistemeve ujore, që luajnë rol të rëndësishëm në proceset e oksido-reduktimit. Studimet mikrobiologjike dhe limnologjike të liqenit të Shkodrës të realizuara më parë kanë vlerësuar sasinë e bakterieve saprofitike. Proceset biokimike transformuese realizohen më mirë se në hallkat e tjera të zinxhirit ushqimor, prej aktivitetit enzimatik të mikrobeve. Komuniteti bakterial në sipërfaqe të sedimenteve është shumë herë më i lartë se ai në shtresat e sipërme të ujit. Algat mikroskopike mund të përdoren për vlerësimin e gjendjes ushqyese dhe cilësisë së ujërave. Gjithashtu, cianobakteriet mund të prodhojnë substanca të rrezikshme për zooplanktonin, molusqet, peshqit dhe organizmat e tjerë ujorë, si alkaloidet neurotoksike (Anabaena, Aphanizomenon etj.) ose peptidet hepatotoksike (Microcystis, Nodularia etj). Zhvillimi i cianobakterieve fillon me periudhën e ngrohtë, kushte limnologjike të qëndrueshme dhe me rritjen e sasisë së lëndëve organike në verë. Pranë fshatrave të banuara (Zogaj, Kamicë) janë gjetur këto specie cianobakteriesh siç janë: *M. aeruginosa*, *M. ëesenbergii*, *Plantolyngbbya limnetica*, *P. circumcreta*, *Nostoc coeruleum*, *Anabaena flos-aquae*, *Oscillatoria limosa* etj.

Në tërësi, Liqeni i Shkodrës dominohet nga specie oligo-mezotrofe dhe mezotrofe, si *Asterionella formosa*, *Cyclotella ocellata*, *Fragillaria capucina*, etj., por që shpesh shoqërohen edhe me specie me valencë eutrofe, si *Fragillaria construens*, *F. ulna*, *Gymphonema acuminata*, *Navicula capitatoradiata*, *N. cryptotenella*, *Nitzschia recta* etj. Prania e këtyre specieve eutrofe dhe veçanërisht abundanca e tyre e lartë gjatë verës në pjesën jugore të bregut përendimor (Shirokë) dhe fillimin e lumit Buna (Ura), dëshmojnë për një rritje të ushqyesve mbi vlerat normale. Kjo është pasojë e ndikimit të njeriut, si ndotja prej qytetit të Shkodrës dhe zonave të tjera të banuara përreth (Shirokë, Zogaj) dhe aktiviteteve të tjera të kryera përgjatë bazenit të tij. Kjo shtron si domosdoshmëri monitorimin e mëtejshëm të ujërave të liqenit me qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore të tij.

Bakteriet amonifikuese të identifikuar, të cilat janë specie mbizotëruese në liqen janë: *Pseudomonas fluorescens* dhe *Spirillum volants*. Kushtet për bakteriet amonifikuese janë të qëndrueshme kudo në liqen, prej sipërfaqes deri në fund. Numri i bakterieve amonifikuese, aerobe dhe anaerobe fakultative në ujërat e hapura luhetet në një diapazon të gjërë, që shkon nga 16-1500 CFU/100 ml, por në raste të veçanta edhe më shumë, deri në 2800 CFU/100 ml. Bakteriet azotofiksuese aerobe janë: *Azotobacter agilis* dhe *Azotobacter chroococum*. Bakteriet sulfurore janë: *Beggiatoa alba*, *Beggiatoa leptomitiformis*. Bakteriet e hekurit janë: *Siderocapsa major* është gjetur në ujërat sipërfaqësore.

Rekomandime për mbrojtjen e mjedisit:

- Do të respektohen masat mbrojtëse përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për të ruajtur burimet ujore
- Duhet të aplikohen masa specifike për mbrojtjen e shpendëve migratorë të rikthyer në zonës. Gjithashtu, në funksion të mbrojtjes së shpendëve propozohet edhe ofrimi i infrastrukturave të lehta për vëzhgimin e shpendëve
- Projektet infrastrukturore dhe urbane të cilat mund të zhvillohen në zonë duhet të marrin masa zbutëse për mosdëmtimin e habitateve mjedisore
- Do të respektohen distancat mbrojtëse prej 200m sipas legjislacionit sektorial në fuqi
- Nuk lejohen përdorime, aktivitete dhe funksione të cilat kanë ndikime negative në mjedis dhe habitate
- Aktivitetet rekreative të cilat propozohen në buzë të liqenit në krahun e Shirokës dhe në atë të qytetit kanë karakter të përkohshëm me struktura të lehta të cilat nuk ndikojnë negativisht në sistem
- Propozohet rishikimi i projektit të By-Pass Perëndimor dhe marrja e masave zbutëse të ndikimeve negative që ky projekt ka pasur deri më tani në liqen dhe më pas rekomandohet që kjo zonë të kthehet në një hapësirë rekreative për qytetin e Shkodrës
- Këmbët e urës së Bunës duhet të shoqërohen me një projekt teknik për zbutjen e ndikimit të tyre në shkarkimin e ujërave të Bunës dhe rrjedhimisht në përmbytje.
- Propozohet ndalimi i derdhjes së ujërave të zeza të patrajtuara në liqenin e Shkodrës
- Propozohet rritja e marrëdhënieve ndërkufitare dhe marrja e masave të përbashkëta me Malin e Zi për mbrojtjen e liqenit



3.6.2 Masat për menaxhimin e mbetjeve

Këto masa synojnë përmirësimin e një shërbimi sa të komplikuar po aq edhe të veçante në llojin e tij. Të menaxhosh mbetjet urbane në ditët e sotëm do të thotë të sfidosh një seri të lartë faktorësh ndotes - nga ato më organikët natyrore ne organiket me rrezikshmeri të lartë për jetën e banoreve, si ilaçet spitalore (Vendim i KM, nr. 789, date 29.09.2010), e për të vazhduar me mbetjet e ngurta që vijnë nga si pasojë e rritjes së popullsisë dhe konsumit familjarë sëbashku me to.

Në bazë të shpërndarjes së popullsisë, dhe të pergjendrimin të tyre në vendbanime, do të zgjerohet dhe përforcëhet edhe shërbimi i mbledhjes së tyre në të gjitha njësitë administrative.

Në disa raste, veçanërisht për zonat të cilat kanë vështirësi në akses do të përcaktohen disa pika (stacione) transferimi të mbetjeve. **Më pas mbetjet do të depozitohen në landfillin e Bushatit bazuar edhe në Strategjinë e PPK e cila synon rritjen e mbetjeve të depozituara në Landfill.**

Bashkia Shkodër, duhet të reduktojë mbetjet në burim të cilat në mënyrë që të reduktohet edhe sasia e mbetjeve të cilat shkojnë në landfill. Për të arritur këtë do të:

- *Riciklimi*

Do të vendosen koshat e ndarë sipas llojit të mbetjeve të ngurta veçanërisht në qytetin e Shkodrës dhe në Velipojë si dy zonat urbane më të mëdha dhe me fluksin më të madh të mbetjeve. Koshat do të jenë të ndarë në plastikë, qelq, letër dhe të përgjithshme. Më pas do të më anë të bashkëpunimit dhe formimit të PPP do të garantohet riciklimi i tyre.

Në këtë fazë është e rëndësishme të specifikohet edhe rëndësia e mbajtjes së koshave miks në vazhdimësi si pjesë e pandashme dhe e integruar në kulturën e gjenerimit të mbetjeve dhe grumbullimit të tij nga konsumatorët familjare apo të ndryshëm - në mënyrë që të mos krijohet konfuzion në përcaktimin e produktit në baze të makrokategorive si qelq, plastike e letër por të jepet mundësia e ndryshimit të kësaj kulture gradualisht dhe në vazhdimësi të fushatave informuese të cilat do të ndërmerren nga Bashkia Shkodër.

Gjithashtu, institucionet shtetërore dhe organizatat do të sensibilizohen për të ricikluar dhe reduktuar mbetjet. Në këtë kontekst synohet që deri në 2030 të kemi 100% riciklim të letrës, 100% përdorim të letrës së ricikluar, reduktim me 50% të përdorimit të letrës duke përdorur shërbime dixhitale.

Bashkia gjithashtu do të zhvillojë fushata të ndryshme sensibilizuese me bizneset në mënyrë që edhe ato të reduktojnë sasinë e mbetjeve dhe të riciklojnë. Bizneset të cilat riciklojnë më shumë do të promovohen dhe incentivohen.

- *Kompostimi*

Në kuadër të synimit për të reduktuar sasinë e mbetjeve do të përdoren dy politika për kompostimin:

- a. *Kompostimi në bazë ferme/familje/bujtine*

Kjo politikë do të aplikohet kryesisht në njësitë administrative Postribë, Pult, Shosh dhe Shalë. Fermerët/familjet/bujtinat do të ofrohen "kutiza" kompostimi të madhësisë 1m³ të cilat do të shërbejnë për depozitimin e mbetjeve organike. Lënda e përfutur më pas mund të përdoret për qëllime bujqësore.

- b. *Kompostimi në bazë njësie administrative*

Njësitë administrative të Rrethinave, Postribës, Gurit të Zi, Ana e Malit, Bërdicës, Dajçit dhe Velipojës janë ndër prodhuesit kryesorë të mbetjeve organike duke qënë se kanë dhe sipërfaqen më të madhe të tokave bujqësore. Si rrjedhojë do të krijohen qendra të posaçme kompostimi. Materialet e përfutuara prej tyre më pas do të përdoren si bazë për prodhimin bujqësor.

3.6.3 Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmerren dhe me çfarë qëllimi, ndahen në:

- Masa preventive
- Masa përgatitore

- Masa direkte

Masat preventive:

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë.

Masa ligjore, mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve (bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato.

Masat edukative, këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, mgjs më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shkollorë, leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, internetit TV etj.

Masa informative- propagandistike, qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

Masa përgatitore:

Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, është e domosdoshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përherëshme gjatë gjithë vitit dhe përfshihen:

- Zbulimi në kohë i zjarrit
- Transferimi i Informacionit mbi zjarrin
- Organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve
- Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit
- Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret

Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejt të tij. Zonat tona malore kanë një dukshmëri të dobët, me qëllim që zjarri të mund të zbulohet në kohë organizohet shërbimi i monitorimit në terren nga vëzhguesit kundra- zjarr / vrojtuesve kryesisht me patrullim nga toka në periudhën më të rrezikuar të vitit (Sipas VKM nr 1080/2010 për 5 muaj). E rëndësishme për këtë fazë është që nëpërmjet institucioneve qëndrore (ministri/ agjensi etj) dhe jo vetëm të kryhet monitorimi nga ajri, mbikqyrje automatike apo elektronike si edhe vëzhgimi satelitor. Masa keto të cilat do të mundësojnë zbulimin dhe monitorimin e këtyre zjarreve.

Transferimi i informacionit mbi zjarrin i kryer në mënyrë të shpejtë dhe ka efektin e dëshiruar. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalet e tjera si flamuj etj. Qytetarët të cilët zbulojnë zjarre në pyje/kullota duhet të njoftojnë në nr e tel 128 Shërbimin Zjarrfikës. Një organizim më i mirë në mënyrën e transferimit të informacionit do të jetë nëpërmjet radiove-lidhese apo ndërtimit të rrjetit të marrje-dhënie nëpërmjet pajisjeve vëzhguese në të gjithë territorin e mbuluar me pyje.

Organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve deri tek vatra e zjarrit është shumë e rëndësishme për këtë arsye duhet njoftuar menjëherë me zbulimin e zjarrit. Transporti i organizuar i zjarrfiksave dhe pajisjeve mënyra e organizimit të tyre dhe vullnetarëve krijon premisa për menaxhim të mira të situatës së zjarrit.

Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit shërben si si një pozicion mbrojtës për zjarrfikësit por edhe vullnetarët. për këtë arsye hendeqet ekzistuese në pyje duhet të jenë gjatë gjithë kohës të pastruar nga materiali djegës. Hapja e hendeqeve dhe dimensionimi i tyre (gjerësia) është e ndryshme në vartësi nga lartësia e pemëve, pjerësia e terrenit etj. Psh nëse pemët janë rreth 20m, gjerësia e hendekut do të jetë minimuni 40cm.

Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Bazuar në ligjin nr 9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, ligjin nr 9693/2007 “Për fondin kullësor në RSH” si edhe VKM nr 1080/2012, hartohet plani operativ për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

Masa direkte

Pavarësisht nga masat më të mira preventivetë marra, zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye nevojiten masat direkte. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar apo shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementet nga i ashtuquajtimi trekëndësh i Osborn-it, përkatësisht materiali djegës, burimi i nxehtësisë apo oksigjeni.

Sipas asaj se cili material ose mjet përdoret për këtë qëllim, metodat e shuarjes ndahen në:

- Shuarje e zjarrit me tokë, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim, ku materiali i tokës përdoret si izolator, pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolant i nxehtësisë, përkatësisht energjia termike për djegien e drurit.
- Shuarje e zjarrit me ujë, edhe kjo një ndër metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë.
- Luftimi i zjarrit me zjarr, megjithëse duket si konfuze, kjo metodë është efektive por mbart në vetvete rrezik dhe kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë. Në vartësi të taktikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një “zjarr i kontrolluar” (që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose të njëjtë me drejtimin e lëvizjes së zjarrit) i cili djeg materialin para frontit të zjarrit, kur zjarri arin në atë sipërfaqe, nuk ka çfarë të djegë dhe zjarri shuhet.
- Shuarje e zjarrit nga ajri nëpërmjet aeroplanëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930. Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh, por për shkak të specifikës është e vcur si metodë e vecante. Është metodë mjaft e shpejtë dhe efikase sidomos për rastet e tërreneve malore.
- Shuarja e zjarrit me kimikate, në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi këto kimikate shpërbëhen nëpërmjet ujit. Llogaritet se 70% e ujit që përdoret në shuarjen e zjarreve harxhohet pa efektivitet, për këtë arsye ujit i shtohen kimikate të ndryshme të cilat përmirësojnë efekun e shuarjes së zjarrit
- Shuarje e zjarrit me eksploziv, përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të rrezuar pemë, gjermim kanalesh, krijim pengesash etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet “re e pluhurit” e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht zjarri ul intensitetinose shuhet plotësisht.

3.7 Plani i masave për infrastrukturën

3.7.1 Uji i Pishëm

Përsa i përket ujit të pishëm Shkodra ka një mbulim të mirë në rrjet. Është e nevojshme zgjerimi i tubanioneve në zonat të cilat propozohet rritja e intensitetit. Gjithashtu, në zonën e puseve të Dobraçit do të zhvendosen banesat të cilat kanë kaluar vijën mbrojtëse të puseve. Një tjetër ndërhyrje e rëndësishme është edhe krijimi i një stacioni të dytë për pompimin e ujit në krahun e Vau Dejës.

Efiçienca e Ujit

Masat për rritjen e efiçencës së ujit përfshijnë:

- Kufizuesit e rrjedhës
- Rubinetë me sensorë
- ËC me shkarkim të dyfishtë
- Makina larëse me përdorim të vogël uji

- Përdorimi i Ujërave të shiut në tualete, lavazho apo përdorime të tjera përtej pirjes

3.7.2 Kanalizimet e Ujërave të Zeza

Përsa i përket sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në qytetin e Shkodrës do të zgjerohet rrjeti ekzistues për tu përgjigjur me kërkesat e qytetarëve dhe parashikimet për zhvillim të planit. Kryesisht sistemi do të zgjerohet në zonat informale të cilat ende nuk janë të shërbyera me sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Ndërkohë do të ngrihet dhe qendra e trajtimit të ujërave të zeza për Shkodrën duke ndaluar derdhjen e ujërave të ndotura në liqen. Kjo është një ndërhyrje parësore për sistemimin e sistemit dhe mbrojtjen e liqenit.

Në zonën Shirokë-Zogaj, është ndërtuar sistemi i trajtimit të ujërave të ndotura. Ky sistem është ngritur me teknologji moderne përpara pak viteve dhe si rrjedhojë është funksional. Në këtë kontekst, për të shfrytëzuar sa më mirë sistemin e trajtimit dhe mos krijuar kosto shtesë, ndërtimet janë parashikuar që të zhvillohen mbi rrugën kryesore ku kalon dhe tubacioni kryesor. Në këtë mënyrë shfrytëzohet pjerrësia e terrenit dhe nuk nevojiten kosto shtesë për pompimin.

Përsa i përket zonës së Velipojës është ndërtuar sistemi i ri i trajtimit të ujërave në Pulaj. Edhe ky sistem është me teknologji modern çka nënkupton që edhe kjo zonë është e mirëmbuluar me sistemin e trajtimit të ujëra. Këtë verë do të kryhet dhe testimi i sistemit.

Zonat Urbane me densitet të ulët

Trajtimi i ujërave të bardha dhe të zeza në zonat urbane me densitet të ulët, ku kanalizimet janë shumë të shtrenjta për Sherbimet Publike dhe Private, mund të arrihet duke instaluar në parcelat private një impiant IMHOFF, i pozicionuar plotësisht në tokë. Të gjitha ujrat e ndotura që vijnë nga shtepite e përdoruesve do të percillen në këtë impiant.

Impianti IMHOFF përfshin komponentet e mëposhtme:

- Një dhomë e lartë (një kabine shtresezimi) ku ndodh shtresezimi, me një minimum kapaciteti prej 400 Lt të llogaritura nga diferenca midis nivelit të sipërm dhe fundit të shtresezimit;
- Një dhomë e poshtme (kabine tretjeje) ku llumi mblidhet dhe tretet me një kapacitet minimal depozitimi prej 1000 Lt, të llogaritur nga diferenca midis nivelit të sipërm dhe të poshtem të shtresezimit.

Pas para-trajnitimit në Impiantin IMHOFF dhe ndaresit lubrikues, llumi do të dergohet në shtratin e trajtimit të ujërave të zeza.

Shtrati i trajtimit konsiston në një impiant të mbyllur me masen të treguar në tabelën shpjeguese (15-20cm l trashë, me një shtresë zhavorri 10-20cm, 15 cm trashësi pelhura të paendura dhe 40-50cm dhe natyral ku mund të mbillen bimë të ndryshme).

Shtrati i trajtimit mund të ketë një dalje ajrimi ose jo, në varësi të permasave të tij, në mënyrë që të lejojë të gjithë ujrat e ndotur të trajtohen nepermjet procesit të avullimit dhe frymemarrjes së bimeve.

Shtrati i trajnitimit mund të ketë një sipërfaqe ekuivalente në 5m²/banorë. Bimet janë një perberës aktiv në absorbimin e shtresave për arsye të procesit të avullimit dhe frymemarrjes ato i lejojnë ujrat e ndotura dhe përmbajtjeve të tyre të trajtohen.

Bimë të mbjella në shtrat duhet të zgjidhen midis këtyre llojeve:

- **SHKURRE:** Aucuba Japonica, Bamboo, Calycantus Flavidus, Cornus Alba, Cornus Florida, Cornus Stolonifera, Cotoneaster Salicifolia, Kalmia Latifolia, Laurus Cerasus, Rhamnus Frangula, Spirea Salicifolia, Thuya Canadensis.
- **BIMË DHE LULE:** Auruncus Silvester, Astilbe, Elymus Arenarius, Iris Pseudoacornus, Iris Kaempferi, Joxes, Litrium Officinalis, Nepeta Musini, Petasites Officinalis, Ferns.

Në mënyrë opsionale një pike për trajtimin e ujërave të zeza dhe një grope inspektimi mund të instalohet që të kontrollojë veprimin e duhur të bimeve. Në mënyrë me specifike, pika kontrolli të

pershtatshme do te instalohen ne pjesen e dhomes se poshtme (ne rast te shkarkimit te ujrave) per te kontrolluar nivelin e ujit tek bimet dhe per te mbledhur mostra nga llumi.

3.7.3 Masat për energjinë elektrike

Parashikohet përmirësimi i rrjetit ekzistues në bazë të popullsisë dhe intensitetit të propozuar për zhvillim. Gjithashtu, gjatë këtij përmirësimi do të shmangen humbjet ekzistuese në rrjet. Përsa i përket zonës së Velipojës parashikohet ndërtimi i një nënstacioni të ri me kapacitet 20kv i cili ndihmon në përbalimin e fluksit veror.

Përdorim i Energjive të Rinovueshme me bazë diellin në ndërtesa

Në kuadër të përmirësimit dhe shfrytëzimit më të mirë të energjive të rinovueshme në bazë ndërtese, rekomandohet të përdoren dy teknologjitë e mëposhtme, në varësi të kontekstit dhe të tipareve të ndërtesës:


| Teknologjia | Karakteristikat e ndërtesës | Përdorimet | Shkalla | Konsiderata |
|-------------------------|---|--|---------------------|---|
| Panele Fotovoltaike | Nuk duhet të jetë një ndërtesë me hijëzim të lartë. Ballina lindje-perëndim (nëpërmjet jugut). Mund të jetë me tarracë ose çati me pjerrësi jo më të madhe se 30% | Të gjitha përdorimet. Veçanërisht për zyra, shkolla, hotele, institucione etj. | Të gjitha shkallët | Për të maksimizuar impaktin është e nevojshme të tregohet kujdes në lidhje me orientimin e ndërtesës |
| Panele Diellore termale | Nuk duhet të jetë një ndërtesë me hijëzim të lartë. Ballina lindje-perëndim (nëpërmjet jugut). Mund të jetë me tarracë ose çati me pjerrësi jo më të madhe se 30% | Të gjitha përdorimet. Veçanërisht hotelet për ngrohjen e ujit. | Të gjitha shkallët. | Ka nevojë për një kërkesë të lartë për ngrohjen e ujit. Për këtë arsye propozohet kryesisht për hotele ose për shtëpi plazhi. |

3.7.4 Masat për vaditjen dhe kullimin

Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër synon rehabilitimin e rrjetit kullues dhe vaditës për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër duke përfshirë njësitë administrative. Në këtë kontekst do të kryhen:

- Evidentimi dhe Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të kanaleve
- Evidentim dhe Vlerësim i gjendjes ekzistuese të hidrovoreve dhe stacioneve të pompimit
- Plani i Detajuar i Veprimit për zgjerimin, pastrimin dhe rikonstruksionin e rrjetit
- Mirëmbajtjen e Rrjetit

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT TË BASHKISË SHKODER
HARTA: HARTA E KANALIZIMEVE VADITËSE/KULLUESE



3.8 Masat në lidhje me përmytjet

Përmytjet në Bashkinë e Shkodrës ndahen në përmytjen e qytetit të Shkodrës dhe në përmytjen e fushës së Nënshkodrës. Në rastin e përmytjeve të qytetit rolin kryesor e ka liqeni i Shkodrës dhe indirekt roli tjetër i takon lumit Drin. Ndërkohë që për zonën e Nënshkodrës rolin kryesor e ka lumi Drin dhe rol sekondar ka lumi Bunë.

Dy janë shkaqet kryesore:

- Shkaqe natyrore
- Shkaqe njerëzore
- Kombinimi i të dyjave



Në të gjitha rastet KESH-i ka një rol parësor si në zbutjen e shkaqeve natyrore ashtu edhe në eliminimin e shkaqeve njerëzore. Të gjithë këtë procedurë KESH-i e menaxhon me anë të një Rregullore të Administrimit të Kaskadës së lumit Drin e miratuar qysh në vitin 1988. Jemi të mendimit se ka ardhur koha që kjo rregullore të rishikohet me qëllim përmirësimin e saj në kushtet e sotme si edhe të zvogëlimit të sasive maksimale të ujit nga portat e shkarkimeve.

- Ndërtimi i dy veprave të rëndësishme në sistemin hidrografik të njëjës së Shkodrës është një nga çështjet që duhet parë me prioritet për shkak të efekteve negative që ato kanë sjellë dhe mund të sjellin në të ardhmen në fenomenet e përmblytjeve në këtë zonë. Një nga këto është Ura e Re mbi lumin Bunë





- Ndërtimi i dytë hidroteknik është By-Pass-i i Shkodrës i cili është ndërtuar me idenë që të mbroje qytetin nga përmbytjet. Ndërtimi i këtij by-pass-i është i papërfunduar dhe punimet janë ndërprerë dhe për pasojë ka filluar degradimi i tij.

Nga një rikonjicion i bërë konstatohen disa perceptime që edhe kjo vepër hidroteknike ka defekte serioze që në konceptimin e tij. Rrezikon që kjo vepër hidroteknike të luaj rolën e kundërt me idenë për të cilin është ndërtuar, me fjalë të tjera do të influencoj negativisht në fenomenin e përmbytjeve.







Lidhur me problemin e përmytjeve i sugjerojmë Bashkisë së Shkodrës që të ndërmarrë disa iniciativa për kryerjen e disa veprimeve që janë me interes në këtë drejtim.

- Të iniciojë nismën për rishikimin e Rregullores së shkarkimit të prurjeve maksimale në kaskadën e lumit Drin, pranë KESH-it dhe Komitetit të Digave
- Të krijojë një grup ekspertësh për vlerësimin e projekteve të Urës së Re mbi lumin Bune me idenë e marrjes së masave për zbutjen e efektit negativ që luan kjo urë në rastin e ngjarjeve ekstreme.
- E njëjta gjë edhe për By-Pass-in e Shkodrës. Grupi i eksperteve inxhinierë do njihet me projektin për të interpretuar idenë e ndërtuesve për zbutjen e efektit të përmytjeve me anë të By-Pass-it si edhe të marrjes së veprimeve për të shmangur efektin negativ të përmytjes që mund të shkaktoje

Për të qënë sa më të përgatitur për rrezikun e përmytjeve, propozohen një sërë masash të cilat mund të aplikohen në disa nivele sidomos në zonat me rrezikshmëri të lartë në pjesën e nënShkodrës:


- Ngritja e nivelit të katit përdhesë nga toka (kjo gjë duhet të kryhet konform standarteve të rregulloreve përkatëse të cilat garantojnë aksesueshmërinë nga të gjithë)
- Zona të gjelbërta të cilat mund të sakrifikohen në periudhën e përmytjeve
- Gjelbërim dhe rregullim peizazhi në mënyrë që të drejtojnë ujërat drejt vendeve të përshtatje për grumbullimin e tyre ose vendeve të posaçme për përmytje
- Rrethim përgjatë perimetrit të ndërtesës
- Mure kufizuese të papërshkueshme


- Vendosija e shërbimeve eletrike në ndërtesa përmbi nivelin që rrezikon përmbytjen e tyre mbi dysheme.

3.9 Plani i Masave në Infrastrukturë dhe Transport

3.9.1 Akset Rrugore

Infrastruktura rrugore në bashkinë Shkodër shihet jo vetëm si ndërlidhëse e territorit dhe ofrimin e aksesit por edhe në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe të turizmit. Në këtë kuadër, fillimisht janë analizuar nevojat kryesore në lidhje me përmirësimin e cilësisë së akseve rrugore:





Dy hartat e mësipërme, reflektojnë nevojat për ndërhyrje në territorin e bashkisë Shkodër dhe shërbejnë si bazë për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Përsa i përket zhvillimit të infrastrukturës rrugore në bashkinë Shkodër janë parashikuar ndërhyrje në një sërë rrugësh kryesore të tilla si:


- Aksi Shirokë- Zogaj

- Aksi Shkodër- Velipojë
- Aksi Shkodër-Theth
- By-Pass Lindor
- Shkodër-Vau Dejës
- Prekal Koman

Ndërkohë, një tjetër aks me potencial të madh në kuadër të zhvillimit të turizmit është dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore e cila lidh Shkodrën me Gjakovën përgjatë luginës së Drinit. Ky është një investim që i tejkalon përmasat dhe mundësitë e Bashkisë Shkodër, në këtë sens është e nevojshme që të merret në konsideratë nga organet përkatëse qendrore për të realizuar këtë projekt madhor.

Në hartën bashkangjitur dokumentit mund të dallohen qartësisht ndërhyrjet dhe ndryshimet infrastrukturore në rrugë në bashkinë Shkodër. Rrugët janë parashikuar bazuar në specifikimet dhe rregullat e kodit rrugor të Shqipërisë duke ruajtur distancat dhe specifikimet teknike përkatëse:

RRUGË INTERURBANE KRYESORE




KARAKTERISTIKAT PËRBERESE TE RRUGËS INTERURBANE KRYESORE:
 KARREXHATA - 2 KORSI PER DREJTIM - KORSI PERSHPJETIMI DHE NGADALESIMI - BANKINA - KRYQEZIM NE DISNIVEL - RRETHRRROTULLIM - HYRJE PRIVATE OSE ANESORE - KARBURANTI CDO 15 KM - SINJALE RRUGORE
 - VENDKALIM KEMBESORESH - VEND PUSHIMI OSE PARKIMI - MONITORIM ELEKTRONIK I TRAFIKUT.

01 RRUGE PEIZAZHISTIKE:
 Korridori bregdetare peizazhistik



RRUGË INTERURBANE DYTËSORE




KARAKTERISTIKAT PËRBERESE TE RRUGËS INTERURBANE DYTËSORE:
 1 KORSI PËR DREJTIM - BANKINA - KRYQEZIM NE NIVEL - HYRJE PRIVATE OSE ANESORE - KARBURANTI ÇDO 15 KM - SINJALE RRUGORE - VENDKALIM KEMBESORSH - XHEP NDALIMI - KORSI TE DESTINACIONIT TE VEÇANTE

01 RRUGA PËR VELIPOJË:
 Bërdice - Velipojë

02 RRUGA THËHTIT
 Shkodër - Theth

RRUGË URBANE KRYESORE




KARAKTERISTIKAT PËRBERESE TE RRUGËS URBANE KRYESORE:
 2 KORSI PËR DREJTIM - KORSI EMERGJENCE - KORSI BIKLETASH - BANKINA - SEMAFORE - KRYQEZIM NE NIVEL - HYRJE PRIVATE OSE ANESORE - KARBURANTI ÇDO 5 KM - SINJALE RRUGORE - VENDKALIM KEMBESORSH - XHEP NDALIMI - VEND PËSHIMI OSE PARKIMI - MONITORIM ELEKTRONIK I TRAFIKUT

01 RRUGA NDERMJET KORRIDORIT NATYRORE (bypass) DHE UNAZES SE BRENDSHME
 Rruga Ethem Kazzazi deri ne zgjatimin vertiore te Bypasit-4.

02 BYPASS-I GOMSIQË
 Vendbanimi Gomsiqe (Qendra e njesie administrative Velipojë)

03 TRE SEGMENTE RRUGORE PËR NE BREGDET
 Velipojë

RRUGE URBANE DYTËSORE



3.8.2 Bypass-i jug-lindor i qytetit Shkodres

Në vitin 2010 në Shkodër kanë filluar punimet për ndërtimin e by-pass Perëndimor. Një projekt i cili aktualisht është i ndërprerë dhe që ka prodhuar një situatë të vështirë peizazhiste e mjedisore për qytetin e Shkodrës dhe liqenin.



Po ashtu ekziston një projekt ide për vazhdimin e këtij by-pass i cili del nga Shkodra me disa vepra arti infrastrukturore të rëndësishme si tunel në kodrën ku ndodhet Kalaja e Shkodrës si dhe me mbikalim në aksin hyrës në Shkodër për tu lidhur me rrugën ekzistuese tek Bexhisteni. Ky projekt ka impakte të forta mjedisore sidomos tek liqeni i Shkodrës. Po ashtu ka edhe një impakt të fortë viziv dhe peizazhistik për Shkodrën. Si rrjedhojë, grupi i punës rekomandon që të zbatohet projekti për bypass lindor të qytetit të Shkodrës:

Qyteti i Shkodres si kryqender e zones veriore te Shiperise duhe te siguroje anashkalimi e trafikut transit jovetem per nevojat e zones veriore te shqiperise por dhe ate nderkombetar si dhe per dy pikat kryesore te doganave te Hanit te Hotit dhe Murriqanit me Malin e Zi. Ndertimi i nje rruge te shpejtesise se larte e cila do te perballoje kete trafik jep mundesine e krijimit te bypassit juglindor te qytetit te Shkodres.

Rruga e Shpejtesise se larte drejt Malit te zi qe anashkalon qytetin e Shkodres ne pjesen juglindore te tij krijon mundesine e perdorimit te kesaj rruge si nje bypass per qytetin Shkoder ne nderprerjet me rruget qe hyne ne Shkoder nga Vau I Dejes dhe nga Hoti.

Ky bypass do ta cliroje teresisht qytetin e Shkodres nga te gjithe trafiku ne rritje qe vjen nga Europa ne drejtim te Shqiperise nepermjet Malit te Zi. Segmentet lidhese te bypassit me rrjetin e qytetit do te konsiderohen si rruge te kategorive te para urbane.

Avantazhet qe vijne nga zbatimi i plote i ketij projekti ne lidhje me uljen e presionit të Trafikut Tranzit ne trafikun urban te qytetit te Shkodre do te jene

- Zvogelim i ngarkeses se trafikut ne rrjetin rrugor të qytetit dhe clirimi i trafikut nga transporti transit.
- Nje aksesibilitet trafikut me i permisuar ne pjesen jug-lindore të qytetit.
- Sigurimi i lëvizshmërisë për të gjithë qytetarët
- Permisimi i sistemit te menaxhimit te trafikut nga Bashkia e Shkodres
- Do te kemi nje qytet te paster, I pandotur

- Rritje te sigurise te trafikut

Te gjitha fazat qe lidhen me kete projekt do te jene pjese e projektimit dhe te ndertimit te rruges së shpejtesise se larte. Rreziku qendron ne mungesen e koordinimit dhe e informacionit ne nivelet e pushteteve lokale dhe qendrore mbi afatet e ndertimit.

3.8.3 Kryqëzimet

Kryqezimet e rrjetit rrugore percaktohen ne varesi të hierarkise nga të cilat eshte e qarte qe kemi dy lloje kryqezimesh kryesore:

- Ne nivel (ne rrafsh)
- Ne disnivel

Duke ju referuar Strategjisë Territoriale, per Bashkinë Shkodër janë parashikuar disa kalime kryqezime ne disnivel. Synohet ulja vonesat dhe radhet e makinave ne disa nga kryqezimet me te ngarkuara ne rrjetin e rruges primare. Ne perputhje me rezultatet e modelimit dhe simulimeve te trafikut jane percaktuar nyjet e kryqezimeve ne disnivel ndermjet rruges primare, rrjedhese dhe autostrada urbane si me poshte:

1. ByPass-i i rruges nacionale me shpejtesi te larte - rruga nacionale per ne zonen e Hotit
2. Bypass-i Lindor – rruga nacionale per ne zonen e Hotit
3. Bypass-i Lindor - rruga nacionale ne drejtim te Hanit te Hotit
4. Bypass-i Lindor – vazhdimi i rruges se kategorise se pare, nga qendra e qytetit deri ne Vaun e Dejes
5. Rruga veriore jasht unaze – rruga nacionale ne drejtim te Hanit te Hotit
6. Rruga lindore jashte unaze - rruga nacionale ne drejtim te Vaut te Dejes
7. ByPass-i i rruges nacionale me shpejtesi te larte - rruga nacionale ne drejtim te Vaut te Dejes
8. Rruga Shkodër-Lezhë me bypass Lindor

Nderkohe per te gjitha kryqezimet ne nivel rast pas rasti duhet te studjohet menyra e rregullimit te trafikut ne varesi te flukseve perkatese te trafikut, duke zgjehur:

- Rreth rrotullimet
- Rregullimin me semafor, apo
- Rregullimin me perparsi kalimi nepermjet shenjave te trafikut

3.8.4 By Pass Perëndimor

Ky projekt parashikon nje rruge me kater korsi, i cili lidh piken hyrese te rruges nacionale nga Lezha per ne qytetin e Shkodres, ne skajin jug-lindor te qytetit, pergjate te gjithe pjeses lindore dhe pergjate liqenit perpara se te kalohet ne pjesen veriore te qytetit. Kjo autostrade urbane do te ndertohej duke patur ne konsiderate faktin qe trupi i rruges do te luante rrolin e nje argjinature qe nuk do te lejoje permytjen e qytetit nga ngritja e nivelit te ujit ne liqen. E gjithe kjo rruge me kater korsi ka nje gjatesi totale prej 6,74 km, duke bere lidhjen e rruges nacionale per ne kufirin e Hanit te Hotit me zonen turistike te Hotit ne veri te vendit.

Kapaciteti i planifikuar per Bypass-et eshte 3600 PCU (automjete njesi) ne ore, me nje shpejtesi te planifikuar 80 km/ore.

By-passi veri-perëndimor në përfundim do të ishte një rrugë me dy drejtime dhe katër korsi, edhe pse ndërtimi i tij ishte parashikuar në dy faza (siç është planifikuar për Bypass-in jug-lindor). Në fazën e parë të zhvillimit, bypassi veri-perëndimor do të ndërtohej me nje karrexhate, dy drejtime dhe me dy korsi, bashkimi me rruget e tjera te rendesishme do të realizohet me kryqëzime në një nivel ku manovrat do të rregullohen nëpërmjet shenjave horizontale, vertikale dhe sinjalistikës me semafore.

Ndërtimi i dy korsive të tjera nga një për cdo drejtim lëvizjeje dhe dy kryqëzime në disnivel parashikohen për një fazë të dytë të projektit.

Aktualisht është kryer rreth 40% e investimeve për ndërtimin e bypass duke krijuar një situatë të vështirë mjedisore për liqenin e Shkodrës. Në këtë kontekst, nga analizat e kryera si dhe nga komentet e qytetarëve të Shkodrës apo dhe specialistëve të ndryshëm të institucioneve publike, shoqërisë civile dhe private perceptimi i përgjithshëm është që By-Pass nuk arrin të ofrojë sigurinë dhe cilësinë e kërkuar dhe kthehet në një dëm për qytetin e Shkodrës dhe vetë liqenin. Në këtë kontekst janë disa argumenta të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten më poshtë:


1. By-pass nuk arrin të garantojë mbrojtjen nga përmbytjet. Parimi i enëve komunikuese bën që by-pass më shumë të kthehet në një barrierë për largimin e ujit nga qyteti për në liqen, sesa për mbrojtjen e qytetit nga liqeni. Pra, gjendemi në një situatë ku edhe nëse vendosen pompat e largimit të ujit, prapë rrezikohet që të mos arrihet mbrojtja e qytetit nga përmbytja por të rritet më shumë kohëzgjatja e largimit të ujit. Nga një rikonjicion i bërë konstatohen disa perceptime që edhe kjo vepër hidroteknike ka defekte serioze që në konceptimin e tij. Rrezikon që kjo vepër hidroteknike të luaj rol të kundërt me idenë për të cilin është ndërtuar, me fjalë të tjera do të influencoj negativisht në fenomenin e përmbytjeve.
2. By-pass nga mënyra si është operuar deri më tani ka dëmtuar ekosistemin mjedisor dhe ekologjik të liqenit dhe rrezikon ta dëmtojë dhe më tej atë. Ndërtimi i këtij by-pass-i është i papërfunduar dhe punimet janë ndërprerë dhe për pasojë ka filluar degradimi i tij. Vërehet sidomos pranë shëtitorës që ka filluar një proces kënetëzimi.
3. By-pass, nga pikëpamja urbane dëmton cilësinë e qytetit të Shkodrës. Kjo gjë vërehet veçanërisht në ballinën ujore karakteristike të qytetit të Shkodrës tek bexhisteni, ku tashmë, shëtitorja nuk ka më vlerat e mëparshme si rrjedhojë e bllokimit vizual të liqenit nga zhavori.
4. By-pass, nuk garanton të ofrojë një zgjidhje përse i përket trafikut hyrës dhe dalës në qytetin e Shkodrës. Në këtë sens, trafiku sërish duhet të kalojë në disa "pika-të-zeza" si ura e bahçallëkut, rreth-rrotullimi tek ura e bunës dhe rruga hyrëse në qytet. Ndërkohë, by-pass lindor ofron një zgjidhje më të mirë nga kjo pikëpamje duke larguar trafikun nga qyteti.

Bazuar në sa më sipër si dhe në analizat e detajuara të kryera në funksion të sistemit natyror dhe ujore si dhe si pjesë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, rekomandojmë që projekti i by-pass perëndimor të rishikohet dhe të rikonceptohet për të kthyer këtë investim në një funksion tjetër të tipit të parkut të qytetit. Një hapësirë rekreative në funksion të qytetarëve të Shkodrës e cila nuk dëmton sistemin ekologjik të liqenit.

3.8.5 Rrjeti i Lëvizjes me bicikleta dhe transporti publik

Struktura e rrjetit të biçikletave në Bashkinë Shkodër është e ndarë në 4 module kryesore. Secili nga modulet ka karakteristika të ndryshme që i përshtaten korsive të biçikletave. Ky rrjet përbëhet nga 16 segmente të cilat janë të ndara sipas moduleve të përshtatura si mëposhtë:

- 7 segmente të përshtatura me modulën_A
- 8 segmente të përshtatura me modulën_B
- 2 segmente të përshtatura me modulën_C
- 2 segmente të përshtatura me modulën_D



Imazh 36- Modulet

1. Moduli_A

Në këtë modul korsitë e biçikletave janë të integruara me hapësirën e automjeteve. Por kanë hapësirë të dedikuar me trafik ndarëse për ti ofruar ciklistëve siguri nga automjetet pranë tyre. Ky modul është i përshtatur kryesisht përgjatë infrastrukturës interurbane dytësore

2. Moduli_B

Korsitë e biçikletave janë të integruara me hapësirën e dedikuar automjeteve. Dy hapësirat ndahen me sinjalistike horizontale dhe kanë një sistem të ndarjes së hapësirës midis tyre për të lejuar ndërlidhjen midis tyre. Ky modul përshtatet brënda qendrës së qytetit të Shkodrës, Shirokë-Zogaj, Beltojë-Trush i sipërm.

3. Moduli_C


Korsitë e biçikletave nuk janë të integruara me hapësirën e automjeteve. Janë të shkeputura nga korsa e automjeteve me hapësira ndarëse midis tyre. Ky rast aplikohet përgjatë tokave bujqësore që

kane kanale bujqësore përgjatë aksit rrugor. Ky modul gjendet në pjesën e Trushit të poshtëm deri në afërsi të Baks i ri dhe përgjatë Fushës së Kolagjinit.

4. Moduli_D


Në këtë rast hapësira është e ndarë midis këmbësorëve dhe ciklistëve. Ndarja bëhet me anë të sinjalistikës horizontale e cila ofron dhe ndërlidhjen midis tyre. Ky modul është i përshtatur në itenrarin përgjatë Bahçallëkut.

Harta 13- Rruget për biçikleta



Bashkia Shkodër në bashkëpunim me një OJQ lokale ka nisur paralelisht hartimin e Planit Sektorial të mobilitetit. Parashikimet e këtij plani duhet të integrohen dhe harmonizohen me planin e përgjithshëm vendor.

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT TË BASHKISË SHKODER
HARTA: HARTA E RRJETIT TE TRANSPORTIT PUBLIK



Legenda

□ Kufi zona Shkoder

● Stacione:

- Fabrika e teit
- Bahcatlek
- Bechtaseni
- Fermentimi
- Ish-Frigoritari
- Kisha e Zogës
- Postriba
- Stacioni i trenit
- Universiteti
- Ura e Vjetër e Bunës

Linja

- Bahcatlek-Fermentim
- Kriar-Stacioni i trenit-Kriar
- Shiroka-Zogës-Qender
- Stacioni i trenit-Guri i zi
- Linza e qytetit
- Velipoje-Shkoder



REPUBLIKA E SHQIPERISE
 KESHILLI KOMBETAR I TERRITORIT

MIRATOHET
 KRYETARI I K. K. T.
 z. EDI RAMA

Ministria e Zhvillimit Urban

znj. EGLANTINA GJERMENI

Këshilli i Bashkisë Shkodër

Miratuar me vendimin e Këshillit të
 Bashkisë Shkodër

nr: __, datë __/__/__

Kryetari i Këshillit të
 Bashkisë Shkodër

z. _____

Kryetaria e Bashkisë Shkodër

znj. Voltana Ademi

MIRATUAR ME VENDIMIN E K.K.T. së nr: __, datë __/__/2016

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

| | |
|-------|--|
| A. 01 | HARTA E RRJETIT TE TRANSPORTIT PUBLIK |
| | BASHKIA SHKODER UNIVERSITETI POLIS, METROPOLIS PERSATI ARIZONA STATE UNIVERSITY |

3.9 Zhvillimi Urban

3.9.1 Përcaktimi i zonave kryesore të zhvillimit ekonomik dhe atyre me prioritet zhvillimi urban

Në kuadër të hartimit të PPV Shkodër dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të territorit të hartuar në kuadër të PPV, janë përcaktuar tre zona të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe disa njësi të rëndësishme në qytetin e Shkodrës dhe Velipojë për zhvillimin urban. Në këtë kontekst, zhvillimi urban është përcaktuar duke marrë në konsideratë karakterin e zonës, vendndodhjen, dhe potencialin e tyre për të tërhequr investitorë dhe gjeneruar të ardhura për bashkinë dhe komunitetet përkatëse, si dhe mbulimi me infrastrukturën përkatëse.

Parimet udhëheqëse të përcaktimit të zonave me prioritet zhvillimi ekonomik kanë qënë karakteristikat e zonës, mbulimi me infrastrukturë dhe afërsia me akset kryesore infrastrukturore për të garantuar akses të shpejtë dhe të mirë, potenciali për të tërhequr investitorë dhe krijuar vende punësi si dhe përputhshmëria e përdorimit të tokës për zhvillim ekonomik me njësitë/zonat përreth tyre.

Zona Kryesore të Zhvillimit Ekonomik

Zona e ish-fushës së aviacionit- do të jetë një zonë e lirë ekonomike për afrimin e bizneseve dhe investitorëve të rinj në Shkodër. Toka është në pronësi publike dhe pa ndërtime të mëparshme në të kësaj lejon zhvillimin e shpejtë duke u kthyer në një zonë të re ekonomike.

Hapësira e ish-zonës industriale- Është një zonë e rëndësishme së veçantë për bashkinë Shkodër. Tashmë shumë prej industrive të vjetra janë mbyllur. Kjo zonë do të ketë një karakter kryesisht të industrisë së lehtë përpunuese dhe shërbimeve tregtare. Për rivitalizimin e kësaj hapësire është menduar që një projekt katalizator të jetë edhe zhvillimi i stacionit multimodal tek Stacioni i Trenit. Ky projekt do të shërbejë edhe për të ndruar imazhin e zonës në mënyrë që të kryhet kapërcimi nga një zonë ish-industriale dhe e degraduar, në një zonë me përparësi zhvillimin ekonomik dhe të shërbimeve tregtare e industriale të lehta. Për këtë qëllim, duke qënë një zonë sensitive dhe njëkohësisht tejet e rëndësishme për zhvillimin urban është parashikuar që zhvillimi të drejtohet me anë të PDV-ve.

PDV duhet të kthejë në zgjidhje urbane dhe arkitektonike vizionin për të kthyer ish-zonën industriale në një hub të ri ekonomik, tregtar dhe logjistik për Shkodrën. Gjithashtu, PDV duhet të ofrojë dhe disa zgjidhje të detajuara në lidhje me ndërhyrjet në mjedis për rehabilitimin e kësaj zone si dhe përmirësimin e ballinës ujore të lumit KIR..

Fashat ekonomike- Bazuar në PPK Shkodra është pjesë e Rajonit Ndërkufitar Podgoricë-Shkodër si dhe e rajonit ekonomik Shkodër- Lezhë, ku aksi kryesor lidhës midis tre qyteteve është dhe një aks i fortë ekonomik. Në këtë kontekst në Bashkinë Shkodër Aksi Shkodër -Koplik dhe Aksi Ura e Bahçallëkut--Bërdicë shihen si dy akse të rëndësishme ekonomike. Për të përmirësuar dhe strukturuar këto dy akse ekonomike, në bashkëpunim me bizneset dhe komunitetin do të hartohen edhe projektet për rikualifikimin urban të tyre duke krijuar një ambjent sa më tërheqës për biznesin. Këto akse kryesisht do të shërbejnë në ofrimin e shërbimeve tregtare duke qënë se kanë marrë tashmë një karakter të tillë dhe gëzojnë një akses të mirë nga rrugët nacionale.

Zonat kryesore të zhvillimit urban

Zona e Qendrës Shkodër- është caktuar si një zonë me prioritet zhvillimin urban duke shfrytëzuar aksesin e mirë që kjo zonë ka në shërbime dhe në infrastrukturë si dhe potencialin për zhvillimin ekonomik duke parë edhe shumëllojshmërinë e përdorimeve dhe shërbimeve që ofrohen në këtë hapësirë. Karakteri i propozuar i zonës do të jetë ai miks, duke respektuar normat përkatëse për ofrimin e hapësirave publike dhe të gjelbërta. Gjithashtu, duke qënë se në këtë hapësirë ndodhet dhe nja nga zonat më të rëndësishme historiko-kulturore të qytetit të Shkodrës një kujdes i veçantë duhet treguar në zhvillimin e saj. Për këtë qëllim, duke qënë një zonë sensitive dhe njëkohësisht tejet e rëndësishme për zhvillimin urban është parashikuar që zhvillimi të drejtohet me anë të PDV-ve.

PDV duhet të përkthejnë në zgjidhje urbane dhe arkitektonike vizionin për të kthyer qendrën e qytetit të Shkodrës në një qendër Europiane e cila respekton historikun e saj. Një hapësirë miqësore ndaj këmbësorëve dhe me hapësira të përshtatshme rekreative e urbane. PDV-të duhet të marrin në konsideratë mundësitë e shtimit të hapësirave pedonale e veçanërisht të ofrojë zgjidhje urbane për këmbësorizimin e rrugës nga zig-zaku deri tek Stadiumi Loro Boriçi.

Zona pranë By-Pass Perëndimor- shihet si një zonë e re dhe me potencial zhvillimi urban për qytetin e Shkodrës. Ndërthurja midis funksioneve institucionale, shërbimeve rekreative dhe zhvillimit urban të përzierë do të garantonte një nismë të mirë edhe në rehabilitimin mjedisor të shkaktuar nga projekti i bypass perëndimor. Në këtë zonë gjithashtu është parashikuar një terminal i vogël ujq për varka dhe mjete të vogla lundrimi të cilat mund të shërbejnë kryesisht për qëllime rekreative dhe turistike në Liqenin e Shkodrës. Ndërkohë, në këtë zonë është përcaktuar dhe një park i madh rekreativ i cili përtej aspektit mjedisor dhe shtimit të sipërfaqeve të gjelbra të shfrytëzueshme nga qytetarët e Shkodrës do të luajë një rol edhe në menaxhimin natyror të rrezikut të përmytjeve. Për këtë qëllim, duke qënë një zonë sensitive dhe njëkohësisht tejet e rëndësishme për zhvillimin urban është parashikuar që zhvillimi të drejtohet me anë të PDV-ve.

PDV-të duhet të përkthejnë në zgjidhje urbane dhe arkitektonike vizionin për të kthyer zonën e ish-bypass perëndimor të Shkodrës në një qendër të re rekreative, rezidenciale e urbane për Shkodrën. PDV-të duhet të marrë në konsideratë propozimet e kryera nga plani në lidhje me këtë zonë dhe të detajojë më tej ato.

Zona e Qendrës Velipojë-Rrjoll- është caktuar si një zonë me prioritet zhvillimin urban duke shfrytëzuar aksesin e mirë që kjo zonë ka në shërbime dhe në infrastrukturë si dhe potencialin për zhvillimin turistik duke parë edhe shumëllojshmërinë e përdorimeve dhe shërbimeve që ofrohen në këtë hapësirë. Karakteri i propozuar i zonës do të jetë ai miks midis shërbimeve hoteliere dhe shërbimeve të tjera në funksion të turizmit të harmonizuar me disa hapësira banimi, por duke respektuar normat përkatëse për ofrimin e hapësirave publike dhe të gjelbërta. Ndërkohë, territori i Rrjollit shihet si një potencial i jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit elitare. Duke qënë një zonë relativisht e virgjër, është tejet e rëndësishme që për të arritur qëllimin e një zone turistike elitare mjedisi dhe integriteti ekologjik i zonës të ruhen. Në këtë kontekst, duke qënë se kemi të bëjmë me dy hapësira territoriale të rëndësishme nga pikëpamja e zhvillimit turistik, por njëkohësisht të vendosura në një zonë sensitive mjedisore është parashikuar që zhvillimi të drejtohet me anë të PDV-ve.


PDV-të duhet të përkthejnë në zgjidhje urbane dhe arkitektonike vizionin për të kthyer zonën e Velipojë-Rrjoll në një hapësirë të rëndësishme turistike për Shkodrën dhe Rajonin. PDV-të duhet të marrë në konsideratë propozimet e kryera nga plani në lidhje me këtë zonë dhe të detajojë më tej ato.

Zona e Ura Bunës-Shirokë-Zogaj- është caktuar si një zonë me prioritet zhvillimin urban jo për nga intensiteti i zhvillimit sesa për nga rëndësia dhe cilësia e zhvillimit urban që PPV kërkon të promovojë. Kjo zonë është pjesë e programit të rivitalizimit të ballinave ujore dhe shtrihet përgjatë liqenit të Shkodrës i cili është një aset i rëndësishëm mjedisor jo vetëm në nivel vendor por edhe në

atë ndërkombëtar. Gjithashtu, shihet si një nga hapësirat më interesante rekreative për Shkodrën por edhe për zhvillimin turizmit. Në këtë kontekst, duke qënë se kemi të bëjmë hapësira territoriale të rëndësishme nga pikëpamja e zhvillimit turistik dhe rekreativ, por njëkohësisht të vendosura në një zonë sensitive mjedisore është parashikuar që zhvillimi të drejtohet në disa raste me anë të PDV. PDV-të duhet të përkthejë në zgjidhje urbane dhe arkitektonike vizionin për të kthyer zonën buzë liqeni në një hapësirë të rëndësishme rekreative për Shkodrën dhe Rajonin. PDV-të duhet të marrë në konsideratë propozimet e kryera nga plani në lidhje me këtë zonë dhe të detajojë më tej ato.

Trajtimi i Zonave Informale

Nw territorin e bashkisw Shkodwr gjenden disa zona informale tw miratuara sipas pwrctimeve tw ALUIZNIT:



Përsa i përket trajtimit të tyre parashikohen disa ndërhyrje. Në Shkodër, ky fenomen është më së pranishëm dhe si rrjedhojë programi synon të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së hapësirave urbane informale. Politika synon të trajtojë problemin në dy drejtime kryesore, aspekti ligjor, si mbyllja e procesit të legalizimeve, dhe në aspektin infrastrukturor si përmirësimi i infrastrukturës. Përfshirja e komuniteteve në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e infrastrukturës do të jetë një aspekt kyç ku incentivimi i projekteve pilot dhe krijimi i platformave të ndryshme të komunikimit ku qytetarët mund të kontribuojnë me ide apo parime të zhvillimit.

Zonat e ndryshme të qytetit do të zhvillohen dhe integrohen duke u bazuar në konceptet si: Lagjia Kiras (buzë liqeni) me konceptin e qytetit kopësht (duke qënë se ndodhet pranë hapësirës

rekreative/parkut rekreacional). Rrethinat me konceptin "urban agriculture/agricultural garden) duke qënë se ndodhen pranë tregut rajonal të bujqësisë. Lagjia Mark Lula (integrim duke përdorur rikualifikimin e stacionit të trenit apo dhe prania me zonën industriale/ekonomike e cila do të gjenerojë punësim).

Shfrytëzimi i Hapësirave të cilat nuk kanë përfunduar ndërtimin është një tjetër prioritet për zonat informale. Në këtë kontekst nxitja e partneriteteve midis qytetarëve, bashkisë dhe organizatave të ndryshme për të ofruar shërbime në këto ngrehina është një mundësi e mirë për të konsoliduar territorin dhe ofruar njëkohësisht shërbimet e munguara.

Gjithashtu, e rëndësishme është që zonat informale të mbrohen nga situata të përmbytjeve apo rreziqeve të tjera natyrore. Aty ku është e mundur do të përmirësohen kushtet infrastrukturore, ndërkohë që në disa zona, ku është e pamundur të ndërhyhet do të ketë edhe zhvendosje në vende të tjera. Një alternative e mundshme në këtë aspekt është trajtimi me banesa sociale.

3.9.2 Plani i strehimit

Bashkia Shkodër, historikisht ka qënë dhe mbetet qëndra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut Shkodër. Me ndarjen e re administrative, bashkia Shkodër përfshin brënda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Shkodrës dhe 10 njësi të tjera administrative. Nga këndvështrimi strukturor demografik në bashkinë Shkodër, banojnë rreth 63 përqind e popullatës së qarkut Shkodër, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës është e shpërndarë në bashkitë e tjera të qarkut si Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz, respektivisht me rreth 14.3%, 14.1%, 5% dhe 3% e popullatës gjithsej të qarkut. Popullata rezidente e bashkisë Shkodër, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 76%, duke shënuar një numër popullsie prej 136 mijë banorë në fillim të vitit 2016.

Plani i strehimit merr parasysh analiza demografike mbi rritjen e popullsisë por edhe një sërë faktorësh të tjere që lidhen drejtpërdrejtë me mireqenien sociale (në veçanti integrimin e fashave të ndryshme sociale siç mund të jenë edhe qytetarët e ardhur rishasi), punësimin në shkallë të gjerë në zonat urbane dhe rurale, ofrimin të shërbimeve, rritjes së kapaciteteve pritëse për turistë dhe vizitorë etj. Plani Përgjithshëm Vendor ka pra si qëllim që t'i përqaset nevojës për strehim duke parashikuar nevojat aktuale për strehim por edhe duke dhënë mundësinë në të radhmen për t'u përballur me ndryshime dhe nevoja të paparashikueshme në kushtet e sotme duke lejuar mundësi dhe diversitet për ofertën e strehimit, për të zbutur efektet e papritur të një zhvillimi të shpejtë.

Një ndër drejtimet e zhvillimit demografik i nxjerr në pah nga projeksionet e INSTAT dhe të dokumentit të analizave është fakti se struktura e familjeve shkodrane po ndryshon. Këto ndryshime do të sjellin largimin më të hershëm të të rinjëve prej familjes dhe krijimin e familjeve të reja ku nuk në të njëjtën banesë bashkëjetojnë shumë kurorë. Pra pritët një shtim i numrit të familjeve të reja që rrjedhimisht do të sjelli edhe një kërkesë në rritje për banim . Paralelisht me këtë prirje, vihet re edhe një diversifikim i të ardhurave për familje, gjë që do të sjelli edhe një nevojë më të diversifikuar për prerjen e apartamenteve si dhe të mënyrës së përdorimit të banesave. Bazuar në këto projeksione, plan i strehimit propozon shitimin në numër dhe sidomos në prerje dhe përdorime të banesave duke parashikuar rritje të banesave që do të përdoren me qera si dhe futjen e formave të reja të të banuarit si *Co-Living* dhe *Shared common space*. Këto forma të të banuari janë veçanërisht të përshtatshme për familjet e reja dhe për personat që për arsye pune, transferohen për perjudha të shkurtra kohore në Shkodër. Kjo lloj përqasje ndaj strehimit pritët të jetë veçanërisht efektive në kushtet aktuale të një tregu pune gjithë e më të hapur dhe ndërkombëtar i cili kërkon gjithnjë e më shumë fleksibilitet.

Për sa i takon strehimit të ofruar nga tregu i lirë, plani, duke u bazuar në konceptin e policentrizmit propozon forcimin e qendra ekzistuese duke me synim përdorimin më eficient të hapësirës, infrastrukturës dhe shërbimeve. Në veçanti, disa prej qendrave shihen si zona me prioritet zhvillimi urban.

Zona e Qendrës së Shkodrës e cila përfaqëson një nga pikat me përqëndrim më të lartë të shërbimeve dhe mbulimit me infrastrukturë, propozohet të jetë zonë me prioritet zhvillimi urban. Kjo zonë ofron mundësi për shtimin e ofertës së strehim i cili do të karakterizohet edhe nga shtimi i hapësirave publike sipas specifikimeve të KSHP në pasaportat përkatëse.

Zona Buzë Liqeni e sila do të zhvillohet pjesërisht për qëllim strehimi do të jetë një tjetër zonë me prioritet zhvillimi urban. Karakteri i zhvillimit urban në këtë zonë do të jetë i tillë që të lejojë një shkrirje sa më natyrale ndërmjet qytetit dhe zonës natyrore.

Strehimi Social

Ky program synon te ofroje mundesi strehimi edhe persa i takon politikave sociale dhe atyre grupeve te cilet per nje arsye apo tjetet futen ne grupin e atyre banoreve te cilet nuk mund te perballojne dot cmimin e nje banese ne kushtet e soteme te tregut.

Per kete arsye Plani i Pergjithshem Shkoder parashikon te adresoje keto politika ne dy drejtime baze, a) nevojat e lidhura me pa-pershtatshmerine fizike te baneses ne te cilen jetojne dhe b) nevojat e lidhura me situatat dhe nevojat social ekonomike te banoreve.

Nevojat Hapersinore

Politika e pare pasqyrohet me teper si nje 'opus-operandi', dhe perpiqet te jape nje zgjidhje te qendrushme per strehim atyre shtresave te popullsisë te cilat ligjerisht jane vulnerabel.

Ketu po flasim per ato banesa/godina te cilat jane ngritur ne menyre informale dhe per nje arsye apo tjetet nuk plotesojne kriteret e legalizimit. Sipas "Strategjise se Strehimit Social 2016 -2025" te miratuar se fundi nga Ministria e Zhvillimit Urban (2016), programi synon orientimin e politikave te strehimit ne baze te nevojave paresore te banoreve, duke shenjestrimit grupet me vulnerabel, si grate e keqtrajtuara etj. Bashkia Shkoder do te luaje nje rol kryesore ne integrimin e termit vulnerabel gjithashtu edhe te asaj popullsisë e cila paraqet dobesi ne procesin e marrjes se nje prone ne menyre te ligjshme.

Sipas të dhënave statistikore të Bashkisë Shkodër nga viti 2005 – 2014, 1882 familje kanë shpallur kërkesë për mbështetje nga politikat e Strehimit Social. Me Reformën e Re Administrative Ligji 115/2014) kjo Bashki ka pësuar një rritje të popullsisë me gati dyfishimin e numrit dhe si pasojë rritjen e nevojave për trajtim të veçantë me politikat e Strehimit Social gjithashtu edhe ato komunitete (komuna) të cilat deri dje nuk ishin pjesë përbërëse e Bashkisë Shkodër.

Nevojat me karakter social

Ne kushte te nje veshtiresie financiare per te ofruar banesa sociale Bashkia Shkoder do te aplikojte politika kushtezuese per sektorin e ndertimin qe synon investim mbi 7 kate godine. Duke aplikuar keto politika Bashkia Shkoder do ta kete me te lehte te garantoje burimet financiare, duke i hapur rruge politikave te strehimit qe shenjestojne se pari problematikat sociale - para te ardhurave dhe 'perballueshmerise' ekonomike qe keta banore perfaqesojne. Ne rast se pika 'nevojat hapesinore' eshte nje faktor qe ndikohet nga vendosja fizike e objektit, 'nevojat sociale' ndikohet nga faktore te disniveleve social - ekonomike ndermjet banoreve te te njejtës Bashki. Me hartimin e ketij programi, Bashkia Shkoder ne 15 vitet e ardheshme do jete e kujdeshme te hartojte nje seri masash dhe

progreamesh qe identifikojne levizjet nder vite te disniveleve sociale dhe ekonomike. Hartimi i ketyre progreameve eshte ne perputhje te plote me Strategjine e Ministrise se Zvillimit Urban mbi strehimin.


Nëpërmjet Strategjisë synohet zhvillimi i kapaciteteve të 61 njësive vendore për sigurimin e njohurive rreth kërkesës dhe ofertës për strehim social në mënyrë periodike; përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e qasjes në strehim të 50% të familjeve në pozita të pafavorizuara; bashkërendimi i përpjekjeve midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor, për përmirësimin e procesit të shpërndarjes së strehimit në 61 njësitë vendore; sigurimi i marrëveshjeve të Partneritetit Publik-Privat (PPP) për përmirësimin e alternativave të strehimit social dhe rritjen e numrit të familjeve përfituese me 20% si dhe zgjerimi i alternativave të strehimit, përmes progreameve të orientuara për familjet me të ardhura të ulëta e të mesme dhe kryesisht ato të pafavorizuara me 30%. Bazuar në dy analizat e mësipërme nëpërmjet PPV Shkodër është parashikuar ofrimi i strehimit social në dy mënyra:

- Mënyra e drejtpërdrejtë e ndërtimit të banesave sociale
- Mënyra e financimit të banesave sociale me anë të progreameve të intenstitetit me kushte në zona specifike.

3.9.3 Tipologjitë e propozuara hapësinore, bazuar në përcaktimet e zonave/njësive për dendësim, rigjenerim, rizhvillim, konsolidim, konservim, urbanizim.

Tipologjitë hapësinore janë një fushë komplekse studimi, e cila bazohet në dy komponentë kryesorë: Si të kategorizojmë në mënyrë ezauruese (ose pothuajse të tillë) trajta dhe marrëdhënie të ndryshme mes vendbanimeve, ndërtesave, zonave, hapësirave, etj, dhe si të përdorim këto kategorizime për çështje të planifikimit e zhvillimit në nivel vendor, e më gjerë. Në thelb, ***një tipologji është një grup objektesh*** (ndërtesa, fshatra, segmente rrugore, individë, etj) ***me një apo disa karakteristika të përbashkëta***. Kështu psh. një grup ndërtesash të tipit kullë, me lartësi 5-8 kate, përbëjnë një tipologji. Gjithashtu, një grup fshatrash të shtrirë linearisht në lidhje me një rrugë kryesore formojnë një tipologji. Edhe një zonë me rrjet rrugor kuadratik përbën një tipologji të caktuar. Duke evidentuar këto grupime karakteristikash, nëpërmjet studimit shumështrësor, ne mund të arrijmë në konkluzione sasiore, apo cilësore, të aplikueshme për to në mënyrë të përgjithësuar.

Përsa i përket territorit të Bashkisë Shkodër, ka një ndarje të qartë midis vendbanimeve rurale dhe atyre urbane. Gjithashtu, një element tejet i rëndësishëm i marrë në konsideratë është edhe kufiri urban-rural. Në këtë kontekst, në bashkinë Shkodër janë gjetur:



Në këtë kontekst për të promovuar tipologji urbane sa më të ndërlidhura dhe më eficiente të cilat promovojnë një cilësi të lartë jetesë janë përcaktuar dhe ndërhyrjet në territor të cilat ndodhin në bazë njësie:

- **“Dendësim”** është procesi i rritjes së dendësisë së ndërtimit në një territor të caktuar.
- **“Konservim”** është procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar, në formën e tij ekzistuese/originale.
- **“Konsolidim”** është procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës dhe strukturës urbane ekzistuese duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara
- **“Rigjenerim/ripërtëritje”** është procesi i përmirësimit të kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori apo ndërtimi.
- **“Rizhvillim”** është procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një zonë, e cila është e ndërtuar, por e degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore.
- **“Urbanizim”** është një ndryshim i popullsisë dhe territoreve nga rurale në urbane, rritja graduale e përqindjes së popullsisë që jeton në zonat urbane dhe mënyrat në të cilat çdo shoqëri i përshtatet këtij ndryshimi.

Duke u bazuar edhe në eksperiencën e qyteteve të ndryshme botërore në lidhje me planifikimin e territorit dhe ofrimin e tipologjive urbane cilësore, janë evidentuar një sërë tipologjishë, të cilat më pas kanë shërbyer si shembull dhe përshtatur për propozimet tipologjike për Bashkinë Shkodër. Këto tipologji janë gjithashtu një udhëzues edhe për bashkinë gjatë fazës së implementimit të planit apo edhe të hartimit të PDV-ve për të arritur një cilësi urbane të lartë dhe të dëshirueshme.

1. Banesa Mono Familjare, zona kryesisht gjysem-periferike dhe periferike

Intensiteti < 0.6

Karakteristikat: Ne kete kategori futen te gjitha ato banesa, te perbera nga femije, qe jetojne ne zona gati rurale por qe kane lidhje te ngushte me qytetin. Siguria e femijeve dhe e pronese gjithashtu per keto popullsi eshte shume domethenese. Ne keto zona ka pak hapësira publike, edhe aktivitetet jane te llojit te biznesit te vogel, si restorante dhe minimarkete.

Strategjia nr.1: Nxitja e Zhvillimit Komunitar.

Duke marre ne konsiderate formen fizike, nje nder strategjite te cilat mund te aplikohen eshte ajo e forcimit te ndjenjes komunitare dhe intimitetit ndermjet banoreve te ketyre zonave. Rrethimet e banesave te hapura jane nje celes I ketij suksesi e ku bashkepunimi ne fqinjesi tenton te rritet. Ne rastet kur keto banesa jane te rrethuara vendosja e dhe krijimi I nje parku urban ne brendesi te ketyre lagjeve do te jepte rezualtatin e deshiruar.

Strategjia nr.2: Nxitja e Integrimit me qytetin.

Ashtu si nxitja e bashkepunimit ne nje zone te percaktuar perkon me formen fizike dhe urbane te ketyre zonave ashtu edhe nevojshmeri per te lidhur keto lagje me qytetin rriten. Pra strategjia e perforecimit te brendshem kerkon paralelisht edhe nje strategji te hapjes. Per te realizuar kete strategji eshte e domosdoshme qe nyjet kryesore te rrugëve te lidhin keto zona/ lagje me qendren e qytetit ne menyre sa me te bute dhe te shpejte – te cilen mund ta mundesoje pista e nje biciklete, transporti urban, trotuare te gjere etj. Te gjithë keto elemente jane te rëndesishem per keto lagje dhe per perforecimin e cilesise se jetes. Nje fokus te vecante ne keto zona duhet me marre edhe lidhja e lokale/restoranteve me keto akse rrugore te pajisur me elementet e lartepemundur ne menyre qe te gjenerojne rritje ekonomike dhe integrim social. Eshte e rëndesishme gjithashtu qe mungesa e hapësirave te gjelberta te zevendosohet nga dedikimi I hapësirave per integrim social, I lartepemundur, ne menyre qe te rritet cilesia e jeteses.






Hapesirat publike e private. (infrastruktura)

Ne keto lagje sistemi rrugore eshte i perbere nga rruge te ngushta pergjithesisht, dhe ndohere gjarperteshe. Eshte e rendesishme qe nderyhjet e ardheshme ne sistemin rrugore, por edhe ate private (parcelat), te marrin ne konsiderate disa probleme, si: fragmenetimin e perdorimin ineficent te tokes dhe shperdarjen e rretit infrastrukture te padrejte hapesine ndermjet parcelave te te njejtit bllok.


Tipologjia e Banesave

Ne keto zona kryesisht perfaqesohen nga banesa monofaljare ku numri maksimal i dhomave nuk i kalon 4 deri ne 5. Pergjithesisht keto banesa jane te shoqeruara nga godina ne funksion te banesese si, garazh dhe depo. Godinat ne funksione te baneses dallojne nga godinat aktivitet, pasi te parat jane te shkeputura nga rruga dhe nuk komunikojne direkt me te, ndersa aktivitetet kane dalje direk ne rruge.



Hapesirat/Godinat ne sherbim publik (private e publike)

Ne kete kategori futen te gjitha ato objekte, parcela, apo hapesira te ndermjeteme, publike dhe jo vetem te cilat luajne nje rol primare ndaj publikut apo klienti. Ofrimi i ketyre elementeve mbetet eshte i rendesishem per krijimi e vendeve te integritit social dhe nxitjen e shumllojshmerise ekonomike.



2. Apartamente Urbane ne zonat te gjelberta

Intesiteti $0.6 < x < 1.5$

Karakteristikat: Ne kate kategori futen te gjitha ato komponente jo domosdoshmerisht familjare dhe femijet e tyre por grupet perberese jane banore me hapësira te perbashketa ne bashkemenaxhim. Ne keto kategori futet nje mix social, ne moshe, dhe menyra jetese te ndryshme. Persa I takon hapësirave publike dhe te gjelberta lidhja e tyre me keto banesa apartamente mbetet shume I rendesishem dhe perkrah ketij elementi shtohet edhe nevoje per sherbime me karakter publik dhe ne sherbim te popullsise kaq mixe. Ne rast se do te kerkonim nje forme fizike te godinave ne keto lagje me intensitetin e lartepmendur do te dallonim 2 forma mbizoteruese.

A) Banesa ne hapësira te gjelberta (gjurme katror)

Banesat e ketij lloji tentojne te formojne ne gjurmen e tyre hapësira te medha e te gjelberta ne hapësirat e ndermjeteme – duke krijuar hapësira publike per qellim publik e te shfrytezueshme ne pjesen me te madhe nga vete banoret e ketij blloku banesash.

B) Banesa ne bllok me kende te hapura (gjurme steke)

Banesat me kende te hapura, ose gjurme steke, ndryshe nga A) formojne hapësira te gjelberta e publike te aksesueshme thjeshte nga rruga duke lejuar penetrimin nga njera rruge ne tjetren permes bllokut ne forme steke.

Persa I takon perzgjedhjes ato do te perkufizoheshin me dy prioritete te ndryshme,

A) eshte me thjeshte e aplikueshme aty ku blloku i banesave eshte I mire pajisur me sistem rrugore, ndersa B) aty ku sistemi rrugore humb qendersine dhe shtrihet drejte periferise. Te dyja keto forma urbane nxisin bashkeveprimin dhe mireqenin sociale ne lagjet ku keto banesa marrin keto forma.




Hapesirat publike e private. (infrastruktura)

Keto lloje blloqe banesash jane te lidhura kryesisht ne menyre te njetrateshme me sistemin rrugore, here duke lidhura me bulevarde kryesore te qytetit e here me rruge pershkruese te gjata. Hapesirat publike ne keto blloqe banesash kane rol gjysem private, pasi jane kryesisht ne sherbim te banoreve.

Funksiione


Ne kete katogori futen blloqe shtepiash te perbera ne apartamente, jo me shume se 6. Pervec siperafaqeve te mbuluara per funksion aktiviteti apo banese keto blloqe shtepiash duhet te jene te plotesuara me godina ne funksion te tyre, si vendgrumbullimi mbeturinash, parkinge bicikletash e motorrash gjysem te mbyllur etj.



Hapesirat ne sherbim publik (private e publike)

Hapesirat e ndermjetme te banesave ne llojin A), si pershkruar me siper, nuk projektohen per te lene hapësira te ndertueshme ne te ardhmen por per perdorim te hapësirave semi-private qe keto blloqe banesash krijojne.

Persa i takon banesave llojit 'steke', lloji B), hapësirat e ndermjetme luajne te njeitin rol gjysem privat e me funksione per banoret perreth, si kende lojrash, aktivitetesh social kulturore etj.



1. Qyteti Miks në Brëndësi.

Intesiteti $1.5 < x$

Karakteristikat:Keto blloqe godinash shtrihen kryesisht ne qender te qytetit dhe jane te dominuara nga nje numer i larte sherbimesh, si shkolla, spitale, etj.

Ne kete teresi mbizoterojne aktivitetet e lloji biznes, tregti, sherbime ndaj biznesit / klientit, zyra etj. Me rritjen e intesitetit ne kete rast nuk do te kuptojme medoesmos rritjen edhe te banoreve, por te gjithë asaj teresie qe ka te beje me banore ditore, si turist, kliente, punetore ne administrata e nxenes shkolle.

Ne kete teresi kaq mikse eshte e rendesishme te dallojme dy perberes se qendres.

a) Qyteti Historik | b) Qyteti Tregtar.


A) Qyteti Historik:

Qyteti Historik shtrihet kryesisht ne pjeset me qendrore te qytetit dhe mbart nje vlere kulturore dhe turistike te pazevendesusheme per qendren. Nese qyteti tregtar ne qender terheq banore potencialisht te qytetit dhe zonave perreth ai historiku terheq 'banore' me kombesi te huaj, si turistet. Nderthurja e ketyre dy kulturave eshte e rendesishme per mbijetesen e seciles nga to. Nderthurja arkitektonik i ketyre dy 'qyteteve' duhet te jete i tille qe te mos cenoje keto vlerat kulturore / historike te vlefshme po ashtu edhe ne aspektin ekonomik te qytetit. Aksesueshmeria dhe promovimi i ketyre vlerave mbeten pika e forte ne te cilen projektet e te ardhmes duhet te perqendrohen.

B) Qyteti Tregtar:

Qyteti Tregtar, po ashtu si edhe ai historik, mbivendosen ne qender te qytetit, por kriteret e pozicionimit te tyre ndryshojne nga konteksti historik i vete qytetit.

Qyteti tregtar, duke ditur llojin e banoreve qe terheq, duhet te garandojne ose plotesoje disa kritetere, si afersia nga hapesirat e medha publike, rruge/bulevarde, sheshe etj - kjo per arsye per te mos kthyer qytetin te jetueshem vetem gjate dites, kur keto aktiviteteve jane hapur, por edhe gjate orareve te ndryshme.






Hapesirat publike e private. (infrastruktura)

Rrjeti infrastrukturore ne keto blloqe godinash eshte i shpeshte dhe boshtor - me funde qe lidhin godinnat me rendesi te vecante per qytetin.

Dominojne kryesisht aktivitetet pergjate rrugeve/bulevardeve dhe mbi to ngirhen zyra dhe banesa. Sistemi i parkingeve eshte i plotesuar kryesisht nga katet perdhe apo parkinge ne nivel, ndersa rruget u japin kryesisht prioritet kembesoreve, klienteve, dhe turisteve.


Koeficienti i Shfrytëzimit te Tokes (K.SH.T)

Numeri i kateve ne keto banesa arrin nje lartesi mesatare nga 20 deri ne 25 metra, dhe lartesia e kateve nuk i kalon te 7 katet e me perjashtim ato godina qe arrijne deri ne 9 kate por qe kane nje shumllojshmeri perdorimesh dhe funksionesh.(e drejta per zhvillimi me kusht). Parkingjet ne katet perdhe, dhe banesat per qellime te strehimit social jane format me te perhapura te perballjes se mix te banoreve te ndryshem qe qyteti gjeneron dhe terheq.



Hapesirat ne sherbim publik (private e publike)

Ne keto blloqe godinash aktivitet dhe sherbimet e ndryshme ndodhen te shkrira me gjurmen e godinave shume funksionale, dhe ralle here te shkeputura. Po ashtu e vogel eshte edhe hapesira publike, ndersa vete keto godina marrin funksionin e atraksionit si per kalimtarete por edhe per qytetin.



3.9.4 Përcaktimi i Planeve të detajuara vendore dhe Termat e Referencës për Planet e Detajuara Vendore

Në bashkinë Shkodër janë përcaktuar një sërë njësish strukturore për tu zhvilluar nëpërmjet planeve të detajuara vendore.

Termat e referencës për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore bazohen në vkm 671, dt 29.07.2015, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", seksioni 8 Plani i Detajuar vendor, nenet 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70. Zonat dhe njësitë për të cilat hartohen plane të detajuara vendore janë përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër.

Procesi i hartimit të PDV-së koordinohet nga kryetari i Bashkisë, i cili është edhe autoriteti përgjegjës për hartimin e planit. Plani i detajuar vendor (PDV) me nismë publike hartohet nga grupi i punës mbi bazën e planit të miratuar të veprimeve. Grupi i punës është i përbërë nga specialistë të Bashkisë Shkodër, institucioneve publike në varësi dhe ekspertë të fushave të ndryshme, vendës apo edhe të huaj. Grupi i punës për hartimin e PDV-së, me nismë publike, ngrihet me vendim të kryetarit të njësisë vendore.

Edhe në rastet kur PDV-ja hartohet me nismë private, procesi i përzgjedhjes së ekspertëve, pjesë e grupit të punës, duhet të bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe transparent, me qëllim përzgjedhjen e konsulencës më të mirë.

Hartimi i planit konsultohet rregullisht me Forumin Këshillimor të PDV-së, të ngritur pranë njësisë vendore, vullnetarisht apo me kërkesë të posaçme të kryetarit të njësisë. Forumi Këshillimor i PDV-së përbëhet nga përfaqësues të grupit të interesit nga zona/njësia, përfaqësues të akademisë dhe të shoqërisë civile.

Plani i Detajuar Vendor mund të hartohet për të gjithë njësinë/zonën e përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, ose për një grup njësish ose zonash në rast se ato janë pranë njëra tjetrës në mënyrë që të ketë një veprim sa më të harmonizuar e koordinuar midis tyre.

Ndërkohë, PDV mund të hartohet për të gjithë njësinë ose për një pjesë të saj. Në këtë rast, grupi i punës të përcaktuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, fillimisht në konsultim me Forumin Këshillimor dhe grupet e interesit bën shpërndarjen e Koefficientit të Shfrytëzimit Publik dhe Koefficientit të Shfrytëzimit të Rrugëve në nivel njësie. Shpërndarja e këtyre dy koefficientëve shërben për përcaktimin hapësirës subjekt i hartimit të PDV.

Kjo procedurë aplikohet edhe në rastet e hartimit të PDV me nismë private. Pra fillimisht duhet të kryhet shpërndarje e dy koeficientëve dhe më pas të vijohet me nëndarjet për qëllime hartimit të PDV me faza. Nëndarjet e reja duhet të jenë midis 1.5-4 hektarë.

Më pas vijohet me procedurat përkatëse të specifikuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në lidhje me përmbajtjen e PDV-së dhe hapave të miratimit e konsultimit. Në rastin e PDV-me faza secila fazë mund të miratohet më vete.

Përmbajtja e dokumentit të PDV-së:

Dokumenti i Planit të Detajuar Vendor (PDV) bazohet në dokumentin e planifikimit vendor, dokumentet e planifikimit vendor sektorial dhe legjislacionin në fuqi. Dokumenti i PDV-së përmban:


- dokumentin e analizës për zonën/njësinë;
 - strategjinë e zhvillimit të zonës/njësisë;
 - propozimin me përcaktime territoriale;
 - rregulloren e PDV-së;
 - vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin e PDV-së (studimin e fizibilitetit);
 - hartat që shoqërojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e secilës prej pikave më sipër, në shkallën që varion nga 1:500 në 1:2,000, në përputhje me madhësinë e zonës;
 - relacionin e propozimeve të planit;
 - studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis;
 - planin e veprimeve dhe investimeve për zbatimin e PDV-së;
 - indikatorët për monitorimin e zbatimit të PDV-së;
 - në rastet e PDV-së me nismë private, dokumenti i PDV-së përmban edhe kontratën e bashkëpunimit mes palës private të interesuar për hartimin e PDV-së dhe autoritetit përgjegjës për hartimin e PDV-së.
- ***Dokumenti i analizës përmban:***
 - hartat në shkallë 1:500 ose 1:2,000 në varësi të sipërfaqes së zonës/njësisë përkatëse, që prezantojnë rilevimin teknik të topografisë, hapësirave, përdorimeve, parcelave, objekteve dhe infrastrukturave në zonë, emërtimet, dimensionet, si dhe kufirin e saj;
 - dokumentim të detajuar fotografik të zonës/njësisë;
 - hartën shoqëruar me listën e pronarëve të parcelave dhe objekteve dhe të gjitha të dhënat për çdo pronë sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme;
 - relacionin me rregullat dhe hartat që tregojnë zonat dhe strukturat e mbrojtura, nëse ka të tilla, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjedisin dhe për trashëgiminë kulturore;
 - analizën e detajuar të problemeve mjedisore, të peizazhit dhe të infrastrukturave, në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor apo planeve vendore sektoriale;
 - analizën e cilësisë së objekteve ekzistuese dhe të nevojave për rigjenerim, konservim apo mirëmbajtje.
 - ***Propozimi me përcaktime territoriale me komponentët:***
 - relacionin dhe hartat për planin e propozuar të përdorimit të tokës pas riorganizimit të parcelave përmes ndarjes dhe/ose bashkimit. Përdorimi i tokës paraqitet për kategoritë bazë, nënkategoritë dhe për funksionet apo aktivitetet sipas shpërndarjes së tyre në parcela dhe në çdo objekt;

- relacionin dhe hartat për planin e propozuar të të gjitha infrastrukturave të nevojshme kryesore dhe dytësore në zonë, përfshirë parkimin;
 - paraqitjen grafike të propozimeve për të garantuar akses dhe përdorim të barabartë dhe të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat;
 - përcaktimin në hartë dhe argumentimin në relacion të objekteve që do të shemben dhe atyre që do të rigjenerohen dhe/ose do të restaurohen;
 - paraqitjen volumetrike dhe gjurmën e objekteve/strukturave të parashikuara;
 - paraqitjen e detajuar në relacion dhe në hartë të shpërndarjes së intensitetit të ndërtimit dhe të koeficientit të shfrytëzimit të tokës për çdo parcelë, si dhe të distancave dhe lartësive të objekteve në përputhje me rregulloren e zhvillimit;
 - mënyrën e zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në përputhje me ligjin dhe me rregulloret përkatëse.
- *Rregullorja e PDV-së përmban:*
 - përkufizimet e termave të përdorur;
 - shpjegimin e kodeve të përdorura për: - kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës; - sistemet/zonat/njësitë; - kode të tjera sipas rastit.
 - normat, treguesit dhe standardet e zbatueshme të planifikimit, sipas kësaj rregulloreje;
 - rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, që përfshijnë, të paktën: - normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi; - normat, standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike dhe mjedisore, nëse ka elemente të tilla në zonë;
 - përcaktimin e vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu), nëse ka elemente të tilla në zonë.
 - rregullat për zhvillimin e njësisë/zonës që përmbajnë, të paktën: - kushtet e zhvillimit; - kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës; - aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës; - përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse.
 - të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private, që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit;
 - rregullat e nëndarjes dhe të bashkimit të parcelave në çdo njësi;
 - rregullat e sistemit rrugor dhe transportit që përmbajnë, të paktën: - përcaktimin dhe përshkrimin e kategorive të rrjetit rrugor në përputhje me legjislacionin e posaçëm; - kushte teknike dhe përmasat; - parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit, sipas legjislacionit të posaçëm; - përcaktimin e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë anëve të trupit të rrugës;
 - rregulla arkitektonike, sipas rastit;
 - rregullat për përdorimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”.

Në përputhje me pikën 14, të nenit 22 të ligjit, procesi i hartimit të PDV-së shoqërohet nga përgatitja e studimit paraprak të fizibilitetit, ku llogariten përqindjet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kostot dhe kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

3.10 Masat për Trashëgiminë Kulturore dhe Historike

Bashkia Shkodër ka në territorin e saj një numër të konsiderueshëm veprash të trashëgimisë kulturore dhe historike. Kryesisht ato shtrihen në territorin e qytetit të Shkodrës, pjesë e të cilit është shpallur edhe si qendër historike:




Mbi 90% e tyre janë monumente të kategorisë së parë, ndërkohë që pjesa tjetër të kategorisë së II. Në vitet e fundit ka pasur disa iniciativa për restaurimin e këtyre monumenteve, ku dallon veçanërisht investimi në pedonalen e Shkodrës si dhe në rrugën Gjuh'a'Dol. Këto investime kanë ndihmuar edhe në përmirësimin e imazhit të qytetit dhe tërheqjen e shumë vizitorëve. Gjithashtu, ato kanë ndihmuar dhe në zhvillimin e bizneseve lokale.

Në territorin e bashkisë Shkodër ka 2 monumente “vendbanime” të kategorisë së parë si dhe tre monumente “vepra arti” të kategorisë së parë. Gjithashtu ka disa 2 monumente të varrezave dhe disa zonifikime të rëndësishme arkeologjike. Në fund ka dhe 11 monumente “ndërtesa të projektuara” të cilat janë të kategorisë së parë dhe të dytë.

Në territorin e bashkisë Shkodër janë të pozicionuara edhe zona Arkeologjike “A” dhe Zona Arkeologjike “B”. Të gjitha ndërhyrjet në këtë zonat arkeologjike duhet të bazohen në ligjet sektoriale në fuqi.

Rekomandime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore:

- Mbrojtja e monumenteve të kulturës dhe atyre historike është e nevojshme për të ruajtur trashëgiminë historike dhe arkitektonike të Shkodrës.
- Mbrojtja e këtyre monumenteve do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9048, datë 07.04, 2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”. Të gjitha ndryshimet apo rinovimet e strukturave të trashëgimisë duhet të bëhen pasi të jetë marrë leja nga strukturat kompetente sipas Ligjit.
- Njësitë strukturore monumente përcaktohen në planin e përgjithshëm dhe mënyra e ndërhyrjes në to përcaktohet nga kjo rregullore. Në rastet kur e lejon Plani i Përgjithshëm dhe legjislacioni në fuqi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, një ndërtim i ri që bëhet ngjitur me struktura të veçanta monumente duhet:
 - Të theksojë vlerën arkitektonike të strukturës monument;
 - Të ndërtohet në një distancë të mjaftueshme nga struktura monument, që kjo e fundit të mbetet normalisht e perceptueshme ;
 - Struktura e re mund të jetë në kontakt/i takuar me një strukturë monument, vetëm nëse kjo ka një mur kallkan, i cili që në fillim, është menduar të fshihet, mbulohet nga një strukturë ngjitur me të.
- Në rastet e lejuara nga Plani i Përgjithshëm dhe legjislacioni në fuqi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, zgjerimi i një strukture monumentale duhet:
 - të ruajë aspektin monumental të strukturës,
 - Të mos jetë më i lartë se vija horizontale e fasadës së monumentit.
 - Të ruajë arkitekturën e godinës monument dhe të jetë e konceptuar si një arkitekturë e pavarur, e lidhur në pika të caktuara me të. Lidhjet duhet të jenë të tilla që të ruajnë koherencën arkitektonike të strukturës monument.
 - Të respektojë vijat e ndërtimit të rrugicave dhe të rrugëve siç përcaktohen në PPV ose PDV.
- Rekomandohet përmirësimi i aksesit në infrastrukturë dhe përfshirja e monumenteve të kulturorës dhe historisë si pjesë e guidave turistike
- Zbatimi i projektit të “quartierit të muzeve” është një projekt pilot i cili mund të hapë udhën për zhvillimin e një mori projektesh të tjera të cilat kanë si synim promovimin e trashëgimisë historike e kulturore



Kapitulli 4- Plani i Investimeve Kapitale

Ndërsa qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është instrumentalizimi i mekanizmave të vlefshëm dhe të qëndrueshëm të menaxhimit financiar të përkthyer në projekte kapitale zhvillimi, realizimi i të cilave do të mundësojë:

1. garantimin e mekanizmave të nevojshëm përmes të cilave objektivat prioritare të identifikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë të integrohen sa më mirë në procesin e planifikimit
2. krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta midis projekteve kapitale prioritare dhe prioriteteve në kryerjen e shpenzimeve nëpërmjet shpërndarjes efektive të burimeve në dispozicion
3. parashikim më të mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë disa vjeçare për të gjitha programet e shpenzimeve
4. inkurajimin e parimit të vlerës së parashë nëpërmjet efektivitetit dhe efikasitetit ekonomike në kryerjen e shpenzimeve publike
5. forcimin e disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal

Gjithashtu, për përcaktimin e prioriteteve është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm me komunitetin si e vetmja mënyrë për të përfaqësuar dëshirat e tij në këtë plan. PIK është hartuar për periudhën e planit të përgjithshëm vendor por ai do të rishikohet çdo vit duke patur parasysh ndryshimin e prioriteteve, mundësive të financimit, ndryshimin e bazës ligjore etj. Në mënyrë që PIK të bëhet një instrument legjitim dhe i zbatueshëm, miratimi i tij nga Këshilli Bashkiak është një

domosdoshmëri. Ky dokument hartohet në mënyrë që t'i shërbejë stafit të Bashkisë për ta ndjekur dhe zbatuar planin, dhe Këshillit Bashkiak dhe komunitetit për ta monitoruar administratën bashkiake për përdorimin e fondeve, nivelit të shërbimeve të ofruara dhe përfshirjes së tyre përgjatë gjithë procesit.

Për hartimin e PIK janë përdorur të dhëna të historikut financiar të Bashkisë, paketa fiskale, buxheti afatmesëm, strategjia e Qarkut Shkodër, etj. Njëkohësisht është marrë në konsideratë edhe kuadri ligjor përkatës për financat vendore dhe konkretisht:

- Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 10190, datë 26.11.2009 "Për Buxhetin e vitit 2010"
- Udhëzimi nr. 20/1, datë 26.02.2009 "Për përgatitjen e buxhetit vendor"
- Udhëzimi nr.7/1, datë 22.02.2010 "Për përgatitjen e buxhetit vendor"
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore"
- Udhëzimi nr.35, datë 5.11.2008 për zbatimin e ligjit nr. 9869 datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore"
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore"
- Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 "Për disa ndryshime në Ligjin 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore"
- Ligji nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".
- Ligji nr. 9931, datë 09.06.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".
- Ligji nr. 10117, datë 23.04.2009 "Për disa ndryshime ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar".
- Ligji nr.10146, datë 28.09.2009 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar".
- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

4.1 Vlerësim mbi PIK

Plani Investimeve Kapitale është një instrument planifikimi disavjeçar, i cili identifikon të gjitha investimet kapitale të cilat do të kryhen nga Bashkia brenda kësaj periudhe, kohën e kryerjes së tyre dhe burimin e financimit për çdo investim në mënyrë që të maksimizojë përfitimin e qytetarëve. Fokusi i Planit të Investimeve Kapitale është të krijojë një mjet për të lehtësuar vendimmarrjen në nivel lokal, duke bërë të mundur përdorimin e burimeve në dispozicion në mënyrën më të mirë të mundshme. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një procesi transparent duke:

- përfshirë departamentet e bashkisë në përgatitjen dhe justifikimin e projektpropozimeve të projekteve kapitale
- vendosur prioritetet dhe lidhur burimet financiare me shpenzimet e projekteve
- u konsultuar me komunitetin dhe Këshillin Bashkiak për marrjen e vendimeve

Plani i Investimeve Kapitale, përveç llojit dhe natyrës së investimit, adreson:

- synimin e Bashkisë për çdo investim kapital të planifikuar për t'u kryer
- lidhjen e tij me prioritetet e komunitetit dhe ndihmon në balancimin e nevojave me mundësinë për të paguar
- përfituesit dhe përfitimin nga realizimi i investimit kapital
- vlera / çmimi / kostoja e investimit
- burimin e financimit të tij
- periudhën e financimit për secilin projekt
- kohëzgjatjen e secilit projekt
- impaktin në zonën ku kryhet investimi

Pavarësisht se Planit i Investimeve Kapitale hartohet për periudhën e planit, ai është subjekt rishikimi cdo vit nga ana e Bashkisë në mënyrë që të reflektojë sa më mirë nevojat dhe prioritetet. Është e rëndësishme të theksohet se Planit i Investimeve Kapitale duhet rishikuar çdo vit edhe për arsye të inflacionit apo ndryshimeve në bazën ligjore, gjë që bën që vlerat e projekteve të veçantë dhe të të ardhurave të mos jenë ato që parashikohen sot.

Bashkia është duke përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm për vitet 2016-2019 (të ardhurat dhe shpenzimet sipas kësaj PBA-je janë marrë parasysh në hartimin e PIK). Përgatitja e këtij buxheti ndihmon për një planifikim të kujdesshëm në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkisë për vitet që vijnë. Në këtë mënyrë ky program ndihmon planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë hartimit të Planit të Investimeve Kapitale. Megjithatë, Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Planit i Investimeve Kapitale janë të ndryshëm në thelb. Ky ndryshim lidhet me faktin se nëse në projekt - buxhet shpenzimet kapitale planifikohen mbi bazën e shumës së fondeve në dispozicion për këto investime, pra mjetet monetare vendosnin "diktatin" mbi investimet kapitale, e kundërta ndodh me Planin e Investimeve Kapitale ku janë investime kapitale ato që diktojnë burimet financiare të Bashkisë.

4.2 Metodologjia dhe politikat për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale

Hartimi i metodologjisë së përgatitjes dhe zbatimit të Planit të Investimeve Kapitale ka qenë hapi i parë i punës. PIK është hartuar në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit dhe Planin e Zhvillimit të Bashkisë. Duke qenë se në këtë plan strategjik përcaktohen se cilat janë projektet prioritare, ato kanë qenë baza për hartimin e PIK. Gjithashtu gjatë punës grupi i ngritur për hartimin e PIK është bazuar në Manualin për Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale i përgatitur nga Co-PLAN gjatë vitit 2008. Fillimisht është bërë një analizë financiare për 3 vitet e kaluar. Kjo analizë ndihmoi grupin e punës në parashikimin e të ardhurave, për periudhën e PIK.

Gjithë grupi ka marrë pjesë në hartimin e politikave të këtij plani. Këto politika lidhen me:

- përcaktimin se cili do quhet një investim kapital. Megjithëse mund të ketë përcaktime të ndryshme të shpenzimeve kapitale, përgjithësisht është rënë dakord që shpenzimet kapitale përfshijnë:
 - ndërtimin dhe blerjen e ndërtimeve të reja, strukturave, faciliteteve, pajisjeve, mobiljeve, studimeve, zhvillimet dhe blerjen e tokës, dhe të gjitha sendet e tjera shoqëruese që i sjellin këto në funksionim
 - rehabilitimet thelbësore të këtyre më sipër
 - normalisht kanë një jetë të dobishme më shumë se një vit

Janë përfshirë në këtë plan edhe investimet për asete për funksionimin e përditshëm të Bashkisë si blerje kompjutera, fotokopje, printera, tavolina, rafte, makina etj. Arsyeja është se fondet e identifikuar për investime kapitale përfshijnë edhe fondet për këto lloj asetesh fikse.

- përcaktimin e periudhës së planit të investimeve kapitale.
- përcaktimin e përgjegjësisë për menaxhimin e planit (lehtësuesi)
- përcaktimin e formave të pjesëmarrjes qytetare
- përcaktimin e burimeve të financimit
- përcaktimin e kriterëve për prioritarizimin e projekteve kapitale
- përcaktimin e formatit të planit të investimeve kapitale


4.3 Analiza Financiare e Bashkisë

Për të kuptuar ecurinë e financave vendore në Bashkinë Shkodër, u përdorën të dhëna nga Ministria së Financave për periudhën 2010 – 2014. Arsyeja e përdorimit të këtij burimi, justifikohet me faktin se arrihen të sigurohen seri kohore për një periudhë pesë vjeçare për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore përbërëse të Bashkisë Shkodër. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel njësie administrative¹ në monedhë vëndase dhe për efekt analize u konsoliduan në nivel bashkie.

Performanca e të ardhurave totale të Bashkisë Shkodër rezulton të ketë patur luhatje të mëdha gjatë periudhës 5 vjeçare, me një rënie drastike në vitin 2013, dhe me një prirje përmirësuese nga ky vit e më tej. Burimet financiare totale (transferta ndërqeveritare dhe të ardhura të veta vendore) në dispozicion të Bashkisë Shkodër janë luhatur në nivelin 1.7 – 2.1 miliard lekë në vit gjatë periudhës 2010-2014. Në vitin 2014, të ardhurat totale shënuan nivelin e 2.1 miliard lekëve, një rritje me rreth 80.6% krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare të bashkisë së re Shkodër rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale.

Ato përfaqësojnë mesatarisht në pesë vitet në analizë rreth 78.4% të të ardhurave totale (mesatarja e dy viteve të fundit është 82.4). Përbërja e tyre ndaj totalit të të ardhurave ka ndryshuar në kahun rritës veçanërisht gjatë dy viteve të fundit 2013 dhe 2014. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare bën që planifikimi i investimeve kapitale rezulton të jetë subjekt dhe i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore. Ndërkohë, të ardhurat vendore kanë përfaqësuar mesatarisht rreth 21.6% ndaj totalit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër gjatë periudhës së konsideruar. Në ndarjen sipas njësive të qeverisjes vendore përbërëse, kontribuesi kryesor në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave është **ish-Bashkia** Shkodër e cila përfaqësoi mesatarisht 62.8% ndaj totalit të të ardhurave në pesë vitet në analizë. Ndër komunat pjesë e bashkisë Shkodër, evidentohet kontributi i rëndësishëm i njësive Rrethinat, Velipojë, Postribë dhe Gur i zi në performancën e të ardhurave totale. Në terma kumulativë këto katër komuna vlerësohet të kenë përfaqësuar mesatarisht rreth 22.7% të të ardhurave totale të Bashkisë së re Shkodër përgjatë periudhës 2010-2014.

Grafik 1 Kontributi i njësive administrative në ecurinë e të ardhurave totale (gr. majtas, në pikë përqindjeje); Kontributi sipas burimit në të ardhurat totale (gr. djathtas, në pikë përqindjeje)



Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të autorit

Pamjet grafike tregojnë për një varësi të lartë financiare të njësisë së qeverisjes vendore nga burimet ndërqeveritare dhe në veçanti transfertat e kushtëzuar. Varësia financiare bën që projektet për investime kapitale të jenë subjekt pothuajse tërësisht i vendimeve të qeverisë qendrore. Përdorimi i instrumentit të huasë bankare mund të jetë një mënyrë për të rritur autonominë financiare dhe për të realizuar investime kapitale por, kosto në terma interesash dhe mundësia e ri-pagimit të kryegjësë nuk duhet të rëndojnë planet e ardhshme për investime kapitale të njësisë së qeverisjes vendore.

Për periudhën 2010-2012, të ardhurat ndërqeveritare përfaqësuan mesatarisht 76.1% ndaj totalit të të ardhurave. Në dy vitet në vijim, pesha e tyre ndaj totalit u rrit në nivelin 82.1%, si pasojë e rritjes së të ardhurave në trajtën e transfertës së kushtëzuar (vlera më e lartë në vitin 2014). Pas rënies vjetore të shënuar në vitin 2013, të ardhurat ndërqeveritare vijuan të shtohen me ritme më të shpejta edhe në vitin 2014. Kjo kategori të ardhurash filloi të ngushtohet nga viti 2011 me rreth 10.9% në terma vjetorë në vitin 2011 dhe me rreth 16% në vitin 2012. Viti, 2013, shënon reduktimin në vlerën më të madhe në 5 vitet e analizuara me rreth 25.5% si rezultat i reduktimit të të ardhurave në trajtën e transfertës së kushtëzuar, të pa kushtëzuar dhe nga taksat e ndara. Kështu niveli i të ardhurave ndërqeveritare rezultoi të jetë rreth 2.1 miliard lekë në vitin 2014, më një rritje rreth 80.6% krahasuar nga një vit më parë.

Sipas elementëve përbërës së të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare, peshën kryesore e zënë të ardhurat nga transfertat e kushtëzuar (mesatarja e 5 viteve është 51.9%), pesha e së cilës ndaj totalit të të ardhurave ndërqeveritare rezultoi të ketë pësuar rritje përgjatë 5 viteve në analizë. Mesatarisht në pesë vitet e fundit, 54.7% e transfertës së kushtëzuar vjen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë. Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar përfaqësuan mesatarisht rreth 45.3% të të ardhurave ndërqeveritare gjatë pesë viteve në analizë. Të ardhurat nga taksat e ndara rezultojnë në një nivel

më të ulët ndaj totalit të të ardhurave ndërqeveritare krahasuar me nivelin e transfertës së kushtëzuar dhe asaj të pakushtëzuar.

Pavarësia financiare e Bashkisë Shkodër, matur si raport it ë ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale, rezultoi mesatarisht 24.7% për pesëvjeçarin 2010-2014. Raporti i të ardhurave vendore ndaj të ardhurave totale përgjatë kësaj periudhe rezultoi të jetë reduktuar nga viti 2011 deri në vitin 2012 (21.9%) dhe të jetë rritur në vitin 2013 dhe 2014 (nga 23.7% deri në 73.7%).


Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më madhe nga performanca e taksave dhe tatimeve vendore. Pas një zgjerimi me rreth 4.7% në vitin 2011, të ardhurat vendore u tkurrën ndjeshëm në vitin 2013. Në vitin 2013, performanca negative e të ardhurave vendore u udhëhoq nga tkurrja e të ardhurave nga taksat dhe tatimet vendore, përkatësisht të ardhurat nga *taksa vendore mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin)*, *taksa vendore e ndikimit të infrastrukturës nga ndërtimet e reja dhe legalizimet*, dhe *tatimi mbi tokën bujqësore*. Viti 2014 rezultoi me zhvillime pozitive në terma të të ardhurave vendore të cilat shënuan rritje me rreth 80.6% në terma vjetorë nën kontributin pozitiv të tre kategorive kryesore përbërëse. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet vendore u rritën në terma vjetorë gjatë vitit 2014 nën kontributin pozitiv dhe në rritje të të ardhurave nga *tatimi mbi tokën bujqësore* dhe *mbi ndërtesat*. Rritja e të ardhurave nga *tarifa e pastrimit dhe higjienës* në vitin 2014 kontribuoi pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga tarifatat vendore dhe të ardhurat vendore në total.

Shpenzimet totale të kryera nga Bashkia Shkodër përgjatë 3 viteve të konsideruara në këtë seksion të analizësⁱⁱ rezultojnë të jenë reduktuar nga 1.2 miliard në 400 milion lekë. Pas ngushtimit me rreth 34% në terma vjetorë përgjatë viteve 2011 dhe 2013, shpenzimet e kryera nga Bashkia Shkodër supozohet të kenë ndjekur një prirje rritëse në dy vitet në vijim (2013 dhe 2014) duke patur parasysh nivelin e të ardhurave të analizuara më sipër. Financimi i shpenzimeve totale nga Bashkia Shkodër vlerësohet të jenë realizuar kryesisht nga transferata e kushtëzuara nga ministritë e linjës. Shpenzimet e realizuara me fonde të veta rezultuan përcaktuesi kryesor i kahut të zhvillimeve në ecurinë e përgjithshme të shpenzimeve totale për vitin 2012.

Shpenzimet e kryera nga bashkia e re Shkodër gjatë periudhës në analizë përfaqësohen në masën më të madhe nga ato operative dhe të personelit. Këto dy kategori paraqesin elasticitet të ulët ndaj kufizimeve të mundshme buxhetore. Pra, në raste shkurtimesh të buxhetit, përgjithësisht janë shpenzimet kapitale ato që preken më shumë. Sipas njësive të qeverisjes vendore përbërëse, Bashkia Shkodër paraqet nivelin më të lartë të shpenzimeve në secilën prej kategorive të shpenzimeve të konsideruara (investime dhe korente).

Në ndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve, qëllimit të përdorimit të fondeve në dispozicion apo programeve buxhetore, struktura e shpenzimeve të bashkisë Shkodër rezultoi të dominohet nga shpenzimet për funksionet e "*mbrojtjes sociale*", "*shërbimet e përgjithshme publike*", "*strehimi dhe komoditeti i komunitetit*" dhe "*çështjet ekonomike*".

Grafik 2 Shpenzimet totale dhe sipas përdorimit (në pikë përqindjeje, gr. majtas); Kontributi sipas programeve në shpenzimet totale (në pikë përqindjeje, gr. majtas)



Burimi: Ministria e Financës, përpunime të autorit

Në ndarjen sipas programeve “shërbime të përgjithshme publike” rezulton programi në të cilin përthithet një pjesë e konsiderueshme e fondeve në dispozicion të Bashkisë së re Shkodër (me një vlerë rreth 1.3 miliard lekë për periudhën 2010-2012). Mesatarisht, përgjatë periudhës 2010-2012 në këtë program u alokuan rreth 50.2% e shpenzimeve totale, ku maksimumi arrit në vitin 2010 me rreth 580 milion lekë. Brenda këtij programi, shpenzimet për administratën e bashkisë, komunave dhe institucioneve të varësisë “planifikim, menaxhim dhe administrim” zënë peshën kryesore ndër vitet e konsideruar. Mbi 96.1% e fondeve të shpenzuara në këtë program buxhetor origjinuan nga fondet e veta të bashkisë së re Shkodër dhe u shpenzuan kryesisht për paga dhe shpenzime të tjera operative.

| | Programi Strategjik OS5 PS8: Ndryshimet Klimatike | Integrimi i masave të përshtatjes (adaptimit) dhe reduktimit të GHG në hartimin e planeve vendore të detajuara, menaxhimin e ujrave dhe tokës duke përfshirë bujqësinë, pyjet dhe ruajtjen e natyrës. | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia/ Donatorë | | Marrja e masave për të shmangur dhe për tu perballur me ndryshimet klimatike | | I mesëm |

4.5 Burimet e Financimit

➤ **Partneriteti publik-privat (PPP)**

Partneriteti Publik-Privat është një formë e financimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike nëpërmjet burimeve private. Është një mënyrë inovative për të përfshirë sektorin privat në zhvillim, në aktivitete ekonomike dhe në shërbime, që tradicionalisht janë kryeër nga autoritetet publike ose kompanitë publike. Në këtë mënyrë publiku do të jetë me i përfshirë në qeverisjen lokale, në monitorim dhe kontroll, dhe detyrat e menaxhimit do të kalojë sektorit. Ekzistojnë mundësi të ndryshme për të bërë PPP sipas eksperiencës internacionale dhe legjislacionit në fuqi. Gjithsesi, përfshirja e sektorit privat në projekte të zhvillimit të infrastrukturës mund të jetë e suksesshme vetëm nëse projekti vetë është bankable (e leverdisshme për bankat) dhe ka kapacitet për të shlyer investimin, normat e interesit dhe koston e menaxhimit të projektit, duke përdorur të ardhurat nga përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të ofruara.

Në Shqipëri ekziston tashmë një kuadër legjislativ, përfshi Ligjin e ri “Mbi Koncesionet (2006, VKM.27, datë 19.01.2007; “Mbi adoptimin e rregullave për vlerësimin dhe dënimin e koncesioneve”). Ky kuadër ligjor përfshin ligje për mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e ujit, për energjinë, planifikimin, pronësinë, standartet Shqiptare, implementimin e punimeve, licensimet etj. Çdo projekt koncesioni është subjekt i procedurave të tenderimit konkurrues, që nënkupton një ndërtim me të eficient të projektit nga sektori privat; gjenerim të të ardhurave shtesë nga sektori privat; zgjidhje kreative dhe inovative të problemeve teknike, dorëzim me të shpejtë të projektit; optimizim të jetëgjatësisë (integrim të projektit, ndërtimit, financave dhe mirëmbajtjes). Propozimet që vijnë nga sektori privat janë vlerësuar në përputhje me interesin publik; me planet strategjike në bazë sektori dhe në vlerat me të mira për shtet. Brenda këtij konteksti sugjerohet të shikohet në mjetet e mëposhtme operative financiare për:

- impiant trajtimi të rrjetit kanalizimesh
- transport publik
- platforme logjistike
- disa ndërtime etj.

➤ **Fondi i Zhvillimit të Rajoneve**

Një burim i mirë për financim është aplikimi tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në të cilin janë në dispozicion disa grante si:

- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore;
- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar;
- Granti konkurrues për shëndetësinë;
- Granti konkurrues për objektet kulturore dhe të trashëgimise kulturore;
- Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime;
- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh;
- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin;
- Granti konkurrues për pyllëzimin.

➤ **Instrumentat e Drejtimit të Zhvillimit**

Në kuadër të hartimit të planit të përgjithshëm vendor janë përcaktuar zona të cilat mund të operohet me anë të instrumentave të zhvillimit në mënyrë që bashkia të kapë vlerën e shtuar. Në këtë kontekst janë përdorur është përdorur **intensiteti me kushte**.

Intensiteti i ndërtimit me kushte është instrument nxitës për zhvilluesit (për të fituar më tepër sipërfaqe ndërtimi), ndërkohë që përmes kushtit bën të mundur sigurimin e fondeve për infrastruktura publike ose ndërtim të infrastrukturës drejtpërdrejt nga zhvilluesi. Pra, në thelb synon

të sigurojë contribute për financimin e investimeve kapitale në infrastruktura e shërbime publike, përfshirë programet sociale të strehimit.

Instrumente të tjera që mund të përdoren për të gjeneruar fonde për financimin e infrastrukturës publike përfshijnë:

- financimin përmes vlerës së rritur të taksës së pronës;
- zona të zhvillimit të biznesit (*Business Improvement District – BID*);
- zona vlerësimi të veçantë;
- tarifën/ ndarjen e vlerës së rritur të tokës.

4.6 Miratimi dhe Monitorimi i PIK

Miratimi i Planit të Investimeve Kapitale nga Këshilli Bashkiak është një proces shumë i rëndësishëm për të garantuar zbatimin e tij. Në këtë mënyrë secili prej sektorëve merr detyrimet dhe përgjegjësitë për përmushjen në kohë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga miratimi dhe zbatimi i Planit të Investimeve Kapitale.

Më sipër është pasqyruar procesi i hartimit të PIK, mirëpo puna nuk mbaron këtu. Faza tjetër shumë e rëndësishme e procesit është monitorimi. Për të garantuar realizimin e PIK është e domosdoshme që stafi i bashkisë të bëjë të mundur monitorimin e këtij procesi. Nuk është vetëm stafi i Bashkisë që duhet të bëjë monitorimin e zbatimit të planit, por është gjithashtu edhe Këshilli Bashkiak e komuniteti. Një indikator i lidhur me procesin e monitorimit është edhe matja e impaktit që do të sjellë realizimi i projektit kapital, numri i përfituesve nga projekti, harmonizimi i tij me projektet e tjera kapitale etj. Ka një mënyrë shumë të thjeshtë të monitorimit të PIK e cila ndonëse lidhet me të dhëna statistikore mundëson nxjerrjen e raporteve të monitorimit të tij. Disa prej elementëve të monitorimit të PIK janë:

- nëse projekti i ka përmbushur objektivat apo jo
- të përmbledhë dhe të mësojë nga variacionet në kosto
- të krahasojë buxhetin e planifikuar me kostot reale
- niveli i përmbushjes së elementëve sasiorë (sa prej projekteve të planifikuara janë realizuar)
- impakti i shkaktuar (sa është numri i përfituesve)
- ndikimi në ekonominë lokale (si ka ndikuar projekti në nxitjen e biznesit, zgjerimin e tij, punësimin, në të ardhurat vendore, a janë rritur ato, si dhe sa janë rritur, si është trendi i konstatuar në raport me atë të planifikuar, a mbulohet kostoja e investimit, pas sa vitesh do të mund të realizohet kjo etj.)
- si dhe sa ka ndikuar projekti kapital në kapitalizimin e burimeve financiare të Bashkisë
- monitorimi afateve (a është realizuar projekti kapital në kohën e planifikuar, a janë realizuar të gjitha etapat e tij)

Vlen të përmendet se monitorimi nuk duhet bërë vetëm në fund të vitit por duhet të shihet si një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit. Përsa i përket monitorimit të kostove të projekteve dhe shtyrjes së tyre ato duhet patjetër të rishikohen përpara hartimit dhe miratimit të buxhetit të vitit pasardhës.

Në terma financiarë, monitorimi i Planit të Investimeve Kapitale shihet si një proces i domosdoshëm i financave bashkiake duke impaktuar të gjithë treguesit e buxhetit. Nëpërmjet tij evidentohet eficientia dhe efektiviteti i çdo sektori të përfshirë dhe performanca e Bashkisë.

Më poshtë jepet një tabelë që mund të përdoret për monitorimin e PIK. Kjo tabelë përshkruan projektet, statusin, jep preventivin total të tyre dhe vlerën reale, burimin e financimit të parashikuar

dhe burimin real, periudhën e parashikuar në PIK dhe periudhën reale dhe sqarime për diferencat. Duhet theksuar që kjo tabelë nuk është e vetmja që mund të përdoret.

Tabele: 2- Monitorimi i PIK

| N r | Projektet/Përshkrimi | Statusi | Vlera e projektit sipas PIK | Vlera reale e projektit | Diferencat | Sqarime | Burimi Financimit i parashikuar | Burimi i financimit real | Sqarime | Periudha e parashikuar sipas PIK | Periudha reale e realizimit | Sqarime |
|-----|----------------------|---------|-----------------------------|-------------------------|------------|---------|---------------------------------|--------------------------|---------|----------------------------------|-----------------------------|---------|
| 1 | | | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | | | | | |
| ... | | | | | | | | | | | | |
| | SHUMA TOTALE | | | | | | | | | | | |

Kapitulli 5- Monitorimi i Planit të Zhvillimit

Plani i Zhvillimit të Bashkisë Shkodër do të implementohet me anë të projekteve të drejtpërdrejta, parashikimeve në PBA, si dhe parashikimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të rregullores. Në këtë kontekst ngarkohen drejtoritë përkatëse për zbatimin e politikave të Strategjisë. Ndërkohë, në të njëjtën kohë, në mënyrë periodike dhe sistematike duhet bërë monitorimi i zbatimit të strategjisë

dhe të planit. Bazuar në parashikimet ligjore të 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, bashkitë kanë detyrim ligjor të hartojnë një raport vjetor në lidhje me zhvillimin e territorit. Ky raportim duhet të shërbejë dhe për qëllime të brendshme të bashkisë ku në bazë të treguesve të bëhet monitorimi strategjisë dhe planit.

Çdo vit, bashkia duhet të masë treguesit e mëposhtëm, dhe çdo tre vjet duhet hartuar një raport i brendshëm në lidhje me zbatimin e strategjisë. Në varësi të rezultateve të monitorimit, mund që më pas të bëhet ndryshimi dhe alternimi i politikave dhe programeve për t’ju përgjigjur dinamikave të reja. Qëllim i monitorimit nuk është vetëm evidentimi i situatës ekzistuese por edhe matja e shkallës së zbatimit të strategjisë. Për monitorimin e planit do të përdoren 3 lloj indikatorësh.

Fillimisht, janë indikatorët e përcaktuar në vkm 671 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” në shtojcën tre të cilat masin ndryshimet në bazë sistemi:

Tabele: 3- Monitorimi 1

| Sistemi | Indikatorë | Zonë | Njësia |
|---------------|---|--|---|
| Sistemi Urban | 1. Sipërfaqja e territorit urban (Stu. të përgjithshme); 2. Sipërfaqja e infrastrukturës/banore 3. Popullsia (ekzistuese dhe e parashikuar/piramida e popullsisë); 4. Strehimi privat/social 5. Shërbime administrative; 6. Shërbime sociale/banorë, arsim/banorë dhe shëndetësi/banorë; 7. Transporti publik dhe privat (nr. makina/ familje) 8. Ndarja në zona; 9. Sipërfaqet e gjelbra/banorë dhe sportive/banorë; 10. Hapësira kulturore dhe për rekreacion/banore; monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore; 11. Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare; 12. Intensiteti për ha; 13. Parkime/banore; 14. Indikatorët ekonomikë (GDP / sektorë / lloji bizneseve/çmimet/punësimi/punësimi për sektor /taksat vendore/borxhi/shpenzimet sipas sektorit); 15. Pronat publike dhe private; 16. Tendencat e zhvillimit në territor | a) hapësira publike; b) kategoritë e banimit; c) Nënkategoritë e banimit; ç) Sipërfaqja bruto; d) Sipërfaqja neto; dh) Dendësia për ha; e) Dendësia për ha = njësi/banimi për ha; f) Sipërfaqja e infrastrukturës; g) Gjelbërimi në nivel zone; gj) Parkimi; h) Ndarja në njësi; i) Vlera e tokës | Ksht Kshr Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Gjelbërimi/banorë Parkimi/banorë Nr. banorësh Nr. përdoruesish Shërbimet Nënkategoritë e lejuara Funkcionet/aktivitetet e lejuara |

| | | | |
|------------------|---|---|---|
| Sistemi Bujqësor | Sip. Territor bujqësor; Sip. Primar (Boniteti I-IV); Sip. Territor Bujqësor Dytësor (Boniteti V-X); Sip. T Bujqësor me sistem ujitjeje; Sip. T Bujqësor pa sistem ujitjeje; Sip. T. Pafryt | Kategoria Bazë Nënkategoria Ndarja në njësi | Ksht Kshr Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Nënkategoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara |
| Ujor | Ujëra tokësore Ujëra Bregdetare | Sip- Liqene Lumenj Përrenj Ligatina | |
| Infrastruktura | Sip. rrugë kombëtare Sip. rrugë interurbane Sip. rrugë urbane parësore Hekurudha Porte Aeroporte Gazdote Elektrodote Ujësjiellës-Kanalizime | | |
| Natyror | Sip. e përgjithshme Sip. pyjore Sip. Kullota Sip. të gjelbra (jo urbane) Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm | Kategoria Bazë Nënkategoria Ndarja në njësi | Ksht Kshr Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Nënkategoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara |

Një set i dytë indikatorësh lidhet me monitorimin e Strategjisë së zhvillimit të territorit:

Tabele: 4 Monitorimi 2

| Objektivi | Programi | Treguesit e monitorimit |
|--|--|---|
| Objektivi Strategjik 1 <i>Përmirësimi i Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale</i> | <i>Programi Strategjik OS1PS1:</i> Terminalet Multimodale | Nr Pasagjerë Nr Mjete Nr Biznese pranë terminalit Frekuenca e Udhëtimeve |
| | <i>Programi Strategjik OS1PS2:</i> Rregullimi i Portave hyrëse në Shkodër | Projekte të Zbatuara Fluksi i Lëvizjes Nr Aksidente |
| | <i>Programi Strategjik OS1PS3:</i> Lidhjet Strategjike Rajonale e Kombëtare | Projekte të Zbatuara Fluksi i Lëvizjes Probleme Trafiku (Pika të zeza) |
| | <i>Programi Strategjik OS1PS4:</i> Bashkëpunimi Ndërkufitar | Nr Projekte të Aplikuara Nr Projekte të Zbatuara |

| | | |
|---|---|--|
| | | Nr Aktorë të Angazhuar Shuma e Fondeve të Përfutuara |
| Objektivi Strategjik 2 Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses | Programi Strategjik OS2PS3: Qëndrat me një Ndalesë dhe Ngritja e Kapaciteteve Lokale | Nr Qendra me një Ndalesë Nr staf për qendër Nr përdorues Nr staf i trajnuar Cilësia e Shërbimit të ofruar Kënaqësia e Qytetarëve nga shërbimi |
| | Programi Strategjik OS2PS4: Qeverisja Elektronike | Nr funksioneve të shtuara Nr Shërbimeve online Nr përdoruesit online |
| | Programi Strategjik OS2PS5: Qëndrat Multifunkionale dhe shërbimet Sociale | Nr Projekte të zbatuara Nr Përdorues Cilësia Fizike e ndërtesave |
| Objektivi Strategjik 3 Konkurueshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik | Programi Strategjik OS3PS1 Zhvillimi Rural | Nr I Fermave Sip bazë e fermës Nr projekte të zbatuara Fonde për Zh. Rural |
| | Programi Strategjik OS3PS3: Zhvillimi i Turizmit | Nr. Hoteleri sipas kategorive Nr. Bujtina të Reja Nr. Guida Projekte të zbatuara Nr Vizitorë ditorë Nr Turistë Nr Vizitorë sipas atraksioneve turistike Evente social kulturore të zhvilluara në Shkodër Nr Konferenca dhe Panaire |
| | Programi Strategjik OS3PS4: Mbështetja e sipërmarrjeve të reja | Nr sipërmarrje të reja në vit Nr sipërmarrje të cilat kanë akses në trajnime Nr sipërmarrje të reja sipas sektorit ekonomik |
| | Programi Strategjik OS3PS5: Zhvillimi i Zonave Ekonomike | Nr biznese të reja në zonë ekonomike Sip toke të rigjeneruar Nr punonjës në z.ekonomike Nr. Biznese në zonë ekonomike sipas sektorëve Nr Biznese sipas madhësisë |
| | Programi Strategjik OS3PS6: Branding i Bashkisë Shkodër | Nr broshura Nr. Turistë Nr. Përdorues të Logo Nr. Spote Publiciteti |
| Objektivi Strategjik 4 Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban | Programi Strategjik OS4PS1: Rikualifikimi i Ballinave Ujore | Vlera e tokës në zonë Vlera e apartamenteve Vlera e qerasë sipas zonës |

| | | |
|--|---|---|
| | | Sip Apartamente boshe Sip Hapësira për shërbime boshe Sip Hapësira tregtare boshe |
| | Programi Strategjik OS4PS4: Urbanizimi i Zonave Informale | Sip Rrugë të asfatuara Nr Rrugë me mbulim ndricim Sip të mbuluara me kanalizime Nr Banesa me akses në ujë të pishëm Sip hapësira publike Shërbime Publike të ofruara në zonë Nr Biznese aktive në zonë Numeri i Legalizimeve të kryera në një vit. |
| | Programi Strategjik OS4PS6: Përmirësimi dhe Integrimi i Komuniteteve Rome | Cilësia e Banesave Nr të punësuar Hapësira sociale në zonë |
| | Programi Strategjik OS4 PS7: Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban | Nr Projekte të zbatuara |
| | Programi Strategjik OS4PS8: Hapësirat Publike; Hapësirat Rekreative dhe Sportive | Sip Hapësira Publike Sip Hapësira Rekreative Sip Hapësira Sportive |
| | Programi Strategjik OS4PS9: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ | Mbulimi me rrjet të ujit të pishëm sipas zonave Mbulimi me kanalizime ujëra të zeza sipas zonave Mbulimi me kanalizime ujëra të bardha sipas zonave |
| | Programi Strategjik OS4PS10: Strehimi Social dhe i Përballeshëm | Nr të strehuar në vit Nr kërkesa në vit Nr banesa sociale në vit sipas llojit |
| | Programi Strategjik OS3PS10: Efiçienca Energjitike dhe Energjia e Rinovueshme | Përmirësimi i EE KË të harxhuar në vit KË të prodhuar me energji diellore KË të prodhuar me energji erë |
| | Programi Strategjik OS4 PS11: Transporti Publik | Nr autobuzë Nr linja Nr udhëtarë Nr përdorues abone Nr përdorues bileta sipas kategorive % e mbulimit të zonave me |

| | | |
|--|--|---|
| | | transport public |
| | Programi Strategjik OS3PS12: Biçikletat | Gjatësia korsi bicikleta urbane Gjatësia korsi bicikleta interurbane Përdorues bicikleta në vit |
| | Programi Strategjik OS4PS14: Parkimet | Sip Parkime publike në rrugë Sip Parkime publike Përdorues parkimi public |
| Objektivi Strategjik 5 Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore | Programi Strategjik OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane | Sasia Ton Mbetje në Lendfill Sasia Ton të kompostuara Sasia Ton sipas kategorisë të ricikluara |
| | Programi Strategjik OS5 PS7: Menaxhim i pyjeve dhe Kullotave | Sip pyjore Fidanë të mbjellur në vit |

Në fund, sygjerohet që bashkia të fillojë të grumbullojë një set të dhënash të cilat janë të nevojshme për proceset e hartimit të planeve në vite apo dhe të planeve sektoriale. Indikatorët jo domosdoshmërisht mblidhen nga bashkia, por mund të jenë dhe nga institucione të tjera si INSTAT. Në këtë sens bashkia mjafton të krijojë një databazë me të dhëna në nivel lokal duke mbledhur në mënyrë periodike treguesit e mëposhtëm.

Tabele: 5 Monitorimi 3

| Kategoria | Treguesi |
|---|---|
| <u>Demografi</u> | <u>Jetëgjatësia</u> |
| | Dendësia e popullsisë/ hektarë |
| | Raporti urban/rural i popullsisë |
| | Nr Lindje në vit |
| | Nr vdekje në vit |
| | Emigrimi dhe imigrimi në Bashkinë Shkodër |
| | Piramida e popullsisë |
| | Popullsia sipas gjinisë dhe moshës |
| | Treguesit mbi komunitetet rome |
| | Prindër të vetëm |
| | Persona të cilët jetojnë vetëm |
| <u>Transporti, aksesueshmëria dhe komunikimi</u> | <u>Punësimi në sektorin e transportit</u> |
| | Akresi në këmbë në hapësira të gjelbërta |
| | Koha e udhëtimit për në punë |
| | Modaliteti i udhëtimit për në punë |
| | Akresi në internet |
| | Numri i udhëtarëve ditorë me tren |
| | Numri i firmave me ëbsite |
| | Numri i përdoruesve të ëbsite të bashkisë |
| | Numri i përdoruesve të transportit publik në ditë |
| | Numri i përdoruesve të biçikletave |
| | Akresi në ujë të pishëm |

| | |
|--------------------------|---|
| Energjia | Emetimet e GHG |
| | Konsumi i Energjive të rinovueshme |
| | Investimet në energji |
| | Prodhimi i energjisë sipas burimit |
| | Çmimi i elektricitetit dhe gazit |
| Mirëqënia Sociale | % e popullsisë që jeton në banesa sociale |
| | Akresi në shërbime sociale |
| | % e popullsisë me ndihmë sociale |
| | Akresi në shkolla të mesme |
| | Sipërfaqja mesatare për banim në m ² |
| | Çmimi mesatar i banesave |
| | Braktisja e shkollave fillore |
| | Banesat boshe |
| | Niveli i sigurisë në zona |
| | Nr krevatë dhe nr punonjës në shërbime shëndetësore |
| | % e banesave që kanë mangësi në shërbime bazë |
| Ekonomia | % e punësimit sipas sektorëve |
| | % e punësimit në sektorin publik dhe privat |
| | Numri i bizneseve të mëdha |
| | Numri i bizneseve të vogla dhe të mesme |
| | Lëvizjet për qëllime punësimi |
| | Specializimi ekonomik (investimet sipas sektorëve) |
| | Dendësia e punësimit sipas zonave |
| | Investime në ekonomi të gjelbërta |
| | Investime në sipërmarrje sociale |
| | Numri i Turistëve |
| | Numri i Shtretërve në Hotel për zonë |
| | % e vetëpunësimit |
| Mjedisi | % e zonave me vlera të larta ekologjike |
| | Nr i banesave të lidhura me sistemin e kanalizimeve |
| | Nivelet e zhurmës |
| | Cilësia e ajrit |
| | Erozioni Bregdetar |
| | Cilësia e Ujit të Pishëm |
| | Tërmetet |
| | Temperaturat Mesatare |
| | Niveli i rreshjeve |
| | Thatësitrat |
| | Përmytjet |
| | Emetimet e GHG |
| | Rrëshqitjet e tokës |
| | % e Mbulimi të Tokës |
| | Nivelet e zhurmës |
| Institucionale | Pjesëmarrja elektorale |
| | Partneritete publike private |
| | Nr i përdoruesve të shërbimeve publike |

| | |
|---------------------|--|
| | Nr i përdoruesve të zyrave të informacionit |
| | Kënaqësia e publikut me shërbimet qeverisësë |
| <i>Territoriale</i> | <i>Humbja e tokës bujqësore</i> |
| | % E Humbjes së tokës natyrore |
| | % e mbulesës së tokës |
| | % e zhvillimit për qëllime banimi |
| | % e zhvillimit për qëllime shërbimi |
| | % e zhvillimit për qëllime tregtare |
| | % e zhvillimit për qëllime infrastrukturore |

5.2 Faktorë që mund të shkaktojnë një rishikim të pjesshëm të PPV-së.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër mund të jetë subjekt i rishikimeve të pjesshme si rrjedhojë e disa faktorëve si më poshtë vijon:

- ***Ndryshime të pjesshme si rrjedhojë e monitorimit periodik të zbatimit të planit***

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër zbatohet nga bashkia nëpërmjet disa mënyrave ku mund të përmenden planeve vendore sektoriale, planeve të detajuara vendore, investimeve strategjike / kapitale, projekteve pilot të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit, sipas planit të veprimeve të këtij plani. Në këtë kontekst ngarkohen drejtoritë përkatëse për zbatimin e politikave të Strategjisë. Ndërkohë, në të njëjtën kohë, në mënyrë periodike dhe sistematike duhet bërë monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe të planit. Bazuar në indikatorët dhe treguesit e përdorimit, Bashkia Shkodër duhet të bëjë mbledhjen e tyre në mënyrë periodike sipas specifikimeve, dhe çdo 2 vjet duhet të prodhojë një raport në lidhje me zbatimin e planit bazuar në indikatorët e mësipërm.

Rezultatet e monitorimit të vazhdueshëm të zbatimit të planit mund të reflektohen me nevojën për ndryshime të pjesshme të Planit të Përgjithshëm Vendor në të tre komponentët e tij ku përfshihen Strategjia, Plani i Zhvillimit si dhe Rregullorja Vendore. Në këtë kontekst, ndryshimet e pjesshme të planit mund të miratohen vetëm në Këshill Bashkiak, ose në raste specifike kur ato prekin interesa të rëndësishme kombëtare ndryshimet pas miratimit në këshill Bashkiak dërgohen për miratim edhe në Këshillin Kombëtar të Territorit. Në çdo rast, ndryshimet e pjesshme të planit duhet të reflektohen edhe në Regjistrin e Integruar të Territorit.

- ***Ndryshime të pjesshme si rrjedhojë e ndryshimeve të vullshme ekonomike, sociale e demografike e mjedisore***

Në rastet kur bashkia Shkodër vëren ndryshime të vullshme ekonomike, sociale apo demografike të cilat mund të kenë impakt pozitiv ose negativ në territor, Bashkia Shkodër, mund të kërkojë një rishikim të pjesshëm të PPV në mënyrë që të përgjigjet sa më mirë këtyre ndryshimeve. Ndryshimet e pjesshme mund të lidhen me promovimin e mëtejshëm të një situatë ekonomike, sociale e demografike apo mjedisore të re e cila sjell përfitime komunitare në punësim, shkollim etj. Gjithashtu, këto ndryshime mund të vijnë si rrjedhojë e krizave apo fatkeqësive të ndryshme në sektorët e sipërpërmendur. Ndryshimet e pjesshme në këtë kontekst mund të miratohen vetëm në Këshill Bashkiak, ose në raste specifike kur ato prekin interesa të rëndësishme kombëtare ndryshimet pas miratimit në këshill Bashkiak dërgohen për miratim edhe në Këshillin Kombëtar të Territorit. Në çdo rast, ndryshimet e pjesshme të planit duhet të reflektohen edhe në Regjistrin e Integruar të Territorit.

- ***Ndryshime të pjesshme si rrjedhojë e vendimeve/projekteve të qeverisë qendrore të cilat kanë impakt në territorin e Bashkisë Shkodër***

Plani i përgjithshëm vendor mund të jetë subjekt i një rishikimi të pjesshëm si rrjedhojë e ndryshimeve të politikave, strategjive dhe planeve në nivel qendror. Gjithashtu, edhe në rastet e implementimit të projekteve madhore nga qeveria qendrore mund të jetë e nevojshme një rishikim i pjesshëm në mënyrë që të përshtatet me kushtet e reja. Ndryshimet e pjesshme në këtë kontekst mund të miratohen vetëm në Këshill Bashkiak. Gjithashtu, në rastet e planeve, strategjive dhe veçanërisht të projekteve, sygjerohet edhe konsultimi me Bashkinë Shkodër dhe qytetarët e Shkodrës në mënyrë që ndryshimet të jenë sa më të koordinuara.

- ***Ndryshime të pjesshme si rrjedhojë e hartimit të planeve sektoriale vendore***

Bashkia Shkodër, në zbatim të planit të përgjithshëm vendor, mund të marrë nismën për hartimin e planeve sektoriale vendore. Këto plane bazohen në parashikimet e PPV-së, por si rezultat i hartimit të analizave më të detajura për çështjet specifike mund të jetë e nevojshme një rishikim i pjesshëm i planit të përgjithshëm vendor. Në këtë kontekst, planet sektoriale mund të hartohen si rekomandim dhe përcaktim i drejtpërdrejtë i PPV ose mund të vijnë si rezultat i nevojave apo ndryshimeve të situatës vendore. Bazuar në vkm 671, dt 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, neni 72, përcakton se *“përmbajtja dokumentit të PVS-së, nisma për hartimin e PVS-së; hartimi i PVS-së, bashkërendimi i PVS-së, këshillimi dhe takimi publik në kuadër të PVS-së, botimi në regjistër i PVS-së, miratimi, hyrja në fuqi e PVS-së kryhen duke ndjekur si bazë procedurat e përcaktuara për PPV dhe PKS”*. Më pas ndryshimet si rrjedhojë e tyre në PPV miratohen sërish në Këshill Bashkiak. Të gjitha ndryshimet reflektohen në Regjistrin e Integruar të Territorit.

Përtej pikave të sipërpërmendura mund të jenë dhe një sërë faktorësh të tjerë të cilët çojnë në rishikimin e pjesshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor. Në çdo rast jo të sipërpërmendur nisma për rishikimin e pjesshëm duhet të miratohet në Këshill Bashkiak.

Kapitulli 6- Raporti për Kapacitetet Institucionale

6.1 Nevoja për ngritjen e kapaciteteve institucionale

Bashkia Shkodër, në kuadër të reformës territoriale ka pësuar ndryshime të rëndësishme përsa i përket sipërfaqes territoriale që ajo mbulon. Gjithashtu, si rrjedhojë e këtyre ndryshime dhe nevojave të ndryshme të qytetarëve, sociale, ekonomike, territoriale, mjedisore e infrastrukturore kërkon dhe ngritjen e kapaciteteve të tjera në përputhje me sa më sipër.

Bazuar në analizën institucionale të kryer në kuadër të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër janë vënë re këto mangësi dhe është përpiluar një listë me rekomandime. Rekomandimet shërbejnë si për zbatimin e planit ashtu dhe në përgjithësi për ngritjen e kapaciteteve për hartimin e planeve sektoriale apo vendore. Ndër pikat konkluzionet kryesore të analizës të situatës institucionale janë:

Tabele: 6 SËOT Institucional

| Pikat e Forta |
|---|
| Përqëndrimi i institucioneve kryesore në qytetin e Shkodrës si zyrat e Qarkut, Prefekturës, Agjencive rajonale të mjedisit, bujqësisë etj |
| Krijimi i Agjencisë së Zhvillimit Rajonal me qendër në Shkodër |
| Pozicioni strategjik i favorshëm për të përfituar fonde (ipa,cbc). Pozicionimi i zyrave qendrore të disa prej programeve ndërkombëtare |
| Kulturë institucionale me punën me financimet e huaja |
| Qëndër historike për rajonin e veriut |
| Traditë e mirë bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm |
| Qëndër rajonale në ofrimin e shërbimeve |
| Është ruajtur bërthama kryesore institucionale, kapacitet i lartë njerëzor në Shkodër |
| Shoqëri civile aktive |
| Prania e Universitetit të Shkodrës |
| PIKAT E DOBËTA |
| Bashkia ka një sipërfaqe 58-here me e madhe që përbën një sfidë për ofrimin e shërbimeve |
| Mungesa e kapaciteteve të specializuara/specialist në zonat periferike malore |
| Mungesa e eksperiences institucionale në njësinë qendrore për trajtimin e çështjeve të zhvillimit rural dhe malor |
| Mungesa e informacionit jo të plote për territorin e ri |
| Ndergjegjesimi i ulet për detyrimet qytetare/publike në pagimin e taksave |
| Mungesa e bazës materiale të plotë si kompjutera, softëare etj në njësitë administrative |
| Mungesa e kapaciteteve të specializuara në hartimin e planeve të menaxhimit, planeve të detajuara vendore |
| Rreziqet |
| Pabarazi në ofrimin e shërbimeve/menaxhim i dobët larg qendres |
| Vështirësi në ngritjen e kapaciteteve lokale në zonat periferike |
| Vështirësi në menaxhim/zhvillim i ngadalte |
| Paaftësia për të ofruar shërbime cilësore/mbulimi vetëm i kostove administrative |
| Pabarazi në zhvillimin rajonal krahasuar me vendet fqinj |
| MUNDËSITË |
| Menaxhim i integruar i territorit |
| Zhvillimi në baze të prioriteteve nga momenti i hartimit të planit |
| Dixhitalizim i shërbimeve dhe shërbimet online |
| Qëndrat multifunkcionale |

Në këtë kuadër propozohen të merren masat e mëposhtme:

1. Plotësim i databazës së informacionit

- Në kuadër të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë shkodër është krijuar një bazë e mirë informacionit të cilën tashmë bashkia duhet të vazhdojë ta plotësojë në mënyrë periodike
- Krijimin e një zyrë të fortë të statistikave lokale dhe grumbullimin e statistikave të bazuar në treguesit e propozuar në plan si dhe për nevoja të tjera lokale
- Plotësimi i databazës së informacionit dhe inventarizimi i pyjeve, kullotave, tokave bujqësore
- Inventarizim dhe krijimi i një databaze të fortë informacioni në lidhje me zhvillimin ekonomik
- Plotësimi i bazës material të zyrave të bashkisë dhe njësive administrative me kompjuter, softëare të nevojshëm si autocad dhe GIS.

2. Trajnime të stafit të bashkisë në:

Në këtë aspekt janë identifikuar pesë fusha si më prioritaret:

- Planifikim dhe Menaxhim Territori
- Trajtimi i çështjeve sociale (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore)
- Zhvillim Rural dhe Menaxhim Pyjesh
- Turizëm dhe guida turistike
- Menaxhim i rreziqeve natyrore

Përsa i përket planifikimit dhe menaxhimit të territorit, trajnimet mund të konsistojnë në:

- Hartim politikash zhvillimi
- Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit
- Përdorim i GIS dhe Regjistrat të Territorit
- Menaxhim Projektsh
- Rregulla të përdorimit të tokës

Ndërkohë përsa i përket çështjeve sociale trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve mund të konsistojnë në:

- Trajnime për trajtimin e rasteve të dhunës në familje
- Trajnime për trajtimin e grave të dhunuara
- Trajnime për këshillimin e të rinjve
- Trajnime për strehimin social

3. Gjithëpërfshirja e qytetarëve në proceset qeverisëse

Bashkia Shkodër synon të rrisë transparencën ndaj publik dhe të përmirësojë shërbimet duke modernizuar dhe dixhitalizuar një sërë shërbimesh të cilat lidhen me Bashkinë. Në këtë kontekst do të ofrohen shërbime dixhitale për bizneset me anë të të cilave mund të kryhen veprimet për pagimet e taksave. Gjithashtu, me të njëjtën logjikë më pas do të dixhitalizohet edhe shërbimi për qytetarin duke u bazuar në një Portal unik në të cilin mund të merren informacion si dhe të merren shërbime e kryhen veprime të ndryshme. Portali do të jetë i përdorshëm për “telefonat inteligjent” si dhe në versionin e një faqeje interneti.

Gjithashtu do të krijohen programe të cilat synojnë përfshirjen e qytetarit në hartimin e projekteve komunitare. Do të krijohen mundësi ku qytetarët të shprehin opinionin e tyre dhe dëshirën për hartimin e projekteve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të

Bashkisë. Praktika të planifikimit në nivel “lagjeje” dhe “komuniteti” do të testohen dhe aplikohen si një mënyrë novatore për zhvillimin e qëndrueshëm territorial.

Në planin afatgjatë, në vizionin e bashkisë, pas ngritjes së kapaciteteve qëndrat me një ndalesë do të luajnë dhe rolin e katalizatorit përse i përket planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në bashkëpunim me përfaqësitë komunitare do të ngrihen kapacitetet që të arrijnë të zhvillojnë projekte dhe më pas të zbatojnë ato. Qëndrat me një ndalesë gjithashtu do të konkurojnë me njëra tjetrën për tërheqjen e financimeve nga Bashkia. Në këtë sens rritet bashkëveprimi komunitar dhe pronësia e projektit duke garantuar edhe kohezion social.

4. Bashkëpunimi Ndërkufitar

Synon mbështetjen dhe ngritjen e strukturave për bashkëpunimin ndërkufitar midis bashkisë Shkodër dhe bashkive kufitare në Mal të Zi. Ngritjen e strukturave për shkëmbime eksperiencash. Ky program është më tepër i karakterit të marrëdhënieve institucionale. Gjithashtu shërben në ngritjen e kapaciteteve për harimin e planeve të përbashkëta si dhe në aplikimin për projekte në thirrje të IPA Cross Border Montenegro-Albania 2014-2020.

6.2 Marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe strukturën e stafit të nevojshëm për zbatim.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër është e nevojshme angazhimi i një sërë drejtorish për implementimin e suksesshëm të tij, duke qënë se planifikimi është një proces i vazhdueshëm dhe jo vetëm një koncept urbanistik.

2. Në këtë kontekst duhet të angazhohen drejtoritë e mëposhtme për zbatimin e PPV:

- *Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve (përfaqësuar nga Specialisti i Sektorit Juridik)*

Kjo drejtori, ndihmon drejtorinë e planifikimit të territorit dhe zhvillimit urban duke ofruar konsulencën e nevojshme ligjore në zbatimin e planit si dhe në plotësimin e dokumenteve të rregullores së planit apo të vendimeve/udhëzimeve në funksion të zbatimit të PPV sipas rastit dhe nevojave lokale të cilat mund të parashtrohen pas miratimit të planit. Gjithashtu, kjo drejtori, duhet të mbajë të përditësuar drejtorinë e planifikimit të territorit në lidhje me ndryshimet e mundshme ligjore të cilat mund të ndodhin pas miratimit të planit në mënyrë që PPV të përditësohet rast pas rasti sipas nevojës.

- *Drejtoria e Shërbimeve Sociale, CPU dhe Strehimit (përfaqësuar nga Përgjegjësi i Sektorit i Planifikimit Strategjik, Standarteve dhe Monitorimit)*

Kjo drejtori, zbaton politikat përkatëse për strehimin dhe monitoron ecueshmërinë në lidhje me strehimin social. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të planit, është e nevojshme krijimi i një databaze hapësinore në lidhjet me kërkesat për strehim si dhe përgjigjes së tyre. Drejtorja është përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të projekteve në fushën e strehimit në bashkëpunim me drejtorinë e planifikimit të territorit. Kjo drejtori duhet të përgatisë në mënyrë periodike raportin e monitorimit të situatës së strehimit.

- *Drejtoria e Ndhmës Ekonomike (përfaqësuar nga drejtori i drejtorisë)*

Kjo drejtori duhet të përgatisë në mënyrë periodike raportin e monitorimit të situatës së ndihmës ekonomike. Është përgjegjëse për zbatimin e programeve për ndihmën ekonomike.

- *Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve (Specialist i Sektorit të Studimeve dhe Koordinimit të Investimeve Bashkiake)*

Kjo drejtori është drejtpërdrejt e lidhur me koordinimin e investimeve të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë Territoriale si dhe parashikimet për investime të planifikuara në PPV. Koordinon dhe monitoron me drejtorinë e planifikimit të territorit ecueshmërinë e zbatimit të investimeve. Në fund përgatit raportin e monitorimit në lidhje me ecueshmërinë e investimeve si dhe jep rekomandime për ndryshimet përkatëse në PPV.

- *Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*

Është një ndër drejtoritë më të rëndësishme për monitorimin e zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit hartojnë raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të planit dhe japin rekomandime për ndryshime nëse është e nevojshme.

- *Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave (Përgjegjës Sektor i Menaxhimit të Ujërave; Përgjegjës Sektor i Mbrojtjes së Pyjeve dhe Mjedisit)*

Monitoron situatën mjedisore dhe menaxhon pyjet e ujërat. Harton plane menaxhimi për pyjet në kuadër të planifikimit sektorial vendor. Çdo vit përgatit raportin e monitorimit të PPV në lidhje me çështjet mjedisore dhe ofron rekomandimet përkatëse për përshtatjen me situatë të reja. Është përgjegjëse për zbatimin e masave në mjedis të parashikuara në PPV dhe për monitorimin e drejtpërdrejtë të rezultateve të tyre.

- *Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastrukturës (Përgjegjës Sektor i Shërbimeve të Pastrimit, Gjelbërimit dhe Varrezave Publike; Përgjegjës Sektor i Ndriçimit, Sinjalistikës, Transportit dhe Mobilitetit)*

Drejtoria është përgjegjëse për zbatimin e planit të ndërhyrjeve infrastrukturore sipas masave të parashtruara në PPV dhe në Strategji. Në kushte të caktuara mund të marrë nismën për hartimin e planeve sektoriale ose për plotësimin e rregulloreve përkatëse me nene shtesë në përgjigje të nevojave lokale.

- *Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor (Specialist Buxheti)*

Kjo drejtori është monitoruese e programit buxhetor dhe sigurohet që parashikimet e PPV reflektohen në PBA. Monitoron situatën e buxhetit dhe çdo vit paraqit raportin për buxhetin ku ofrohen dhe rekomandimet përkatëse për zbatimin e planit.

- *Drejtoria e të Ardhurave*

Monitoron të ardhurat të cilat gjenerohen nga bashkia dhe si të ardhurat të cilat vijnë drejtpërdrejtë nga parashikimet dhe zbatimi i PPV. Në fund ofron rekomandimet përkatëse dhe ndryshimet e nevojshme në PPV.

- *Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit (Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Sistemeve dhe Menaxhimit të Zyrës së Integruar me një ndalesë)*

Mbështet drejtoritë e tjera në zbatim të PPV duke ofruar ekspertizë teknike. Ndiemon në përgatitjen e termave të referencës për softëare të ndryshëm dhe në zbatimin e programit të qeverisjes elektronike. Çdo vit, harton një raport monitorimi mbi zyrën e integruar me një ndalesë.

- *Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (Përgjegjës Sektor i Shërbimeve Mbështetëse)*

Mbështet drejtoritë e tjera në zbatimin e PPV duke ofruar asistencë në zhvillimin e prokurimeve si dhe me anë të shërbimeve të tjera mbështetëse sipas nevojës.

- *Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit (Përgjegjës Sektori i Planifikimit dhe Statistikave)*

Përgjegjëse për monitorimin e zhvillimit ekonomik në territorin e bashkisë. Jep rekomandimet përkatëse për politikën ekonomike të cilat bashkia duhet të ndjekë në bazë vjetore si dhe ndryshime të cilat mund të jenë të nevojshme në strategjinë territoriale. Mund të marrë nismën për hartimin e një plani sektorial vendor për zhvillimin ekonomik.

- *Drejtoria e Turizmit (Përgjegjës Sektori i Zhvillimit të Turizmit dhe Produktit Turistik)*

Merret drejtpërdrejtë me zbatimin e programeve për zhvillimin e turizmit. Mund të hartojë një plan sektorial vendor për turizmin për të fuqizuar dhe detajuar më shumë sektorin. Monitoron situatën e zhvillimit të turizmit në Bashkinë Shkodër dhe çdo vit përgatit një raport monitorimi.

- *Drejtoria e Zhvillimit rural dhe bujqësisë*

Merret drejtpërdrejtë me zbatimin e programeve për zhvillimin rural dhe bujqësinë. Mund të hartojë një plan sektorial vendor për zhvillimin për të fuqizuar dhe detajuar më shumë sektorin. Monitoron situatën e zhvillimit të rural në Bashkinë Shkodër dhe çdo vit përgatit një raport monitorimi.

- *Drejtoria e Planifikimit të Territorit*

Merret drejtpërdrejtë me zbatimin e PPV për Bashkinë Shkodër. Shërben si coordinator edhe për drejtoritë e tjera. Detajon vendore sipas rastit apo dhe njësitë strukturore. Monitoron zbatimin e planit dhe në fund të çdo viti përgatit një raport vlerësimi ku ofron dhe rekomandimet përkatëse për PPV.

- *Institucionet në varësi të bashkisë Shkodër*

Secila drejtori e institucioneve në varësi të bashkisë Shkodër koordinon me drejtorinë e planifikimit të territorit të Bashkisë për zbatimin e PPV si dhe programeve përkatëse. Çdo vit drejtoritë hartojnë raportet përkatëse të monitorimit të cilat i paraqiten bashkisë shkodër së bashku me rekomandimet specifike dhe konkrete.

- *Njësitë administrative*

Koordinojnë me drejtoritë e planifikimit dhe kontrollit të territorit zbatimin e planit si dhe monitorimin e tij. Ofrojnë shërbime këshilluese ndaj qytetarit.

3. Për ngritjen e këshillit teknik për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi:

Kryetari i Bashkisë Shkodër me urdhër ngre grupin përbërës për shqyrtimin dhe këshillin teknik për lejet e ndërtimit. Grupi i ngritur me urdhër të kryetarit shqyrton dokumentacionin si dhe përgatit me shkrim raportin teknik së bashku me rekomandimet dhe vërejtjet përkatëse për kryetarin e bashkisë. Grupi duhet të përbëhet të paktën nga:

- Përfaqësues i drejtorisë Juridike (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i drejtorisë së planifikimit të territorit (2 përfaqësues- njëri prej tyre kryetar i grupit të punës)
- Përfaqësues i drejtorisë së kontrollit të territorit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i drejtorisë së mjedisit (2 përfaqësues)

- Përfaqësues i drejtorisë së shërbimeve dhe infrastrukturës (1 përfaqësues)
- Përfaqësues nga rajoni (për njësinë administrative Shkodër) ose përfaqësues nga njësi administrative ku aplikohet leja

Grupi i punës mund të mbledhet në mënyrë periodike për shqyrtimin e kërkesave për leje në mënyrë që të respektohen afatet ligjore përkatëse. Gjithashtu, për koordinimin e grupit të punës përdoret sistemi elektronik i lejeve.

4. Marrëveshje për zbatimin e PPV

Në kuadër të zbatimit të PPV bashkia Shkodër duhet të hartojë një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme qeveritare si dhe me partnerë të tjerë lokale apo edhe me komunitetet. Një sërë marrëveshjesh ndërliken me:

- Marrëveshje në fushën e zhvillimit ekonomik, turizmit dhe zhvillimit rural
- Marrëveshje në fushën e mobilitetit urban
- Marrëveshje në fushën e mjedisit
- Marrëveshje me institucione akademike dhe profesionale për ngritjen e kapaciteteve vendore në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të territorit
- Marrëveshje me MZHU/AKPT për asistencë në zbatimin e PPV
- Marrëveshje në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar

Gjithashtu, sygjerohet përcaktimi i një PIU (Project Implementation Unit) i cili mund të jetë me financim të bashkisë ose në marrëveshje me donatorë të ndryshëm për të koordinuar punën në zbatimin e planit gjatë vitit të parë të zbatimit. PIU gjithashtu do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV.

Rekomandohet rekomandimi i zbatimit të projekt fishës të lidhur me shërbimin e 'arkitekti im', e cila do të mundësojë zbatimin e planit si dhe rritjen e sensibilitetit komunitar në lidhje me këtë plan.

Marrëveshjet e ngritura në kuadër të zbatimit të PPV mund të kenë si fokus disa çështje të ndryshme si:

- marrëveshje për zbatim projektsh të përbashkëta,
- marrëveshje për monitorimin e situatës ekzistuese dhe plotësimin e databazës së të dhënave,
- marrëveshje për hartimin e planeve sektoriale vendore,
- marrëveshje për menaxhimin e hapësirave publike,
- ndërgjegjësimin e publikut
- ngritjen e kapaciteteve vendore
- monitorim të situatës mjedisore

Në këtë kontekst, janë identifikuar një sërë aktorësh të ndryshëm me të cilët bashkia Shkodër mund të lidhë marrëveshje të reja ose të zgjerojë ato ekzistuese përse i përket zbatimit të PPV:

- Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër
- Universiteti POLIS
- Sëiss Helvetica DLDP
- Malteser
- Save the Children
- PLGP/USAID
- SIDA

- ADA
- Bashkia Ulqin
- Bashkia Malësisë së Madhe
- Bashkia Vau Dejës
- Bashkia Tropojë
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
- Ministria e Zhvillimit Urban
- Ministria e Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
- Ministria e Transportit
- Business Improvement District-Shkodra
- Komuniteti Musliman
- Komuniteti Katolik

Gjithashtu, sygjerohet lidhja e marrëveshjeve edhe me shoqërinë civile dhe me shoqatat e ndryshme të cilat operojnë në Shkodër.

6.3 Vlerësimi i nevojave të personelit dhe burimeve për hapësirën e departamentit

Bazuar në analizën e kryer të situatës institucionale dhe nevojave për zbatim të PPV, rekomandohen masat e mëposhtme:

- Nevojat për hapësira të departamentit (mjedise zyre)

Në njësitë administrative qëndër Shkodër (Bashkia Shkodër), Ana e Malit, Dajç, Bërdicë, Gur i Zi, Rrethina, Velipojë dhe Postribë vlerësohet se situata për hapësira pune është e mjaftueshme dhe në një gjendje të pranueshme. Ndërkohë, përsa i përket njërive administrative Pult, Shosh dhe Shalë parashikohen disa ndërhyrje jo në zgjerimin e ambienteve sesa në rregullimin dhe rikonstruksionin e tyre. Gjithashtu, është e nevojshme që edhe ambientet e “rajoneve” në njësinë administrative Shkodër ti përshtaten një rikonstruksioni të zyrave për tu përshtatur me kërkesat e reja.

Në total vlerësohet që është e nevojshme të shpenzohet një shumë prej 30 000 000 Lekë si investim fillestar për përmirësimin e ambienteve të hapësirave të departamentit. Ndërkohë, në buxhet duhet të parashikohet një shumë prej 5 000 000 lekë në vit për rregullime dhe mirëmbajtje.

- Pajisje zyre

| Njësia | Karrige | Tavolina | Kompjuterë | Skaner | Printer | Programe Kompjuterike |
|-------------|---------|----------|------------|--------|---------|------------------------|
| Shkodër | 10 | 10 | 20 | 3 | 5 | Autocad/ Adobe/ GIS |
| Bërdicë | - | - | 3 | 1 | 1 | Autocad |
| Ana e Malit | - | - | 3 | 1 | 1 | Autocad |
| Dajç | - | - | 1 | 1 | 1 | Autocad |
| Velipojë | - | - | 3 | 1 | 1 | Autocad |
| Gur i Zi | - | - | 2 | 1 | 1 | Autocad |
| Postribë | - | - | 2 | 1 | 1 | Autocad |
| Rrethina | - | - | 3 | 1 | 1 | Autocad |
| Pult | - | - | 1 | 1 | 1 | Autocad |
| Shosh | - | - | 1 | 1 | 1 | Autocad |
| Shalë | - | - | 1 | 1 | 1 | Autocad |

Gjithashtu, përsa i përket rajoneve në njësinë administrative shkodër, duhet të plotësohen të paktën me nga 2 kompjutera dhe 1 printer, pra në total 10 kompjuter dhe 5 printer. Bazuar në sa më sipër kostot mund të parashikohen si më poshtë:

| Pajisja | Copë | Cmimi për njësi | Kosto totale |
|----------------|-------------|------------------------|-----------------------|
| Karrige | 10 | 2 500 lekë | 25 000 Lekë |
| Tavolina | 10 | 15 000 Lekë | 150 000 Lekë |
| Kompjuter | 40 | 78 000 Lekë | 3 120 000 Lekë |
| Skaner | 13 | 15 000 lekë | 195 000 Lekë |
| Printer | 15 | 30 000 lekë | 450 000 Lekë |
| | | Total | 3 940 000 Lekë |

Gjithashtu, duhet llogaritur një buxhet vjetor prej 100,000 Lekë për mirëmbajtjen e pajisjeve të reja dhe atyre ekzistuese.

Në fund, përsa i përket shërbimit me programe kompjuterike, duke qënë se këto paketa kanë kosto relativisht të larta për buxhetin e Bashkisë Shkodër, sygjerohet lidhja e marrëveshjeve me donatorë të ndryshëm për ofrimin e këtyre programeve.

- **Nevojat të tjera**

Bashkia Shkodër ka një territor në mbulim i cili është mjaft i gjerë dhe i vështirë në disa raste për tu aksesuar. Këshillohet blerja e 3 automjeteve të tipit fuoristradë të cilat mundësojnë aksesin edhe në zona të vështira. Këto automjete rekomandohet që të kërkohen si marrëveshje me donatorë të ndryshëm, ose në rastin e pamundësisë së gjetjes së financimeve nga palë të treta, të paracaktohet në buxhet shpezimet përkatëse për të blerë të 1 automjet në vit. Gjithashtu, duhet të përcaktohen edhe shpenzimet përkatëse për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes.

Shtojca 1 – Raport mbi degjesta dhe konsultimet

Hyrje

Kjo Shtojcë komunikimi dhe Gjithëpërfshirje vjen si nevojë për të dokumentuar në mënyrë transparent ate cka është konsultuar dhe marre ne shqyrtim nga te gjithë ata qe me perkushtim dhe pergjegjshmeri profesionale kane mundesuar arkivimin dhe perpunimin e metejshem te infomacioneve mbi Bashkine Shkoder dhe, duke filluar nga Agjensia Kombetare e Planifikimit, Ministrite e ndryshme (si ajo e Mjedisit), Bashkia Shkoder, Administratore te njesive bashkiake, Drejtore te Agjensive Rajonale dhe Drejtorive Bashkiake, grupe interesi, profesioniste te ndryshem, intelektuale, grupe rinore dhe studentore, dhe banore te ndryshem te bashkise Shkoder te cilet u jane pergjigjur pyetesoreve. Ky dokument, ashtu si edhe indeksi tregon, eshte i ndare ne pese (5) kapituj e qe ne menyre plotesuese reflekton punen dhe vullnetin e te gjithë atyre aktoreve te lartepemendur.

Raport mbi komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e hartimit të PPV Bashkia Shkodër.

1.0 Dëgjesat Publike.

- 1.1 Dëgjesë Publike për Procesin e Planit dhe gjetjet e analizave
- 1.2 Dëgjesë Publike për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit për Bashkinë Shkodër.
- 1.3 Dëgjesë Publike për Planin e Zhvillimit

2.0 Fokus Grupe.

- 2.1 Me Përfaqesues te njesive administrative Postribë, Shosh, Shale, Pult.
- 2.2 Me Përfaqesues te njesive administrative Velipojë.
- 2.3 Me Përfaqesues te njesive administrative Dajç, Anë e Malit.
- 2.4 Me Përfaqesues te qëndrave kulturore, sociale dhe organizatave jo qeveritare te cilat operojne ne zone.

3.0 Takime me Administratore, Drejtorit Lokale/Rajonale dhe Keshill Bashkiak.

- 3.1 Drejtoria e Pergjithshme e Mjedisit (MM). – Z. Julian Beqiraj
- 3.2 "Pergjegjesite Bashkiake dhe pjesemarrja qytetare" - Keshill Bashkiak
- 3.3 "Financat Vendore" - Keshill Bashkiak
- 3.4 Drejtoria mbi Menaxhimin e Emergjencave Natyrore. – Z. Ridvan Bushati
- 3.5 Drejtoria e Basenit "Drin" e "Bune". – Z. Martin Pellumbi
- 3.6 Drejtoria e Bujqesise Shkoder. – Z. Fiqiret Xhabiaj
- 3.7 Drejtoria Rajonale e Mjedisit. - Eduard Terthora

4.0 Takime Nderkufitare.

- 4.1 Takim Ndërkufitare – Shkodër
- 4.2 Takim Ndërkufitar- Podgorice

5.0 Komunikimi ne Internet dhe ne Media.

- 5.1 Pyetësor Online
- 5.2 Emision Televiziv 1
- 5.3 Emision Televiziv 2
- 5.4 Mbulim i drejtpërdrejtë i dëgjesave publike në media

Raporti mbi komunikimin dhe pjesmarrjen e qytetareve ne procesin e hartimit te PPV Bashkia Shkoder

Bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, si dhe në VKM 671 dt 29.27.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 8, pikat 3a, 3c:

“Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit organizon një ose më shumë seanca takimi publik dhe këshillimi përpara çdo vendimmarrjeje që ka lidhje me planifikimin, dhe i përsërit ato, sipas nevojës, me qëllim informimin e plotë të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e konflikteve.”

dhe

“Përmbledhja e vërejtjeve apo propozimeve gjatë takimit publik i bashkëlidhen projektit të dokumentit të planifikimit, të paraqitur për miratim, dhe njoftohet së bashku me të nëpërmjet botimit në regjistër dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit”

Bashkia Shkodër ka ngritur një platformë të hapur dhe transparente komunikimi dhe këshillimi me publikun. Platforma bazohet në disa shtylla komunikimi, e ku grupi i punes se Univeristetit Polis ka qene i pranishem;

- Prezantime të mëdha publike
- Konsulta me grupe interesi
- Fokus Grupe
- Takime me persona të rëndësishëm të cilët kanë dhënë kontribut në Shkodër
- Komunikim me anë të internetit në faqen zyrtare të Bashkisë si dhe në atë të facebook
- Media audiovizuale

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur të gjithë hapat e ndjekur për këshillimin dhe komunikimin me publikun gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër dhe grupit te punës së hartimit te Planit te Pergjithshem Vendore.

Dëgjesat Publike

Dëgjesë Publike për Procesin e Planit dhe gjetjet e analizave

Dëgjesa e parë publike mbi gjetjet e procesit te Analizes u zhvillua në dt 15 Mars 2016 në ambientet e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Te pranishëm në këtë Dëgjesë Publike ishin:

Znj. Voltana Ademi – Kryetare e Bashkisë Shkodër, Z. Dritan Meta – Zv. kryetarë i Bashkisë Shkodër, Anetare te Forumit Keshillimore Vendore, sipas dispozitave ligjore (v.k.m 671 date 20.07.2015), Eksperte te Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit (AKPT), Nenpunes te Administrates Publike Vendore e Rajonale, Grupi I punes per Hartimin e Planit Vendor (Polis University, Arizona State University), Eksperte te DLDP dhe AADF, etj. Nje pjese te rendesishme ne kete degjese e zuri edhe Shoqeria Civile, Shoqata te ndryshme, kryesisht ne sektorin e mjedisit, qe veprojne ne Shkoder.

Te ftuar te tjere ishin gjithashtu nga organizata dhe grupe interesi te ndryshem por gjithashtu edhe nga bota akademike, si profesore te universitetit "Luigj Gurakuqi", ku dhe u mbajt ky takim. Kjo Degjese Publike, ashtu si edhe dispozitat ligjore percaktojne, eshte shpallur 30 dite perpara saj dhe eshte transmetuar ne kohe reale si nga kanalet televizive lokale si edhe ata shtetore, nder to permendim: tvsh, startv, abc dhe rozafa tv.

Degjesa Publike u hap ne oren 12:00 dhe fjalimin e pare e mbajti Kryetarja e Bashkise Shkoder, zonja Voltana Ademi, e ftuar nga zv. Kryetari z. Dritan Meta.

Mbas nje falenderimi te ngrohte per te ftuarit e pjesemarresit e tjere per pranine e tyre znj. Ademi nenshtroji disa ceshtje te cilat rendesia e tyre vjen nga Hartimi I planit, si:

- a) zhvillimi I nje plani sa me gjithepershires ne te miren e interesave te qytetareve te Shkodres,
- b) sfidat te cilat plani duhet te konsideroje e qe rrjedhin nga reforma e re administrative dhe nga zgjerimi I kufirit bashkiak, duke konsideruar edhe pikat e forta e shtrirjes se re.

Dy elemente te tjere te cilet znj. Ademi I perkufizojte si sfida te rendesishme te shtrirjes se re territorial jane te lidhura me sektorin bujqesore dhe ate te menaxhimit te situatave te emergjences, si permbytjet te shkaktura nga kryzeqezimi I degeve ujore me ate te liqenit.

Ne mbyllje te fjalimit te saje, e duke garantuar nje vazhdimesi te konsultave me publikun, Kryetarja e Bashkise Shkoder ftoj grupin e punes te universitetit Polis e ate te Arizona State University.

Te paret te cilet filluan ishin 3 perfaqesues te Arizona State University, David Pijaëka, Braden Kay e Michael Umderhill I cili mbajti edhe fjalimin mbi punen e bere.

Ky prezantim u pasqyruar ne dy kapituj, a) njeri i lidhur mbi ngritjen e pyetjeve te cilat grupi i punes i vlereson si sfidat te cilat plani duhet ti marre ne konsiderate, b) dhe e dyta mbi prezantimin e disa shembujve te padeshirueshem te krijuar ne ShBA e qe rasti I Shkodres mund te evitoje, si psh shperhapja urbane dhe problemet qe rrjedhin nga ky fenomen, si menaxhimi i transportit publik apo mbledhja e mbetjeve urbane.

Disa nga sfidat te cilat grupi i punes se Arizona State University ngriti jane te lidhura me: punesimin (inkubatore formimi profesional), dendesine dhe perqendimin e sherbimeve publike, transportin, perfshirjen e shoqerise aktive ne Shkoder ne promovimin e kultures dhe siper marrjes ushqimore.

Me pas prezantimi I punes se kryer u vijua nga pasqyrimi I 'Analizes se thelluar te territorit' dhe ate te 'Metabolizmit Urban' ashtu si edhe dispozitat ligjore ne v.k.m 671 date 15.03.2015 'Mbi hartimin e PPV-s'.

Per kete grupi i punes se Universitetit Polis shfaqti zbulimet me te reja mbi territorin e ri te Bashkise Shkoder, duke filluar nga skaji me veriore i Republikes se Shqiperise (qe eshte edhe pjese e Bashkise Shkoder) deri ne Velipoje, perfshire qytetin e Shkodres.

Disa nga keto harta te prezantuara ishin:

- a) Prezantimi I Planeve te hartuar me pare, si ato te miratuar si edhe ata jo te miratuar (si psh: Plani I Pergjithshem Kombetare, PINS Bregdeti, PPV vjeter Shkoder, EPTISA per zhvillimin e Qarkut Shkoder e Lezhe sebashkuj), b) Hartat e Metabolizmit Ujore, Ushqimore dhe Energjise, c) Sistemi klimaterik, ç) Gjeoinxhenieria, d) Boniteti tokave, dh) Sistemet territorial (zonat e mbrojtura/biodiversiteti), e) Sistemi ujore, ë) Sistemi infrastrukture, f) Harta periferialitetit etj.

Ne vijim grupi punes se Universitetit Polis pasqyroj nje bashkesi analize mbi tipologjite e vendbanimeve, te ndara ne 8 klase, si; tipologjia bregdetare, tipologjia rurale-bujqesore, tipologjia suburbane liqenore e lumore, periferike urbane, qyteti, periferike informale, rurale kodrinore, rurale malore. Se fundi analiza urbane per qytetin e Shkodres pershkrojti akset kryesore rrugore ne nje hulumtim te bazuar ne karakteristikat morfologjike e funksionale, te kateve perdhe e gjithashtu te shesheve 'rruazore' te unazes se brendeshme te qytetit.

Ne mbyllje te prezantimin e te gjetjeve me te reja ne fazen e analizes fjala kaloi te pranishemeve te cilet ndoqen kete prezantim.

Karakteri i ketyre nderhyrjeve ishte si i llojit 'koment' por edhe 'pyetje'. Nder to te shumta ishin komentet te cilat vleresonin nevojën e njohjes se pjeses kulturore te qytetit te Shkodres, te ekzistences se pjeseve historike por gjithashtu edhe territoreve rurale - si bujqesia dhe turizmi i paeksploruar.

Disa nga pyetjet dhe komentet kryesore të ngritura në takim ishin:

- Cili është raporti i komprimisit që duhet të bëjë ky plan në lidhje me të dhënat? Duke qënë se mungon një databazë e integruar e të dhënave në territor? (grupi i punës është duke punuar për ngritjen e një databaze informacioni. Jemi të ndërgjegjshëm që nuk do të jetë e plotë por do të jetë e mjaftueshme për të plotësuar fazën e planifikimit. Nëse presim në pafundësi për të pasur momentin perfekt për të planifikuar nuk do të arrijmë ta bëjmë kurrë)
- Cilat janë afatet e planit? Plani ka një kohëzgjatje 10 vjeçare. Bazuar në termat e kontratës ne si grup pune kemi një afat prej 18 javësh.
- Cilat janë parashikimet për zgjerimet e zonave urbane të Shkodrës? Nuk mund të japim një përgjigje në këtë fazë për parashikimet
- A janë marrë në konsideratë planet e mëparshme të hartuara për Shkodrën? A janë analizuar faktorët të cilat kanë cuar në moszbatimin e tyre? Planet e mëparshme janë marrë në konsideratë. Janë analizuar dhe prej tyre janë nxjerrë konkluzione për elementë të cilat mund të përdoren edhe në këtë plan.
- A duhet të ketë Shkodra një zhvillim policentrik apo monocentrik? Është shumë shpejt për të dhënë një përgjigje mbi këtë gjë. Gjithësesi ne mendojmë që zhvillimi policentrik është i nevojshëm në mënyrë që të garantohet që popullsia qëndron pranë burimeve.
- A janë analizuar avantazhet konkurruese të Bashkisë Shkodër? Po avantazhet konkurruese të bashkisë shkodër janë marrë në konsideratë. Si në aspektet sektoriale ashtu dhe në raport me vendet e tjera në rajon.
- A është marrë në konsideratë fakti i bashkë-jetesës fetare në Bashkinë Shkodër? Po është marrë në konsideratë dhe ne e shohim si një pikë të favorshme për zhvillimin e bashkisë.
- A mund të zhvillohet Shkodra si një qytet port? Në të shkuarën Shkodra ka pasur një port i cili lejonte anijet tregtare deri tek Bexhisteni... Jemi duke e marrë në konsideratë që të ketë një port për qëllime të lëvizjes së turistëve. Por kursesi port mallrash.
- A është marrë në konsideratë trashëgimia kulturore dhe çfarë planesh keni ju për të ardhmen në lidhje me këtë çështje? Ne kemi analizuar problematikat në lidhje me trashëgiminë kulturore. Pa dyshim përmirësimi i aksesit dhe promovimit të tyre do të jenë pjesë e planit tonë. Gjithësesi në fazën e strategjisë do të shihen alternativat se si mund të përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme në funksion të shoqërisë dhe zhvillimit të turizmit.
- A është marrë në konsideratë trashëgimia natyrore? Çfarë po ndodh me planin e alpeve? Po trashëgimia natyrore është një faktor i rëndësishëm në lidhje me zhvillimin e Shkodrës. Plani i Alpeve është në fazën fillestare. Ne kemi marrë kontakt me studion dhe do të vijojmë më tej bisedimet dhe bashkërendimin.
- A do të rregullohet infrastruktura Shkodër-Velipojë? Gjatë verës është një problem shumë i madh edhe si rrjedhojë e lëvizjeve për qëllime bujqësore në këtë aks... Është një ndër problematikat që kemi evidentuar. Do të shihen alternativat në momentin e hartimit të planit të infrastrukturës rrugore për përmirësimin e këtij aksi.

te Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit (AKPT), Nenpunes te Administrates Publike Vendore e Rajonale, Grupi i punes per Hartimin e Planit Vendor (Polis University, Arizona State University), Eksperte te DLDP dhe AADF, qytetare te ndryshem e shume te tjere. Te ftuar te tjere ishin gjithashtu nga organizata dhe grupe interesi te ndryshem por gjithashtu edhe nga bota akademike, si profesore te universitetit “Luigj Gurakuqi”, ku dhe u mbajt ky takim.

Znj. Voltana Ademi ne fjalimin e hapjes se Degjeses Publike nenvizoje rendesine e Hartimit te ketij Plani si nje domosdoshmeri qe vjen fill pas Reformes Territoriale. Ne kete domosdoshmeri Ajo parashtroji nevojën e nje vizioni dhe te nje shtrirje sa me horizontale ne territorin e ri te Bashkise Shkoder – per te qene me afer komuniteteve dhe qytetareve. Nje rendesi te vecante Ajo i dha edhe nevojës per nje zhvillim sa me ekologjik, qe respekton natyren dhe qe ve ne levizje ato potenciale natyrore, turistike dhe ekonomike kaq te rendesishme per banoret ne zonat me rurale te Bashkise. Ballinat ujore, jane nje pjese e integruar e ketij zhvillimi me karakter ekonomik dhe turistik, por gjithashtu edhe ne cilesine e jeteses per ato banore te cilet i jetojne keto hapësira – si urbane por edhe rurale. Inovacioni teknologjik, dhe aksesueshmeria ne portalet e sherbimeve publike jane dhe do te mbeten nje nga prioritetet per Bashkine Shkoder dhe hartimin e ketij plani.

Ne mbyllje te fjalimit te saj, Znj. Voltana Ademi kryetare e Bashkise Shkoder, ftojti grupin e Universiteti Polis per te prezantuar ‘Hartimin e Strategjise se Zhvillimit’.

Ne prezantimin e Strategjise se Zhvillimit kater (4) ishin kolonat kryesore te cilat u shtri hartimi i ketij plani strategjik:

1. Roli rajonal i Bashkise Shkoder me bashkite kufitare dhe shtetet fqinje, si Mali i Zi dhe Kosova, ***në përputhje me Qëllimet e Hartimit të P.P.K (Planit të Përgjithshëm Kombëtar), në pikat e mëposhtëme:***

a. te Nxisë kohezionin territorial nëpërmjet zhvillimit të balancuar ekonomik e social të rajoneve dhe përmirësimin e konkurrencës.

2. Forcimi i brendeshem ne Bashkine Shkoder, persa i perket levizjes dhe sherbimeve, ***në përputhje me Qëllimet e Hartimit të P.P.K (Planit të Përgjithshëm Kombëtar), në pikat e mëposhtëme:***

b. të Përkrah zhvillimin e gjeneruar nga funksionet urbane mixe dhe përmirësoje marrëdhënien mes zonave urbane dhe zonave rurale,

c. te Promovojë aksesibilitet, dhe

d. te Rrise aksesin në njohuri dhe informacion.

3. Mjedisi dhe zhvillimi i tij ne menyre sa me ekologjike dhe te nderthurur me sistemin natyrore (si pjese e integruar e problematikave te nderlidhura me emergjencat natyrore), ***në përputhje me Qëllimet e Hartimit të P.P.K (Planit të Përgjithshëm Kombëtar), në pikat e mëposhtëme:***

e. te Reduktojë dëmet mjedisore,

f. te mbroje dhe përforcojë resurset natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.

4. Cilesia e jeteses e lidhur me a. **sherbimet** dhe b. **rikreativitetin/ vlerat natyrore**, ne perputhje me Axhendën Evropiane te Territorit 2020, Strategjia Evropa 2020 ,Vizionin Territorial i Evropës 2050 dhe Planit te Pergjitheshme Kombetare. Keto dokumente synojne te orientojne zhvillimin hapësinor (policentrizmin përkundrejt pabarazive hapësinore), dhe të garantojnë akses të njëjtë rajonal per njerëzit, në infrastrukturë dhe ne njohuri, ne menyre qe banoret lokale te menaxhojnë burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore në mënyrë të zgjuar e në funksion të ripërtëritjes (resilience). Ne perputhje me Udhezimet dhe Rekomandimet e mesiperme vizioni strategjik perkrah dhe i bashkengjitet konceptit te policentrizmit te shtire ne polet e vendbanimeve te komunave te vjetra, dhe orienton zhvillimin e bypass-it perendimore si barriere natyrore dhe zhvillimi i ketij territori si zone rikreative per banoret.

Nje pergjigje e vecante e ne kete faze ju dha edhe atyre shqetesimeve e komenteve te ngritura ne prezantimin e Analizave nga degjuesit, si e ardhmja e bypassi-it perendimore dhe zhvillimi Policentrik vs. Monocentrik. **Rritja e sherbimeve** ne shkalle Bashkie dhe **Perforecimi i vlerave natyrore** ishte edhe strategjia e propozuar ndaj problematikave te gjeneruara nga Reforma Territoriale, nga rreziqet natyrore, dhe nevojave ne rritje per nje nivel jetese me te larte jo vetem ne ish komunat e vjetra por edhe ne qytet.

Ne mbyllje te prezantimit fjala kaloi te pranishemeve te cilet ndoqen kete prezantim. Karakteri i ketyre nderhyrjeve ishte si i llojit 'koment' por edhe 'pyetje'. Nder to te shumta ishin komentet qe sygjeroin nje shtrirje sa me te gjere te sherbimeve administrative me rol ekonomik, social dhe gjithepershires ne qeverisjen vendore.



(Shkoder, 27 Prill 2016)

Pyetjet dhe komentet e ngritura në këtë takim:

1. Strategjia ka nevojë që të ketë disa prioritete të qarta, dy-tre, në mënyrë që më pas dhe politikant dhe programet te cilat ju keni ngritur të jenë të koordinuara dhe të harmonizuara. Përshembull prioriteti ekologjik- do të bënte që edhe projektet të fokusoheshin me një pikëpamje sa më miqësore ndaj mjedisit. (Po shumë e drejtë. Ne nuk mund të përcaktojmë prioritete për ju. Prandaj zhvillohen dëgjësas publike. Gjithësesi do të reflektohet në dokumentin e strategjisë: tre prioritete Shkodra e Gjelbër (Green and Resilient); Shkodra Smart; Shkodra e Jetueshme;)
2. Nuk jam shumë e sigurtë përsa i përket propozimit tuaj për by-pass lindor. Duke llogaritur që unaza ka vetëm pak kohë që ka përfunduar dhe nuk ka hyrë ende në efikasitet të plotë mendoj se mund të ishte një shpenzim i tepërt i cili do të shtonte qarkullimin e makinave. (Plani hartohet për një periudhë 10-15 vjeçare. Në këtë kontekst është e rëndësishme që të parashikohen infrastruktura të cilat i kalojnë problematikave afatshkurtër. By-pass lindor do të jetë në dy faza, e para e cila e lidh me unazën ekzistuese, dhe e dyta e cila kalon përtej qytetit Shkodër dhe lidhet në Shtoj me aksin Shkodër-Koplik. Gjithashtu, bypass është i nevojshëm edhe si rrjedhojë e PPK e cila parashikon si aks prioritar Han i Hotit-Shkodër. Në këtë kontekst duhet një devijim i trafikut jashtë qytetit. Bypass lindor është një zgjidhje më ekologjike dhe më e mirë për qytetin sesa ai perëndimor.)
3. A është marrë në konsideratë plani EPTISA? Përse duhen hartuar plane çdo dy vjet? A garanton afati juaj kohor që nuk do të kemi një plan të nxituar i cili do të krijojë probleme në zbatim? (Po, Plani EPTISA është marrë në konsideratë. Ky plan vjen edhe si rrjedhojë e reformës territoriale, e cila tashmë ka ndryshuar totalisht territorin e bashkisë Shkodër. Nevojitet një vizion i përgjithshëm për bashkinë. Ne jemi të ndërgjegjshëm për afatet kohore. Ato janë të përcaktuara

me VKM nga qeveria qendrore e cila është dhe financuese e tyre. Gjithësesi, ne do të bëjmë maksimumin për të kapur afatet kohore pa kompromentuar cilësinë. Nëse e shohim të arsyeshme do të kërkojmë dhe një shtyrje të planit. Deri tani kemi qënë në kohë me të gjitha kërkesat ligjore dhe kontraktuale.)

4. Mendoj se është e rëndësishme që të zhvillohet peshkimi në liqen. Nëse shohim Malin e Zi e kanë shumë të zhvilluar këtë sektor. (Po shumë e drejtë. Për këtë është parashikuar edhe programi strategjik për zhvillimin e akuakulturës)
5. Mendoj që propozimi juaj për By-Pass Lindor është shumë i mirë. By-pass perëndimor është një dëm ekologjik dhe peizazhistik i qytetit të Shkodrës.
6. Projekti i pazarit të vjetër nuk është bërë siç duhet. Është shumë kitç. A keni menduar për të bërë një projekt të ri për këtë zonë? (Ne e kemi përfshirë edhe Bexhistenin si pjesë e programit për rigjenerimin e Ballinave Ujore. Në këtë kontekst do të jetë pjesë e një masterplani më të detajuar i cili do të saktësojë dhe ndryshimet që mund të ndodhin me këtë zonë. Në këtë fazë është shumë e vështirë të japim një përgjigje të detajuar se si do të duket më vonë. Ne e shohim si pjesë të integruar me ballinën ujore)
7. Mendoj se ½ e Bashkisë Shkodër mund të zhvillohet me anë të konceptit të turizmit të qëndrueshëm. Këto përjashtoj Velipojën e cila është qëndër turizmi masiv dhe 10-fishohet gjatë periudhës së verës. (Ne kemi parashikuar zhvillimin e ekoturizmit dhe agriturizmit në pjesën e njësisë administrative postribë/ Gur i Zi/ Shosh/ Shalë/ Pult. Gjithashtu dhe si koncept i integruar me agroturizmin në njësitë e nënshkodrës.)
8. Mendoj se duhet të shtoni disa pika të tjera në itineraret tuaja turistike:
 - a. Gjeokompleksiteti i Shkodrës
 - b. Artizanatin si një degë me potencial ekonomik dhe me potencial turistik
 - c. Kultura dhe zonat arkeologjike (komentet tuaja do të merren parasysh dhe do të reflektohen në strategji. Gjithësesi në këtë fazë më shumë jepet koncepti, janë projektet ato të cilat saktësojnë edhe itineraret)
9. Liqeni i Shkodrës duhet të ketë një trajtim shumë të kujdesshëm pasi vërehet eutrofikimi i tij. (Po është pjesë e politikave tona për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu në konsultime me palën malazeze kemi rënë dakord që duhet shumë më shumë ndërveprim. Një ndërhyrje do të jetë ndalimi i të gjitha derdhjeve të ujërave të zeza në liqen. Ndërkohë në plan do të ketë dhe masa më të detajuara se në strategji përse i përket kësaj ceshtje.)
10. Zefjana është një zonë jashtë Bashkisë Shkodër të cilin duhet ta shihni me prioritet për të propozuar një fabrikë tullash (ok, është jashtë kompetencave tona. Hapja e fabrikës së tullave vjen si kërkesë e privatit, është pak e vështirë që ta përcaktojmë ne. Ajo që mund të bëjmë është që të parashikojmë një zonë industriale/ekonomike në momentin e hartimit të planit të përdorimit të tokës.)
11. Përse hidhen poshtë planet dhe hartohen plane të reja çdo dy vjet? A nuk është shpenzim parash? Kush garanton që ky plan nuk duhet hartuar sërish? (Reforma territoriale dhe ndryshimet ligjore në planifikimin e territorit kanë shkaktuar këtë konfuzion. Ne jemi të angazhuar maksimalisht për të dorëzuar një produkt cilësor. Kemi dhe angazhimin e bashkisë përse i përket zbatimit të këtij plani)
12. Duhet të shihni mundësinë e ndërtimit të një porti dhe disa pontileve në Bashkinë Shkodër (Po është marrë në konsideratë)

13. Është e rëndësishme që të shpreheni për parkimet (po janë marrë në konsideratë, janë reflektuar tek raporti)
14. Zhvillimi ekonomik, duhet të krijohen inkubatorë për sipërmarrjet e reja (po është marrë në konsideratë, është reflektuar tek raporti)
15. Duhet që Shkodra të ketë një aeroport sezonal. Është një fushë e vjetër fluturimi e cila mund të përdoret (qëllimi nuk justifikon shpenzimin. Kemi tre aerporte shumë pranë si Podgorica, Ulqin dhe Aeroporti i Rinas. Gjithashtu fusha që ju thoni tashmë nuk ka asgjë të ngjashme me një fushë për aeroport, vetëm emri i ka mbetur, është kthyer në një pikë depozitimi inertesh)
16. Duhet të parashikoni kurrën e gjelbër të Shkodrës dhe pyllëzime në tarabosh (po është e parashikuar)
17. Çfarë parashikimesh keni për Rrjollin? (zonë turistike elitare me impakt sa më të vogël në mjedis dhe në natyrë)
18. Çfarë do të ndodhë me ujërat e zeza ? (është parashikuar qëndra e trajtimit të ujërave të zeza)
19. Çfarë do të bëni për përmytjet?(është pjesë e masave të cilat do të rekomandohen në plan gjatë fazës tjetër. Gjithësesi nuk mund të japë plani i shkodrës zgjidhjen përfundimtare. Është një kombinim me institucione të tjera përtej shkodrës.)
20. Duhet mbështetur zejtaria. Është premtuar në fushatë ngritja e një qëndre panairesh tek bexhisteni? (po shumë e drejtë)
21. Gjatë hartimit të planit të kaluar, është parashikuar ndërtimi i një terminali ndërkombëtar tek pika 2.5, pranë bypass lindor. Është zgjidhja optimale për Bashkinë Shkodër. (Ai stacion është në një zonë të urbanizuar dhe banimi. Do të shtonte trafikun. Propozojmë rigjenerimin e stacionit të trenit për të promovuar dhe infrastrukturën hekurudhore)

Degjesa publike për Planin e Zhvillimit (23/06/2016)

Dëgjesa u organizua në ambientet e Universitetit të Shkodrës “ L.Gurakuqi”. Takimi filloi sipas Rendit të ditës i cili ishte bërë publik , si në ambientet e bashkisë edhe në faqën zyrtare te Bashkisë Shkodër. www.bashkiashkodër.gov.al

Në dëgjesë ishin të pranishëm, Këshilltarë te Këshillit të Bashkisë, Petagogë te Universitetit “ Luigj Gurakuqi”, përfaqësues te shoqërisë civile , Anëtarët e Forumit Këshillimor Vendor të PPV, përfaqësues të institucioneve publike, dhomës së tregëtisë, specialistë nga fusha të ndryshme si edhe banorë të Bashkisë Shkodër.

Dëgjesën e hapi Kryetarja e Bashkisë zj. Voltana Ademi e cila mbasi përshëndeti pjesëmarrësit , vlerësoi punën e bërë nga Studio e Projektimit dhe grupi teknik për materialin e përgatitur dhe në vijmësi kërkoi bashkëpunimin e të gjithë aktorëve të jenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm . zj. Ademi vlerësoi bashkëpunimin e frutshëm ndërmjet institucioneve , ku një vlerësim të vecantë bëri për Ministrinë e Zhvillimit Urban si edhe për Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit , në të njëjtën kohë një falenderim edhe për Qeverinë Shqiptarë për financimin e këtij projekti.

Zj. Ademi ndër të tjera vlerësoi edhe transparencën me të cilën është realizuar ky proces.

Më pas z. Michael Underhill , përfaqësues i “ Arizona State University” bëri një përshkrim të vizionit dhe procesit për të arritur këtë vision. Kështu qëllimi i këtij plani në fund duhet të “krijojë një qytet të jetueshëm për të gjithë”, u shpreh ndër të tjera z. Underhill. Ku përdorimi me efikasitet i mjedisit ku jetojmë dhe investimet duhet të kenë një impact sa më pozitiv. Ku në investime përfshihen si ato publike

dhe ato private. Zbatimi I zgjuar , me pjesëmarrje duke koordinuar veprimet me komunitetin do të jetë një process I përhershëm.

Më pas u kalua në një përmbledhje të gjithë procedurës së ndjekur deri në këtë moment duke filluar që nga Analiza e territorit , nga Strategjia , Vizioni ,Objektivat Progtamet etj , prezantime këto të bëra nga I gjithë grupi teknik duke filluar nga z. Besnik Aliaj, ark. Ledian Bregasi , ark Ledio Allkja.

Njëkohësisht u bë një prezantim përmbledhës nga z. Molnar Kolaneci lidhur me Menaxhimin e ujrave në Bashkinë Shkodër , si edhe disa konsiderata dhe zgjedhje në kuadër të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të bëra nga z. Sherif Lushaj.

Mbas kësaj u kalua në prezantimin e Planit I cili përmbante.

Qëllimin

Parimet e Planifikimit

Procesi

Përcaktimet që vijnë nga PPK, PINS Bregdeti

Direktivat Sektoriale.

Analiza metabolike e territorit

Analiza SËOT si edhe Konkluzionet.

Vizioni, Objektivat si edhe Sistemet (Objektivat Strategjike, Sistemet territoriale)

Programet , politikat dhe konsiderata financiare.

Plani i veprimit dhe Financat

Përmbledhëse e dëgjësive publike , konsultimeve .

Rrjeti i propozuar rrugor

Njësitë strukturore

Përdorimet kryesore të tokës.

Ky material ish përpunuar në harta në format gis si edhe në jpg, të cilat u paraqitën për audiencën.

Vëmë në dukje se i gjithë materiali, ishte i aksesueshëm për publikun shkodran dhe jo vetëm , në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër , prej rreth 10 ditë përpara se të zhvillohej Dëgjesa Publike. Aktualisht ky material vazhdon të jete i publikuar në këtë faqe ku edhe mbas kësaj dëgjësë të interesuarit të mund të marrin informacionin e kërkuar dhe njëkohësisht të paraqesin observacionet/ vlerësimet e tyre.

Një prezantim i rëndësishëm dhe me interes ishtë si do të dukej qyteti mbas realizimit të projekteve strategjike.

Mbas kësaj u kalua në pyetje dhe diskutime.

z. Peter Saraci petagog në universitetin e Shkodrës, bëri një pyetje : Cili do të jetë impakti financiar I zbatimit të planit referuar të drejtës së pronësisë? Kjo ka të bëjë pikërisht me sugjerimet e planit për zonat informale apo te përmbytjeve. Përgjigjja u dha nga z. Alija I cili vlerësoi pyetjen dhe në të njëjtën kohë shpjegoi që nuk është detyrë e PPV të përcaktojë këtë faturë financiare të këtij procesi nisur nga vetë kompleksiteti I çështjes. Njëkohësisht vuri në dukje bashkëpunimin e MZHU dhe ALUIZNIT për të qënë pjesë active e hartimit të PPV dhe detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ky Plan.Njëkohësisht theksoi se PPV zhvillohet mbi bazën e parimit të ruajtjes dhe zhvillimit të pronës private dhe njëkohësisht në rastet kur e kërkon interesi public vlerësimin e saj sipas kushteve të tregut.

z.Mustaf Lici , anëtar I Këshillit të Bashkisë, vlerësoi punën e kryer si edhe transparencën dhe shprehu opinionin e tij që ky Plan duhet të jetë vetëm në shërbim të interesit qytetar. Njëkohësisht z. Lici pyeti se në zonën Shirokë-Zogaj cfarë parashikon ky plan. Z. Alija vlerësoi interesin e këshilltarit dhe sqaroi se në këtë zonë janë parashikuar disa zona zhvillimi , gjithnjë bazuar në përdorimin e lejuar të tokës, referuar legjislacionit mjedisor , nisur nga fakti që kjo është një zonë e mbrojtur.

z. Aleks Dushi , në cilësinë e Anëtarit të Forumit Këshillimor , mbasi bëri një vlerësim të punës kërkoi te ketë një orjentim më të madh në drejtim të zhvillimit të turizmit kryesisht në qytetin e Shkodrës.

z. Mark Rupa , anëtari Këshillit të Bashkisë , kërkoi opinion se si do të trajtohen zonat informale në afersi të stacionit të trenit (hekurudhes) , nisur nga Programet Strategjike të paraqitura.

z. Xhemal Bushati , Kryetar i Këshillit të Bashkisë , këroi një sqarim lidhur me aksin Shkodër-Velipoje , projekti i të cilit po realizohet nga ARRSH, a është koordinuar më këtë institucion në mënyrë që të mos ketë mbivendosje apo shpëputje projektesh.

z. Leke Marku , banues në NjA Velipojë, njëkohësisht biznesmen në fushën e prodhimit të materialeve inerte, kërkoi që të kihet parasysh që zona në të cilën ushtrohet biznesi I tij të jetë I parashikuar në këtë Plan.

z. Luan Heta anëtar I Këshillit të Bashkisë, vlerësoi punën e kryer dhe shprehu opinionin e tij që ky Plan duhet të japë edhe zgjidhje konkrete lidhur me çështjet e përmbytjeve në zonën e Shkodrës dhe te mos ngelemi vetëm në fazën e konstatimit të problematikave.

z. Maxhid Cungu , zv/kryetar i Këshillit të Qarkut Shkodër dhe njëkohësisht anëtar I Këshillit të Bashkisë,shprehu konsideratat e tij lidhur me materialin e paraqitur dhe transparencën me të cilën është hartuar ky Plan. Njëkohësisht z. Cungu sugjeroi që në këtë Plan të kihet parasysh furnizimi I popullsisë me ujeë të pijshëm dhe të mund të përdoret burimet e Shtodrit. Njëkohësisht përmirësimi I aksit Ura e Bahcallëkut Bërdicë duhet të jetë prioritet.

Pas këtyre diskutimeve/sugjerimeve/opinioneve z. Besnik Alija garantoi të gjithë të pranishmit që vërejtjet apo sugjerimet e tyre do të vlerësoheshin nga ekspertët.

Takimin e mbylli Kryetarja e Bashkisë zj. Voltana Ademi e cila falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për mendimet e tyre, njëkohësisht falenderoi madiat të cilat e transmetuan këtë dëgjese direkt për të gjithë qytetarët.

Fokus Grupe

2.1 Fokus Grup 1- përfaqësues të njësive administrative Postrribë, Shosh, Shalë, Pult. Takimi u zhvillua në njësinë administrative Postrribë më 21 Mars 2016.

Ky takim u zhvillua ndërmjet Prezantimit të Analizave (15 Mars) dhe Hartimit të Strategjive (27 Prill) si pjesë e degjesave e konsultimeve e me nevojat lokale të komunave të reja të Bashkise Shkoder, që tashme janë ndarje administrative të të njëjtes bashki. Në këtë takim grupi i punës së Universitetit Polis prezantoi analizat e realizuara dhe të punuara për degjесen e parë të kësaj faze të leximit të territorit të ri bashkiak.

Në këtë takim ishin të pranishëm, zv. Kryetari i Bashkise Shkoder Z. Arben Gjuraj, përfaqësues të njësive administrative dhe anëtarë të tjera të Bashkise Shkoder sëbashku me banorë të zonës dhe mesues të profileve të ndryshme.

Në këtë takim tre ishin drejtimet të cilat këto komunitete ngriten arsyetimet e tyre të nevojshmerise për të trajtuar në Planin e Përgjithshëm Vendore: a) Arsimi, dhe b) Menaxhimi pyjeve dhe bujqesia. C) zhvillimi rural.

Përsa i takon arsimin nevojat u shtruan si domosdoshmeri e rritjes së aksesit në shkollë dhe situata e ofrimit të hapësirave të nevojshme për mesimdhënie.

Përsa i takon menaxhimin të pyjeve dhe bujqësisë, banorët e ngriten nevojën e pikave të grumbullimit bujqësorë dhe atij pyjorë për të pasur mundësinë e tregëtimit të këtyre produkteve. Një element tjetër, por jo me pak i rëndësishëm, ishte edhe ai i ngritur nga përfaqësues të njësive administrative më veriore të bashkise Shkoder – si bashkimi në akse rrugore e kufitare me Malin e Zi dhe Kosovën, për të afëruar këto vendbanime sa më afër me qendrat shqipfolëse.

Komentet kryesore:

1. Lidhja me Kosovën nga Drisht dhe Prekal
2. Rajone Historike të Kushtëzuar nga Basenet Ujore
3. Infrastruktura rrugore problematike (janë 40 fshatra dhe nga këto vetëm 10 të lidhura me rrugë)
4. Ka disa kështjella të cilat duhet të merren në konsideratë për itinerare turistike
5. E nevojshëm qendra e informacionit dhe përgatitja e guidave
6. Duhet të ketë projekte për energjinë elektrike duke promovuar mullinjtë me erë si dhe mullinjtë e vegjël të cilët funksionojnë me ujë
7. Promovimi i Ushqimeve BIO shihet si një potencial i rëndësishëm për këtë zonë, madje mund të ketë një projekt përse i përket tregut të produkteve BIO
8. Mbetjet Urbane mbeten një problem. Nuk qëndron problematika tek sasia e gjeneruar por tek edukimi i qytetarëve për të mos i hedhur ato në lumenj
9. Parku i thëthit duhet 3-fishuar
10. Shkollë e mesme Mes+Dragoç ka nevojë për shtim ambjentesh. Gjithashtu e nevojshme është dhe shtimi i fondeve për mirëmbajtjen
11. Është e rëndësishme të ketë një projekt përse i përket terreneve sportive
12. Pylli i Gështenjave është një potencial i mirë për zhvillimin e zonës. Janë 4000 hektarë gështenja të cilat nuk shfrytëzohen. Duhet parashikuar një qëndër grumbullimi gështenjash
13. Është e nevojshme të promovohet agro-përpunimi pasi është një nga mënyrat për të rritur vlerën e produkteve vendase
14. Është një zonë shumë e favorshme për turizmin sidomos për turizmin malor dhe ekologjik
15. Është e nevojshme një qëndër grumbullimi për bimët medicinale
16. Duhet mbështetur produktet tradicionale si qepa, pjeperi dhe perimet

17. Shkollat duhen pajisur me laborator dhe palestër
18. Është i nevojshëm rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Theth dhe rritja e sigurisë rrugore në këtë aks
19. Është e nevojshme ruajtja e arkitekturës tradicionale e cila është duke humbur gjatë kësaj periudhe
20. Duhet rritur potencialet për gjenerim të ardhurash. E shoh të domosdoshëm një treg rajonal dhe një qendër kooperative/grumbullimi për gështenja dhe bimë medicinale
21. Është e nevojshme të hartohen plane për menaxhimin e pyjeve
22. Kooperativat blegtorale janë një mundësi e mirë për zonën
23. Pyjet duhet të përdoren përmes shoqatave të pyjeve



(Postribe, 21 Mars 2016)

2.2 Fokus Grup 2- përfaqësues të njësive administrative Velipojë. Takimi u realizua me 21 Mars 2016

Takimi u zhvillua në njësine administrative Velipojë me 21 Mars 2016.

Ky takim u zhvillua ndërmjet Prezantimit të Analizave (15 Mars) dhe Hartimit të Strategjive (27 Prill) si pjesë e degjësave të konsultimeve me nevojat lokale të komunave të reja të Bashkisë Shkodër, që tashmë janë ndarje administrative të të njëjtes bashki. Në këtë takim grupi i punës së Universitetit Polis prezantoi analizat e realizuara dhe të punuara për degjësën e parë të kësaj faze të leximit të territorit të ri bashkiak.

Disa nga argumentet e shqyrtuar në këtë takim ishin të lidhura me sektorin e turizmit dhe të mirat ekonomike të cilat rrjedhin nga zhvillimi i metejshëm i këtij sektori si një burim i ardhurash të qëndrueshme për banorët e ish-komunes Velipojë.

Disa nga problemet e ngritura në këtë takim nga banorët ishin të lidhura me potencialin turistik që njësia administrative Velipojë ofron si;

a. rrjeti infrastrukturor i pamjaftueshëm për të përballuar fluksin turistik gjatë pushimeve verore. Shpesh herë, sipas komenteve të pranishmeve, ky rrjet i fluksit turistik (Shkodër - Velipojë) ndeshet në të njëtin segment me fluksin e praktikave ditore (kryesisht në sektorin e bujqësisë) të banorëve në fshatrat që kjo rrugë përkrah - duke u kthyer në burim aksidentesh dhe humbje në sektorin e turizmit.

Nevoja për krijimin e disa segmenteve të lidhura nga Velipoja me Shkodrën (për funksione dhe fluks të ndryshëm) dhe me aksin kryesor Lezhë - Shkodër në hyrje të njësive administrative Berdica, përbenin argumentin dominues dhe me karakter propozues të banorëve të zonës.

dhe b. roli turistik i Velipojes në shkallë rajonale, përkrah Shengjini-t dhe Ulqinit.

Komentet e Takimit:

1. Rruga e amortizuar dhe trafiku që krijohet gjatë verës. Gjithashtu përdorimi i rrugës kryesore edhe për qëllime bujqësore ngadalëson trafikun. Duhet një degëzim ose një rrugë bujqësore e re
2. Duhet përmirësuar lidhja me Shëngjinin nga Rrjollli
3. Duhet të shihet mundësia për krijimin e një Porti të vogël në Pulaj
4. Duhet parë mundësia e përdorimit të Diellit për prodhimin e energjisë
5. Laguna e Mortenës është një potencial i rëndësishëm natyror i cili duhet mbrojtur
6. Problematikë shumë e madhe e zonës është e lidhur me titujt e pronësisë. Mungojnë certifikatat e pronësisë
7. Duhet parë mundësia e hapjes së një dege profesionale për turizmin
8. Duhet parë mundësia e një depo grumbullimi të produkteve bujqësore
9. Duhet kufizuar patjetër shpërhapja urbane në dëm të tokës bujqësore
10. Duhet parashikuar rruga Ulqin-Velipojë-Shëngjin
11. Duhet ndërtuar disa parqe lokale në Velipojë
12. Duhet ndërtuar tregje urbane në velipojë gjatë verës
13. Lartësia e ndërtesave në brezin bregdetar duhet kufizuar
14. Dokumentat e pronësisë janë shumë problem në zonën e plazhit
15. Kanalizimet. Është bërë qendra e trajtimit por nuk janë lidhur me ndërtesat
16. Trotuaret duhet të parashikohen për secilën rrugë
17. Sinjalistika rrugore
18. Parking në qendër të velipojës
19. Duhet pastruar kanalet e kullimit dhe riparuar hidrovoret
20. Duhet parashikuar korsi të emergjencave. Janë shumë të nevojshme gjatë verës
21. Nënstacioni i velipojës duhet parashikuar
22. Grumbullimi i mbetjeve



(Velipoje, 21 Mars 2016)

2.3 Fokus Grup 3- përfaqësues të njësive administrative Dajç, Anë e Malit.

Takimi u zhvillua në njësine administrative Dajç me 21 Mars 2016.

Ky takim u zhvillua ndërmjet Prezantimit të Analizave (15 Mars) dhe Hartimit të Strategjive (27 Prill) si pjesë e degësive e konsultimeve me nevojat lokale të komunave të reja të Bashkisë Shkoder, që tashme janë ndarje administrative të të njëjtes bashki. Në këtë takim grupi i punës së Universitetit Polis prezantoi analizat e realizuara dhe të punuara për degësimin e parë të kësaj faze të leximit të territorit të bashkiak.

Disa nga argumentet e shqyrtuar ne kete takim ishte e lidhur me menaxhimin e resurseve natyrore dhe hidrike ne dobi te sektorit te bujqesise dhe tregtimit te produkteve lokale, por gjithashtu edhe te sektorit te ecoturizmit.

Mirembajtja e kanaleve vaditese e kulluese, mbrojtja nga permbytjet e tokes bujqesore, dhe mundesia per te tregtuar produktet (afersia nga nje infrastrukture kryesore ne shkalle rajonale), ishin disa nga problematikat e nevojat e shprehura ne kete fokus grup.



(Dajç, 21 Mars 2016)

Komentet e këtij takimi:

1. Turizmi Kulturor duhet parë si potencial në zonën e anës së Malit
2. Qëllimi i planit duhet të jetë që të përmirësojë kushtet e jetesës së banorëve të zonës
3. Fluksi i lëvizjeve është shumë i madh. Duhet të ketë një rrugë dytësore nga bërdisa në Velipojë
4. Duhet të krijohen lidhjet e prodhuesve vendas me prodhues të tjerë jashtë vendit
5. Është shumë e rëndësishme që të përmirësohet lidhja e fshatrave periferike me bashkinë qëndër
6. Është i rëndësishëm rehabilitimi i ujësjellësave në zonën e Anës së malit
7. Pastrimi i Prrenjve dhe i kanaleve kulluese duhet të kryhet në mënyrë periodike pasi janë burim përmbytjesh
8. Qendra e njësisë duhet rregulluar. Gjithashtu qendrat e fshatrave/ sheshet kryesore duhen rregulluar
9. Ana e Malit është portë hyrëse e Shqipërisë! Duhet rregulluar rruga dhe estetika e saj
10. Zona e nënshkodrës shquhet për prodhimin e perimeve. Duhet të ketë disa pika grumbullimi
11. Sherebela zhvillohet natyrale në Tarabosh. Duhet promovuar si produkt autentik dhe bio
12. Është e nevojshme që nga ura e bahcallëkut deri në bërdisë të konsiderohet si një hapësirë për shëtitore gjatë Drinit. Të ketë një korsi për këmbësorë dhe bicikleta
13. Zona buzë lumi duhet të parashikohet për argëtim
14. Është i rëndësishëm një terminal transporti në Bërdisë
15. Siguria rrugore është shumë e dobët. Duhet rregulluar sinjalistika
16. Harku i Bërdisës ka nevojë të ketë një zgjidhje për trafikun. Burim aksidentesh dhe trafiku gjatë verës

2.4 Fokus Grup 4- takim me përfaqësues të organizatave jo qeveritare të cilat operojnë në zonë.

Në këtë takim kishte dhe përfaqësues të institucioneve kulturore në Shkodër si drejtuesit e muzeve. Ky takim u zhvillua ndërmjet Prezantimit të Analizave (15 Mars) dhe Hartimit të Strategjive (27 Prill). Në këtë takim grupi i punës së Universitetit Polis prezantoji analizat e realizuara dhe të punuara për degjeshen e parë të kësaj faze të leximit të territorit të ri bashkiak dhe diskutoji mbi nevojat të cilat plani i përgjithshëm vendore mund të plotësojë në mënyrë që Shkodra të ketë një vizibilitet turistik më të lartë dhe një nivel kulturor produktiv në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Të shumta ishin edhe propozimet - ndër to ishte edhe ai i Bibliotekës së Qytetit për të shtrirë shërbimin e saj edhe në rrjete kulturore të kohës së lire dhe mesimore.



(Salla e Keshillit Bashkiak Shkoder, 22 Mars)

Komentet e takimit:

1. Kalaja e Shkodrës është e rrethuar nga ndërtimet. Duhet të shihet mundësia që ato të strukturohen e rregullohen ose në disa raste të zhvendosen
2. Sinjalistika kafe (objekteve kulturore) duhet të jetë një prioritet për bashkinë
3. Shkodra është një qytet muze, duhet të ketë një përqasje të integruar të turizmit kulturor. Duhet një qendër informacioni
4. Aksesimi në Kalanë e Shkodrës për autobuza është shumë problematik. Duhet parashikuar një zonë shërbimi ku parkimi të kombinohet me shitjen e suvenirëve.
5. Zona e liqenit është shumë problematike për ndotjen nga derdhja e ujërave të zeza
6. Cfare do të bëni me komunitetin rom pas urës së Bunës? Mendoj që duhet ti trajtoni në mënyrë për ti integruar me qytetin. Duhet përmirësuar kushtet e jetesës
7. Duhet zgjeruar rrjeti i bibliotekës edhe në shkolla. Duhet parë mundësia e dixhitalizimit të bibliotekës. Gjithashtu gjatë verës mund të zhvillohet bibliobus në zonat turistike. Gjithashtu ka nevojë për shtim hapësire.
8. Lulishtet janë të mbyllura dhe të rrethuara
9. Parkingjet në qytet duhen parë me prioritet
10. Duhet një hapësirë për jetën e natës
11. Disa shkolla janë të nënshfrytëzuara. Duhet parë mundësia për ti përdorur edhe si hapësira multifunktionale

12. Duhet hartuar projekte edhe në funksion të njerëzve me aftësi të kufizuara
13. Duhet zhvilluar më shumë aktivitete social kulturore
14. Duhet një zyrë e mirëfilltë për koordinimin e projekteve me OJQ

2.5 Fokus Grup 5- takim me përfaqësues të rinjve të Shkodrës i zhvilluar tek Qendra Rinore Arka.

Në këtë takim kishte përfaqësues të shoqatave kulturore në Shkodër dhe me te rinj te ndryshem. Ky takim u zhvillua ndermjet Prezantimit te Analizave (15 Mars) dhe Hartimit te Strategjive (27 Prill).

Ne kete takim te hapur ndaj qytetareve shkodrene u diskutuan tre tematika; a) Jeta nates, b) siper marrja, c) universiteti.

Komentet e para te cilat u shprehen nga te pranishmit kishin te benin pikerisht me jeten kulturore, muzikore dhe artsike per nje qytet qe di te shijoje ne menyre qytetare jeten e nates.

Siper marrja, kryesisht per te rinjte, ishte nje nga temat tjera te cilat u ngriten ne kete takim.

Zhvillimi i nje kampusi universitare, me sherbime te ndryshme, ishte nje nga kerkesat e vecanta te cilat degjuesit ja adresuan planit.



(Qendra Rinore Arka, 26 Mars)

Komentet e marra në këtë takim

1. Duhet të shihni të dhënat në open street map. Ju ndihmon në përditësimin e të dhënave
2. Duhet të rritet kontrolli publik i shpenzimeve dhe transparenca ndaj publikut
3. Duhet një zonë për jetë nate duke qënë se shkodra ka shumë të rinj dhe është qytet studentor
4. Shkodra si qytet studentor. Duhet parë mundësia e hapjes së një dege arti. Gjithashtu nuk ka nevojë për një kampus universitar. Banesat për studentë le të jenë të shpërndara në qytet. Ndërkohë të parashikohen zgjerime për universitetin.
5. Duhet një sallë për aktivitete social kulturore për të rinjtë
6. Duhet të zhvillohen sportet ujore
7. Duhet të ketë një hapje të institucioneve publike edhe në zona të tjera përtej qendrës së qytetit
8. Shumë e rëndësishme hapja e qendrave me një ndalesë

1. Takime me Administratore, Drejtorit Lokale/Rajonale.

3.1 Drejtoria e Pergjithshme e Mjedisit (MM). – Z. Julian Beqiraj / Sulejman Xhepa/ Silvanka Alshabani

Ky takim u zhvillua si pjese e informimit mbi situaten e territoreve te rendesise kombetare ne Bashkine e re Shkoder. Ne kete takim u fol mbi menaxhimin e zonave te mbrojtura dhe kryesisht mbi problematikat mjedisore te liqenit te Shkodres. Niveli i larte i metaleve te renda ishte nje nga problematikat e ngritura persa i takon ketij territori liqenore. Studimi i faktoreve ndotes, perfishire bashkepunimin me Malin e Zi, do te çonte ne orientim me te sakte te nderhyrjeve qe duhen marre ne shkalle kombetare se pari e ma pas ate lokale.

Së fundi u fol për kurorën malore të Alpeve dhe potencialin turistik që ka kjo zonë veriore e Bashkisë Shkodër ka, ndaj edhe mbrojtja dhe promovimi i vlerave natyrore, të biodiversitetit dhe të klimës të mbeten një prioritet i rëndësishëm Kombëtar.

3.2 "Pergjegjesite Bashkiake dhe pjesemarrja qytetare" - Keshill Bashkiak

Ky takim u realizua me date 20/05/2016 dhe i organizuar nga Fondacioni Gjerman Konrad Adenauer dhe Friedrich Ebert sebashku me Bashkine Shkoder ne sallën e Keshillit Bashkiak. Ky takim u organizua si pjese e programit te ketyre dy fondazione mbi pergjegjesite bashkiake dhe pjesemarrjen qytetare. Sipas nje sondazhi, me mbi 800 te intervistuar vetem ne qytetin Shkoder, shprehet optimiste per transformimet qe kane fokus hapsirat publike dhe te gjelberta. Nje vecori tjetër për të cilin u zgjodh Shkodra te behej ky takim ishte edhe fakti se Bashkia e ketij qyteti rezultoi si bashkia me niveli me te larte te informimit ne nivel te qeverisjes vendore ne rang republike. (ligji 119/2015 mbi "Te drejten e infomimit ne nivel te qeverisjes vendore"). Pas prezantimit te rezultatit, Keshilli Bashkiak diskutoji mbi menytrat te ndryshme qe mund te adresojne qytetaret persa i takon problemeve te ndryshme dhe afrimi i tyre ne axhenden e Keshillit Bashkiak.



(Salla Keshillit Bashkiak Shkoder, 20 Maj)

3.3 "Financat Vendore" - Keshill Bashkiak Shkoder

Takimi mbi projekt buxhetin e Bashkise Shkoder e realizua nga Bashkia Shkoder me date 29 Mars 2016 ku ishin te ftuar anetare te Keshillit Bashkiak dhe qytetare te ndryshem. Takimi u realizua ne forme tematikash ku fjaline hyrese Znj. Ademi ja dedikojë rendesise se hapesirave publike dhe ndergjegjesimit

te komunitetit. Me pas drejtorite perkatese, si ajo e sherbimeve social / menaxhimit te emergjencave etj, te Bashkise shfaqen programin Bashkiak mbi financat vendore. Nje risi e ketij programi ishte edhe 'Regjistri elektronik i bizneseve' i cili synon te lidh te ardhurat me sherbimet. Persa i takon zonave veriore te Bashkise Shkoder u ngrit shqetesimi se nuk ekziston nje sistem adresash.



(Ftесе Publike e Bashkise Shkoder mbi Financat Vendore)

3.4 Mbi Menaxhimin e Emergjencave Natyrore. - Bashkia Shkoder

Ky takim u realizua me date 20/05/2016 si pjese e mbledhjes se informacioneve prane drejtorive lokale ne menyre te hartimit te nje strategjie sa me afer problematikave territoriale te lidhur me kontekste specifike dhe te vecanta ndermejt tyre. Rasti ne fjale eshte i referuar menaxhimit te emergjencave civile dhe atyre natyrore. Ne kete takim nje rendesi e vecante e shprehur nga z. Bushati (Drejtor i Emergjencave Civile, mbrojtjes dhe shpetimit nga zjarri) ju dha menaxhimit te situatave te emergjences. Disa nga problematikat te cilat u ngriten jane te lidhura per bashkepunimin vertikal ndermjet institucioneve te ndryshme dhe pergjigjia ne menyre te sinkronizuar ne rrjete aktoresh. Persa i takon situatave te emergjencave rurale ku aksesimi eshte pothuajse i pamundur apo i veshtire per tu arritur (zona malore, zona te permytura) z. Bushati shprehet se bashkepunimi horizontal me shoqata apo banore lokale te ndryshme (si ajo e peshkatave), ka qene mjaft i sukseshem.

Me tej, me Reformen e Re territoriale Bashkia Shkoder perballet me nje dimension me te ndryshem te emergjencave, nga ato qe kapin flukset turistike dhe infrastrukture tek ato me rurale malore.

Me rritjen e ketyre dinamikave te emergjencave lind gjithashtu edhe nevoja e menaxhimit ne menyre sa me gjithepershiresë te aktore te ndryshem, ndaj edhe nevojat e ngritura nga kjo drejtori jane ato te shtimit te; punesuarëve sa me te kualifikuar ne kete drejtori, te burimeve te financimit dhe gjithashtu te kalimit te kopetencave administrative ne menyre qe te kete pergjigje te menjehershme ndaj emergjencave.

Nje element tjetër i rendesise se emergjencave dhe menaxhimit te tyre ishte edhe zona pergjate bypassit perendimore. Pa u futur ne ceshtje teknike te bypassit, z.Bushati u shpreh se permyjtja nga ngritja e nivelit te liqenit jo vetem qe shkakton me shume deme ekonomike dhe njerzore (per shkak te afersise nga qyteti) por mbi te gjitha zgjat me gjate ne hark kohore se permyjtja e tokave pergjate lumenjve - e kjo per shkak te vete aftesise se rrembyeshme qe lumi Drin dhe Kir ka, per te dale me pas ne Bune.



(Bashkia Shkoder - Z. Ridvan Bushati Drejtori Emergjencave Civile, Mbrojtjes dhe Shpetimit nga Zjarri)

3.5 Drejtoria e Basenit “Drin” e “Bune”. – Z. Martin Pellumbi

Ky takim u zhvillua si pjese e informimit mbi situaten e segmentit hidrik natyrore ne Bashkine Shkoder Drin - Bune. Disa nga tematikat te folur ne kete takim jane qofte te sferes turistike dhe shfrytezimit te lumit Buna per qellime te tilla, por edhe ato te lidhura me menaxhimin dhe evitimin e situatave te emergjencave ujore natyrore. Perforecimi i argjinaures pergajte ketij segmenti ujore dhe rritja e aksesit per qellime rikreative ishin disa nga propozimet e z.Pellumbi.

3.6 Drejtoria e Bujqesise Shkoder. – Z.Fiqiret Xhabiaj

Ky takim u zhvillua si pjese e informimit mbi situaten e tokes bujqesore ne Bashkine Shkoder. Ne kete takim 2 ishin tematikat e trajtuara ne menyre te vecante, njera persa i takon aftesise prodhuese te produkteve lokale dhe ajo pjese e lidhur me tregtimin e ketyre produkteve. Persa i takon aftesise prodhuese problematikat qe shfaq Bashkia e re Shkoder jane te lidhura me teknologjine e veshtire qe sektori i bujqesise has, dhe kosto e larte e karburantit qe reflekton me pas edhe kostot e ujitjes dhe te perpunimit te tokes. Pavaresisht puneve te kryera se fundi mbi thellimin e kanaleve kullues pergjate ish komunes Dajç dhe Programeve te ofruar nga Ministria e Bujqesise, ky sektor mbetet akoma ne ritme te avashte drejte shkalles rajonale te konkurrences dhe tregtimit te produktit bujqesore. Fragmentimi i tokes bujqesore ne parcela te vogla familjare ben qe ky sektor te mbetet akoma large idese se fermes - pavaresisht disa shembujve te mire qe mund te ndiqen e qe jan realizuar fale Bashkepunimit Internacional.

3.7 Drejtoria Rajonale e Mjedisit - Eduard Terthora

Ky takim u realizua me date 11 Maj 2016 si pjese e informimit mbi situaten e vendgrumbullimit te mbeturinave urbane (landfill) dhe menaxhimit te tyre. Ne kete takim u diskutua kryesisht si per sistemin e grumbullimit ashtu dhe per sfidat territoriale qe has Bashkia e re Shkoder pas Reformes Territoriale. Z. Terthora foli edhe per disa projekte pilot per te ekperimentuar por pa sukses mbi pika e grumbullimit dhe transferimit nga zonat me rural drejt landfillit.

Ky takim u shoqerua edhe me nje vizite ne vend-depozitimin e vjeter te Bashkise Shkoder, prane varrezave te Deshmoreve dhe pergjate lumit Kir.

3.8 Autoriteti Rrugor Shqiptar (Simon Prendi/ Holta Dedaj)

Takim konsultues me autoritetin rrugor Shqiptar. Në këtë takim u diskutua në lidhje me korridorin Adriatik Jonian dhe me Bypass të Shkodrës. Sipas ArrSh Adriatik Jonian do të hyjë në Shqipëri nga Muriqani dhe jo nga Han i Hotit sic eshte percaktuar ne PPK. Gjithashtu eshte diskutuar në kete takim edhe ne lidhje me bypass lindor dhe perendimor te Shkodrës. Një tjetër temë diskutimi ishte dhe rehabilitimi i rruges se velipojes ku Arrsh eshte ne proces hartimi te projektit teknik. Ky projekt do te pasqyrohet edhe ne planin e pergjithshem vendor.

Takime ndërkufitare

3.1 Takimi Ndërkufitar Shkodër

Ky takim u zhvillua në qytetin e Shkodrës. Pjesë e takimit ishin Ministria e Zhvillimit Urban/ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit/ Bashkia Shkodër/ Universiteti POLIS/ REC/ GIZ/ Bashkia Ulqin/ Ministria e Turizmit dhe Planifikimit Hapësinor Mal i Zi/ Studio CAU. Ky takim u zhvillua me ndërmjetësim të MZHU për harmonizimin e planeve. Në takim fillimisht u bë një prezantim nga pala malazeze për hartimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër dhe për Hartimin e Planit për Bashkitë përreth liqenit të Shkodrës. Pas prezantimit pati një diskutim dhe pyetje nga pala Shqiptare në lidhje me Korridorin Adriatik Ionian dhe akse të tjera lidhëse. Me prioritet u pa lidhja ujore nëpërmjet liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna. Gjithashtu lidhja Zogaj Virpazar me rrugë. U pa me rëndësi lidhja midis parqeve kombëtare si dhe lidhja me një rrugë të vogël shërbimi midis Ulqinit dhe Velipojës. U ngrit si problematikë ndotja e liqenit të Shkodrës dhe përmbytjet.

Pas prezantimit të palës malazeze, u zhvilluan disa prezantimi nga pala shqiptare ku fillimisht u prezantua nga AKPT plani i përgjithshëm kombëtar dhe PINS Bregdeti. Më pas nga Universiteti POLIS u prezantua një pjesë e strategjisë për PPV Shkodër. Në këtë pjesë pati disa diskutime të rëndësishme në lidhje me masat për përmbytjet dhe aksin lidhës Shkodër-Theth. Nga POLIS u prezantua dhe një koncept për të lidhur Thethin me Valbonën i cili pati debat veçanërisht me përfaqësues të REC mbi llojin e rrugës. Në fund të takimit u zhvillua dhe një prezantim nga AA në lidhje me shkollën verore në Shkodër.

3.2 Takime ndërkufitare (2)

Keto takime u zhvilluan ne Podgorice, prane Center for Architecture and Urbanism (CAU), e angazhuar ne hartimin e Planit te Pergjithshem Vendore te Bashkise Ulqin dhe Planit per Liqenin e Shkodres.

Ne kete takim, ashtu si edhe ne Shkodër, u shfaq interes i larte nga ana e Bashkise Ulqin lidhja e fluksit turistik te bregdetit Malazez me ate Shqiptare, duke afruar gjithnje e me shum lidhjet infrastrukturore me zonat turistike si nje fluk i vazhdueshem nga Ulqini ne Velipoje e me pas per ne Shengjin. Lidhja e ketyre pikave turistike kaq te rendesishem per bregdetin Shqiptare, ashtu si edhe P.P.K udhezoi, jo vetem qe do te sillte nje zhvillim me te qendrueshem turizmit ne keto njesi administrative por gjithashtu do te promovonte turizmin bregdetare ne mbeshtetje te komuniteteve qe jetojne ne keto zona - sipas strategjive te PINS Bregdetit.

Nje teme tjeter e cila u trajtua ishte gjithashtu edhe lidhja ujore, ajo pergjate ketyre vendbanimeve ne bregdet por edhe te atyre vendbanimive qe pershkojne Liqenin e Shkodres deri ne te dale te Lumit Buna.



Komunikimi në internet dhe me media

Përtej komunikimit me anë të degjesave publike grupi i punës së bashku me Bashkinë Shkodër kanë ndjekur dhe një fushatë informimi për komunitetin me anë të mediave online.

5.1 Televizioni

- Emision me prezencën e Besnik Aliaj dhe Sotir Dhamo

Pas zhvillimit të dëgjesës së parë publike është bërë një emision televiziv me pjesëmarrjen e Prof Besnik Aliaj dhe Dr Sotir Dhamo nga Universiteti POLIS. Në këtë emision janë shpjeguar hapat në të cilat do të kalojë plani si dhe gjetjet e para të analizave.

- Emision me prezencën e Ledio Allkja, Dritan Meta, Taulant Dibra

Ky emision është zhvilluar përpara prezantimit të Strategjisë Territoriale në Bashkinë Shkodër. Në këtë emision janë diskutuar konceptet kryesore të zhvillimit të Bashkisë. Disa nga projektet strategjike. Një hapësirë të veçantë në diskutim pati dhe zhvillimi i turizmit dhe zhvillimit rural.

- Paraqitja e të gjithë dëgjesave publike live ose të regjistruara në media

Dëgjesat publike të zhvilluara në Bashkinë Shkodër si dhe fokus grupet janë paraqitur direkt ose të regjistruara në mediat lokale.

5.2 Komunikimi në Internet

- Hedhja e dokumentave në faqen online të Bashkisë


Bashkia përtej detyrimit ligjor të paraqitjes së materialeve në Regjistrin e Integruar të Territorit, ka hedhur të gjithë dokumentat për akses publik edhe në faqen e saj online.

- Hedhja e dokumentave në faqen facebook të Bashkisë


Dokumentat për të rritur transparencën dhe zgjeruar gamën e gjerë të informimit të qytetarëve janë hedhur edhe online në faqen facebook të bashkisë.

- Zhvillimi i pyetësorit

Për të rritur sasinë e të dhënave të gjeneruara dhe mbledhur sa më shumë ide dhe komente nga qytetarët është zhvilluar dhe një pyetësor online. Në pyetësor kane marre pjese 186 veta. Disa nga pergjigjet jane si me poshte:




Q2 Moshë
Multiple Choice




| Choices | Totals |
|---------|--------|
| nen 18 | 3 |
| 18-30 | 87 |
| 30-45 | 58 |
| 45-65 | 23 |
| mbi 65 | 1 |

Q4 Nese banoni ne njesine Shkoder (Qytet Shkoder), specifiko rajonin:
Multiple Choice




| Choices | Totals |
|----------|--------|
| Rajoni 1 | 46 |
| Rajoni 2 | 40 |
| Rajoni 3 | 26 |
| Rajoni 4 | 35 |
| Rajoni 5 | 13 |
| Shiroke | 0 |
| Zogaj | 0 |

Q6 Niveli i Edukimit
Multiple Choice




| Choices | Totals |
|--------------|--------|
| I Paarsimuar | 0 |
| Fillor | 0 |
| I mesem | 25 |
| I larte | 147 |

Q7 Punesimi:
Multiple Choice




| Choices | Totals |
|----------------|--------|
| I pa pune | 39 |
| I punesuar | 75 |
| I vetepunesuar | 25 |
| Student | 31 |
| Pension | 2 |


Q13 Ne zonen ku ju banoni, cilat sherbime publike ofrohen:
Multiple Choice




Q14 Ju lutem specifikoni cilesine e sherbimit publik te furnizimit me uje te pishem
Multiple Choice




Q15 Ju lutem specifikoni cilesine e sherbimit te kanalizimeve te ujerave te zeza
Multiple Choice




Q16 Ju lutem specifikoni cilesine e mbledhjes dhe transportit te mbetjeve:
Multiple Choice




Q17 Ju lutem specifikoni cilesine e infrastruktures rrugore
Multiple Choice




Q18 Ju lutem specifikoni cilesine e ndricimit rrugor
Multiple Choice



Q19 Ju lutem specifikoni cilesine e hapesirave publike
Multiple Choice



Q20 Cilat sherbime sociale ofrohen ne zone?
Multiple Choice



Të dhënat e pyetësorit janë përdorur më pas nga grupi i punës gjatë hartimit të strategjisë dhe më pas edhe në hartimin e planit.

SHTOJCA 2- STUDIM MBI PASURITË UJORE DHE PËRMBYTJET

Bashkia e Shkodrës për vetë formën dhe shtrirjen që ka pritet të ketë një variacion të madh të elementeve klimatike dhe ujorë. Siç dihet Bashkia e Shkodrës fillon që nga bregdeti i Velipojës (kuota "0") deri në veri të alpeve në majën e Jezercës që arrin kuotat në 2692 m mbi nivelin e detit. Kufijtë e Bashkisë së Shkodrës nuk ndjekin kufijtë gjeografike të territorit dhe ndodh shpesh që një njësi gjeografike të ndërpritet nga këta kufij dhe për rrjedhojë është e vështirë të bëhet një ndarje rajonale qofte klimatike apo dhe ujore. Si njësi më të njohura që përfshihen në Bashkinë e Shkodrës përmendim vetë qytetin e Shkodrës, fusha e Nënshkodrës (fusha e Bregut të Bunës), fusha e Mbishkodrës (pjesërisht) dhe Alpet Perëndimore (pjesërisht).

1. Karakteristikat klimatike

Territori i Bashkisë Shkodër nga pikëpamja e rajonizimit klimatik përfshihet në tre zona të ndryshme klimatike dhe kjo për faktin që forma e kësaj bashkie është e zgjatur dhe fillon që nga bregdeti (Velipojë) dhe shkon deri në Alpet e Shqipërisë (në veri të Thethit).

- Zona e parë që përfshin Ultësirën e Nënshkodrës bën pjesë në nënzonën klimatike veriore mesdhetare fushore.
- Zona e dyte, që është mjaft e ngushtë, bën pjesë në nënzonën klimatike veriore mesdhetare kodrinore. Këtu duhet pasur parasysh veçoria e relievit të bashkisë së Shkodrës ku kalimi nga zona fushore në zone malore është mjaft i menjëhershëm dhe në këtë kuptim zona kodrinore pothuajse nuk ndihet.
- Zona e tretë, që bën pjesë në Alpet Shqiptare, përfshihet në zonën klimatike mesdhetare malore veriore.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ka një numër të konsiderueshëm të vendmatjeve meteorologjike të cilat shërbejnë për të karakterizuar elementet e ndryshëm klimatike. Në këtë studim janë përfshirë edhe disa vendmatje meteorologjike që ndodhen në rrethinat e Bashkisë Shkodër. Në figurën e mëposhtme paraqitet Harta e Zonave Klimatike të Shqipërisë ku është treguar në forme skematike edhe Bashkisë së Shkodrës.




Fig. 1 Ndarja e zonave klimatike të Shqipërisë

Për zonën e parë të Ultësirës së Nënshkodrës, shtrirja e kësaj fushe midis një relievi malor në veri-lindje e lindje, lartësia e vogël mbi nivelin e detit (5 deri 500 m) kushtet e një relievi pak a shumë të rrafshët dhe përmasat e kufizuara janë faktorët që kanë përcaktuar tiparet klimatike e karakteristike të saj. Midis

faktorëve lokalë përmendim, së pari shtrirjen gjeografike të kësaj fushe në skajin perëndimor të vendit tonë dhe hapja e gjerë e saj nga jug-perëndimi që lejon depërtimin lehtësisht të erërave të ngrohta detare, ndërsa ndikimi kontinental vjen nga gryka e Drinit (Vau-Dejës).

Në fushën e Nënshkodrës numri i mjaftueshëm i vendmatjeve meteorologjike krijon mundësi për një studim të hollësishëm të veçorive kryesore hidrometeorologjike. Për rastin konkret ne morëm këto vendmatje meteorologjike të cilat janë më përfaqësuese për studimin e objektit tonë si vendmatja meteorologjike Shkodër "A" me lartësi të vendmatjes $H_s=13.0$ m; Dajç $H_s=8.0$ m; Bushat $H_s= 20$ m dhe Velipojë $H_s= 5.0$ m.

| EMËRTIMI | SHKODËR | VELIPOJË |
|--|-----------------------|---------------------|
| Temperatura mesatare vjetore | 15.5 ⁰ C | 15.3 ⁰ C |
| Temp.mes.më e lartë në verë | 25.2 ⁰ C | 24 ⁰ C |
| Temp.më e lartë absolute | 40.6 ⁰ C | 33.5 ⁰ C |
| Temp.mes.më e ulët në dimër | 5.8 ⁰ C | 7.8 ⁰ C |
| Temp.më e ulët absolute | - 13.0 ⁰ C | -9.0 ⁰ C |
| Reshjet mesatare vjetore | 1800 mm | 1500 mm |
| Reshjet më të mëdha vjetore | 2720 mm | 2310 mm |
| Reshjet më të ulëta vjetore | 608 mm | 630 mm |
| Reshjet më të mëdha 24 orëshe | 239 mm | 232 mm |
| Zgjatja faktike e djellëzimit në orë vjetor | 2650 | 2720 |
| Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 0.1 mm | 99 mm | 95 mm |
| Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 1.0 mm | 96 mm | 83 mm |
| Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 10 mm | 51 mm | 51 mm |
| Lagështia relative % | 80% | 69% |
| Drejtimi mbizotërues i erës vjetore | N 10.3 | S 7.2 |
| Mbizotërimi i drejtimit të erës në verë | S 12.3 | N 2.4 |
| Mbizotërimi i drejtimit të erës në dimër | E 16.2 | N 5.3 |
| Shpejtësia mesatare e erës m/sek | 3.8 m/s | 3.7 m/s |
| Thellësia maksimale mesatare e borës cm | 10 cm | 5.0 cm |
| Avullimi mesatar (ETP)(EV) | 860, 620 mm | 880, 600 mm |

- **Diellzimi**

Dihet që dielli është burimi kryesor i jetës dhe si i tille është një nga elementet kryesore klimatike. Nga ana tjetër njohja e karakteristikave të diellzimit është e domosdoshme në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë. Elementet kryesore që po paraqesim me poshtë kanë të bëjnë me sasitë mujore të rrezatimit

të përgjithshëm (në kah/m²), zgjatja faktike e diellzimit (në orë) dhe numri mesatar i ditëve me diell. Këta elemente janë matur vetëm në stacionin meteorologjik të Shkodrës, që ka qenë stacioni i më i kompletuar.

Tab. 1 Sasitë mujore të rrezatimit të përgjithshëm (këh/m²)

| Stacioni | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|----------|-----|---|-----|----|----|------|------|------|------|------|------|-----|---------|
| Shkodër | 4.7 | 6 | 9.4 | 14 | 18 | 22.2 | 24.9 | 25.2 | 21.4 | 16.1 | 11.8 | 6.8 | 15.5 |

Tab. 2 Zgjatja faktike e diellzimit (orë)

| Stacioni | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|----------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|---------|
| Shkodër | 116.2 | 116.8 | 167.3 | 188.7 | 248.1 | 292.5 | 341.5 | 316.0 | 245.5 | 194.8 | 110.5 | 104.7 | 2442.4 |

Tab. 3 Numri mesatar i ditëve me diell*

| Stacioni | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|----------|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|---------|
| Shkodër | 22 | 22 | 26 | 27 | 30 | 30 | 31 | 31 | 29 | 29 | 24 | 21 | 322 |

* ditë me diell konsiderohen ato ditë gjatë të cilave në diagramin e aparatit krijohet djege ose gjurmë të saj të paktën për një periudhë minimale prej 6 minutash.

- **Temperatura e ajrit**

Temperatura ajrit është një nga elementët kryesorë klimatik që shërben për të karakterizuar klimën e një rajoni me regjimin e saj mesatar, me ecurinë e saj vjetore mujore e ditore si dhe vlerat ekstreme të saj ndikojnë në strukturat e veprave ndërtimore si ura, tombino etj.

Një analizë e hollësishme e kushteve klimatike të zonës në studim tregohet në grafikun e figurës 2 dhe tabelën 4 shpërndarja e temperaturave mujore e vjetore për vendmatjet meteorologjike Shkodër "A", Bushat dhe Velipojë për periudhën 40 vjeçare.

Tabela 4 Temperatura e ajrit mesatare mujore e vjetore

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Mes |
|-------------|-----|-----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-----|------|
| Shkodër "A" | 4.7 | 6.0 | 9.4 | 14.0 | 18.0 | 22.2 | 24.9 | 25.2 | 21.4 | 16.1 | 11.8 | 6.8 | 15.5 |
| Bushat Bunë | 6.2 | 8.2 | 10.3 | 13.4 | 18.2 | 21.6 | 23.9 | 23.8 | 20.4 | 15.6 | 11. | 7.3 | 15.0 |

| | | | | | | | | | | | | | |
|----------|-----|-----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-----|------|
| Velipojë | 6.6 | 8.5 | 10.3 | 13.5 | 18.2 | 22.1 | 24.0 | 23.9 | 21.2 | 16.2 | 11.9 | 7.4 | 15.3 |
|----------|-----|-----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-----|------|




Fig. 2 Shpërndarja brendavjetore e temperaturës mesatare të ajrit

Tabela 5 Temperaturat e ajrit minimale absolute të ajrit

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Më e ulëta |
|----------------|-------|-------|------|-----|-----|------|------|------|-----|-----|------|------|------------|
| Shkodër | -13.0 | -12.4 | -4.2 | 0.1 | 4.1 | 10.0 | 11.4 | 12.7 | 8.7 | 4.3 | -4.5 | -6.8 | -13.0 |
| Bushat Bunë | -11.0 | -6.8 | -3.6 | 0.0 | 5.8 | 8.0 | 10.4 | 11.7 | 5.6 | 6.8 | -2.0 | -6.3 | -11.0 |
| Velipojë | -9.0 | -2.8 | -3.1 | 3.0 | 7.0 | 11.0 | 11.7 | 11.9 | 7.5 | 0.3 | -1.5 | -4.0 | -9.0 |

Tabela 6 Temperatura e ajrit maksimale absolute mujore e vjetore

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Më e larta |
|-------------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------------|
| Shkodër "A" | 15.6 | 19.5 | 24.5 | 27.5 | 32.5 | 35.8 | 40.6 | 39.4 | 36.4 | 29.3 | 24.5 | 21.7 | 40.6 |
| Bushat Bunë | 18.6 | 21.8 | 26.5 | 31.2 | 35.2 | 36.5 | 39.5 | 39.2 | 35.9 | 33.2 | 24.0 | 19.3 | 39.5 |
| Velipojë | 13.0 | 17.8 | 19.5 | 23.1 | 28.8 | 30.4 | 33.8 | 31.0 | 28.2 | 25.1 | 20.1 | 14.3 | 33.8 |

Muaji më i ftohtë i vitit është janari me temperatura mesatare mujore nga 4.7⁰ C në Shkodër "A" dhe në Velipojë 6.6⁰ C. Muajt më të nxehtë në zonën në studim janë korriku dhe gushti me temperature mesatare mujore nga 25.5⁰ C deri 23.9⁰ C.

Minimumi absolut është -13⁰ C në Shkodër, ndërsa muaji më i nxehtë korriku 40.6⁰ C në Shkodër.

Në përgjithësi mund të themi se zona në studim ka një homogjenitet të temperaturave mesatare vjetore që luhaten nga 15.0⁰ C deri në 15.5⁰ C, ndërsa temperaturat ekstreme luhaten ato minimalet absolute nga -13⁰ C në -9.0⁰ C, maksimalet absolute nga 40.6⁰ C në 33.8⁰ C.

Tabela 7 Numri i ditëve me temperaturë minimale ≤ 0.0

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Shuma |
|-------------|-----|-----|-----|---|---|---|---|---|---|----|-----|-----|-------|
| Shkodër "A" | 5.3 | 2.5 | 1.3 | - | - | - | - | - | - | - | 0.4 | 1.8 | 11.3 |
| Bushat Bunë | 4.4 | 2.0 | 1.0 | - | - | - | - | - | - | - | 1.2 | 2.5 | 11.1 |
| Velipojë | 3.0 | 1.5 | - | - | - | - | - | - | - | - | 0.1 | 0.8 | 7.0 |

Tabela 8 Numri i ditëve me temperaturë minimale ≤ -5.0

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Shuma |
|-------------|-----|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|-----|-------|
| Shkodër "A" | 0.4 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 0.2 | 0.6 |
| Bushat Bunë | 0.8 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 0.1 | 0.9 |
| Velipojë | 0.2 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 0.2 | 0.2 |

Siç shikohet nga tabela 7 në zonën në studim kemi rreth 10 ditë me temperatura të ulëta (ditë të akullta). Ndërsa sipas tabelës 8 ditë me temperatura ≤ -5.0⁰ C kemi më pak se një ditë. Kështu që këto temperatura praktikisht janë të papërfillshme.

Reshjet atmosferike

Reshjet atmosferike janë një nga elementet më të rëndësishëm klimatik që përcaktojnë veçoritë klimatike të zonës. Në rastin projektimit të një rruge veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e drenazhimit që lidhet direkt me mbrojtjen e rrugës dhe nga ana tjetër edhe me kushtet e transportit të mjeteve lëvizëse.

Siç tregohet në grafikun e figurës 3 shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka formën e “U” që është tipike e një regjimi Mesdhetar të reshjeve. Sasia më e madhe e reshjeve pritet gjatë periudhës së ftohtë të vitit dhe muajt më të lagët janë nëntor-dhjetor-janar (Dajç-Bunë 227, 216, 223 mm; Bushat Bunë 211, 216, 214 mm). Muaji më i thatë është korriku (përkatesisht 40, 43 mm).

Sasia e reshjeve vjetore në zonën në studim është nga më të mëdhatë jo vetëm në Ultësirën Bregdetare, por edhe në të gjithë vendin. Në krahasim me vlerën mesatare në territorin shqiptar (1400 mm), kjo zonë renditet ndër zonat më të lagëta të Shqipërisë.

Në tabelën 9 jepen reshjet mujore dhe vjetore shumëvjeçare për vendmatjet meteorologjike Shkodër “A”, Dajç Bunë dhe Bushat Bunë dhe Velipojë. Duke patur parasysh sasinë maksimale për 24 orë të reshjeve dhe intensitetin për intervale të ndryshme kohe në periudha të ndryshme përsëritje (return periods), kjo zonë karakterizohet nga një intensitet të lartë reshjesh. Shih tabelën 4. në Shkodër “A” bien 239 mm, Dajç Bunë 196 mm dhe Velipojë 232 mm.

Në tabelën 10 jepen reshjet më të mëdha 24 orëshe me siguri të ndryshme.

Tabela 9 Reshjet mujore dhe vjetore

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Shuma |
|-------------|-----|-----|-----|-----|-----|----|----|----|-----|-----|-----|-----|-------|
| Shkodër | 210 | 179 | 158 | 127 | 113 | 56 | 33 | 45 | 132 | 348 | 235 | 261 | 1800 |
| Dajç Bunë | 223 | 174 | 151 | 135 | 110 | 64 | 40 | 58 | 120 | 175 | 227 | 216 | 1690 |
| Bushat Bunë | 214 | 158 | 139 | 124 | 108 | 67 | 43 | 63 | 131 | 169 | 211 | 216 | 1650 |
| Velipojë | 196 | 136 | 128 | 116 | 94 | 66 | 33 | 67 | 105 | 161 | 224 | 194 | 1520 |

Tabela 10 Reshjet më të mëdha 24 orëshe

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|-------------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|---------|
| Shkodër | 152 | 106 | 191 | 155 | 205 | 96 | 96 | 230 | 239 | 209 | 163 | 143 | 239 |
| Dajç Bunë | 101 | 136 | 68 | 76 | 182 | 131 | 55 | 85 | 125 | 113 | 196 | 152 | 196 |
| Bushat Bunë | 118 | 95 | 97 | 53 | 181 | 120 | 120 | 133 | 331 | 93 | 159 | 99 | 331 |

| | | | | | | | | | | | | | |
|----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|
| Velipojë | 135 | 163 | 192 | 145 | 232 | 137 | 65 | 127 | 163 | 130 | 146 | 177 | 232 |
|----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|

Tabela 11. Reshjet më të mëdha 24 orëshe me siguri të ndryshme

| Vendmatja | Siguritë e ndryshme | | | | |
|-------------|---------------------|-----|-----|-----|-----|
| | 1 | 2 | 5 | 10 | 20 |
| Shkodër | 281 | 260 | 219 | 192 | 160 |
| Dajç Bunë | 235 | 212 | 181 | 157 | 133 |
| Bushat Bunë | 220 | 199 | 171 | 150 | 127 |
| Velipojë | 219 | 197 | 169 | 145 | 121 |

Tabela 12. Numrit të ditëve me reshje

| Vendmatja | Numri i ditëve | | |
|-------------|----------------|---------------|----------------|
| | ≥ 0.1 mm | ≥ 1.0 mm | ≥ 10.0 mm |
| Shkodër | 128.7 | 124.8 | 66.3 |
| Dajç Bunë | 99 | 96 | 51 |
| Bushat Bunë | 116 | 96 | 57 |
| Velipojë | 95 | 83 | 51 |




Fig. 3 Shpërndarja brendavjetore e reshjeve atmosferike

Tabela 13 Vitet me reshje vjetore maksimale e minimale dhe raporti e tyre

| Vendmatja | Reshjet maksimale | | Reshjet minimale | | Raporti ndërmjet reshjeve max dhe min. |
|-------------|-------------------|------|------------------|----------|--|
| | Sasia mm | Viti | Sasia mm | Sasia mm | |
| Shkodër | 2720 | 1960 | 608 | 1907 | 4.5 |
| Bushat Bunë | 2550 | 1967 | 998 | 1953 | 2.5 |
| Dajç Bunë | 2390 | 1960 | 954 | 1953 | 2.5 |
| Velipojë | 2310 | 1968 | 630 | 1953 | 3.67 |

Siç shikohet nga tabela 13 vite të lagështa me shumë reshje atmosferike janë ato të dekadës gjashtë të shekullit të kaluar ndërsa vite të thata janë ato të dekadës pestë të shekullit XX; bën përjashtim Shkodra për faktin se vendmatja meteorologjike e qytetit Shkodër ka të dhëna meteorologjike që në shekullin nëntëmbëdhjetë, më i vjetri në Ballkan.

Bora

Në zonën në studim bora është një fenomen i rrallë dhe kur qëllon të bjerë, ajo nuk krijon shtresë. Në qoftë se krijon shtresë, koha e qëndrimit të saj është shumë e shkurtër.

Në zonën në studim, çdo vit vrojtohen mesatarisht 1 deri 5 ditë me borë. Këto ditë vrojtohen më tepër gjatë muajve të periudhës së ftohtë të vitit, sidomos dhjetor, janar dhe shkurt. Shtresa e borës qëndron gjatë vetëm gjatë dimrave të jashtëzakonshëm që shoqërohen me temperatura negative, të tilla kanë qenë dimrat e viteve 1954, 1962-63 dhe sidomos viti 1985.

Në zonën fushore trashësia mesatare e borës arrin deri në 5 cm, kurse në zonat kodrinore ajo arrin deri në 10 cm.

Tabela 14 Numri mesatar i ditëve me borë

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Shuma |
|-----------|-----|-----|-----|---|---|---|---|---|---|----|-----|-----|-------|
| Shkodër | 1.9 | 1.8 | 0.9 | - | - | - | - | - | - | - | 0.2 | 0.7 | 5.5 |
| Velipojë | 0.4 | 0.3 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 0.2 | 0.9 |

Zona në studim për shkak të ndikimit zbutës të detit Adriatik nuk ka kushte të përshtatshme për krijimin e shtresës së borës.

Sipas përpunimit statistikor të lartësisë mesatare maksimale të borës për rajonin që po studiojmë rezulton se në 2% (një herë në 50 vjet) për zonën kodrinore lartësia e borës arrin deri 30 cm; një herë në 30 vjet bora arrin 25 cm; një herë në 20 vjet arrin 20 cm dhe një herë në 10 vjet arrin në 15 cm.

Lagështia e ajrit

Si një tregues i rëndësishëm i lagështisë së ajrit shërben lagështia relative e ajrit e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik dhe njerëzor.

Siç shihet edhe nga tabela 13 më poshtë, zona e marrë në studim karakterizohet nga vlera mesatare të lagështisë relative të ajrit që luhaten në vendmatjen meteorologjike të Shkodrës nga 56 deri 76 dhe 65 deri 72 në Velipojë.

Rajoni që është marrë në studim pranë bregut Adriatik në përgjithësi ka vlera më të larta të lagështisë mesatare relative se sa pjesa e brendshme e territorit.

Vlerat më të larta të lagështisë mesatare relative përgjithësisht vrojtohen në periudhën e ftohtë të vitit, që është e lidhur me veprimtarinë ciklopikë që zhvillohen gjatë kësaj periudhe. Siç shihet edhe nga tabela, vlerat më të larta i kanë muajt dhjetor 76 dhe nëntor me 72% në Velipojë.

Gjatë muajve të verës vlerat mesatare të lagështisë relative të ajrit janë më të ulëta sidomos në muajt korrik dhe gusht që janë muajt më të ngrohtë të vitit.

Tabela 13. Mesatarja mujore e vjetore e lagështisë relative

| Vendmatja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Mes |
|-----------|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|-----|
| Shkodër | 75 | 72 | 68 | 68 | 67 | 63 | 56 | 56 | 64 | 70 | 73 | 76 | 68 |
| Velipojë | 69 | 69 | 67 | 70 | 70 | 70 | 65 | 67 | 69 | 65 | 72 | 70 | 69 |

Në zonën në studim maksimumi i lagështisë relative është në orën 4 dhe 5 ndërsa minimumi në orën 14 dhe 15. Në pjesën më të madhe të natës, lagështia relative qëndron pothuajse e pandryshuar.

Për të karakterizuar lagështinë relative të ajrit përdoret një tregues tjetër i rëndësishëm i këtij elementi, numri mesatar i ditëve me lagështi relative mbi 80% në orën 14⁰⁰ të vrojtimit.

Ky tregues gjen një përdorim të gjerë praktik. Në vendmatjet meteorologjike Shkodër ai është 57.5 ditë ndërsa në Velipojë është 40.8 ditë.

Era

Regjimi i erës ka një rëndësi të veçantë si për formimin e kushte klimatike, ashtu edhe për qëllime praktike. Për të përshkruar regjimin e erës në zonën në studim ku do të projektohet rruga Baçallëk-Gomsiqe (Velipojë) do të marrim të dhënat meteorologjike Shkodër dhe Velipojë.

Në parametrat kryesorë të erës përfshihen të dhënat për drejtimin e saj (shpeshtësia sipas drejtimeve të ndryshme), si dhe shpejtësia e saj sipas drejtimeve të ndryshme.

Tabela 14. Rastisja mesatare shumëvjeçare e drejtimit të erës dhe shpejtësia mesatare sipas drejtimeve

| Vendmatja | Q | N | | NE | | E | | SE | | S | | SË | | Ë | | NË | |
|-----------|------|-----|-----|------|-----|------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|
| | | r | sh | r | sh | r | sh | r | sh | r | sh | r | sh | r | sh | r | sh |
| Shkodër | 31.7 | 7.0 | 2.6 | 11.3 | 4.0 | 10.3 | 4.5 | 9.2 | 3.7 | 4.3 | 8.1 | 4.3 | 7.1 | 6.2 | 3.2 | 9.0 | 3.3 |
| Velipojë | 37 | 22 | 3.5 | 12 | 3.8 | 6.3 | 4.3 | 4.2 | 3.6 | 7.2 | 6.8 | 4.2 | 4.9 | 3.4 | 5.0 | 2.7 | 2.7 |

r – rastisja (shpeshtësia e drejtimit të erës)

sh- shpejtësia e erës m/s

Vendmatjet meteorologjike karakterizohen: Shkodra me vlerë 31.7 % qetësi gjatë vitit ndërsa në Velipojë kemi 37% qetësi.

Shpejtësia mesatare vjetore luhetet në kufijtë nga 2.7 m/s deri në 6.8 m/s për vendmatjen meteorologjike Shkodër, ndërsa në Velipojë luhetet 2.7 m/s deri 5.0 m/s ndërsa ajo maksimale ka arritur në raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme (tufane) nga 31 m/s deri 40 m/s.

Vlerat më të mëdha të tyre vrojtohen në stinën e dimrit kur veprimtaria cikloprike është e theksuar. Në këtë stinë shpejtësia mesatare në territorin e Ultësirës në Nënshkodrës luhetet nga 2 deri 6 m/s.

Shpejtësia mesatare mujore më të vogla të erës u përkasin muajve të periudhës së ngrohtë të vitit, veçanërisht muajt korrik dhe gusht, kurse më të mëdha janë regjistruar në stinën e dimrit veçanërisht në muajin shkurt.

Një tregues i rëndësishëm janë edhe shpejtësia mesatare e erërave vjetore sipas drejtimeve. Vlerat më të larta të shpejtësisë vrojtohen në ato drejtime që kanë rastisje më të madhe. Në Shkodër drejtimi NE është më i madhi në të gjithë zonën dhe shpejtësia është 4 m/s.

Erërat e forta 11-15 m/s dhe mbi 15 m/s janë ngjarje të rralla. Ato janë të lidhura më tepër me situata të caktuara sinoptike. Më shpesh shfaqen në gjysmën e ftohtë të vitit por nuk mungojnë dhe në periudhën e ngrohtë të vitit.




Fig. 4 Trëndafil i erës vendmatja Shkodër




Fig. 5 Trëndafil i erës vendmatja Velipojë

Për zonën e dytë të Fushës së Mbishkodrës është një sektor i ngushtë dhe për të cilin nuk ka ndonjë informacion që ta karakterizojë.

Për zonën e tretë të klimës mesdhetare malore veriore ku përfshihen Alpet është zona që përfshin pellgjet ujëmbledhës të lumit Kir (pjesa e sipërme) dhe lumit Shalë. Kjo zonë quhet ndryshe dhe Alpet perëndimore dhe është pikërisht kjo zonë që ndërpret masat ajrore me lagështi që vijnë nga Atlantiku dhe krijojnë kushte shume të favorshme për krijimin e reshjeve.

Kjo zonë dallohet për një klimë malore me dimër të ashpër e reshje te pasura shiu dhe bore dhe me verë relativisht të freskët (kryesisht në sektorin e mesëm dhe te sipërm të pellgut ujëmbledhës). Këto veçori lidhen kryesisht me karakterin e saj te mbyllur prej vargjesh malore të larta që hapet pak nga jugu, me largësinë e lartësisë nga deti etj.

Për të analizuar karakteristikat klimatike të kësaj zone do të bazohemi në të dhënat meteorologjike të vrojtuar në vendmatjet meteorologjike të Thethit dhe Kodër Shëngjergjit, të cilat ndodhen respektivisht në pjesën e sipërme dhe të mesme të pellgut ujëmbledhës të lumit Shalë.

Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 9.9°C ne vendmatjen meteorologjike ne Theth deri ne 11.2°C ne Kodër Shëngjergj. Ajo e janarit përkatësisht 0-1.5°C pra me ndryshime te papërfillshme kurse temperatura mesatare e Korrikut arrin 19.0°C ne Theth e ne 20.6°C ne Kodër Shëngjergj duke pasur një alternative mesatare përkatësisht 19.6°C e 18.4°C çka pasqyron karakterin malor të klimës. Vlera e temperaturës minimale absolute takohet ne Theth -19.3°C kurse në Kodër Shëngjergj shkon deri ne -18.5°C. Kurse ajo maksimale absolute ne Theth 33.5°C dhe në Kodër Shëngjergj 34.5°C. Në tabelën 1, 2 dhe në figurën 2 jepen karakteristikat kryesore të temperaturave për vendmatjet e Thethit dhe Kodër Shëngjergjit që ndodhen brenda pellgut.

Ditët e akullta ne pjesën e ulet janë rreth 100-110 dhe ne pjesën e larte 150-170 dite ne vit.

Tab. 1 Shpërndarja brendavjetore e temperaturave, Theth

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|-------------------|------|------|------|-----|------|------|------|------|------|------|-----|------|---------|
| Temp. Mesatare | 0.0 | 1.8 | 4.1 | 8.8 | 14.3 | 17.0 | 18.9 | 19.0 | 15.9 | 10.8 | 6.8 | 1.8 | 9.9 |
| Temp mes minimale | -3.4 | -1.7 | -0.2 | 4.2 | 9.0 | 11.7 | 13.3 | 13.4 | 10.7 | 6.2 | 2.7 | -1.7 | 5.4 |

| | | | | | | | | | | | | | |
|--------------------|-------|-------|-------|------|------|------|------|------|------|------|-------|-------|-------|
| Temp mes maksimale | 3.4 | 5.4 | 8.2 | 13.4 | 19.4 | 22.4 | 24.4 | 24.7 | 21.2 | 15.5 | 10.8 | 5.2 | 14.5 |
| Temp min absolute | -19.2 | -13.7 | -13.0 | -5.6 | 0.5 | 4.5 | 4.0 | 7.6 | 0.2 | -2.5 | -11.5 | -14.0 | -19.3 |
| Temp max absolute | 12.4 | 14.9 | 21.2 | 25.6 | 30.2 | 30.2 | 33.5 | 32 | 29.5 | 25.5 | 19.0 | 14.2 | 33.5 |

Tab. 2 Shpërndarja brendavjetore e temperaturave, Kodër Shëngjergj

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|--------------------|-------|-------|-------|------|------|------|------|------|------|------|-------|-------|---------|
| Temp. mesatare | 1.5 | 2.7 | 6.3 | 9.8 | 15.0 | 18.1 | 20.9 | 20.6 | 17.2 | 12.2 | 6.7 | 3.2 | 11.2 |
| Temp mes minimale | -1.7 | -0.9 | 2.2 | 5.4 | 9.7 | 12.9 | 15.1 | 14.9 | 11.9 | 7.7 | 3.0 | 0.3 | 6.7 |
| Temp mes maksimale | 4.7 | 6.2 | 10.5 | 14.5 | 20.3 | 23.3 | 26.8 | 27.3 | 22.0 | 16.7 | 10.2 | 6.2 | 15.7 |
| Temp min absolute | -15.5 | -18.5 | -12.0 | -3.0 | 1.4 | 4.9 | 6.2 | 8.2 | 1.2 | -2.0 | -14.0 | -11.4 | -18.5 |
| Temp max absolute | 15.0 | 17.5 | 25.0 | 25.3 | 29.5 | 32.5 | 36.0 | 35.5 | 33.7 | 27.5 | 21.0 | 16.1 | 36.0 |




Fig. 2 Shpërndarja brendavjetore e temperaturave të ajrit, Theth

Për nga sasia e reshjeve atmosferike pellgu ujëmbledhës i lumit të Shalës është nga pellgjet ujëmbledhës te Alpeve që bien shumë reshje në vit, rreth 3000 mm. Në vendmatjen meteorologjike të Thethit gjatë periudhës 1951-1990 kanë rënë 2849 mm dhe në Kodër Shëngjergj 2923 mm. Të dhënat e reshjeve mesatare mujore jepen në tabelën 3 dhe në figurën 2.

Tab. 3 Shpërndarja brendavjetore e reshjeve, Alpet Perëndimore

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|------------------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|----|----|-----|-----|-----|-----|---------|
| Thethi | 324 | 323 | 247 | 225 | 142 | 99 | 63 | 97 | 143 | 302 | 444 | 440 | 2849 |
| Kodër Shëngjergj | 357 | 329 | 259 | 228 | 153 | 114 | 55 | 98 | 159 | 288 | 447 | 437 | 2923 |




Fig. 3 Shpërndarja brendavjetore e reshjeve, Alpet

Stina më e lagët është vjeshta në të cilën bie mesatarisht rreth 1760mm në (Kodër Shëngjergj) pastaj vjen stina e dimrit me ndryshime fare të vogla (2-5%) më pak. Karakteristike për reshjet e vjeshtës është rënia e tyre kryesisht në formë shiu dhe me intensitet të madh, sidomos gjatë muajit tetor-nëntor kurse gjatë dimrit reshjet e botes zënë një vend të rëndësishëm në sektorin e sipërm (Theth). Stina e

pranverës shënon fillimin e pakësimit gradual të reshjeve, duke arritur në Kodër Shëngjergj deri 563 mm, ndërsa arrijnë minimumin në stinën e verës ku bien vetëm 10% e shumës vjetore. Numri i ditëve me reshje të vërtetuar gjatë vitit lëkundet ndërmjet 110-140 ditë. Në lartësitë e mëdha (majat e maleve) bora është e përhershme. Lartësia maksimale e shtresës së borës në pellgun ujëmbledhës arrijnë 1.5-2.5 m por mund të arrijë dhe 4m. Lartësia e borës varet shumë nga forma e relievit.

Pasuritë ujore të Bashkisë së Shkodrës

Objektet ujore të rëndësisë së veçantë për Bashkinë e Shkodrës janë objekte që paraqesin interes edhe kombëtar. Në Bashkinë e Shkodrës kemi një konvergencë të dy objekteve të rëndësishëm ujorë që janë lumi Drin dhe lumi Bunë, të cilët përfaqësojnë gati 50% të ujërave që derdhen në detin Adriatik e Jon nëpërmjet territorit të Shqipërisë. Njëkohësisht në territorin e Bashkisë Shkodër kemi dhe liqenin e Shkodrës, që është liqeni më i madh jo vetëm i Shqipërisë por edhe i gjithë gadishullit Ballkanik.

Më poshtë po rendisim objektet ujore me të rëndësishëm, që janë pjesë përbërëse e territorit të Bashkisë Shkodër:

- Liqeni Shkodrës
- Lumi Buna
- Lumi Drin
- Lumi Shalës
- Lumi Kirit
- Rezervuarët e bujqësisë etj

Duke qene se objektet ujore të sipërpërmendura janë të rëndësishëm është e kuptueshme se ato kanë qenë monitoruar në mënyrë të rregullt me anë të stacioneve hidrologjike që në rastin e Bunës apo të liqenit të Shkodrës datojnë që nga viti 1928.



Vendmatja hidrologjike, lumi Bunës Shkodër



Vendmatja hidrologjike liqeni Shkodrës, Shirokë



Vendmatja hidrologjike, Buna ish fabrika e Çimentos (bashkimi me lumin Drin)



Vendmatja hidrologjike, lumi Drin Ura e Baçallëkut

- Liqeni i Shkodrës

Liqeni i Shkodrës me një sipërfaqe të përgjithshme prej 368 km² prej të cilave 149 km² përfshihen brenda territorit të Shqipërisë, është liqeni me sipërfaqen më të madhe jo vetëm në vendin tonë por në të gjithë Gadishullin Ballkanik. Ai është i pozicionuar në kufirin midis Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe luan rolin e një rregulluesi natyror të rrjedhjes së përgjithshme ujore të lumit Buna. Ky është një liqen tipik fushor me thellësira të vogla të cilat lëkundën mesatarisht nga 7 - 10 m. Tërësia ujore Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna – Lumi Drin formon një sistem të vetëm hidrografik që grumbullon ujërat e një pellgu me sipërfaqe të përgjithshme prej 19582 km² (vete liqeni i Shkodrës ka një sipërfaqe ujëmbledhëse rreth 5180 km²). Duhet theksuar se llogaritjet e prurjeve për akse të ndryshme hidrometrike të tërësisë ujore Liqeni i Shkodrës – Lumi Drin – Lumi Buna në përgjithësi paraqesin një problem të vështirë, që kushtëzohet nga vetë natyra e veçantë hidrografike e kësaj tërësie. Derdhja e ujërave të Drinit në shtratin e Bunës, menjëherë pas daljes së saj nga liqeni i Shkodrës, jo vetëm që pengon shkarkimin e lirshëm të ujërave të liqenit në detin Adriatik, por në disa raste shkakton edhe rrjedhje në drejtim të kundërt. Në këtë nyje hidrike pengohet jo vetëm shkarkimi i ujërave të liqenit nëpërmjet Bunës, por edhe një pjesë e ndodh edhe në lumin Drin në derdhjen e tij. Në këto kushte në Bunë takohet rryme e penguar ose ndryshe rrymë me presion të ndryshueshëm. Kjo gjendje nuk ndodh në çdo kohë por vetëm në ato faza kur Drini sjell ujëra të shumta. Në bazën e të gjithë projekteve që mund të realizohen në këtë sistem ujor qëndron zgjidhja e problemit hidrologjik-hidraulik të nyjës, i cili konsiston në radhë të parë në vlerësimin e lakores së prurjes në kushtet e një regjimi jo uniform ose me presion të ndryshueshëm.


Megjithatë tërësia e problemeve që paraqiten në këtë liqen është e madhe dhe pavarësisht se ai është liqeni më i madh për nga sipërfaqja në Ballkan, ai është liqeni më pak i studiuar në vendin tonë krahasuar me liqenin e Ohrit apo të Prespës.

Proceset dhe dukuritë që kushtëzojnë regjimin hidrologjik të tërësisë zhvillohen në zona fiziko gjeografike të ndryshme dhe në shtetet fqinje me njeri-tjetrin. Pavarësisht përpjekjeve të bëra deri tani akoma nuk ka një studim tërësor të tij si nga pikëpamja hidrografike e batimetrike ashtu edhe e regjimit ujor të tij. Për këtë arsye për studimin e tyre është i domosdoshëm bashkëpunimi bilateral ndërmjet specialisteve të të dy shteteve Shqipërisë dhe Malit të Zi.

- **Aspekte hidrologjike të tërësisë ujore Liqeni Shkodrës-Bunë-Drin**


Aktualisht në sistemin ujq Liqeni Shkodrës – Buna – Drini janë në funksionim 5 vendmatje ku monitorohet niveli i ujit, prej të cilave një është në liqenin e Shkodrës në Shirokë, një është në lumin Drin në Urën e Baçallëkut dhe tre vendmatje funksionojnë në lumin Bunë dhe konkretisht në urën e Bunës në Shkodër, tek ish Fabrika e Çimentos (pika e bashkimit të Drinit me Bunën) dhe e fundit në Dajç. Të gjitha vendmatjet janë të pajisura me aparate vetëregjistruar të teknologjisë së kohës.

Siç u tha me sipër një nga problemet e ndërlikuara të këtij sistemi ujq është ndikimi i rrjedhjes ujore të lumit Drin në lumin Bune. Për ilustrim në figurën më poshtë jepen nivelet orare të matura për një periudhë dy javore të vendmatjeve të Baçallëkut dhe urës së Bunës 8.12.2008 deri 25.12.2008.



Luhatja e nivelit të ujit në vendmatjen e Drinit në Urën e Baçallëkut

08.12.2008 – 25.12.2008




Luhatja e nivelit të ujit në vendmatjen e Bunës në Urën e Shkodrës

08.12.2008 – 25.12.2008

Vihet re që luhatjet e niveleve në Urën e Baçallëkut që reflektojnë regjimin e punës të H/C të Vaut të Dejës vërehen në përmasa më të reduktuara në nivelet e Bunës në Shkodër. Ky është vetëm aspekti cilësor i problemit, ndërsa aspekti sasior është ai që është më shqetësues dhe që nuk është i lehtë për tu llogaritur në gjithë gamën e luhatjes së niveleve.


Regjimi i nivelit të ujit, Liqeni Shkodrës: Për të karakterizuar regjimin e nivelit të ujit të Liqenit të Shkodrës janë marre për baze të dhënat e vrojtuar në vendmatjen e Shirokës për periudhen 1948-2005. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur ecuria e nivelit mesatar të ujit në liqenin e Shkodrës ndër vite.

Niveli mesatar i ujit liqeni Shkodrës - Shiroke 1948-2005



Nga grafiku konstatohet si më poshtë:



1. Ecuria e nivelit mesatar vjetor tregon për një tendence ulje ndër vite sidomos pas 1980.
2. Në stadin aktual të studimeve nuk është e mundur të dallohet qarte që ky konstatim i tendencës se uljes se nivelit të ujit është i efekti i kaskadës se lumit Drin apo ndikimi i ndryshueshmërisë se klimës.
3. Ecuria e nivelit të ujit tregon për një luhatje të madhe të liqenit nga viti në vit. Kjo dukuri ndodh për shkak të hyrjeve dhe daljeve të konsiderueshme në këtë liqen (Moraça-200m³/s dhe Buna-320m³/s); Ky liqen është tepër dinamik. Ujërat e këtij liqeni rinovohen 2-2.5 herë gjatë vitit, ndërkohë që liqeni i Prespës e ka këtë kohë rreth 10-12 vjet, ndërsa liqeni i Ohrit arrin në 70-85 vjet.
4. Ky fenomen e bën liqenin e Shkodrës mjaft të ndjeshëm dhe për këtë arsye menaxhimi uJOR i tij përbën një domosdoshmëri aktuale.



Regjimi i nivelit të ujit


Shpërndarja brendavjetore e niveleve tregon për një regjim mesdhetar ku ndryshe nga ajo që pritej që shkrirja e borës të ishte një komponent i ndjeshëm, nisur nga pellgu ujëmbledhës që ka (shto edhe praninë e gëlqerorëve), konstatohet që në një fare mase ecuria e niveleve ndjek atë të reshjeve atmosferike.

1. Ushqimi kryesor i liqenit të Shkodrës në territorin shqiptar janë reshjet e bollshme në rajon si dhe prurjet nëntokësore.
2. Reshjet që bien janë kryesisht në forme shiu por shkrirja e bores është një tjetër komponent i rëndësishëm.
3. Duke pasur në konsiderate të gjithë këto faktorë pritej që në shpërndarjen brendavjetore, shkrirja e bores të ishte një komponent i ndjeshëm.
4. Nga analiza e të dhënave ka rezultuar se shpërndarja mujore e nivelit të ujit ndjek regjimin e reshjeve (shih fotot më poshtë).
5. Në përfundim mund të thuhet që liqeni i Shkodrës ka një regjim shiu tipik Mesdhetar me një ndikim të lehtë të shkrirjes së borës.




Të dhëna të batimetrisë së liqenit të Shkodrës

Kuota më e ulët e tabanit të liqenit të Shkodrës në pjesën shqiptare, është -3 m nga niveli i detit. Tabani i liqenit të Shkodrës në dalje të lumit Bunë vjen duke u rritur dhe arrin deri në kuotën 4 m mbi nivelin e detit. Në përgjithësi tabani i liqenit të Shkodrës është pothuaj i sheshtë.



Batimetria e liqenit të Shkodrës



Një profil gjatësor i tabanit të liqenit të Shkodrës

Disa të dhëna për lumenjtë e tjerë të Bashkisë Shkodër

- Lumi Shalë: Pellgu ujëmbledhës i lumit të Shalës shtrihet në qendër të Alpeve Shqiptare dhe përbën kufirin midis Alpeve Perëndimore dhe Alpeve Lindore. Lumi Shalës fillimet e veta i ka në veri nga zona e njohur me emrin Gropat e Thethit, por vija e tij ujëndarëse arrin në kuota tepër të larta siç është maja e Jezercës në lindje, 2692 m mbi nivelin e detit dhe maja e Radohimës në perëndim me kuotën 2563 m mbi nivelin e detit. Derdhet në liqenin e

Komanit dhe sipërfaqja ujëmbledhëse është rreth 260 km². Është lumi me ujëshmëri më të lartë në vendin tonë.

Prurjet mesatare mujore të lumit Shalë në Lesniqe

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|---------|
| 31.2 | 28.6 | 26.9 | 38.2 | 39.7 | 28.1 | 13.6 | 8.20 | 16.2 | 31.0 | 46.4 | 43.5 | 29.30 |

- Lumi Kir: Pellgu ujëmbledhës i lumit të Kirit ndodhet në pjesën perëndimore të Alpeve Shqiptare. Lumi i Kirit e ka zanafillën e tij nga tre degë: dega qendrore fillon nga Biga e Shalës ne kuotën 2230 m, dega e djathte ne Gjara të Boksit dhe dega e majte fillon nga qafa e Boshit. Të tri degët takohen në fshatin Bogë. Deri në vendmatjen e Rasekut ka një sipërfaqe ujëmbledhëse prej rreth 231km².

Prurjet mesatare mujore të lumit Kir në Rasek

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Vjetore |
|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|---------|
| 27.8 | 27.5 | 20.0 | 19.1 | 13.6 | 4.87 | 0.87 | 0.84 | 7.42 | 18.5 | 32.2 | 30.4 | 16.9 |

- **Disa aspekte të përmytjeve në zonën e Bashkisë Shkodër**

Përmytjet në Bashkinë e Shkodrës ndahen në përmytjen e qytetit të Shkodrës dhe në përmytjen e fushës së Nënshkodrës. Në rastin e përmytjeve të qytetit rolin kryesor e ka liqeni i Shkodrës dhe indirekt roli tjetër i takon lumit Drin. Ndërkohë që për zonën e Nënshkodrës rolin kryesor e ka lumi Drin dhe rol sekondar ka lumi Bunë.

Dy janë shkaqet kryesore:

- Shkaqe natyrore
- Shkaqe njerëzore
- Kombinimi i të dyjave



Përmytja e Shkodrës, janar 2010

Në të gjitha rastet KESH-i ka një rol parësor si në zbutjen e shkaqeve natyrore ashtu edhe në eliminimin e shkaqeve njerëzore. Të gjithë këtë procedurë KESH-i e menaxhon me anë të një Rregullore të Administrimit të Kaskadës së lumit Drin e miratuar qysh në vitin 1988. Jemi të mendimit se ka ardhur koha që kjo rregullore të rishikohet me qëllim përmirësimin e saj në kushtet e sotme si edhe të zvogëlimit të sasive maksimale të ujit nga portat e shkarkimeve.

Ngjarjet ekstreme të viteve të fundit që lidhet me përmytjet në zonën e qytetit të Shkodrës dhe të zonës së Nënshkodrës e kanë bërë emergjente marrjen e masave për uljen e ndikimit negativ të përmytjeve në këto zona. Problematike mbetet zona e Nënshkodrës ku ndryshimet demografike që janë shoqëruar me transformimin e tokave bujqësore me zona urbane, e bëjnë mjaft të vështirë mënjanimin e përmytjeve të kësaj zone.

Për mendimin tonë zgjidhja e problemit të përmytjeve në Bashkinë e Shkodrës është një problem që i kalon kufijtë e kësaj bashkie përse i përket shtrirjes së madhe prej gati 20000 km² territor dhe nga ana tjetër vështirësia e zgjidhjes nga ana teknike kërkon një ekspertizë shumë të kualifikuar ndërkombëtare.

Ekziston mendimi i përgjithshëm se një nga masat e shpejta që mund të ndërmerret me këtë rast është riparimi i argjinaturave mbrojtëse të lumit Bunë, i cili duhet paraprirë nga një studim inxhinierik nga ekspertë hidroteknik vendas të bonifikimit.

Me këtë rast përmendim dhe një ide tjetër që ka ekzistuar edhe me parë (para viteve 90) por që filloi të zbatohet për fare pak kohë dhe në mënyrë të nxituar mbas ngjarjeve të përmbytjeve të fundit 2010-2011. Është fjala për thellimin e shtratit të lumit Bunë që do të mundësonte rritjen e kapacitetit transportues të lumit Bune, gjë që do të zbuste efektin e përmbytjeve. Një ndërhyrje e tillë në lumin Bunë duhet parë me shumë kujdes sepse ekziston një rrezik tjetër që sjell largimin e një sasive të madhe të ujërave të liqenit të Shkodrës dhe për pasojë zvogëlimin e pasqyrës së liqenit. Ndërhyrje të tilla duhet detyrimisht të paraprihen me studime të rëndësishme hidraulike-inxhinierike-modeluese me qëllim shmangien e efekteve të pariparueshme në ekosistemin e liqenit të Shkodrës. Nga ideja e përpunuar para viteve 90 ka qene menduar të ndërtoheshin disa porta të komandueshme në dalje të liqenit në mënyrë që të mos ndodhte largimi i ujërave të liqenit.

Ndërmarrja e iniciativave për të bërë ndërhyrje në një sistem kaq kompleks ujon që është ai i nyjes së Shkodrës pa bërë studime fizibiliteti është me pasoja për kete territor të Bashkisë Shkodër. Për fat të keq në këto vite të fundit pikërisht në zemer të kësaj nyje ujore janë bërë disa ndertime që kanë rezultuar të pabazuara me studime paraprake përse i përket efektit të tyre në fenomenin e përmbytjeve në zonën e qytetit të Shkodër.

- Ndërtimi i dy veprave të rëndësishme në sistemin hidrografik të nyjes së Shkodrës është një nga çështjet që duhet parë me prioritet për shkak të efekteve negative që ato kanë sjellë dhe mund të sjellin në të ardhmen në fenomenet e përmbytjeve në këtë zonë. Një nga këto është Ura e Re mbi lumin Bunë





Siç mund të konstatohet vetëm nga këto pamje kemi të bëjmë me një ngushtim artificial të shtratit të Bunës. Nga njëra ane kemi pjesën e rotorit ku ndodhet mekanizmi që rrotullon dy krahët e urës. Kjo pjesë është si forme rrethore me diametër 16 m që ndodhet pothuaj në pjesën qendrore të lumit. Nga ana tjetër kemi këmbët (rreth dhjete të tilla) të urës që në formën që janë kanë patjetër kanë një rol frenues të rrjedhës ujore të Bunës. Kjo do të sillte një ngritje artificiale të nivelit në pjesën e sipërme të kësaj ure.

- Ndërtimi i dytë hidroteknik është By-Pass-i i Shkodrës i cili është ndërtuar me idenë që të mbroje qytetin nga përmbytjet. Ndërtimi i këtij by-pass-i është i papërfunduar dhe punimet janë ndërprerë dhe për pasojë ka filluar degradimi i tij.

Nga një rikonjicion i bërë konstatohen disa perceptime që edhe kjo vepër hidroteknike ka defekte serioze që në konceptimin e tij. Rrezikon që kjo vepër hidroteknike të luaj rolin e kundërt me idenë për të cilin është ndërtuar, me fjalë të tjera do të influencoj negativisht në fenomenin e përmbytjeve. Nga ana tjetër ky ndërtim rezulton i pambaruar dhe për më tepër punimet janë ndërprerë dhe kanë filluar të duken shenjat e para të degradimit të këtij ndërtimi.

Më poshtë jepen disa foto të këtij by-passi





Lidhur me problemin e përmytjeve i sugjerojmë Bashkisë së Shkodrës që të ndërmarrë disa iniciativa për kryerjen e disa veprimeve që janë me interes në këtë drejtim.

- Të iniciojë nismën për rishikimin e Rregullores së shkarkimit të prurjeve maksimale në kaskadën e lumit Drin, pranë KESH-it dhe Komitetit të Digave
 - Të krijojë një grup ekspertesh për vlerësimin e projektit të Urës së Re mbi lumin Bunë me idenë e marrjes së masave për zbutjen e efektit negativ që luan kjo urë në rastin e ngjarjeve ekstreme. Këto masa do të konsistojnë në modifikimin e këmbëve (pilave) të urës për të lehtësuar sadopak rrjedhjen e Bunës.
 - E njëjta gjë edhe për By-Pass-in e Shkodrës. Grupi i eksperteve inxhinierë do njihet me projektin për të interpretuar idenë e ndërtuesve për zbutjen e efektit të përmytjeve me anë të By-Pass-it si edhe të marrjes së veprimeve për të shmangur efektin negativ të përmytjes që mund të shkaktojë vetë By-Pass-i.
-